

FRIDRIH ENGELS

ORIGJINA E FAMILJES,
E PRONËS PRIVATE
DHE E SHITETIT



RILINDJA
Redaksia e botimeve
PRISHTINË
1976

Marrë nga libri: K. Marks — F. Engels
VEPRA TË ZGJEDHURA, II — Tiranë 1975.

ORIGJINA E FAMILJES, E PRONËS PRIVATE DHE E SHTETIT¹⁴²

PARATHËNIE PËR BOTIMIN E PARË

Kapitujt që pasojnë janë, deri në një farë pike, përmbushje e një porosie. Vetë Karl Marksi deshi t'i parashtronte rezultatet e hulumtimeve të Morganit në lidhje me të dhënat e studimit të vet — deri diku, mund të them, të studimit tonë — materialist të historisë dhe vetëm në këtë mënyrë të tregonte gjithë rëndësinë e tyre. Sepse Morgani në Amerikë zbuloi përsëri në mënyrën e vet kuptimin materialist të historisë, që kishte zbuluar Marksi dyzet vjet më parë, dhe i udhëhequr prej këtij botëkuptimi arriti, duke krahasuar barbarinë dhe qytetërimin, në pikat kryesore po në ato rezultate që arriti edhe Marksi. Dhe ashtu sikundër ekonomistët profesionistë në Gjermani për shumë vjet me radhë treguan po aq zell për të kopjuar nga „Kapitali”, sa dhe për ta mbajtur në heshtje, kështu bënë edhe përfaqësuesit e shkencës „parahistorike”

në Angli me „Shoqërinë e lashtë”^{*} të Morganit. Vepra ime mund të zëvendësojë vetëm në një shkallë të dobët atë që nuk arriti ta bënte i ndjeri miku im. Por unë kam përpara meje midis ekstrakteve të hollësishme, që ka nxjerrë Marksi nga libri i Morganit¹⁴³, vërejtjet kritike të tij, që unë do t'i përdor këtu kur këto të kenë të bëjnë me temën.

Sipas kuptimit materialist, momenti përcaktues në histori, në fund të fundit, është prodhimi dhe riprodhimi i vetë jetës. Por edhe vetë prodhimi është dy llojesh. Nga njëra anë — prodhim mjetesesh jetese, mjetesesh ushqimi, veshjeje, banese dhe veglash të domoshme për këtë gjë; nga ana tjetër — prodhimi i njeriut vetë, vazhdim i gjinisë^{**}. Rendet shoqërore, në të cilat rrojnë njerëzit e një epoke historike të caktuar dhe të një vendi të caktuar, kushtëzohen nga të dyja llojet e prodhimit: nga njëra anë — nga shkalla e zhvillimit të punës, nga ana tjetër — nga shkalla e zhvillimit të familjes. Sa më pak është e zhvilluar puna, sa më e kufizuar është sasia e produkteve të saj, dhe si rrjedhim, edhe pasuria e shoqërisë, aq më shumë duket ndikimi mbizotërues i lidhjeve gjinore mbi rendin

* „Ancient society, or Researches in the Lines of Human Progress from Savagery through Barbarism to Civilisation”. By Lewis H. Morgan. London, Macmillan and Co., 1817 [Luis H. Morgan. „Shoqëria e lashtë, ose kërkime mbi vijat e përparimit të njerëzimit nga egërsia te qytetërimi nëpërmjet barbarisë”. Londër, Makmilan e K^o, 1877]. Libri është shtypur në Amerikë, dhe në Londër është shumë vështirë ta gesh. Autori vdiq disa vjet më parë.

** Këtu Engelsi ka diçka të pasaktë, sepse vë krahas me vazhdimin e gjinisë edhe prodhimin e mjeteve të jetesës si shkaqe që përcaktojnë zhvillimin e shoqërisë dhe të rendit shoqëror. Po në vetë veprën „Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit” Engelsi tregon, duke analizuar materialin konkret, se mënyra e prodhimit material është faktori kryesor, prej të cilit varet zhvillimi i shoqërisë dhe i rendit shoqëror. *Red.*

shoqëror. Por brenda kuadrit të kësaj strukture të shoqërisë, të bazuar në lidhjet gjinore, zhvillohet gjithnjë më tepër prodhimtaria e punës, dhe bashkë me të — prona private dhe këmbimi, ndryshimet pasurore, mundësia për të përdorur fuqinë punëtore të të tjerëve dhe me këto zhvillohet edhe baza e kontradiktave të klasave: elemente të reja shoqërore, që brez pas brezi përpiqen t'ua përshtasin rendin e vjetër shoqëror kushteve të reja, derisa, më në fund, mospajtimi midis tyre shpie në një përmbysje të plotë. Shoqëria e vjetër, e bazuar në bashkësitë gjinore, përmbysset nga përleshja midis klasave shoqërore që janë formuar rishtazi; vendin e saj e zë shoqëria e re, e organizuar në shtet, hallkat më të ulëta të së cilës nuk janë më bashkësitë gjinore, por bashkësitë territoriale, — një shoqëri, ku rendi familjar u nënshtrohet plotësisht marrëdhënieve të pronës dhe ku tani e tutje zhvillohen lirisht kontradiktat e klasave dhe lufta e klasave, që përbëjnë përmbajtjen e gjithë historisë së shkruar deri në kohën tonë.

Merita e madhe e Morganit është se ai zbuloi dhe rindërtoi në vijat kryesore këtë bazë parahistorike të historisë sonë të shkruar dhe në lidhjet gjinore të indianëve të Amerikës Veriore gjeti çelësin e enigmave kryesore, të pazgjidhura deri atëherë, të historisë së lashtë greke, romake dhe gjermane. Vepra e tij nuk është punë e një dite. Ai punoi afro dyzet vjet me materialin e vet, derisa e zotëroi plotësisht. Por edhe libri i tij është një nga veprat e pakta të kohës sonë, që bëjnë epokë.

Në shtjellimin që pason lexuesi përgjithësisht do të dallojë lehtë atë që i takon Morganit dhe atë që kam shtuar unë. Në kapitujt historikë mbi Greqinë dhe mbi Romën unë nuk jam kufizuar me të dhënat e Morganit dhe kam shtuar atë që kam pasur në dorë. Kapitujt mbi keltët dhe mbi gjermanët kryesisht më

përkasin mua; Morgani këtu kishte pothuajse vetëm burime të marra nga të tjerët, dhe mbi gjermanët — përveç Tacitit — kishte vetëm falsifikimet e dobëta liberale të zotit Friman¹⁴⁴. Argumentat ekonomikë, të cilët për qëllimet e Morganit ishin të mjaftë, kurse për qëllimet e mia nuk mjaftonin fare, janë ripunuar fund e krye prej meje. Më në fund, kuptohet vetëvetiu, unë përgjigjem për të gjitha konkluzionet që janë bërë pa përmendur drejtpërdrejt Morganin.

*Botohet sipas Veprave
të K. Marksit e të F. Engelsit,
bot. i 2-të rus., vëll. 21, f. 25-27*

PARATHËNIE PËR BOTIMIN E KATËRT GJERMANISHT¹⁴⁵

Botimet e mëparshme të këtij libri, që kishin dalë me tirazh të madh, u mbaruan krejt pothuaj këtu e gjysmë viti më parë, dhe botuesi më është lutur me kohë që të pregatis një botim të ri. Punë më të ngutshme më kanë penguar deri më sot që ta bëj këtë gjë. Që kur doli në dritë botimi i parë kanë kaluar shtatë vjet, dhe gjatë kësaj kohe në studimin e formave primitive të familjes janë bërë përparime të mëdha. Prandaj këtu duheshin bërë ndreqje dhe plotësime, aq më tepër që për një farë kohe nuk do të kem mundësi të bëj ndryshime të tjera, sepse ky tekst mendohet të shtypet me klishe.

Kështu, unë e rishqyrtova me kujdes gjithë tekstin dhe bëra një sërë shtesash, në të cilat besoj se është marrë parasysh sa duhet gjendja e sotme e shkencës. Përveç kësaj, në këtë parathënie unë flas shkurt për zhvillimin e pikëpamjeve mbi historinë e familjes që nga Bahofeni deri te Morgani; unë e bëj këtë sidomos, sepse shkolla angleze e historisë primitive me tendenca shoviniste vazhdon të bëjë ç'është e mundur për ta mbytur në heshtje revolucionin që

kanë bërë zbulimet e Morganit në pikëpamjet për historinë primitive, kurse, nga ana tjetër, ajo nuk ka aspak turp të përvetësojë rezultatet e nxjerra prej Morganit. Por edhe në vende të tjera aty-këtu po e ndjekin me shumë zell këtë shembull anglez.

Vepra ime është përkthyer në gjuhë të ndryshme. Së pari italisht: „L'origine della famiglia, della proprietà privata e dello stato, versione riveduta dall'autore, di Pasquale Martignetti”, Benevento, 1885. Pastaj rumanisht: „Origina familiei, proprietatei private si a statului, traducere de Joan Nadejde”, në revistën e Jasit „Contemporanul”, prej shtatorit 1885 deri në maj 1886. Pastaj danisht: „Familjens, Privatejendommens og Statens Oprindelse, Dansk, af Forfatteren gennemgaaet Udgave, Besörger af Gerson Trier”, Köbenhavn, 1888; është në botim e sipër përkthimi frëngjisht i Anri Rave, që është bërë sipas këtij botimi gjermanisht.

* * *

Deri në fillim të vjetëve 1860—1870 as që mund të bëhej fjalë për një histori të familjes. Shkenca historike në këtë fushë ishte ende krejt nën ndikimin e Pesë librave të Moisiut. Forma patriarkale e familjes, që aty ishte pikturuar më me hollësi se kudo gjetkë, jo vetëm quhej patjetër si forma më e vjetër, por edhe identifikohet — përveç poligamisë* — me familjen e sotme borgjeze, në këtë mënyrë dilte sikur familja përgjithësisht nuk ka pasur asnjë zhvillim historik; shumë-shumë, pranohej se në kohët primitive mund të ketë pasur një periudhë marrëdhëniesh seksuale të parregullta. — Është e vërtetë se përveç monogami-

* *Poligamia* (nga greqishtja *poli* — shumë dhe *gamos* — martesë) — fjalë për fjalë martesë me shumë gra. *Red. Përkth.*

së* njihej edhe poligamia orientale dhe poliandria** indo-tibetiane; por këto tri forma nuk mund të vendoseshin sipas një rendi historik, dhe figuronin njëra pranë tjetrës pa asnjë lidhje midis tyre. Që te disa popuj të botës së lashtë, si edhe te disa të egër, që ekzistojnë edhe sot, origjina zihej jo nga ati, por nga nëna, kështu që vija e gruas pranohej si e vetmja që kishte rëndësi; që te shumë popuj të sotëm martesat janë të ndaluara brenda grupesh të caktuara, pak a shumë të mëdha, që në atë kohë nuk kishin studjuar ende për së afërmi, dhe që ky zakon gjendet në të gjitha kontinentet, — këto fakte, në të vërtetë, dihehin, dhe shembuj të tillë grumbulloheshin gjithnjë më tepër. Por se si duheshin trajtuar këto fakte, këtë nuk e dinte njeri, madje edhe në „Hulumtime mbi historinë primitive të njerëzimit“ etj. të E.B. Tejlorit (1865) ato figurojnë vetëm si „zakone të çuditshme“ bashkë me zakonet që ndalon të preken drutë e nderura me vegla hekuri dhe gjepura të tilla fetare që ekzistojnë te disa të egër.

Studimi i historisë së familjes fillon më 1861, kur doli në dritë vepra e Bahofenit „E drejta amtare“. Autori shtron aty këto teza: 1) njerëzit në krye rronin në marrëdhënie seksuale të pakufizuara, që ai i quan me fjalën jo të përshtatshme „heterizëm“***; 2) këto marrëdhënie përjashtojnë çdo mundësi për të caktuar me siguri, dhe prandaj origjina mund të caktohej ve-

* *Monogami* (nga greqishtja *monos* — i vetëm dhe *gamos* — martesë) fjalë për fjalë martesë me një burrë ose me një grua vetëm. *Red. Përkth.*

** *Poliandri* (nga greqishtja *poli* — shumë dhe *andras* burrë) — fjalë për fjalë martesë me shumë burra. *Red. Përkth.*

*** *Heterizëm* — marrëdhënie seksuale midis burrave të pamartuar ose monogamë dhe grave të pamartuara. *Red. Përkth.*

tëm nga vija e gruas — sipas së drejtës amtare, — siç ka qenë në fillim të të gjithë popujt e vjetër; 3) për këtë arsye gratë si nëna, si të vetmit prindër që di-heshin me siguri, të brezit të ri, gëzonin në një shkallë të lartë respekt dhe konsideratë, që, sipas mendimit të Bahofenit, arrinte deri në sundimin e plotë të grave (gjinekokraci); 4) kalimi në monogami, ku gruaja i përkiste vetëm një burri, ishte një shkelje e një porosie fetare shumë të vjetër. (d.m.th. në fakt një shkelje e së drejtës së lashtë të burrave të tjerë mbi këtë grua), një shkelje që duhej larë ose lejohej me kusht që si shpërblesë gruaja për një kohë të caktuar t'u jepej të tjerëve.

Provat e këtyre tezave Bahofeni i gjen në shumë citate të letërsisë së vjetër klasike, të mbledhura me zell shumë të madh. Zhvillimi nga „heterizmi” në monogami dhe nga e drejta amtare në të drejtën atërore bëhet, sipas mendimit të tij — veçanërisht te grekët, — me zhvillimin e mëtejshëm të pikëpamjeve fetare, me hyrjen e perëndive të reja, që përfaqësojnë pikëpamjet e reja, në grupin tradicional të perëndive, që personifikonte pikëpamjet e vjetra, kështu që këto të fundit shtyhen prej të parave gjithnjë më tepër në plan të fundit. Kështu, sipas Bahofenit, nuk është zhvillimi i kushteve reale të jetës së njerëzve, por pasqyrimi fetar i këtyre kushteve të jetës në kokat e po atyre njerëzve, që ka shkaktuar ndryshimet historike në gjendjen shoqërore midis burrit dhe gruas. Sipas kësaj pikëpamjeje, Bahofeni e interpreton „Orestinë” e Eskilit si paraqitje dramatike të luftës midis së drejtës amtare, që po zhduket, dhe së drejtës atërore, që lind dhe triumfon në epokën heroike. Për hir të dashnorit të saj Egjistit, Klitemnestra vrau bashkëshortin e vet Agamemnonin, që ishte kthyer nga lufta e Trojës; por Oresti, biri i saj dhe i Agamemnonit, merr hakun e t'et duke vvarë t'ëmën. Për këtë gjë e

ndjekin erinitë*, mbrojtëset demonike të së drejtës amtare, sipas së cilës vrasja e nënës është një krim shumë i rëndë, që nuk mund të lahet kurrsesi. Por Apolloni, i cili me anën e orakullit të vet e shtyri Orestin të bënte këtë vepër, dhe Athinaja, të cilën e thërrasin si gjykatëse, — që të dyja këto perëndi, që përfaqësojnë këtu rendin e ri, rendin e së drejtës atërore, — mbrojnë Orestin; Athinaja i dëgjon të dy palët. Gjithë objekti i grindjes formulohet shkurt në debatet që bëhen midis Orestit dhe erinive. Oresti thotë se Klitemnestra bëri një krim të dyfishtë duke vrarë bashkëshortin e vet dhe njëkohësisht atin e tij. Pse erinitë ndjekin Orestin, dhe jo Klitemnestrën, e cila është shumë më fajtoare se ai? Përgjegjja është e habitshme:

„Me burrin që vrau nuk ishte gjak”¹⁴⁶.

Vrasja e një njeriu, i cili nuk kishte afëri gjaku, edhe kur ky njeri është burri i gruas që e ka vrarë, mund të lahet. Kjo nuk u takon aspak erinive; puna e tyre është që të ndjekin vrasjen vetëm midis të afërmeve nga gjaku, dhe këtu, sipas së drejtës amtare, vrasja e nënës është një vrasje shumë e rëndë, që nuk mund të lahet kurrsesi. Por Apolloni del si mbrojtës i Orestit; Athinaja e hedh çështjen në votim përpara anëtarëve të aeropagut — të jurisë së Athinës; votat ndahen më dysh — për shfajësim dhe për dënim; atëherë Athinaja, si kryetare, jep votën e vet në favor të Orestit dhe e nxjerr të pafajshëm. E drejta atërore triumfoi mbi të drejtën amtare, „perënditë e brezit të ri”, siç quhen ato nga vetë erinitë, triumfojnë mbi erinitë,

* *Erinitë* (mitologji greke) — perënditë e hakmarrjes, që përytyrohen si gra me gjarpin në vend të flokëve.
Red. Përkt.

dhe në fund të fundit edhe këto pranojnë të zënë një vend të ri në shërbim të rendit të ri.

Ky interpretim i ri, por fare i drejtë i „Orestisë”, është një nga pjesët më të bukura dhe më të mira në gjithë librin e Bahofenit, por njëkohësisht provon se Bahofeni beson në erinitë, në Apollonin dhe Athinanë të paktën po aq sa besonte në kohë të vet Eskili; dhe pikërisht — ai beson se ato në epokën heroike greke kanë bërë mrekulli: përmbysën të drejtën amtare, duke e zëvendësuar me të drejtën atërore. Është e qartë se një pikëpamje e tillë, sipas së cilës feja konsiderohet si leva vendimtare e historisë së përbotshme, është, në fund të fundit, një misticizëm i kulluar. Prandaj të studjosh fund e krye vëllimin e trashë e me format të madh të Bahofenit është një punë e vështirë dhe jo gjithnjë e frytshme. Por kjo nuk e pakëson meritën e tij si studjor që ka hapur një rrugë të re; ai që i pari që zëvendësoi frazat mbi një kohë primitive të panjohur, ku marrëdhëniet seksuale ishin të parregullta, me provën se në letërsinë e vjetër klasike ka shumë gjurmë që tregojnë se te grekët dhe te popujt aziatikë përpara monogamisë ka ekzistuar me të vërtetë një gjendje e tillë kur, pa shkelur fare zakonin, jo vetëm burri ka pasur marrëdhënie seksuale me shumë gra, por edhe gruaja — me shumë burra; se ky zakon, pas zhdukjes së tij, ka lënë gjurmë — gruaja duhej ta fitonte të drejtën e monogamisë duke vajtur për një kohë të caktuar me burra të tjerë; se prandaj në fillim origjina mund të caktohej vetëm nga vija e gruas — nga nëna te nëna; se kjo rëndësi e jashtëzakonshme e vijës së nënës është ruajtur për një kohë të gjatë edhe në periudhën e monogamisë me atësi të sigurt ose të paktën të pranuar; dhe se kjo gjendje e parë e nënave, si të vetmit prindër të sigurt të bijve të vet, u siguronte atyre, dhe bashkë me këtë edhe grave përgjithësisht, një pozitë më të lartë shoqërore, që

më vonë nuk e kanë pasur kurrë më. Në të vërtetë, Bahofeni nuk i ka formuluar këto teza aq qartë — sepse e pengonte botëkuptimi i tij mistik. Por ai ato i provoi, dhe kjo në vitin 1861 ishte një revolucion i tërë.

Vëllimi i trashë i Bahofenit ka qenë shkruar gjermanisht, d.m.th. në gjuhën e një kombi që në atë kohë interesohej për parahistorinë e familjes së sotme më pak se për çdo gjë tjetër. Prandaj ky libër mbeti i panjohur. Pasardhësi më i afërm i Bahofenit po në këtë lëmë e që doli në vitin 1865, as që ia kishte dëgjuar emrin Bahofenit.

Ky pasardhës që Xh. F. Mak-Lenani, një njeri krejt i kundërt me paraardhësin e vet. Në vend të mistikut gjenial, këtu kemi juristin e thatë; në vend të fantazisë së rrëmbyer poetike, këtu kemi kombinacionet që i ngjajnë së vërtetës së avokatit që mbron një çështje para gjyqit. Mak-Lenani thotë se te shumë popuj të egër, barbarë, madje edhe të qytetëruar të kohës së lashtë dhe të kohës së re, ka një formë të tillë martese, ku dhëndrri, vetëm ose me disa miq të vet, duhet gjoja t'ua rrëmbejë nusen me forcë të afërmve të saj. Ky zakon është, siç duket, një mbeturinë e një zakoni më të vjetër, kur burrat e një fisi i rrëmbejnë me të vërtetë gratë me forcë gjatë, te fiset e tjera. Por si lindi kjo „martesë me të rrëmbyer“? Derisa burrat mund të gjenin mjaft gra në fisin e vet, nuk kishte asnjë arsye për një martesë të tillë. Por ne gjejmë po aq shpesh se te popujt e pazhvilluar ekzistojnë disa grupe (në vitin 1865 ato shpesh i identifikonin gjithnjë me vetë fiset), brenda të cilave martesë ishte ndaluar, kështu që burrat ishin të shtërnguar të merrnin gra, dhe gratë burra — jashtë grupit të vet; kurse te disa popuj ekziston një zakon, sipas të cilit burrat e një grupi i merrnin gratë e veta vetëm brenda grupit

të vet. Mak-Lenani grupet e para i quan ekzogame*, grupet e dyta i quan endogame** dhe aty për aty, pa vajtur shumë larg, ngre një kontrast të madh midis „fiseve” ekzogame dhe endogame. Dhe megjithëse vetë hulumtimet e tij mbi ekzogaminë i tregojnë atij se ky kontrast në shumë raste, në mos në shumicën ose edhe në të gjitha rastet, ekziston vetëm në përfytyrimin e tij, megjithatë ai e vë këtë si bazë të të gjithë teorisë së vet. Sipas kësaj, fiset ekzogame mund të marrin gra vetëm nga fiset e tjera, dhe kjo në një gjendje lufte të paprerë midis fiseve, siç ka qenë në periudhën e egërsisë, mund të bëhet vetëm duke rrëmbyer.

Më tutje Mak-Lenani pyet: nga doli ky zakon i ekzogamisë? Ideja e afërisë së gjakut dhe e fëlligshtisë në gjak*** këtu nuk kanë të bëjnë fare: këto janë gjëra që zhvillohen vetëm shumë më vonë. Tjetër gjë është zakoni shumë i përhapur midis të egërve për të vrarë foshnjat femra menjëherë pas lindjes së tyre. Kështu në secilin fis lind një tepricë burrash që ka si pasojë të parë të domosdoshme faktin se disa burra kanë së bashku një grua vetëm — poliandrinë. Këtej, mendon ai, rrjedh që dihej se kush ishte nëna e foshnjës, por nuk dihej se kush ishte i ati, dhe prandaj afëria llogaritej vetëm nga ana e gruas dhe jo e burrit. Kjo ishte e drejta amtare. Kurse pasojë e dytë e mungesës së grave brenda fisit — mungesë që zbutej, por nuk zhdukej nga poliandria, — ka qenë pikërisht rrëmbimi sistematik i grave të fiseve të tjera.

„Meqenëse ekzogamia dhe poliandria lindën nga i njëjti shkak, — nga pabarazia numerike e të dy seksëve, — atëherë ne duhet të themi se në të gjitha ra-

* *Egzogame* — martesë jashtë fisit. *Red. Përkth.*

** *Endogame* — martesë brenda fisit. *Red. Përkth.*

*** *Fëlligshti në gjak* — marrëdhënie seksuale midis njerëzve shumë të afërt. *Red. Përkth.*

caj ekzogame në fillim ka ekzistuar poliandria... Dhe prandaj ne duhet ta konsiderojmë të padiskutueshëm faktin se midis racave ekzogame sistemi i parë i afërisë ka qenë ai që njihte lidhjet e gjakut vetëm nga ana e nënës (Mak-Lenan, „Studime mbi historinë e lashtë”, 1886. Martesa primitive, f. 124).¹⁴⁷

Merita e Mak-Lenanit është se ai tregoi përhapjen e gjithanshme dhe rëndësinë e madhe të asaj që ai e quan ekzogami. Ai nuk *zbuloi* aspak faktin e ekzistencës së grupeve ekzogame dhe sidoqoftë nuk e kuptoi këtë. Pa përmendur vërejtjet e mëparshme të shumë vëzhguesve, — vërejtje të veçuara, që kishin qenë pikërisht burimet e Mak-Lenanit, — Lejthemi („Etnologjia përshkruese”, 1859) kishte përshkruar në mënyrë të saktë dhe të drejtë këtë sistem të magarët e Indisë¹⁴⁸ dhe kishte treguar se ky sistem ishte përhapur kudo dhe gjendej në të gjitha kontinentet, — këtë pasazh e citon vetë Mak Lenani. Por edhe Morgani ynë që më 1847 në letrat e veta mbi irokezët (të botuara në „American Review”) dhe më 1851 në librin „Lidhja e irokezëve” argumentoi ekzistencën e të njejtit sistem në këtë grup fisesh dhe dha një përshkrim të saktë të tij, kurse mendja prej avokati e Mak-Lenanit si do të shohim, ka sjellë shumë më tepër konfuzion se sa fantazia mistike e Bahofenit në fushën e së drejtës amtare. Një tjetër meritë e Mak-Lenanit është se ai njohu si rend më të parë sistemin e origjinës në bazë të së drejtës amtare, ndonëse këtë, siç e pranon edhe ai vetë më vonë, Bahofeni e kishte zbuluar më parë. Por edhe këtu ai ka gjëra të paqarta; ai flet gjithnjë për „afëri vetëm nga vija e gruas” (kinship through females only), duke përdorur kurdoherë këtë shprehje, e cila është e drejtë për një shkallë më të lashtë, edhe për shkallët më të vona të zhvillimit, kur origjina dhe e drejta e trashëgimit, në të vërtetë, pranohen ende vetëm nga vija e gruas, por afëria njihet dhe caktohet gjithashtu edhe

nga ana e burrit. Kjo është mendja e ngushtë e një juristi që ka krijuar një shprehje juridike të ngurtë dhe vazhdon ta përdorë këtë pa e ndryshuar edhe në kushte të tjera, kur kjo shprehje nuk është më e përshtatshme.

Por megjithëse i shembëllen së vërtetës, teoria e Mak-Lenanit, siç i duket edhe atij vetë, nuk është dhe aq e argumentuar mirë. Të paktën atij vetë i bie në sy

„fakti interesant se forma e rrëmbimit” (në dukje) „të grave është shprehur në mënyrë më të theksuar dhe më të prerë pikërisht te ata popuj, ku sundon afëria *maskullore*” (d.m.th. origjina nga vija e burrit) (f. 140).

Dhe më poshtë:

„Është për t'u çuditur që vrasja e foshnjave, me sa dimë, nuk praktikohet kurrë në mënyrë sistematike atje ku ekziston pranë ekzogamisë edhe forma më e lashtë e afërisë” (f. 146).

Të dyja këto fakte janë në kundërshtim të drejt-përdrejtë me mënyrën e shpjegimit të tij, dhe kundër tyre ai mund të nxjerrë vetëm hipoteza të reja, edhe më të ngatërruara.

Megjithatë, teorinë e tij në Angli e aprovuan dhe e pritën me simpati të madhe; këtu Mak-Lenanin të gjithë e quanin si themelues të historisë së familjes dhe si autoritet të dorës së parë në këtë fushë. Antiteza e tij midis „fiseve” ekzogame dhe endogame, megjithëse ishin vënë re disa përjashtime dhe ndryshime, mbetej gjithnjë baza e pranuar nga të gjithë e pikëpamjeve sunduese dhe ishte bërë si veshoke që e bënë të pamundur çdo vështrim të lirë në këtë fushë, dhe prandaj edhe çdo hap vendimtar përpara. Kundërshtimet ekzagjerimit të meritave të Mak-Lenanit, që

u bë një gjë e zakonshme në Angli, dhe sipas shembullit anglez edhe në vende të tjera, është detyra jonë të theksojmë se me antitezën e tij midis „fiseve” ekzogame dhe endogame, që është bazuar në një keqkuptim të thjeshtë, ai ka shkaktuar më shumë dëm me studimet e veta se sa ka sjellë dobi.

Ndërkaq filluan të dilnin në dritë gjithnjë më tepër fakte që nuk hynin dot në kuadrin elegant të teorisë së tij. Mak-Lenani nuk njihte veçse tri forma martesë: poligaminë, poliandrinë dhe monogaminë. Por tani që vëmendja ishte drejtuar në këtë pikë, filluan të gjenin gjithnjë më tepër prova se në popujt e pazhvilluar kishin ekzistuar forma të tilla martesë, kurdisa burra kishin së bashku disa gra; dhe *Leboku* („Origjina e qytetërimit”, 1870) e pranoi këtë martesë me grupe (Communal marriage) si një fakt historik.

Fill pas kësaj, më 1871, doli *Morgani* me një material të ri dhe nga shumë pikëpamje vendimtar. Ai u bind se sistem i veçantë i afërisë, që është në fuqi te irokezët, është një sistem i përbashkët për gjithë vendasit e Shteteve të Bashkuara dhe, si rrjedhim, i përhapur në gjithë kontinentin, ndonëse ky sistem është drejtpërdrejt në kundërshtim me shkallët e afërisë, ashtu siç rrjedhin në të vërtetë nga sistemi i martesës që ekziston atje. Ai e shtyri qeverinë federale amerikane të mblidhte, në bazë të pyetjeve dhe të pasqyrave të hartuara prej tij, informata mbi sistemet e afërisë së popujve të tjerë dhe nga përgjegjet pa: 1) se sistemi i afërisë i indianëve të Amerikës është në fuqi edhe në shumë fise të Azisë, dhe në një formë pak të ndryshme — në Afrikë dhe në Australi; 2) se ky sistem shpjegohet plotësisht me formën e martesës me grupe, e cila ndodhet pikërisht në fazën e zhdukjes në Havai dhe në ishujt e tjerë të Australisë, dhe 3) se krahas me këtë formë të martesës në po këta ishuj është në fuqi edhe një sistem afërie, që mund të shpjego-

het vetëm me një formë edhe më primitive të martesës me grupe, që sot është zhdukur. Të dhënat që mbledhi, bashkë me konkluzionet e veta, të nxjerra prej tyre, ai i botoi në veprën e vet „Sistemet e gjinisë dhe të afërisë”, 1871, dhe me këtë e hodhi diskutimin në një fushë shumë më të gjerë. Duke u nisur nga sistemet e afërisë, ai rindërtoi format e familjes, që u përgjigjen atyre, dhe, në këtë mënyrë, zbuloi një rrugë të re kërkimesh e krijoi mundësinë për të shikuar më tej në parahistorinë e njerëzimit. Po të triumfante kjo metodë, konstruksionet elegante të Mak-Lenanit do të bëheshin hi e pluhur.

Mak-Lenani e mbrojti teorinë e vet në një botim të ri të „Martesës primitive” („Studime mbi historinë e lashtë”, 1876). Ndonëse vetë e ndërton historinë e familjes në një mënyrë krejt artificiale, vetëm me anë hipotezash, ai kërkon nga Leboku dhe nga Morgani jo vetëm prova për çdo tezë të tyre, por edhe prova të pakundërshtueshme, prova nga ato që i pranon vetëm gjyqi i Skocisë. Dhe këtë e bën po ai njeri, i cili, duke u mbështetur në lidhjen e ngushtë midis vëllait të nënës dhe djalit të motrës te gjermanët (Taciti, „Germania”, kapitulli 20), në tregimet e Cezarit se te bretonët çdo dhjetë ose dymbëdhjetë burra kanë gra të përbashkëta dhe në gjithë tregimet e tjera të shkrimtarëve të vjetër mbi bashkësinë e grave te barbarët, nxjerr pa ngurruar përfundimin se në të gjithë këta popuj ka sunduar poliandria! Të duket sikur po dëgjon një prokuror që mund t'i lejojë vetes liri të plotë në përdorimin e materialit për akuzën, kurse nga mbrojtësi kërkon provën më kategorike me fuqi juridike për çdo fjalë.

Martesa me grupe është një trillim i kulluar, thotë ai, duke mbetur kështu shumë më prapa nga Bahofeni. Sistemi i afërisë te Morgani — sipas mendimit të tij — nuk është gjë tjetër veçse rregulla të thjeshta

mirësjelljeje shoqërore, dhe kjo provohet nga fakti se indianët u drejtohen edhe të huajve — të bardhëve — me fjalën vëlla ose atë. Kjo është njësoj sikur t'i tekej kujt të thoshte se fjalët atë, nënë, vëlla, motër janë forma të thjeshta thirrjeje, që nuk kanë asnjë kuptim, sepse priftërinjtë katolikë dhe abateshat thirren gjithashtu etër dhe nëna, dhe sepse murgjit dhe murgjeshat, madje edhe masonët edhe anëtarët e shoqërive të esnafëve në Angli në mbledhjet solemne i drejtohen shoqi-shoqit me fjalën vëlla dhe motër. Me një fjalë, mbrojtja e Mak-Lenanit ka qenë fare e dobët.

Por mbetej edhe një pikë ku ai nuk ishte goditur. Kontrasti midis „fiseve” ekzogame dhe endogame, mbi të cilin mbështetej gjithë sistemi i tij, jo vetëm nuk ishte tronditur, por pranohej nga të gjithë si guri themeltar i gjithë historisë së familjes. Franonin se shpjegimi që u mundua t'i jepte Mak-Lenani këtij kontrasti nuk ishte i mjaftueshëm dhe ishte në kundërshtim me faktet që tregonte ai vetë. Por vetë ky kontrast, ekzistenca e dy lloj fisesh më vete dhe të pavarura, që përjashtojnë njëri-tjetrin, prej të cilave disa i merrnin gratë brenda fisit, kurse të tjerët këtë gjë e kishin fare të ndaluar, merrej si ungjill i pakundërshtueshëm. Krahaso, për shembull, Zhiro-Tëlonin, „Origjina e familjes” (1874), madje dhe Lebokun, „Origjina e qytetërimit” (botim i 4-të, 1882).

Kundër kësaj pike drejtohet vepra kryesore e Morganit: „Shoqëria e lashtë” (1877), — vepër që është marrë si bazë për studimin që po ju paraqesim. Këtu është zhvilluar me qartësi të plotë ajo që Morgani më 1871 vetëm e kishte marrë me mend në mënyrë të errët. Endogamia dhe ekzogamia nuk përbëjnë aspak një kontrast; ekzistenca e „fiseve” ekzogame deri më sot nuk është provuar asgjëkund. Por në atë kohë, kur sundonte ende martesat me grupe, — dhe kjo mar-

tesë ka shumë të ngjarë të ketë sunduar dikur kudo; — fisi ndahej në disa grupe që ishin në afëri gjaku nga vija e nënës, brenda të cilave martesat ishte rreptësisht e ndaluar, kështu që burrat e një gjinie, megjithëse mund të merrnin gra brenda fisit të tyre dhe, si rregull, kështu bënin, duhej t'i merrnin ato jashtë gjinisë së tyre. Kështu, në qoftë se gjinia ishte fare ekzogame, fisi që përmblihte të gjitha gjinitë ishte dhe ai po aq endogam. Me këtë u përmbys një herë e përgjithmonë mbeturina e fundit e kombinacioneve artificiale të Mak-Lenanit.

Por Morgani nuk u kënaq me kaq. Gjinia e indianeve të Amerikës i shërbeu atij, përveç kësaj, për të bërë një hap të dytë vendimtar përpara në fushën që ai studjonte. Në këtë gjini të organizuar sipas së drejtës amtare ai zbuloi formën e parë, prej së cilës u zhvillua më vonë gjinia e organizuar sipas së drejtës atërore, — gjinia që gjejmë në popujt e lashtë të qytetëruar. Gjinia greke dhe romake, që kishte qenë deri atëherë një enigmë për të gjithë historianët, u shpjegua me gjininë indiane, dhe kështu u gjend një bazë e re për gjithë historinë primitive.

Ky zbulim i ri i gjinisë fillestare me të drejtë amtare, si një etapë që kishte ekzistuar përpara gjinisë me të drejtë atërore të popujve të qytetëruar, ka për historinë primitive po atë rëndësi që ka teoria e zhvillimit të Darvinit për biologjinë dhe teoria e mbivlerësimit të Marksit për ekonominë politike. Kjo i dha mundësi Morganit të bënte për herë të parë një skicë të historisë së familjes, ku, me sa lejojnë materialet e njohura deri sot, u caktuan në vija të përgjithshme në mënyrë paraprake, të paktën, etapat klasike të zhvillimit. Është e qartë për cilindo se me këtë fillon një epokë e re për studimin e historisë primitive. Gjinia me të drejtë amtare u bë strumbullari rreth të cilit vërtitet gjithë kjo shkencë; që prej zbulimit të tij dihet se në

ç'drejtimit dhe ç'gjë duhet të studjohet edhe se si duhet të grupohen rezultatet. Dhe për këtë arsye tani në këtë fushë po bëhen përparime shumë më të shpejta nga ato që ekzistonin përpara se të dilte në dritë libri i Morganit.

Zbulimet e Morganit janë pranuar ose, më mirë të themi, janë përvetësuar tani nga të gjithë studjorët e shoqërisë primitive edhe në Angli. Por pothuajse asnjë prej tyre nuk pranon sheshit se ne i detyrohemi pikërisht Morganit për një revolucion të tillë pikëpamjesh. Në Angli libri i tij është lënë në heshtje, me sa është e mundur, dhe me vetë Morganin i lajnë hesapet vetëm duke e lavdëruar me gjysmë goje për veprat e tij të mëparshme; rrëmojnë me zell disa hollësi të veprës së tij, por heshtin me këmbëngulje për zbulimet e tij me të vërtetë të mëdha. Botimi i parë i „Shoqërisë së lashtë” është mbaruar; në tregun e Amerikës sende të tilla nuk shkojnë; në Angli këtë libër, siç duket, e kanë injoruar në mënyrë sistematike, dhe i vetmi botim, që është ende në shitje, i kësaj vepre që ka bërë epokë, është përkthimi gjermanisht.

Ku është shkaku i kësaj ftohtësie, që s'ke si e quan ndryshe veçse një komplot heshtjeje, sidomos po të kemi parasysh citatet e shumta që jepen vetëm për mirësjellje dhe prova të tjera respekti për kolegët, me të cilat janë mbushur shkrimet e studjorëve tanë më të përmendur të historisë primitive? Apo pse Morganit është amerikan, dhe studjorëve anglezë të historisë primitive nuk u vjen mirë që, me gjithë zellin që tregojnë për mbledhjen e materialit dhe që duhet t'ua pranojmë patjetër, ata janë të shtërnguar t'u drejtohen dy të huajve gjenialë — Bahofenit dhe Morganit — përse u takon tezave të përgjithshme, të domosdoshme për të sistemuar dhe për të grupuar këtë material, shkurt, përse u takon ideve të tyre? Me gjermanin mund të pajtoheshin, por me amerikanin! Ku-

ndrejt një amerikani çdo anglez bëhet patriot; në Shtetet e Bashkuara kam parë plot shembuj të tillë zbavitës.¹⁴⁹ Dhe, përveç kësaj, Mak-Lenani mbahej, si të thuash, si themeluesi zyrtar dhe udhëheqësi i shkollës angleze të historisë primitive; në fushën e historisë primitive ishte si një farë mirësjelljeje të flisje me respektin më të madh për ndërtimin e tij artificial të historisë, që fillonte me vrasjen e foshnjave, kalonte në poliandrinë dhe në martesën me të rrëmbyer dhe arrinte te familja me të drejtën amtare; dyshimi më i vogël për ekzistencën e „fiseve” ekzogame dhe endogame, që përjashtonin njëri-tjetrin në mënyrë absolute, quhej herezi* e guximshme; kështu që Morgani, duke i bërë hi e pluhur të gjitha këto dogma të shenjtëruara, bënte një farë sakrilegji. Dhe, për më tepër, ai i dërmoi ato me argumenta të tillë që mjaftonte t'i thoshje që ato të bëheshin menjëherë të qarta për të gjithë; kështu që adhuruesit e Mak-Lenanit, që deri atëherë kishin ardhur vërdallë të hutuar pa qenë në gjendje të kuptonin kontrastin midis ekzogamisë dhe endogamisë, u detyruan pothuajse t'i binin kokës me grusht dhe të bërtisnin: si është e mundur të kemi qenë kaq budallenj që të mos ta vinim re me kohë vetë këtë gjë!

Por edhe sikur të mos mjaftonin këto krime për ta shtyrë shkollën zyrtare që t'i kthente shpinën me ftohtësi Morganit, ky e mbushi kupën jo vetëm duke kritikuar qytetërimin — shoqërinë e prodhimit të mallrave, formën themelore të shoqërisë sonë të sotme, — në një mënyrë që të kujton Furjenë, por edhe duke folur për transformimin e ardhshëm të kësaj shoqërie me fjalë të tilla që mund t'i thoshte Karl Marksi. Prandaj Morgani e meritoi qortimin plot zemërim të

* Largim nga normat e një feje ose nga pikëpamjet e nga normat e pranuarat prej të gjithëve. *Red. Përkth.*

Mak Lenanit se „metoda e tij historike është për të fare antipatike”, edhe kur profesori i Gjenevës zoti Zhiro-Tëlon e vërtetoi këtë gjë përsëri më 1884. Por vetë zoti Zhiro-Tëlon më 1874 („Origjina e familjes”) bridhte ende i hutuar në labirintin e ekzogamisë së Mak-Lenanit, prej nga e nxori vetëm Morgani!

Nuk ka nevojë të shqyrtojmë këtu sukseset e tjera që historia primitive i detyron Morganit; ajo që është e domosdoshme për këtë çështje është shënuar në veprën time. Katërmbëdhjetë vjet, që kanë kaluar qëkurse doli vepra kryesore e Morganit, e kanë pasuruar shumë materialin tonë të historisë së shoqërive primitive të njerëzimit; me antropologët, me udhëtarët dhe me studjorët profesionistë të shoqërisë primitive janë bashkuar përfaqësuesit e jurisprudencës krahasuese, të cilët kanë sjellë ose material të ri ose pikëpamje të reja. Disa hipoteza të veçanta të Morganit u tronditën ose edhe bile u përmbysën nga këto studime. Por asgjëkundi materiali i mbledhur rishtazi nuk e bëri të domosdoshëm zëvendësimin e tezave themelore me teza të tjera. Sistemimi që i bëri ai historisë primitive, në vijat kryesore, është në fuqi edhe sot. Madje mund të themi se ky sistemim po pranohet gjithnjë më tepër nga të gjithë sa më tepër përpiqen të fshehin se ka qenë pikërisht ai që hodhi bazat e këtij përparimi të madh*.

Fridrih Engels

Londër, 16 qershor 1891

*Botohet sipas Veprave
të K. Marksit e të F. Engelsit,
bot. i 2-të rus, vëll. 22, f. 214-225*

* Duke u kthyer nga Nju-Jorku, në shtator të vitit 1888, unë u takova me një ish-deputet të kongresit të rrethit elektoral të Roçesterit, i cili e kishte njohur Luiz Morganin. Për fat të keq, ai mundi të më tregonte për të pak gjëra. Morgani kishte jetuar në Roçester si prift, duke

u marrë vetëm me punën e vet shkencore. Vëllai i tij, kolonel, shërbente në Uashington, në Ministrinë e Luftës; me ndihmën e të vëllait ai mundi të zgjonte interesimin e qeverisë për kërkimet e veta dhe të botonte disa nga veprat e veta me paratë e shtetit; edhe bashkëbiseduesi im, sipas fjalëve të tij, ishte përpjekur më se një herë për këtë gjë kur ishte deputet në kongres. (*Shënim i Engel-sit*).

I

SHKALLËT PARAHISTORIKE TË KULTURËS

Morgani ka qenë i pari që është orvatur me kompetencë të vendosë në parahistorinë e njerëzimit një sistem të caktuar, dhe derisa një zgjerim i rëndësishëm i materialit të mos na shtërngojë të bëjmë ndryshime, periodizimi i propozuar prej tij do të mbetet pa dyshim në fuqi.

Nga të tria epokat kryesore — egërsia, barbaria, qytetërimi — atë, në të vërtetë, e interesojnë vetëm dy të parat dhe kalimi për në të tretën. Secilën nga këto dy epoka ai e ndan në një shkallë të ulët, të mesme dhe të lartë sipas përparimeve në prodhimin e mjeteve të jetesës, sepse, thotë ai,

„zotësia në këtë prodhim ka një rëndësi vendimtare për shkallën e epërsisë së njeriut dhe të sundimit të tij mbi natyrën; nga të gjitha qeniet e gjalla vetëm njeriu ka mundur të zotërojë pothuajse pa kufi mbi prodhimin e sendeve të ushqimit. Të gjitha epokat e mëdha të përparimit njerëzor pak a shumë përkojnë drejt për së drejti me epokat e zgjerimit të burimeve të ekzistencës”¹⁵⁰.

Krahas me këtë bëhet zhvillimi i familjes, por ky zhvillim nuk na jep karakteristika aq të dalluara për një ndarje të periudhave.

1. Egërsia

1. *Shkalla e ulët.* Foshnjëria e gjinisë njerëzore. Njerëzit ndodheshin ende në vendbanimet e veta të para, në pyjet tropikale ose subtropikale. Ata jetonin, të paktën pjesërisht, nëpër drurë; vetëm kështu mund të shpjgohet ekzistenca e tyre në mes të bishave të mëdha grabitqare. Si ushqim atyre u shërbenin pemët, arrat, rrënjët; suksesi kryesor i kësaj periudhe ka qenë lindja e të folurit të artikulluar. Nga të gjithë popujt, që u bënë të njohur në periudhën historike, asnjëri prej tyre nuk ndodhej në këtë gjendje primitive. Dhe, megjithëse kjo gjendje ka zgjatur ndoshta shumë mijëvjeçarë, megjithatë ne nuk mund të provojmë ekzistencën e saj duke u bazuar në dëshmi të drejtpërdrejta; por, po të pranojmë prejardhjen e njeriut nga mbretëria e kafshëve, duhet të pranojmë edhe këtë gjendje kalimtare.

2. *Shkalla e mesme.* Fillon me përdorimin e peshkut si ushqim (këtu hyjnë edhe gaforret, molusket dhe kafshë të tjera uji) dhe me përdorimin e zjarrit. Të dyja këto janë të lidhura midis tyre, sepse ushqimi i peshkut bëhet plotësisht i përshtatshëm për përdorim vetëm në saje të zjarrit. Por me këtë ushqim të ri njerëzit u bënë të pavarur nga klima dhe nga vendi; duke ndjekur rrymën e lumenjve dhe brigjet e detrave, ata edhe në gjendje të egër mundën që të përhapeshin në pjesën më të madhe të sipërfaqes së tokës. Veglat prej guri të epokës së hershme të gurit, të bëra keq dhe të palëmuara, të ashtuquajtura paleolitike, që i përkasim tërësisht ose në pjesën më të madhe kësaj

periudhe, janë të përhapura në të gjitha kontinentet dhe janë një provë e qartë e këtyre shtegëttimeve. Popullimi i viseve të reja dhe kërkimet energjike e të palodhshme, bashkë me zotërimin e zjarrit që nxirrej me anë të fërkimit, u sollën njerëzve mjete të reja ushqimi: rrënjë dhe zhardhokë, që përmbajnë niseshte e që i piquin në hi të nxehtë ose në gropa-furra, kafshë të egra, të cilat, me shpikjen e armëve të para, të topuzit dhe të shtizës, i shtohen ushqimit të tyre herë pas here. Popuj vetëm gjahtarë, siç i përshkruajnë në librat, d.m.th. popuj që rrojnë *vetëm* me gjah, nuk ka pasur kurrë; për një jetë të tillë gjahu është shumë i pasigurt. Nga pasiguria e përhershme e burimeve të ushqimit në këtë shkallë, me sa duket, lindi antropofagjia, e cila që prej asaj kohe vazhdoi të ruhet gjatë. Australianët dhe shumë polinezianë edhe sot ndodhen në këtë shkallë të mesme të egërsisë.

3. *Shkalla e lartë.* Fillon me shpikjen e harkut dhe të shigjetës, që e bën mishin e kafshëve një ushqim të përhershëm, dhe me gjahun — një nga degët e zakonshme të punës. Harku, kordha dhe shigjeta formojnë tani një vegël shumë të ndërlikuar, shpikja e së cilës don një eksperiencë të grumbulluar për një kohë të gjatë dhe aftësi mendore më të zhvilluar, pra, edhe njohjen njëkohësisht të shumë shpikjeve të tjera. Duke i krahasuar me njëri-tjetrin popujt që njohin harkun dhe shigjetën, por që nuk dinë ende mjeshtërinë e poçarisë (këtë Morgani e quan si fillimin e kalimit në barbari), ne gjejmë me të vërtetë tani disa shenja të formimit të fshatrave, një farë shkalle të prodhimit të mjeteve të jetesës: enë dhe orëndi prej druri, endjen me dorë (pa vegjë) të fibrave prej druri, thurjen e shportave me lëkurë druri ose me gjineshtër, vegla prej guri të lëmuara (neolitike). Zjarri dhe sëpata prej guri zakonisht japin mundësi për të bërë tani lundra nga një

dru i tërë, dhe vende-vende trarë dhe dhoga për të ndërtuar shtëpi. Të gjitha këto përparime ne i gjejmë, për shembull, te indianët e Amerikës Veriperëndimore, të cilët, ndonëse njohin harkun dhe shigjetën, nuk e njohin ende poçarinë. Për epokën e egërsisë harku dhe shigjeta kanë qenë arma vendimtare, ashtu siç u bënë shpata e hekurt për barbarinë dhe arma me zjarr për qytetërimin.

2. Barbaria

1. *Shkalla e ulët.* Fillon me poçarinë. Mund të provohet se kjo ka rrjedhur në shumë raste dhe, ka të ngjarë, kudo nga të lyerit me baltë të enëve të thurura ose të drunjta, me qëllim që këto të duronin zjarrin. Shpejt ata zbuluan se balta që kishte marrë një formë i shërben këtij qëllimi edhe pa enën e brendshme.

Deri tani ne mund të studjonim procesin e zhvillimit në mënyrë fare të përgjithshme, si një gjë që ka vlerë për të gjithë popujt e një periudhe të caktuar, pavarësisht nga vendi ku rrojnë këta popuj. Por me kalimin në barbari ne kemi ardhur në një shkallë të tillë kur fillon të duket rëndësia e ndryshimeve në kushtet natyrore të dy kontinenteve të mëdha. Një moment karakteristik i periudhës së barbarisë është zbutja dhe rritja e kafshëve, si dhe kultivimi i bimëve. Kontinenti i Lindjes, e ashtuquajtura Botë e Vjetër, ka pasur pothuajse të gjitha kafshët që mund të zbuten dhe të gjitha llojet e drithërave që mund të kultivohen, përveç një lloji; kurse kontinenti i Perëndimit, Amerika, nga të gjithë sisorët, që mund të zbuten, ka pasur vetëm lamën dhe këtë vetëm në një pjesë të Jugut, dhe nga të gjitha drithërat, që mund të kultivohen, vetëm një, por më të mirin, — misrin. Për shkak të këtij ndryshimi në kushtet natyrore këtej e tutje popullsia e çdo

hemisferi ndjek një rrugë të veçantë zhvillimi, dhe kufijtë midis shkallëve të ndryshme të zhvillimit janë të ndryshëm për çdo hemisfer.

2. *Shkalla e mesme*. Në Lindje fillon me zbutjen e kafshëve shtëpiake, në Perëndim — me kultivimin e bimëve ushqimore me anë të ujitjes dhe me përdorimin e adobeve (qerpiç i tharë në diell) dhe të gurit për ndërtime.

Ne po fillojmë me Perëndimin, sepse njerëzit, këtu, përpara se të pushtohet Amerika nga evropianët, nuk kishin shkuar asgjëkundi më tutje nga kjo shkallë.

Indianët, që ndodheshin në shkallën e ulët të barbarisë (këtu hynin të gjithë ata që rronin në lindje të Misisipit), njihnin në kohën e zbulimit të tyre një farë mënyre për rritjen e misrit në kopshte dhe, ndoshta, edhe të kungullit, të pjeprit dhe të perimeve të tjera, që përbënin një pjesë mjaft të rëndësishme të ushqimit të tyre; ata rronin në shtëpi prej druri, në fshatra të rrethuara me gardhe. Fiset veriperëndimore, sidomos ato që rronin në pellgun e lumit Kolumbia, ishin ende në shkallën e lartë të egërsisë dhe nuk njihnin as poqarinë as edhe ndonjë lloj kulture të bimëve. Përkundrazi, indianët që u përkisnin të ashtuquajturve pueblos të Meksikës së Re¹⁵¹, meksikanët, banorët e Amerikës Qendrore dhe peruanët ishin në kohën e pushtimit në shkallën e mesme të barbarisë: ata rronin në shtëpi prej adobesh ose prej guri, që u ngjanin kështjellave, kultivonin nëpër kopshte të ujitura në mënyrë artificiale misrin dhe bimë të tjera të ndryshme ushqimore, sipas vendit dhe klimës, të cilat ishin burimet kryesore të ushqimit të tyre, dhe madje kishin zbutur disa kafshë: meksikanët gjelin e detit dhe shpendë të tjerë, peruanët — lamën. Përveç kësaj, ata dinin të punonin metalet, me përjashtim të hekurit, prandaj ata ende nuk mund të bënin pa armë dhe pa vegla guri.

Fushtimi spanjoll e preu çdo zhvillim të mëtejshëm, të pavarur të tyre.

Në Lindje shkalla e mesme e barbarisë filloi me zbutjen e kafshëve që japin çumësht dhe mish, ndërsa kultura e bimëve, si duket, këtu mbeti ende e panjohur për një kohë shumë të gjatë në këtë periudhë. Zbutja dhe rritja e gjësë së gjallë dhe formimi i kopeve të mëdha, si duket, kanë qenë shkak i ndarjes së arianëve* dhe të semitëve** nga masa tjetër e barbarëve. Arianët e Evropës dhe të Azisë emrat e kafshëve shtëpiake i kanë edhe tani të përbashkët, kurse emrat e bimëve të kultivuara — pothuajse kurrë.

Formimi i kopeve solli me vete jetën blegtorale në vendet e përshtatshme për këtë gjë: për semitët — në fushat me bar të Eufratit dhe të Tigrit, për arianët — në fushat me bar të Indisë, si dhe të Amu-Darjes dhe të Sir-Darjes, të Donit dhe të Dnjeprit. Zbutja e kafshëve është bërë për herë të parë, si duket, brenda kufijve të këtyre krahinave me kullota. Prandaj brezave të mëvonshëm u duket sikur popujt barinj kanë dalë nga vende që në të vërtetë jo vetëm nuk mund të ishin djepi i njerëzimit, por, përkundrazi, ishin pothuajse të pabanueshme për të parët e tyre të egër dhe macje edhe për njerëzit që ishin në shkallën e ulët të barbarisë. Përkundrazi, kur këta barbarë të shkallës së mesme u mësuan me jetën blegtorale, atyre kurrë nuk mund t'u shkonte ndër mend që të linin vullnetarisht luginat me bar të lumenjve dhe të ktheheshin në pyjet ku kishin banuar të parët e tyre. Bile edhe kur semitët dhe arianët u shtërnguan të shkonin më tutje, në Veri dhe në Perëndim, edhe atëherë ata nuk mund të

* *Arianë* — emër i grupit të gjuhëve dhe të popujve që bëjnë pjesë në familjen indo-evropiane. *Red. Përkth.*

** *Semitë* — familje popujsh dhe gjuhësh në Azinë Perëndimore dhe në Afrikë. *Red. Përkth.*

shkonin në vendet me pyje të Azisë Perëndimore dhe të Evropës, veçse kur kultivimi i drithërave u dha mundësi të ushqenin gjënë e gjallë të tyre, sidomos në dimër, në këtë tokë më pak të përshtatshme. Ka shumë të ngjarë që kultivimi i drithërave të ketë qenë shkaktuar para së gjithash nga nevoja për ushqimin e gjësë së gjallë dhe vetëm më vonë u bë burim i rëndësishëm për ushqimin e njeriut.

Me ushqimin e bollshëm të arianëve dhe të semi-tëve me mish dhe me qumësht dhe sidomos me ndikimin e favorshëm të tij mbi zhvillimin e fëmijëve duhet shpjeguar, ndoshta, zhvillimi me sukses i këtyre dy racave. Me të vërtetë indianët pueblos të Meksikës së Re, që janë të shtërnguar të ushqehen pothuajse vetëm me bimë, e kanë trurin më të vogël se indianët që janë në shkallën e ulët të barbarisë dhe që ushqehen më tepër me mish dhe me peshk. Sidoqoftë, në këtë shkallë antropofagjia dalëngadalë zhduket dhe mbetet vetëm si një akt fetar ose si magji, gjë që këtu pothuajse është njësoj.

3. *Shkalla e lartë.* Fillon me shkrirjen e mineralit të hekurit dhe kalon në qytetërim me shpikjen e shkriimit alfabetik dhe me përdorimin e tij për të shënuar krijimet me fjalë. Kjo shkallë, e cila, siç u tha më sipër, ka kaluar në mënyrë të pavarur vetëm në hemisferin e Lindjes, është më e pasur me suksese në fushën e prodhimit se të gjitha shkallët e mëparshme së bashku. Kësaj i përkasin grekët e epokës heroike, fiset italice pak më përpara themelimit të Romës, gjermanët e Tacitit, normanët e kohërave të vikingëve¹⁵².

Para së gjithash këtu gjejmë për herë të parë pararendën me pluar të hekurt, që tërhiqej nga kafshë shtëpiake; kjo bëri të mundur që të zhvillohej në përpjestime të mëdha punimi i tokës, *bujqësia*, dhe njëkohësisht të shtoheshin në mënyrë të pakufizuar për kushtet e atëhershme rezervat ushqimore për jetesë;

pastaj kjo bëri të mundur çrrënjosjen e pyjeve dhe kthimin e tyre në ara dhe në livadhe, gjë që përsëri nuk mund të bëhej në shkallë të gjerë pa sëpatën e hekurt dhe pa belin e hekurt. Bashkë me këtë u shtua shpejt edhe popullsia, që u bë më e dendur në hapësira të vogla. Përpara se të lindte bujqësia duhej të krijoheshin kushte krejt të jashtëzakonshme që një gjysmë milioni njerëz të bashkoheshin nën një udhëheqje qendrore të vetme; ka të ngjarë që kjo të mos ketë ndodhur kurrë.

Lulëzimi i plotë i shkallës së lartë të barbarisë na paraqitet në poemat e Homerit, sidomos në „Iliadën”. Vegla të përmirësuara prej hekuri, gjyryku, mulliri me dorë, çarku i poçarit, pregatitja e vajit dhe e verës, punimi i zhvilluar i metaleve, që kthehet në një zanaat artistik, qerrja për të ngarkuar dhe qerrja për luftë, ndërtimi i anijeve me tarrë dhe me dërrasa, zanafillat e arkitekturës si art, qytetet e rrethuara me mure me bedena e me kulla, eposi homerik dhe gjithë mitologjia — ja trashëgimi kryesor që kanë sjellë grekët nga barbaria në qytetërim. Duke krahasuar me këtë përshkrimin që na jep Cezari bile edhe Taciti për gjermanët¹⁵³, që ishin në fillim të së njëjtës shkallë kulture, nga e cila grekët e Homerit pregatiteshin të shkonin në një shkallë më të lartë, ne shohim se sa i madh ka qenë zhvillimi i prodhimit në shkallën e lartë të barbarisë.

Tabloja e zhvillimit të njerëzimit nga shkalla e egërsisë dhe e barbarisë në fillimin e qytetërimit, që dhashë këtu sipas Morganit, është mjaft e pasur me tipare të reja dhe, ajo që ka më tepër rëndësi, me tipare të padiskutueshme, sepse ato janë marrë drejtpërdrejt nga prodhimi. Dhe megjithatë kjo tablo do të duket e zbetë dhe e varfër në krahasim me atë që do të hapet para nesh në fund të shtegëtimit tonë; vetëm atëherë do të mund të hedhim dritë të plotë mbi kalimin nga

barbaria në qytetërim dhe mbi kontrastin e theksuar në mes të tyre. Tani për tani periodizimin e Morganit mund ta përmbledhim kështu: egërsia — periudha ku kemi sidomos përvetësimin e produkteve të gatshme të natyrës; prodhimet e krijuara nga njeriu shërbejnë kryesisht si vegla ndihmëse të këtij përvetësimi. Barbaria — periudha e lindjes së blegtorisë dhe të bujqësisë, periudha e përvetësimit të metodave për të shtuar prodhimin e produkteve të natyrës me anën e veprimtarisë së njeriut. Qytetërimi — periudha kur njeriu mëson t'i përpunojë edhe më mirë produktet e natyrës, periudha e industrisë në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe artit.

II

FAMILJA

Morgani, që e ka kaluar pjesën më të madhe të jetës së vet në mes të irokezëve, të cilët edhe sot rrojnë ende në shtetin e Nju-Jorkut, dhe që ka qenë adoptuar nga një prej fiseve të tyre (nga fisi seneka), zbuloi se te ata ekzistonte sistemi i afërisë, që ishte në kundërshtim me marrëdhëniet e vërteta familjare të tyre. Te ata sundonte një monogami, që mund të prishej lehtë prej të dy palëve dhe që Morgani e quan „familje me çifte”. Pjella e një çifti të tillë bashkëshortësh dihej, pra, nga të gjithë dhe pranohej prej të gjithëve: nuk mund të kishte dyshim se kush duhej quajtur atë, nënë, bir, bijë, vëlla, motër. Por përdorimi i vërtetë i këtyre shprehjeve është në kundërshtim me këtë. Irokezi quan bij dhe bija të vet jo vetëm fëmijët e vet, por edhe fëmijët e vëllezërve të vet, dhe ata e quajnë atë atë. Kurse fëmijët e motrave të veta ai i quan nipër dhe mbesa të vet, dhe ata e quajnë atë ungj. Përkundrazi, irokezja i quan fëmijët e motrave të veta, njësoj si fëmijët e vet, bij të vet dhe bija të

veta, dhe ata e quajnë atë nënë, kurse fëmijët e vëllezërve të vet ajo i quan nipër dhe mbesa dhe atë ata e quajnë emtë. Po kështu edhe fëmijët e vëllezërve, si edhe fëmijët e motrave, e quajnë shoqi-shoqin vëllezër dhe motra. Përkundrazi, fëmijët e gruas dhe fëmijët e vëllait të saj e quajnë shoqi-shoqin kushërinj dhe kushërira. Dhe këta nuk janë vetëm emra pa kuptim, por janë shprehjet e pikëpamjeve reale që sundojnë mbi afërsinë dhe largësinë, mbi barazinë dhe mosbarazinë e afërsisë së gjakut, dhe këto pikëpamje janë baza e një sistemi afërie të përpunuar plotësisht dhe që është në gjendje të shprehë me qindra marrëdhënie të ndryshme afërie të një individi. Për më tepër: ky sistem është në fuqi plotësisht jo vetëm te gjithë indianët e Amerikës (deri më sot nuk është gjetur asnjë përjashtim), por vepron pothuajse pa asnjë ndryshim edhe te banorët e vjetër të Indisë, te fiset dravidiane të Dekanit dhe te fiset gaura në Indostan¹⁵⁴. Fjalët që tregojnë lidhje afërie te tamilët e Indisë Jugore dhe te irokezët e fisit seneka të shtetit të Nju-Jorkut, vazhdojnë të jenë njësoj edhe sot për më shumë se dyqind marrëdhënie të ndryshme afërie. Dhe te këto fise indiane, si edhe te të gjithë indianët e Amerikës, marrëdhëniet e afërsisë, që rrjedhin nga forma ekzistuese e familjes, janë gjithashtu në kundërshtim me sistemin e afërsisë.

Si shpjegohet kjo? Duke marrë parasysh rolin vendimtar që luan afëria në rendin shoqëror te gjithë popujt e egër dhe barbarë, nuk mund ta kalojmë vetëm me disa fraza këtë sistem kaq të përhapur. Një sistem, i përhapur gjerësisht në Amerikë, që ekziston edhe në Azi ndër popujt të një race krejt tjetër, që haset shpesh në forma pak a shumë të ndryshuara kudo në Afrikë dhe në Australi, — një sistem i tillë kërkon një shpjegim historik; prej tij nuk mund të ndahesh vetëm me disa fraza, siç u orvat të bënte, për shembull, Mak-Le-

nani¹⁵⁵. Fjalët: atë, bir, vëlla, motër — nuk janë vetëm tituj nderi, por tituj që sjellin me vete detyrime reciproke të caktuara, shumë serioze, dhe që në tërësinë e tyre përbëjnë një pjesë kryesore të rendit shoqëror të këtyre popujve. Dhe shpjegimi u gjend. Në ishujt Sanduiç (Havai) ekzistonte ende në gjysmën e parë të shekullit tonë një formë familjeje ku kishte pikërisht etër dhe nëna, vëllezër dhe motra, bij dhe bija, ungjër dhe emta, nipër dhe mbesa, si ato që kërkon sistemi i afërisë në Amerikë dhe në Indinë e lashtë. Por çudi! Edhe sistemi i afërisë që ekzistonte në ishujt Havai nuk i përgjigjej formës së familjes që ekzistonte atje në të vërtetë. Dhe pikërisht atje, pa përjashtim, të gjithë fëmijët e vëllezërve dhe të motrave quhen vëllezër dhe motra dhe fëmijë të përbashkët jo vetëm të nënës së tyre dhe të motrave të saj ose të atit të tyre dhe të vëllezërve të tij, por të të gjithë vëllezërve dhe motrave të prindërve të tyre pa dallim. Pra, në qoftë se sistemi amerikan i afërisë kërkon një formë më primitive të familjes, e cila tani nuk ekziston në Amerikë dhe të cilën ne e gjejmë me të vërtetë ende në ishujt Havai, atëherë sistemi i afërisë në ishujt Havai tregon, nga ana tjetër, një formë edhe më primitive të familjes, ekzistencën e së cilës, ç'është e vërteta, ne tani nuk mund ta provojmë asgjëkund, por që *duhet* të ketë ekzistuar, sepse ndryshe nuk mund të lindte një sistem afërie që i përgjigjet kësaj forme.

„Familja — thotë Morgani, — është një element aktiv; ajo nuk qëndron kurrë në një vend, por shkon nga një formë më e ulët në një formë më të lartë krahas me zhvillimin e shoqërisë nga një shkallë më e ulët në një shkallë më të lartë. Përkundrazi, sistemet e afërisë janë pasive; vetëm pas intervalesh të gjata kohe ato regjistrojnë përparimin e bërë gjatë kësaj kohe nga familja dhe pësojnë ndryshime rrënjësore vetëm atëherë kur familja është ndryshuar rrënjësisht”¹⁵⁶

„Dhe pikërisht kështu, — shton Marksi, — ndodh përgjithësisht edhe me sistemet politike, juridike, fetare dhe filozofike.”¹⁵⁷ Ndërsa familja vazhdon të zhvillohet, sistemi i afërisë bëhet i ngurtë, dhe ndërsa ky i fundit vazhdon të ekzistojë nga forca e zakonit, familja i kapërcen caqet e tij. Por po me atë siguri, me të cilën Kyvjeja, në bazë të kockës marsupiale të skeletit të një kafshe që ishte gjetur afër Parisit, mundi të nxirrte përfundimin se ky skelet ka qenë skeleti i një kafshe marsupiale dhe se atje dikur ka pasur kafshë të tilla që janë zhdukur, — me këtë siguri ne mund të nxjerrim përfundimin, në bazë të sistemit të afërisë që historikisht ka mbetur deri më sot, se ka pasur një formë familjeje që i përgjigjet këtij sistemi.

Sistemet e afërisë dhe format e familjes, që porsa u përmendën, ndryshojnë nga ato që sundojnë sot, ngaqë atje çdo fëmijë ka disa etër dhe nëna. Sipas sistemit amerikan të afërisë, të cilit i përgjigjet familja e ishujve Havai, vëllai dhe motra nuk mund të jenë ati dhe nëna e po një fëmije. Kurse sistemi i afërisë i ishujve Havai supozon një familje, në të cilën, përkundrazi, kjo ishte rregull. Këtu kemi një sërë formash familjeje që janë drejtpërdrejt në kundërshtim me ato që deri më sot zakonisht quheshin si të vetmet forma ekzistuese. Koncepti tradicional njih vetëm monogaminë, pranë kësaj edhe poligaminë e një burri dhe, në rastin ekstrem, poliandrinë e një gruaje, por, siç i ka hije filistinit moralizues, ai nuk zë në gojë faktin se praktika, në heshtje por pa ceremoni, i kapërcen kufijtë e caktuar nga shoqëria zyrtare. Studimi i historisë primitive, përkundrazi, na tregon një gjendje ku burrat rrojnë në poligami, dhe gratë e tyre njëkohësisht — në poliandri, dhe prandaj fëmijët e njërës dhe të tjetrës palë quhen fëmijë të përbashkët të të gjithëve, gjendje që, nga ana e vet, derisa të kalojë për-

fundimisht në monogami, pëson një varg të tërë ndryshimesh. Këto ndryshime bëhen në mënyrë të tillë që rrethi i lidhjeve të përbashkëta të martesës, i cili në fillim ishte shumë i gjerë, ngushtohet gjithnjë më tepër, derisa, më në fund, mbetet vetëm çifti që mbizotëron në kohën e sotme.

Duke rindërtuar kështu së prapthi historinë e familjes, Morgani, në një mendje me shumicën e kolegëve të vet, arrin në përfundimin se ka ekzistuar një gjendje primitive, kur brenda fisit kanë sunduar marrëdhënie seksuale të pakufizuara, kështu që çdo grua ishte e çdo burri dhe po kështu çdo burrë — i çdo gruaje. Për një gjendje të tillë primitive është folur që në shekullin e kaluar, por vetëm me fraza të përgjithshme; vetëm Bahofeni, — dhe kjo është një nga meritat e tij të mëdha, — e mori seriozisht këtë problem dhe filloi t'i kërkonte gjurmët e kësaj gjendjeje në legjendat historike dhe fetare.¹⁵⁸ Ne tani e dimë se gjurmët e gjetura prej tij nuk na shpiten aspak në shkallën shoqërore të marrëdhënieve seksuale të parregullta, por në një formë shumë më të vonë, në martesën me grupe. Shkalla shoqërore primitive, që përmendëm, — në qoftë se ka ekzistuar me të vërtetë, — i përket një epoke aq të largët, sa që është e vështirë të gjenden ndër fosilet shoqërore, të të egrit e prapambetur, prova të drejtpërdrejta të ekzistencës së saj në të kaluarën. Merita e Bahofenit qëndron pikërisht në faktin se ai nxori në plan të parë studimin e kësaj çështjeje.*

* Duke e quajtur këtë gjendje primitive *heterizëm*, Bahofeni tregoi se sa pak e kishte kuptuar atë që ai zbuloi, ose, më mirë, që e mori me mend. Me fjalën *heterizëm* grekët, kur ata filluan ta përdornin këtë fjalë, kuptonin marrëdhëniet e burrave të pamartuar ose monogamë me gra të pamartuara; kjo kërkon gjithnjë ekzistencën e një forme të caktuar martese, jashtë së cilës bëhen këto ma-

Këto kohët e fundit është bërë modë të mohohet kjo shkallë fillestare e jetës seksuale të njeriut. Duan ta shpëtojnë njerëzimin nga ky „turp”. Dhe kështu mbështeten jo vetëm në mungesën e një prove të drejt-përdrejtë, por veçanërisht në shembullin e botës së kafshëve të tjera; nga kjo botë Lëturnoi („Evolucioni i martesës dhe i familjes”, 1888) mblodhi shumë fakte që tregojnë se marrëdhëniet seksuale fare të parregullta edhe këtu janë veçori e shkallës së ulët të zhvillimit. Por nga të gjitha këto fakte unë mund të nxjerr vetëm përfundimin se ato nuk provojnë absolutisht asgjë në lidhje me njeriun dhe me kushtet e jetës së tij primitive. Bashkëjetesa e gjatë në çift te vertebrorët shpjegohet mjaft mirë nga shkaqe fiziologjike: për shembull, te zogjtë shpjegohet nga fakti se femra ka nevojë për ndihmë në periudhën kur bie klloçkë; shembujt e një monogamie besnike, që gjejmë te zogjtë, nuk provojnë asgjë në lidhje me njerëzit, sepse njerëzitet, siç dihet, nuk rrjedhin nga zogjtë. Dhe në qoftë se monogamia e rreptë është kulmi i çdo virtyti, atëherë dafina i takon me të drejtë shiritit, i cili në cili-ndo nga 50-200 proglotide ose nyje të trupit ka një aparat të plotë mashkullor dhe femëror dhe gjithë jetën e vet e shkon duke u bashkuar me vetëveten në çdo nyjë të vet. Po të kufizohemi me sisorët, ne do të gjejmë këtu të gjitha format e jetës seksuale — marrëdhënie të parregullta, një lloj martese me grupe, poligaminë, monogaminë; mungon vetëm poliandria, ku kanë mundur të arrijnë vetëm njerëzit. Edhe te më të

rrëdhënie dhe përmban të paktën, si mundësi, prostitucionin. Kjo fjalë nuk është përdorur kurrë me tjetër kuptim, dhe në këtë kuptim e përdor edhe unë bashkë me Morganin. Zbulimet me shumë rëndësi të Bahofenit mistifikohen në mënyrë të pabesueshme, sepse ai kujton se burim i marrëdhënieve të lindura historike midis burrit dhe gruas kanë qenë gjoja kurdoherë idetë fetare të njerëzve dhe jo kushtet e jetës së tyre të vërtetë.

afërmit tanë, te katërduarshët, kemi lloj-lloj ndryshimesh në grupimin e meshkujve dhe të femrave; dhe po të marrim një rreth edhe më të ngushtë dhe të studjojmë vetëm katër lloj majmunësh antropomorfë, atëherë këtu Lëturnoi mund të na thotë vetëm se te ata kemi herë herë monogaminë, herë poligaminë, kurse Sosyri, sipas Zhiro-Tëlonit, na thotë se ata janë monogamë. Edhe pohimet e fundit të Vestermarkut („Historia e martesës së njeriut”, Londër, 1891) mbi monogaminë e majmunëve antropomorfë gjithashtu nuk mund të shërbejnë aspak si prova. Shkurt, të dhënat janë të tilla që i ndershmi Lëturno pranon:

„Por te sisorët nuk ka fare një përputhje të prerë midis gradës së zhvillimit intelektual dhe formës së marrëdhënieve seksuale”.

Kurse Espinasi („Mbi shoqëritë e kafshëve”, 1877) thotë haptazi:

„Kopeja është grupi më i lartë shoqëror që mund të vëmë re te kafshët. Ajo, si duket, është e përbërë nga familje, por që në krye *familja dhe kopeja janë në antagonizëm*, ato zhvillohen në raport të zhdrejtë.”

Siç duket nga ato që thamë më sipër, ne nuk dimë asgjë të caktuar mbi grupimet familjare dhe mbi grupimet e tjera shoqërore të majmunëve antropomorfë; të dhënat, që kemi mbi këtë çështje, janë drejtpërdrejt në kundërshtim midis tyre. Dhe nuk është për t'u çuditur. Sa kontradiktore janë dhe sa nevojë kanë për një kontroll kritik dhe shoshitje të dhënat që kemi mbi fiset e egra njerëzore! Kurse shoqëritë e majmunëve është shumë më vështirë të vëzhgohen se shoqëritë e njerëzve. Pra, hëpërhë ne duhet t'i hedhim poshtë të gjitha përfundimet që janë nxjerrë në bazë të këtyre të dhënave fare të pasigurta.

Përkundrazi, teza e Espinasit, që përmendëm më sipër, na jep një pikëmbështetje më të shëndoshë. Kopeja dhe familja te kafshët e larta nuk plotësojnë njëra-tjetrën, por janë në kundërshtim njëra me tjetrën. Espinasi tregon shumë bukur se si xhelozia e meshkujve në periudhën e të ethurit e dobëson bashkimin në kope ose e prish përkohësisht atë.

„Atje ku familja është lidhur ngushtë, kopeja formohet vetëm si një përjashtim i rrallë. Përkundrazi, atje ku sundojnë marrëdhënie të lira seksuale, ose poligamia, kopeja formohet pothuajse vetëvetiu... Që të mund të formohet kopeja, duhet që lidhjet familjare të dobësohen dhe që individi të bëhet përsëri i lirë. Prandaj ne gjejmë aq rrallë te zogjtë tufa të organizuara... Përkundrazi, te sisorerët ne gjejmë shoqëri deri diku të organizuara, pikërisht sepse individi këtu nuk përpihet nga familja... Prandaj për ndjenjën e bashkësisë së kopësë nuk mund të ketë në formimin e saj armik më të madh se ndjenja e bashkësisë familjare. Ta themi sheshit: në qoftë se është zhvilluar një formë më e lartë shoqërore se familja, një gjë e tillë ka mundur të bëhet vetëm se kjo formë shkriu në veten e vet familje të ndryshuara rrënjësisht, dhe nuk përjashtohet mundësia që pikërisht për këtë arsye më vonë po ato familje të organizohen përsëri në kushte shumë më të favorshme” (Espinas, vepër e cituar nga Zhiro-Tëioni: „Origjina e martesës dhe e familjes”, 1884, f. 518-520).

Këtej duket se, megjithëqë shoqëritë e kafshëve kanë një farë vlere për të nxjerrë disa përfundime mbi shoqëritë njerëzore në të kaluarën, kjo vlerë është vetëm negative. Te vertebrorët e lartë njihen, me sa dimë, vetëm dy forma familjeje: poligamia dhe bashkëjetesa në çifte të veçanta; në të dyja rastet lejohet vetëm një mashkull i rritur, vetëm një bashkëshort. Xhelozia e mashkullit, që në të njëjtën kohë lidh dhe

kufizon familjen e kafshëve, e vë këtë në kundërshtim me kopenë, për shkak të kësaj xhelozije kopeja, forma më e lartë e marrëdhënieve, në disa raste pushon së ekzistuari, në raste të tjera humbet kompaktësinë ose priset në kohën e të ethurit, në rastin më të mirë pengohet në zhvillimin e saj të mëtejshëm. Vetëm kjo mjafton për të provuar se familja e kafshëve dhe shoqëria primitive njerëzore janë dy gjëra që nuk mund të pajtohen, se njerëzit primitivë, që dolën nga gjendja e kafshëve, ose nuk e kanë njohur fare familjen, ose, shumë-shumë, kanë njohur një familje të tillë, që te kafshët nuk haset. Një kafshë kaq e çarmatosur, siç ishte njeriu në procesin e formimit të tij, mund të vazhdonte të ekzistonte në një numër të vogël qoftë edhe në kushte izolimi, kur forma më e lartë e marrëdhënieve ishte bashkëjetesa në çifte, siç rrojnë gorillat dhe shimpanzetë, sipas mendimit të Vestermarkut, që bazohet në tregimet e gjahtarëve. Por për të dalë në procesin e zhvillimit nga gjendja shtazore dhe për të realizuar përparimin më të madh që njihet në natyrë, duhej edhe një element tjetër: mungesa e aftësisë së individit të veçantë për vetëmbrojtje duhej zëvendësuar me forcën e bashkuar dhe me veprimet kolektive të kopesë. Kalimi në gjendjen njerëzore nga ato kushte, në të cilat jetojnë sot majmunët antropomorfë, do të ishte fare i pashpjegueshëm; këta majmunë të lënë më tepër përshtypjen se këtu kemi të bëjmë me degë të shtëmëngura, që janë të dënuara të zhduken dalëngadalë dhe që, sidoqoftë, janë në rënie e sipër. Vetëm kjo mjafton për të hequr dorë nga çdo krahasim midis formave të familjes të ata dhe të njerëzit primitivë. Toleranca midis meshkujve të rritur, mungesa e xhelozisë kanë qenë kushti i parë për formimin e këtyre grupeve më të mëdha dhe më të qëndrueshme, midis të cilave mund të bëhej shndërrimi i kafshëve në njeri. Dhe me të vërtetë, cila është

forma më e vjetër, më e hershme e familjes, ekzistencën e së cilës në histori ne mund ta provojmë në mënyrë të pamohueshme dhe mund ta studjojmë aty-këtu edhe sot? Martesa me grupe, një formë martesë, ku grupe të tëra burrash dhe grupe të tëra grash i përka- sin reciprokisht njëri-tjetrit dhe ku ka shumë pak vend për xhelozitë. Dhe pastaj, në një shkallë më të vonë të zhvillimit, ne gjejmë një formë të tillë që është një përjashtim, si poliandria, e cila në shkallë edhe më të madhe është në kundërshtim të theksuar me çdo ndje- një xhelozie dhe prandaj kafshët nuk e njohin. Por for- mat e martesës me grupe, që ne njohim, shoqërohen me kushte të ndërlikuara aq të veçanta, sa që ato tre- gojnë se duhet të ketë pasur patjetër forma më të her- shme, më të thjeshta të marrëdhënieve seksuale, dhe bashkë me këtë, në fund të fundit, një periudhë ma- rrëdhëniesh seksuale të parregullta, që i përgjigjen ka- limit nga gjendja shtazore të njeriu; prandaj ato që thuhet për martesat të kafshët na kthejnë pikërisht po në atë pikë, prej së cilës ato duhej të na largonin një herë e mirë.

Por ç'do të thotë marrëdhënie seksuale të parre- gullta? Kjo do të thotë se ndalesat kufizuese të kohës sonë ose të ndonjë kohe tjetër më të vjetër atëherë nuk ishin në fuqi. Ne pamë tani se si ra kufizimi i shkaktuar nga xhelozia. Një gjë është e sigurt, që xhe- lozia është një ndjenjë, e cila është zhvilluar pak a shumë vonë. Po këtë gjë mund ta themi edhe për ide- në e fëlligshtisë në gjak. Në fillim jo vetëm vëlla e motër ishin burrë e grua, por edhe sot të shumë po- pupj lejohen marrëdhënie seksuale midis prindërve dhe fëmijëve. Bankrofti („Fiset vendase të shteteve të Pa- cifikut në Amerikën Veriore, 1875”. vëll. I) dëshmon për ekzistencën e këtyre marrëdhënieve të kaviakët në brigjet e ngushticës Bering, të banorët e ishullit Ka-

diak pranë Alaskës, te tindhëret në pjesën e brendshme të Amerikës Veriore britanike; Lëturnoi tregon shumë fakte të tilla të indianët çipevej, te kukusët në Kili, te karaibët,¹⁵⁹ te karenët në Indokinë; nuk po flasim për tregimet e grekëve dhe të romakëve të lashtë për partinët, persët, skitët, hunët etj. Përpara se të zbulohet fëlligshti në gjak (dhe ky është një zbulim, madje shumë i vyer), marrëdhëniet seksuale midis prindërve dhe fëmijëve nuk mund të shkaktonin më tepër neveri se sa marrëdhëniet seksuale midis personash të tjerë të brezave të ndryshëm, dhe kjo ndodh edhe sot në vendet më filistine, pa shkaktuar ndonjë tmerr të madh; madje edhe „zonjusha” mbi gjashtëdhjetë vjeç, kur janë mjaft të pasura, martohen nganjëherë me burra rreth tridhjetë vjeç. Në qoftë se nga format më të hershme të familjes, që ne njohim, hedhim poshtë idetë e fëlligshtisë në gjak, që janë lidhur me këto forma të familjes dhe që janë fare të ndryshme nga idetë tona dhe shpesh krejt në kundërshtim me këto, atëherë do të kemi një formë marrëdhëniesh seksuale, që mund ta quajmë vetëm si formë të parregullt, përderisa nuk ekzistonin ende kufizimet që u vunë prej zakonit. Por këtë nuk rrjedh aspak si përfundim i domosdoshëm se marrëdhëniet seksuale në praktikën e përditshme ishin krejt të parregullta. Nuk përjashtohet aspak bashkëjetesa e përkohshme në çifte, siç ndodh sot në shumicën e rasteve, madje edhe në martesat me grupe. Dhe në qoftë se Vestermarku, studjozi më i fundit nga ata që mohojnë një gjendje të tillë primitive, quan martesë çdo rast kur të dy seksat jetojnë së bashku si çift derisa lind foshnja, atëherë duhet të themi se një martesë e tillë mund të ndodhë edhe në marrëdhëniet e parregullta, pa qenë aspak në kundërshtim me parregullinë, d.m.th. me

mungesën e kufizimeve të marrëdhënieve seksuale të caktuara nga zakoni. Në të vërtetë, Vestermarku nisët nga pikëpamja se

„Parregullia përmban shtypjen e prirjeve individuale”, kështu që „forma më autentike e saj është prostitucioni”.

Mua, përkundrazi, më duket se nuk mund të kuptohen kurrsesi kushtet primitive sa kohë që ato shikohen me syzet e shtëpive publike. Ne do të kthehemi prapë në këtë çështje kur të shqyrtojmë martesën me grupe.

Sipas Morganit, nga kjo gjendje primitive e marrëdhënieve seksuale të parregullta ka të ngjarë që të jetë zhvilluar shumë shpejt:

1. *Familja e një gjaku* — shkalla e parë e familjes. Këtu grupet e martuara ndahen sipas brezave: të gjithë gjyshërit dhe të gjitha gjyshet brenda kufijve të familjes janë midis tyre burra e grua, ashtu si dhe bijtë e tyre, d.m.th. etërit dhe nënat, kështu edhe fëmijët e këtyre të fundit formojnë rrethin e tretë të bashkëshortëve të përbashkët, kurse fëmijët e tyre, stërnipërit e të parëve, formojnë rrethin e katërt. Kështu, në këtë formë të familjes përjashtohen nga të drejtat dhe nga detyrat reciproke bashkëshortore (si do të thoshim ne sot) vetëm stërgjyshërit dhe stërnipërit, prindërit dhe fëmijët. Vëllezërit e motrat — kushërinjtë e parë, kushërinjtë e dytë, kushërinjtë e tretë dhe ata më të largët — të gjithë janë midis tyre motra e vëllezër dhe për këtë arsye të gjithë edhe burra e gra midis tyre. Marrëdhëniet e afërisë midis vëllait dhe motrës në këtë shkallë të familjes përmbajnë në vetëvete edhe marrëdhëniet seksuale midis tyre si një gjë që kuptohet ve-

tëvetiu.* Një shembull tipik për një familje të tillë do të ishin pasardhësit e një çifti, të cilët brez pas brezi të gjithë janë midis tyre vëllezër dhe motra dhe pikërisht për këtë edhe burra e gra midis tyre.

Familja e një gjaku është zhdukur. Edhe te po-

* Në një letër, shkruar në pranverë të vitit 1882.¹⁶⁰ Marksii flet me fjalë shumë të ashpra për falsifikimin e plotë të epokës primitive në tekstin e „Nibelungëve” të Vagnerit. „A është dëgjuar ndonjëherë që vëllai ta përqafojë motrën si grua të vet?”¹⁶¹. Këtyre „perëndive të epsheve” të Vagnerit, të cilët në mënyrë fare moderne aventurat e dashurive të tyre i bëjnë më të kripura, duke i përzier me pak fëllëgshti në gjak, Marksii u përgjigjet: „Në epokën primitive motra ishte gruaja, dhe kjo ishte një gjë morale”. (*Shënim i Engelsit për botimin e vitit 1884*).

Një mik dhe adhurues francez i Vagnerit nuk është në një mendje me këtë vërejtje dhe thotë se në „Edën më të vjetër”, ku është bazuar Vagneri, në „Egisdreka”, Loki e qorton Frejenë kështu: „Përpara perëndive ti përqafove vëllanë tënd”. Këtëj gjoja rrjedh se martesat midis vëllait e motrës qysh atëherë paska qenë e ndaluar. Por „Egisdreka” pasqyron atë kohë kur besimi në mitet e vjetra kishte humbur plotësisht; kjo është një satirë e tipit të Lukianit kundër perëndive. Në qoftë se Loki si Mefistofeli e qorton kështu Frejenë, kjo më tepër flet kundër Vagnerit. Disa vargje më tutje Loki i thotë Niordit: „Me motrën tënde bëre ti një djalë (të tillë) (*vidh systur thinni gatzu slikan mog*).¹⁶² Është e vërtetë se Niordi nuk është as, por van, dhe në „Inglingsage” ai thotë se martesat midis vëllezërve dhe motrave janë të zakonshme te vanët, por kjo nuk ndodh te asët.¹⁶³ Kjo mund të tregonte se vanët janë perëndi më të vjetra se asët. Sidoqoftë, Niordi rron midis asëve si një shok i tyre dhe prandaj „Egisdreka” është më tepër një provë se në epokën e formimit të legjendave norvegjeze mbi perënditë martesat midis vëllezërve dhe motrave, të paktën midis perëndive, nuk shkaktonte ende asnjë neveri. Për të justifikuar Vagnerin do të ishte më mirë në vend të „Edës” t’i referohemi Gëtes, i cili në baladën mbi zotin dhe mbi bajaderën bën po atë gabim në lidhje me detyrën fetare të grave që t’u jepen burrave në tempull, duke e afruar këtë zakon tepër me prostitucionin modern. (*Shtesë e Engelsit për botimin e katërt të vitit 1891.*)

pujt më të egër, për të cilët flet historia, nuk mund të gjesh një shembull të padiskutueshëm të saj. Por që kjo familje *duhet* të ketë ekzistuar, këtë na shtërngon ta pranojmë sistemi i afërisë në ishujt Havai, që është në fuqi edhe sot në gjithë Polinezinë dhe që shpreh shkallët të tilla të lidhjeve të gjakut, të cilat mund të lindnin vetëm në këtë formë të familjes; na shtërngon ta pranojmë këtë gjithë zhvillimi i mëtejshëm i familjes, që kërkon ekzistencën e kësaj forme si një shkallë paraprake të domosdoshme.

2. *Familja punatuane*. Në qoftë se hapi i parë përpara në organizimin e familjes ka qenë përjashtimi i prindërve dhe i fëmijëve nga marrëdhëniet seksuale midis tyre, hapi i dytë ka qenë përjashtimi i motrave dhe i vëllezërve nga këto marrëdhënie. Ky hap, për arsye të një barazie më të madhe në moshë të pjesëmarrësve, ka pasur rëndësi shumë më të madhe, por ka qenë edhe më i vështirë se i pari. Ai u bë dalëngadalë, duke filluar, ndoshta, me përjashtimin nga marrëdhëniet seksuale të vëllezërve dhe të motrave të një barku (d.m.th. nga ana e nënës), në fillim në disa raste, duke u bërë pastaj rregull (në ishujt Havai ka pasur shtëmëngje nga ky rregull edhe në këtë shekull) dhe duke mbaruar me ndalimin e martesës madje edhe midis vëllezërve dhe motrave të një dege, d.m.th., sipas terminologjisë sonë, për fëmijët, për nipërit dhe për stërnipërit e vëllezërve dhe të motrave; ky është, sipas mendimit të Morganit,

„një ilustrim i mrekullueshëm se si vepron pari-mi i seleksionimit natyral”.

Nuk ka dyshim se fiset ku fëlligshtia në gjak u kufizua nga ky përparim duhej të zhvilloheshin më shpejt dhe më mirë se ato ku martesë midis vëllezër-

ve dhe motrave ishte një rregull dhe një detyrë. Dhe sa i madh ka qenë efekti i këtij përparimi provohet nga institucioni i *gjinisë*, që rrjedh drejtpërdrejt prej tij, por që e kalon qëllimin e parë dhe që formon bazën e regjimit shoqëror të shumicës, në mos të të gjithë popujve barbarë të tokës, dhe prej të cilit në Greqi dhe në Romë ne hyjmë drejtpërdrejt në epokën e qytetërimit.

Çdo familje fillestare duhej të ndahej të shumtën pas disa brezash. Ekonomia shtëpiake e përbashkët komuniste primitive, e cila sundon kudo pa asnjë përjashtim deri thellë në shkallën e mesme të barbarisë, përcaktonte përpjesëtimet maksimale të komunës familjare, që ndryshonin sipas kushteve, por që ishin pak a shumë të caktuara për çdo vend. Por, sapo lindi ideja se nuk mund të lejoheshin marrëdhëniet seksuale midis fëmijëve të një nëne, kjo duhet të ketë ndikuar në ndarjen e komunave të vjetra shtëpiake dhe në formimin e komunave të reja shtëpiake (këto komuna nuk ishte e thënë të ishin medoemos një me grupin familjar). Një sërë ose disa sërë motrash bëheshin bërthama e një komune, vëllezërit e tyre të një barku — bërthama e një tjetre. Në këtë mënyrë, ose afërsisht kështu, nga familja e një gjaku lindi ajo formë e familjes që Morgani e quan punaluane. Sipas zakonit të ishujve Havai disa motra të një barku ose më të largëta (kushërira të dyta, të treta etj.), ishin gra të përbashkëta të burrave të tyre të përbashkët, por prej këtij numri përjashtoheshin vëllezërit e tyre; këta burra tani nuk e quanin më shoqi-shoqin vëllezër, as që ishte nevoja të ishin vëllezër, por „punalua”, d.m.th. shokë të afërt, si të thuash — asocié*. Gjithashtu disa vëllezër të një barku ose më të largët ishin të martuar së bashku me disa gra, vetëm se jo me motrat e tyre,

* ortakë. Red.

dhe këto gra e quanin shoqja-shoqen punalua. Kjo është forma klasike e formacionit familjar, që më vonë pësoi një sërë ndryshimesh dhe që kishte si tipar karakteristik kryesor bashkësinë reciproke të burrave dhe të grave brenda një rrethi familjar të caktuar, prej të cilit përjashtoheshin vëllezërit e grave, në fillim ata të një barku dhe më vonë edhe ata më të largët dhe, nga ana tjetër, edhe motrat e burrave.

Pikërisht kjo formë e familjes na jep në mënyrë fare të saktë shkallët e afërisë që shprehen në sistemin amerikan. Fëmijët e motrave të nënës sime janë ende edhe fëmijët të saj, ashtu si fëmijët e vëllezërve të atit tim janë edhe fëmijë të tij, dhe të gjithë ata janë vëllezër të mi dhe motra të mia; por fëmijët e vëllezërve të nënës sime janë tani nipër dhe mbesa të saj, fëmijët e motrave të atit tim janë nipër dhe mbesa të tij dhe të gjithë ata janë kushërinj të mi të parë dhe kushërirra të mia të para. Dhe me të vërtetë, kur burrat e motrave të nënës sime mbeten ende edhe burra të saj, si dhe gratë e vëllezërve të atit tim mbeten ende gra të tija, — juridikisht, në mos gjithnjë faktikisht, — dënim i nga ana e shoqërisë i marrëdhënieve seksuale midis vëllezërve dhe motrave solli me vete ndarjen në dy kategori të fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave, të cilët deri atëherë quheshin pa ndryshim vëllezër dhe motra: një palë mbeten midis tyre si më parë vëllezër dhe motra (edhe për shkallët e largëta të afërisë), të tjerët — në një rast fëmijët e vëllait, në rastin tjetër fëmijët e motrës — tani *nuk mund* të jenë më vëllezër dhe motra, nuk mund të kenë më prindër të përbashkët — as atë të përbashkët as nënë të përbashkët as që të dy së bashku; dhe prandaj këtu për herë të parë lind nevoja e domosdoshme për kategorinë e nipërve dhe të mbesave, të kushërinjve të parë dhe të kushërirave të para, kategori që nuk do të kishte asnjë kuptim në rendin familjar të mëparshëm.

Sistemi amerikan i afërisë, i cili duket një absurditet fare i thjeshtë për çdo formë familjeje, që bazohet në këtë ose atë lloj monogamie, gjen shpjegim të arësyeshëm dhe mbështetje të natyrshme, deri në hollësitë më të vogla, në familjen punaluane. Të paktën po në atë shkallë që ishte përhapur ky sistem afërie, duhet të ketë ekzistuar edhe familja punaluane ose një formë e ngjashme me të.

Për këtë formë të familjes, ekzistenca reale e së cilës në ishujt Havai është provuar, ne do të kishim, ndoshta, të dhëna nga gjithë Polinezia, sikur misionarët e përsëritshëm, si dikur murgjit spanjollë në Amerikë, të kishin ditur të shikonin në këto marrëdhënie antikristiane diçka më tepër se sa vetëm një „turp të shëmtuar“*. Kur Cezari na flet për bretonët, që ishin atëherë në shkallën e mesme të barbarisë, dhe thotë se „te ata çdo dhjetë ose dymbëdhjetë burra kanë gra të përbashkëta dhe në pjesën më të madhe janë vëllezër me vëllezërit dhe prindër me fëmijët“, kjo shpjegohet më mirë se çdo gjë tjetër nga ekzistenca e martesës me grupe. Nën atë periudhë së barbarisë nuk kishin dhjetë-dymbëdhjetë djem aq të rritur, sa që të kishin gra të përbashkëta, kurse sistemi amerikan i afërisë, që i përgjigjet familjes punaluane, nënkupton një numër të madh vëllezërisht, sepse të tillë ishin të gjithë kushërinjtë e parë dhe kushërinjtë më

* Gjurmët e marrëdhënieve seksuale të parregullta, të së ashtuquajturës [„Sumpfzeugung“] „të zënë e mëkatshëm“, që Bahofeni thotë se i ka zbuluar, të shpien — dhe tani nuk ka më dyshim për këtë gjë — në martesën me grupe. „Në qoftë se Bahofeni i quan këto martesë „punalu“ „të paligjshme“, njeriu i asaj epoke do ta quante shumicën e martesave të sotme midis kushërinjve të afërm ose të largët, nga ana e atit ose e nënës, si një fëlligshiti në gjak, si një martesë midis vëllezërisht dhe motrash të një gjaku“ (Marks)¹⁶⁴.

të largët të çdo burri. Kur flet për „prindër me fëmijët”, Cezari, si duket, është gabuar; është e vërtetë se në këtë sistem nuk përjashtohet në mënyrë absurde mundësia që të gjenden në të njëjtin grup të martesish ati dhe biri ose nëna dhe bija, por nuk lejohet që të gjenden në një grup ati dhe bija ose nëna dhe djali. Gjithashtu kjo formë e martesës me grupe ose një formë e ngjashme me këtë na shpjegon shumë lehtë ato që thotë Herodoti dhe shkrimtarë të tjerë të lashtë mbi bashkësinë e grave te popujt e egër dhe barbarë. Po këtë gjë mund të themi edhe për ato që thonë Uotsoni dhe Keji („Popullsia e Indisë”) për tikurët e Audës (në veri të lumit Gang):

„Ata jetojnë së bashku (është fjala për marrëdhëniet seksuale), pothuajse pa asnjë dallim, në komuna të mëdha, dhe kur dy prej tyre quhen burrë e grua, kjo lidhje martesë është vetëm nominale”.

Si duket, institucioni i *gjinisë* ka lindur, në një shumicë të madhe rastesh, drejtpërdrejt nga familja punaluane. Është e vërtetë se për gjininë mund të kemi pasur si pikëpamje edhe sistemin australian të martesës me klasa,¹⁶⁵ australianët kanë gjini, por ata nuk kanë ende familje punaluane dhe kanë një formë më primitive të martesës me grupe.

Në të gjitha format e familjes me grupe nuk dihet kush është ati i foshnjës, por dihet kush është nëna. Ndonëse kjo i quan të gjithë fëmijët e familjes së përbashkët fëmijë të vet dhe kundrejt tyre ka detyrime amtare, megjithatë ajo i shquan fëmijët e barikut të vet nga të tjerët. Pra, është e qartë se, kur ekziston një martesë me grupe, origjina mund të caktohet vetëm nga ana e nënës, dhe prandaj njihet vetëm *vija e gruas*. Kështu ndodh në të vërtetë te gjithë popujt e egër dhe të gjithë popujt që janë në shkallën e ulët të barbarisë; dhe merita e dytë e madhe e Baho-

fenit është se ky qe i pari qe e zbuloi këtë. Njohja e origjinës vetëm nga vija e nënës dhe marrëdhëniet e trashëgimit, që u zhvilluan së këtejmi me kalimin e kohës, ai i quan e drejtë amtare; po e ruaj edhe unë këtë term, meqenëse është i shkurtër; por ai nuk është i saktë, sepse në këtë shkallë të zhvillimit të shoqërisë nuk mund të flasim ende për të drejtë në kuptimin juridik.

Tani po të marrim nga familja punaluane një nga dy grupet e saj tipike, dhe pikërisht grupin e motrave — të një barku dhe të një shkalle afërie më të largët (d.m.th. që rrjedhin nga motra të një barku në brezin e parë, të dytë ose më të largët) — bashkë me fëmijët e tyre dhe me vëllezërit e tyre — të një barku ose të shkallëve më të largëta të afërisë nga ana e nënës (të cilët, sipas premisë sonë, *nuk* janë burra të tyre), atëherë do të kemi pikërisht atë rreth personash, të cilët më vonë dalin si anëtarë të gjinisë në formën e saj fillestare. Të gjithë ata kanë si origjinë të përbashkët një grua; për shkak të origjinës së tyre prej saj të gjitha pasardhëset femra të çdo brezi janë motra. Por burrat e këtyre motrave nuk mund të jenë më tani vëllezërit e tyre, pra, nuk mund të rrjedhin nga kjo grua, pra, nuk bëjnë pjesë në këtë grup të një gjaku, i cili më vonë bëhet gjini; kurse fëmijët e tyre bëjnë pjesë në këtë grup, sepse rolin vendimtar e luan vetëm origjina nga vija e nënës, meqenëse vetëm ajo është e padyshimtë. Me ndalimin e marrëdhënieve seksuale midis të gjithë vëllezërve dhe motrave, bile edhe midis të afërmeve të degëve më të largëta nga ana e nënës, ky grup u shndërrua në gjini, d.m.th. u formua si një rreth i caktuar mirë njerëzish të një gjaku nga vija e gruas, të cilët nuk mund të martohen midis tyre, një rreth që prej kësaj kohe forcohet gjithnjë më tepër në saje të institucioneve të tjera të përbashkëta me karakter shoqëror dhe fetar

dhe shquhet gjithnjë më shumë nga gjinitë e tjera të po atij fisi. Për këtë do të flitet më me hollësi më tutje. Por në qoftë se ne vëmë re se gjinia zhvillohet jo vetëm në mënyrë të domosdoshme, por edhe si një gjë që kuptohet vetvetiu, nga familja punaluane, atëherë kemi arësye ta quajmë si një gjë pothuajse të sigurt ekzistencën e kësaj forme të familjes në të kaluarën të gjithë popujt, ku mund të gjenden institucionet e gjinisë, d.m.th. pothuajse të gjithë popujt barbarë dhe të kulturuar.

Kur Morgani shkroi librin e vet, njohuritë tona mbi martesat me grupe ishin shumë të kufizuara. Diçka dihet mbi martesat me grupe të australianëve të organizuar në klasa dhe, përveç kësaj, Morgani kishte botuar që më 1871 informatat që i kishin ardhur mbi familjen punaluane të ishujve Havai. Familja punaluane, nga njëra anë, shpjegonte plotësisht sistemin e afërisë që sundonte te indianët e Amerikës dhe që i shërbeu Morganit si pikëpamje për të gjitha studimet e veta; nga ana tjetër, ajo shërbeu si pikëpamje e gatshme, prej së cilës mund të nxirrej gjinia e mbështetur në të drejtën amtare; më në fund, ajo përfaqësonte një shkallë shumë më të lartë zhvillimi se sa klasat australiane. Prandaj kuptohet pse Morgani e quante atë si një shkallë zhvillimi që kishte ekzistuar patjetër përpara martesës me çifte dhe që, në kohët shumë të lashta, ishte përhapur kudo. Që atëherë ne kemi njohur një varg të tërë formash të tjera të martesës me grupe dhe tani dimë se Morgani këtu ka shkuar tepër larg. Por ai, megjithatë, pati fatin të gjente në familjen e vet punaluane formën më të lartë, formën klasike të martesës me grupe, pikërisht atë formë, prej së cilës mund të shpjegohet më lehtë kalimi në një formë më të lartë.

Njohuritë tona për martesën me grupe janë pasuruar aq tepër, para së gjithash në saje të misionarit

anglez Lorimer Fajson, i cili e ka studjuar shumë vjet me radhë këtë formë të familjes, në tokën e saj klasike — në Australi.¹⁶⁶ Shkallën më të ulët të zhvillimit ai e gjeti te zezakët australianë në rajonin Maunt Gambir në Australinë Jugore. Këtu tërë fisi është ndarë në dy klasa të mëdha — kroki dhe kumite. Marrëdhëniet seksuale brenda secilës nga këto klasa janë të ndaluara rreptësisht; përkundrazi, çdo burrë i një klase që kur lind është burri i çdo gruaje të klasës tjetër, kurse kjo e fundit është gruaja e lindur për të. Jo individë të veçuar, por grupe të tëra janë të martuara midis tyre, një klasë me klasën tjetër. Dhe duhet të theksojmë se as ndryshimi në moshë, as afëria e gjakut këtu nuk janë kurrë pengesë për marrëdhëniet seksuale, përveç kufizimeve që shkaktohen nga ndarja në dy klasa ekzogame. Për cilindo kroki çdo grua kumite është sipas zakonit grua e tij; por meqenëse bija e tij, si bijë e një gruaje kumite, është edhe ajo një kumite sipas së drejtës amtare, ajo për këtë arsye që kur lind është gruaja e çdo kroki, pra edhe gruaja e atit të vet. Sidoqoftë, organizimi i klasave, ashtu siç e njohim ne, nuk e pengon fare këtë gjë. Kështu, ose ky organizim ka lindur atëherë kur, megjithëse kishte një tendencë të errët për të kufizuar fëlligishtinë në gjak, njerëzit nuk i quanin ende si një gjë të tmerrshme marrëdhëniet seksuale midis prindërve dhe fëmijëve, — dhe në këtë rast sistemi i klasave lindi drejtpërdrejt nga gjendja e marrëdhënieve seksuale të parregullta, — ose marrëdhëniet seksuale midis prindërve dhe fëmijëve *ishin* tashmë të ndaluara prej zakonit kur lindën martesat me klasa, dhe në këtë rast gjendja e sotme tregon se ka ekzistuar më parë familja e një gjaku dhe është hapi i parë për kapërcimin e saj. Hipoteza e fundit ka më tepër të ngjarë. Me sa di unë, nuk jepen shembuj marrëdhëniesh seksuale midis prindërve dhe fëmijëve në Australi, dhe forma më e vonë

e ekzogamisë, gjinia e mbështetur në të drejtën amtare, gjithashtu, si rregull, parakupton në heshtje ndalimin e marrëdhënieve të tilla, si një gjë që ka ekzistuar që me formimin e gjinisë.

Sistemi i *dy* klasave gjendet, përveç rajonit të Maunt-Gambirit në Australinë Jugore, edhe më tej në Lindje në pellgun e Lumit Darling, dhe në Verilindje, në Kuinslend, dhe, kështu, është shumë i përhapur. Ky sistem përjashton vetëm martesat midis vëllezërve dhe motrave, midis fëmijëve të vëllezërve dhe fëmijëve të motrave nga vija e nënës, sepse ata janë të një klase; përkundrazi, fëmijët e motrës dhe të vëllait mund të martohen midis tyre. Një hap më tej drejt ndalimit të fëlligshtisë në gjak kemi në fisin kamilaroi në pellgun e lumit Darling në Uelsin Jugor të Ri, ku dy klasat e para u ndanë në katër, dhe secila prej këtyre katër klasave martohet e tërë me një nga klasat e tjera. Dy klasat e para që prej lindjes janë bashkëshortë midis tyre; sipas asaj ku bën pjesë nëna — në klasën e parë apo të dytë, fëmijët e saj i takojnë klasës së tretë ose të katërt; fëmijët e dy klasave të fundit, që janë të martuara midis tyre, bëjnë pjesë në klasën e parë dhe të dytë. Kështu, një brez gjithnjë bën pjesë në klasën e parë dhe të dytë, brezi që vjen pas tij — në klasën e tretë dhe të katërt, brezi i tretë — përsëri në klasën e parë dhe të dytë. Sipas këtij sistemi, fëmijët e vëllait dhe të motrës (nga ana e nënës) nuk mund të jenë burra e grua, por mund të jenë burra e grua nipërit e vëllait dhe të motrës. Ky sistem, i ndërlikuar në mënyrë të veçantë, ndërlikohet edhe më tepër duke u shartuar — të paktën më vonë — me gjini amtare. Por ne këtu nuk mund të merremi me këtë gjë. Shohim kështu se tendenca për të penguar fëlligshtinë në gjak gjithnjë shfaqet dhe rishfaqet, por duke vepruar në mënyrë instinktive, të vetëvetishme, pa pasur një kuptim të qartë të qëllimit.

Martesa me grupe, e cila në Australi është ende një martesë midis klasash, një martesë në masë e një klase të tërë burrash, shpesh të shpërndarë në të gjithë kontinentin, me një klasë grash të përhapur aq sa edhe klasa e burrave, — kjo martesë me grupe, po ta shikojmë për së afërmi, nuk është aspak aq e tmerrshme sa e përshkruan fantazia e filistajve, që është mësuar me prostitucionin. Përkundrazi, kaluan shumë vjet derisa filluan ta merrnin vetëm me mend ekzistencën e saj dhe s'ka shumë kohë që filluan përsëri ta vënë në dyshim këtë. Një vrojtuesi të cekët ajo i duket si një monogami e paqëndrueshme, dhe në disa raste — si një poligami me një pabesi që ndodh herë pas here. Duhet të punosh vite të tëra, siç bënë Fajsoni dhe Hauiti, për të zbuluar ligjin që rregullon këto marrëdhënie të martesës, të cilat në praktikën e tyre evropianit të zakonshëm i kujtojnë atdheun e tij, — ligj sipas të cilit një zezak i huaj australian, me mijëra kilometra larg nga vendi i lindjes së tij, midis njerëzish që flasin një gjuhë të panjohur për të, shpesh në çdo vendbanim, në çdo fis gjen gra që janë gati t'i jepen pa kundërshtim dhe pa u zemëruar, kurse njeriu që ka disa gra, ia lë natën njëren prej tyre mikut të vet. Atje ku evropiani sheh një gjë kundër moralit dhe kundër ligjit, atje në të vërtetë sundon një ligj i rreptë. Këto gra janë të një klase martesë me mikun, dhe prandaj ato që me të lindur janë gra të tij; po ai ligj moral, që i paracakton ata për shoqi-shoqin, po ai ligj ndalon nën kërcënimin e dënimit publik çdo marrëdhënie seksuale jashtë klasave të martesës, që i përkasin njëra-tjetrës. Bile edhe atje ku i rrëmbejnë gratë, gjë që ndodh shpesh dhe në shumë lokalitete, është një rregull, edhe atje ligji i martesës me klasa respektohet me kujdes.

Me rrëmbimin e grave shfaqen tani shenjat e kalimit në monogami, të paktën në formën e martesës me

çifte: kur një djalë i ri me ndihmën e miqve të vet ka rrëmbyer me forcë ose me dredhi një vajzë, ata të gjithë me radhë hyjnë me të në marrëdhënie seksuale, por pastaj ajo quhet gruaja e djalit të ri që organizoi rrëmbimin. Dhe, përkundrazi, kur gruaja e rrëmbyer ikën nga burri dhe e rrëmben një tjetër, ajo bëhet gruaja e këtij të fundit, dhe i pari humbet të gjitha të drejtat që kishte mbi të. Krahas martesës me grupe dhe brenda kësaj martese, që përgjithësisht vazhdon të ekzistojë, lindin, kështu, marrëdhënie që përjashtojnë persona të tjerë, lidhje pak a shumë të gjata çiftesh më vete, dhe krahas me këtë lind edhe poligamia, kështu që edhe këtu martesa me grupe fillon të zhduket, dhe çështja është kush do të zhduket nga skena më parë nën ndikimin e evropianëve — martesa me grupe apo zezakët australianë, që i përmbahen ende kësaj martese.

Martesa me klasa të tëra, ashtu siç sundon në Australi, është, sidoqoftë, një formë shumë e ulët dhe primitive e martesës me grupe, kurse familja punaluanë, me sa dimë, është shkalla më e lartë e zhvillimit të saj. E para, siç duket, i përgjigjet shkallës së zhvillimit shoqëror të endacakëve të egër, e dyta nënkupton vendosjen e komunave komuniste në banime pak a shumë të qëndrueshme dhe shpie drejtpërdrejt në një shkallë zhvillimi tjetër më të lartë. Ne, pa dyshim, midis këtyre dy formave të martesës do të zbulojmë edhe disa shkallë të ndërmjetme; këtu kemi një fushë kërkimesh që sapo është zbuluar, sapo është prekur.

3. *Familja me çifte*. Një farë bashkëjetese me çifte, për një kohë pak a shumë të gjatë, ka pasur edhe në martesën me grupe ose edhe më parë; burri kishte një grua kryesore (është ende vështirë të themi gruan që dashuronte) midis shumë grave që kishte; dhe ai ishte për të burri kryesor midis burrave të tjerë. Kjo rrethanë ka shkaktuar një ngatërrësë mjaft të madhe

në kokën e misionarëve, të cilët e quanin martesën me grupe herë si një bashkësi të çrregullt grash, herë si një shkelje arbitrare të besnikërisë bashkëshortore. Por një bashkëjetesë e tillë me çifte, që u bë zakon, duhej të përforcohej gjithnjë më tepër, sa më tepër zhvillohej gjinia dhe sa më tepër shtoheshin grupet e „vëllezërve” dhe të „motrave”, që tani nuk mund të martoheshin midis tyre. Shtytja që i dha gjinia ndalimit të martesave midis njerëzve të një gjaku shkoi edhe më tej. Kështu shohim se te irokezët dhe te shumica e indianëve, që janë në shkallën e ulët të barbarisë, martesë është ndaluar midis të gjithë njerëzve të një gjinie që ka sistemi i tyre dhe që janë me qindra. Meqë konfuzioni i ndalimeve të martesës shtohet gjithnjë më tepër, martesat me grupe bëheshin gjithnjë më të pamundshme; ato zëvendësoheshin nga familja me çifte. Në këtë shkallë burri rron me një grua, por në një mënyrë të tillë, që poligamia dhe kohë më kohë pabesia mbeten një e drejtë e burrit, megjithëse e para edhe për arsye ekonomike ndodh rrallë; kurse nga gratë për gjithë kohën e bashkëjetesës, në shumicën e rasteve, kërkohet një besnikëri e rreptë, dhe për shkeljen e besnikërisë bashkëshortore ato dënohen me ashpërsi. Por lidhjet e martesës mund të prishen lehtë nga të dy palët, dhe fëmijët, si dhe më parë, i përkasin vetëm nënës.

Edhe në këtë përjashtim të njerëzve të një gjaku nga lidhjet e martesës, përjashtim që zgjerohet gjithnjë më tepër, vazhdon të veprojë seleksionimi natyral. Sipas Morganit,

„martesat midis anëtarëve të gjinive, që nuk ishin të një gjaku, nxirrnin një racë më të fortë si nga pikëpamja fizike, ashtu edhe nga pikëpamja mendore; dy fise, në përparim e sipër, përziheshin, dhe kafka edhe truri i brezave të rinj rriteshin vetiu derisa të bashkonin në veten e vet zotësitë e të dy fiseve¹⁶⁷.

Kështu, fiset me organizim gjinor duhej të zotëronin mbi ato që kishin mbetur prapa ose t'i bënë me vete me shembullin e vet.

Pra, zhvillimi i familjes në epokën primitive bëhet duke ngushtuar parreshtur rrethin, i cili në fillim përfshin gjithë fisin dhe në të cilin sundon bashkësia e martesës midis dy sekseve. Duke përjashtuar vazhdimisht në fillim njerëzit më të afërm, pastaj edhe ata më të largët, më në fund, edhe ata që ishin lidhur vetëm me krushqi, çdo formë e martesës me grupe bëhet, në fund të fundit, praktikisht e pamundshme, dhe si rezultat mbetet vetëm një çift që nuk është lidhur ende mirë, ajo molekulë, me shkatërrimin e së cilës zhduket përgjithësisht martesë. Këtu duket se sa pak ka të bëjë me lindjen e monogamisë dashuria seksuale individuale në kuptimin e sotshëm të fjalës. Kjo provohet edhe më tepër nga praktika e gjithë popujve që janë në këtë shkallë të zhvillimit. Ndërsa në format e mëparshme të familjes për burrat nuk kishte kurrë mungesë grash, por, përkundrazi, kishte më tepër se sa duheshin, tani gratë u bënë të rralla dhe duheshin kërkuar. Prandaj me lindjen e martesës me çifte fillon rrëmbimi dhe blerja e grave — simptoma këto shumë të përhapura, por jo më tepër se simptoma të një ndryshimi shumë më të thellë, që është bërë; por në bazë të këtyre simptomave, që janë vetëm mënyra për të gjetur gra, pedanti skocez Mak-Lenan nxori lloje të veçanta të familjes: „martesën me të rrëmbyer” dhe „martesën me të blerë”. Përveç kësaj, te indianët e Amerikës dhe në popuj të tjerë (që janë në të njëjtën shkallë zhvillimi) martesë nuk është një çështje e të interesuarve, të cilët shpesh edhe nuk i pyesin, por e nënave të tyre. Kështu shpeshherë fejohen dy persona që nuk njihen fare midis tyre, të cilëve u bëhet e ditur marrëveshja që është bërë vetëm kur vjen koha e martesës. Përpara dasmës dhëndrri u bën peshqeshe

të afërmve të nuses (d.m.th. të afërmve nga ana e nënës, por jo të atit të nuses dhe të afërmve të tij); këto peshqeshe janë si shpërblim për dhënien e vajzës. Martesa mund të priset me dëshirën e secilit prej të dy bashkëshortëve, por te shumë fise, për shembull te irokezët, është formuar dalëngadalë një opinion publik kundër prishjes së martesës në këtë mënyrë; kur ka grindje midis dy bashkëshortëve, rolin e ndërmjetësit e marrin përsipër të afërmit e të dy palëve, dhe vetëm atëherë kur edhe ndërhyrja e tyre nuk jep fryt, bëhet ndarja; në këtë rast fëmijët i mbeten gruas dhe të dy palët kanë të drejtë të martohen përsëri.

Familja me çifte, e cila në vetëvete është ende shumë e dobët dhe shumë e paqëndrueshme që të shkaktojë nevojën për një ekonomi shtëpiake më vete ose vetëm dëshirën për një ekonomi të tillë, nuk e zhduk aspak ekonominë shtëpiake komuniste të trashëguar nga periudha e mëparshme. Por ekonomi shtëpiake komuniste do të thotë sundim i grave në shtëpi, ashtu si njohja pa përjashtim e nënës, meqenëse nuk ka mundësi të njihet me siguri ati, do të thotë respekt të madh kundrejt grave, d.m.th. kundrejt nënave. Një nga idetë më absurde që kemi trashëguar nga epoka e iluminizmit të shekullit XVIII, është ideja se gjoja në fillim të zhvillimit të shoqërisë gruaja ka qenë skllave e burrit. Te të gjithë të egrit dhe te të gjitha fiset që janë në shkallën e ulët, të mesme dhe pjesërisht edhe në shkallën e lartë të barbarisë, gruaja jo vetëm që është e lirë, por zë dhe një vend shumë të respektuar. Se ç'vend zë gruaja në martesën me çifte, për këtë mund të dëshmojë Asher Rajti, që ka qenë shumë vjet misionar midis irokezëve të fisit seneka. Ai thotë:

„Sa për familjet e tyre, në ato kohëra kur ata jetonin ende në shtëpitë e vjetra, të gjata” (ekonomi shtëpiake komuniste të disa familjeve) „... atje kurdoherë zotëronte një klan” (gjini), „kështu që gratë

i merrnin burrat nga të tjera klane" (gjini) "...Zakonisht në shtëpi sundonte femra; zahiretë ishin të përbashkëta; por mjerë ai burrë ose dashnor që ishte tepër dembel ose jo i shkathët dhe nuk binte pjesën e vet në zahirenë e përbashkët! Sado fëmijë dhe sado pasuri të vetën që të kishte ai në shtëpi, çdo minutë mund të priste urdhërin të mbledhjeve lekat dhe të thyente qafën. Dhe as që mund të kundërshtonte; shtëpia bëhej për të një skëtërrë dhe nuk i mbetej gjë tjetër veçse të kthehej në klanin" (gjininë) „e vet ose — ajo që ngjiste më shpesh — të kërkonte të martohej rishtazi në një klan tjetër. Gratë ishin një fuqi e madhe në klanet" (gjininë) „dhe përgjithësisht kudo. Kur ishte rasti, ato s'e kishin për gjë të hiqnin edhe të parin e klanit dhe ta bënin luftëtar të thjeshtë"¹⁶⁸.

Ekonomia shtëpiake komuniste, ku të gjitha gratë ose shumica e tyre janë vetëm të një gjinie, kurse burrat janë nga gjini të ndryshme, është baza reale e sundimit të gruas, e cila ka qenë e përhapur kudo në epokën primitive dhe zbulimi i së cilës përbën meritën e tretë të Bahofenit. — Për të plotësuar ato që thashë më lart, dua të shënoj këtu se të dhënat që kemi nga udhëtarët dhe nga misionarët mbi punën e tepërt të grave të popujt e egër dhe barbarë nuk janë në kundërshtim aspak me ato që thamë më sipër. Ndarja e punës midis dy seksëve nuk varet nga pozita e gruas në shoqëri, por nga shkaqe krejt të tjera. Popujt, ku gratë duhet të punojnë shumë më tepër se sa u takon sipas pikëpamjeve tona, shpeshherë ushqejnë kundrejt grave shumë më tepër respekt të vërtetë se sa evropianët tanë. Dama e epokës së qytetërimit, e rrethuar nga një respekt për sy e faqe dhe që nuk bën asnjë punë të vërtetë, ka një pozitë shoqërore shumë më të ulët se gruaja e epokës së barbarisë, që bënte një punë të rëndë; ajo konsiderohej nga populli i vet me të vërtetë si damë (*lady, frowa, Frau* = zonjë) dhe ishte me të vërtetë e tillë nga karakteri i pozitës së vet.

Një studim më i kujdesshëm i popujve të Amerikës Veri-perëndimore dhe, veçanërisht, i popujve të Amerikës Jugore, që gjenden ende në shkallën e lartë të egërsisë, duhet të na tregojë në është zëvendësuar apo jo plotësisht sot në Amerikë martesat me grupe nga familja me çifte. Për këta popuj tregojnë shembuj aq të ndryshëm lirie seksuale, saqë këtu mezi mund të pranohet një zhdukje të plotë të martesës së vjetër me grupe. Sidoqoftë, nuk janë zhdukur ende të gjitha gjurmët e saj. Të paktën te dyzet fise të Amerikës Veriore burri që merr motrën me të madhe, ka të drejtë të marrë si grua edhe të gjitha motrat e tjera, sapo që ato të arrijnë moshën e caktuar, — një mbeturinë e bashkësisë së burrave për një grup të tërë motrash. Për banorët e gadishullit të Kalifornisë (shkalla e lartë e egërsisë) Bankrofti tregon se këta popuj kanë disa të kremte, kur disa „fise” mblidhen bashkë për të hyrë në marrëdhënie seksuale të parregullta. Si duket, këto janë gjini që në këto të kremte ruajnë ende, në mënyrë të turbullt, kujtimin e asaj kohe kur gratë e një gjinie kishin për burra të përbashkët të gjithë burrat e gjinisë tjetër, dhe anasjelltas. Po ky zakon sundon gjithnjë në Australi. Në disa popuj ndodh që burrat më të vjetër, prijësit dhe priftërinjtë-magjistarë përdorin bashkësinë e grave në interes të vet dhe monopolizojnë për vete shumicën e grave; por për këtë gjë ata duhet në disa të kremte dhe kur bëhen kuvende të mëdha popullore të pranohet bashkësinë që kishte ekzistuar më parë dhe t'u lejojnë grave të veta të dëfrenjë me djem të rinj. Vestermarku në f. 28—29 të librit të vet sjell një varg të tërë shembujsh nga këto saturnale¹⁶⁹ periodike, kur për një kohë të shkurtër hyn në fuqi përsëri bashkimi i lirë seksual i vjetër: te fiset ho, santal, panxha dhe kotar në Indi, te disa popuj afrikanë etj., Vestermarku nxjerr së këtejmi në mënyrë të çuditshme përfundimin se kjo është një

mbeturinë e periudhës së të ethurit, që e kishte njeriu primitiv si dhe kafshët e tjera, dhe jo një mbeturinë e martesës me grupe, të cilën ai e mohon.

Ne vijmë këtu te zbulimi i katërt i madh i Bahofenit, te zbulimi i formës shumë të përhapur të kalimit nga martesë me grupe në martesën me çifte. Ajo që Bahofeni e paraqet si një larje për shkeljen e porosive të vjetra të perëndive, — larje, me të cilën gruaja fiton të drejtën e papërllyeshmërisë, — ajo në të vërtetë s'është veçse një shprehje mistike e shpërbljes që gruaja paguan për të shpëtuar nga bashkësia e burrave, që ekzistonte në kohët e vjetra, dhe për të fituar të drejtën që t'i jepet vetëm një burri. Kjo shpërblje është që gruaja t'u jepet të tjerëve në një kohë të kufizuar: gratë e Babilonisë duhej t'u jepeshin burrave një herë në vit në tempullin e Militës; popuj të tjerë të Lindjes së Afërme dërgonin vajzat e veta për vite të tëra në tempullin e Anaitisit, ku ato duhej të bënin dashuri të lirë me të zgjedhurit e vet, përpara se të fitonin të drejtën për martesë; zakone të tilla me veshje fetare hasim pothuajse te gjithë popujt e Azisë që rrojnë midis detit Mesdhe dhe lumit Gang. Siç e ka vënë re Bahofeni, sakrifica e larjes, që luan rolin e shpërbljes, me kohë bëhet gjithnjë më e lehtë:

„Sakrifica, që përsëritet çdo vit, zëvendësohet nga një detyrim, që bëhet një herë vetëm; pas heterizmit të matronave kemi heterizmin e vajzave; në vend që ta praktikojnë gjatë martesës, e praktikojnë përpara martesës; në vend që t'i jepen kujt do pa ndryshim, u jepen vetëm disa personave të caktuar” („E drejta amtare”, f. XIX).

Te popujt të tjerë mungon veshja fetare: te disa popuj — te trakët, keltët etj. në kohën e vjetër, te shumë autoktonë të Indisë, te popujt malezë, te banorët e ishujve të oqeanit Paqësor dhe te shumë indianë të Amerikës edhe sot — vajzat, derisa të martohen, gë-

zojnë një liri shumë të madhe seksuale. Veçanërisht kjo ndodh pothuaj kudo në Amerikën Jugore, siç mund ta dëshmojnë të gjithë ata që kanë hyrë thellë në këtë kontinent. Kështu Agasis („Një udhëtim në Brazil”, Boston dhe Nju-Jork, 1886, f. 266) tregon sa vijon për një familje të pasur me origjinë indiane. Kur ai u njoh me vajzën e kësaj familjeje, e pyeti për t’anë, duke kujtuar se ky do të ishte burri i nënës së saj, që atëherë merrte pjesë si oficer në luftë kundër Paragujit, por e ëma ju përgjegj me buzëqeshje: *nao tem pai, é filha da fortuna* — ajo nuk ka atë, ajo është pjellë e rastit.

„Kështu flasin kurdoherë gratë indiane dhe metise pa turp ose druajtje për fëmijët e vet jashtë martesës; dhe ky nuk është një përjashtim; si duket, përjashtim është më tepër e kundërta. Fëmijët... shpeshherë njohin vetëm nënën e vet, sepse tërë kujdesi dhe përgjegjësia bie mbi të; për atin e tyre ata nuk dinë asgjë, por edhe gruas, si duket, kurrë nuk i bie ndër mend se ajo dhe fëmijët e saj kanë ndonjë farë pretendimi kundrejt tij”.

Ajo që këtu një njeriu të qytetëruar i duket si një gjë e çuditshme, sipas së drejtës amtare dhe në martesën me grupe nuk është veçse një rregull.

Te disa popuj miqtë dhe të afërmit e dhëndrrit ose dasmorët kërkojnë në kohën e dasmës të drejtën e vet mbi nusen, të trashëguar që nga kohërat e vjetra, kështu që dhëndrri e ka radhën i fundit; kështu ka qënë në kohën e vjetër në ishujt Baleare dhe te augilët e Afrikës, kurse te bareat në Abisini kjo praktikohet edhe sot. Te popuj të tjerë një person zyrtar, kryetar i fisit ose i gjinisë, kasiku*, shamani**, prifti, princi,

* *Kasik* — kryetar fisi te indianët e Amerikës së Mesme. *Red. Përkth.*

** *Shaman* — magjistar te fiset e Siberisë që besojnë në shpirtra. *Red. Përkth.*

ose sido që të quhet, është përfaqësuesi i komunës dhe gëzon të drejtën e natës së parë. Me gjithë orvatjet e neoromantikëve për të zbutur këtë fakt, kjo *jus primae noctis** ekziston edhe sot e kësaj dite si një mbeturinë e martesës me grupe te shumica e banorëve të Alaskës (Bankroft, „Fiset vendase”, I, 81), te tahutët në Meksikën Veriore (po aty, f. 584) dhe te popuj të tjerë; dhe ka ekzistuar gjatë gjithë mesjetës — të paktën në ato vende që kanë qenë në fillim kelte, si për shembull në Aragonë, dhe ku është trashëguar drejtpërdrejt nga martesat me grupe. Ndërsa në Kastilje fshatari kurrë nuk ka qenë bujkrob, në Aragonë ka mbretëruar bujkrobëria më e turpshme deri në vendimin e arbitrazhit të marrë nga Ferdinand Katoliku më 1486¹⁷⁰. Në këtë dokument thuhet:

„Ne vendosim dhe shpallim se zotërinjtë e përmendur më sipër” (senyors, baronët) „... gjithashtu nuk kanë të drejtë, kur një fshatar martohet, të flenë me gruan e tij natën e parë, ose, kur nusja bie në dyshek natën e martesës, të kapërcejnë përmbi shtrat dhe përmbi nusen, në shenjë të sundimit të tyre; zotërinjtë e përmendur më sipër nuk kanë gjithashtu të drejtë të kërkojnë shërbime nga vajza ose nga djali i fshatarit kundër vullnetit të tyre, qoftë me pagesë ose jo”. (Cituar sipas tekstit origjinal në gjuhën katalonishte nga Zugenhajmi, „Bujkrobëria”, Peterburg, 1861, f. 355.)

Bahofeni, më tej, ka pa dyshim të drejtë kur pohon me këmbëngulje se kalimi nga ajo që ai e quan „heterizëm” ose „të zënë të mëkatshëm” në monogami është bërë në radhë të parë në saje të gruas. Sa më tepër që humbisnin karakterin e vet naiv primitiv marrëdhëniet midis sekseve, të trashëguara nga koha e vjetër, me zhvillimin e kushteve ekonomike të jetës dhe, si rrjedhim, me shkatërrimin e komunizmit

* *Jus primae noctis* — e drejta e natës së parë. Red.

primitiv dhe me shtimin e dendësisë së popullsisë, aq më tepër ato do t'u jenë dukur grave poshtëruese dhe të rënda; aq më me këmbëngulje gratë do ta kenë kërkuar si një çlirim të drejtën e papërllyeshmërisë, të drejtën e një martese të përkohshme ose të përherëshme vetëm me një burrë. Ky hap përpara nuk mund të ketë ardhur nga burrat, përveç të tjerave, edhe se ata përgjithësisht kurrë, bile edhe deri në ditën e sotme, nuk kanë pasur ndër mend të heqin dorë nga të mirat e martesës së vërtetë me grupe. Vetëm kur nga gratë u realizua kalimi në martesën me çifte, burrat mundën të vendosnin një monogami të rreptë, — kup-tohet, vetëm për gratë.

Familja me çifte lindi në cakun midis egërsisë dhe barbarisë, me shumë në shkallën e lartë të egërsisë dhe vetëm aty-këtu në shkallën e ulët të barbarisë. Familja me çifte është forma karakteristike e familjes për periudhën e barbarisë, ashtu siç është martesa me grupe — për egërsinë dhe monogamia — për qytetërimin. Që të mund të zhvillohej edhe më tej familja me çifte dhe të bëhej një monogami e fortë, u deshën shkaqe të tjera, përveç atyre që, siç e pamë, kishin vepruar deri atëherë. Qysh në bashkëjetesën me çifte grupi kishte zbritur në njësinë e vet të fundit, në një molekulë me dy atome, — në një burrë dhe në një grua. Seleksionimi natyral e kishte bërë punën e vet duke bërë gjithnjë më tepër përjashtime nga bashkimi i martesës; në këtë drejtim atij nuk i mbetej më tjetër për të bërë. Dhe, si rrjedhim, po të mos kishin filluar të vepronin forca lëvizëse *shoqërore* të reja, nuk do të kishte pasur asnjë shkak për lindjen e një forme të re të familjes nga familja me çifte. Por këto forca lëvizëse hynë në veprim.

Po e lëmë tani Amerikën, këtë tokë klasike të familjes me çifte. Nuk ka shenja të tilla që të na lejojnë të nxjerrim përfundimin se këtu u zhvillua një for-

më më e lartë e familjes, se këtu ka ekzistuar ndonjëherë gjëkund një monogami e fortë përpara zbulimit dhe pushtimit të këtij kontinenti. Ndryshe ishte puna me Botën e Vjetër.

Këtu zbutja e kafshëve shtëpiake dhe rritja e kopeve krijuan burime pasurie që nuk ishin parë deri atëherë, dhe bënë që të lindnin marrëdhënie shoqërore fare të reja. Deri në shkallën e ulët të barbarisë pasuria e përhershme përbëhej pothuajse vetëm prej banesës, prej veshjes, prej stolish primitive dhe prej veglave që duheshin për të gjetur dhe për të përgatitur ushqimin: lundra, armë, orendi shtëpiake shumë të thjeshta. Ushqimi duhej gjetur rishtazi ditë për ditë. Kurse tani popujt barinj, që po përparonin, — arianët në Penxhabin e Indisë dhe në krahinën e Gangut, si dhe në stepat e luginës së Amur-Darjes dhe të Sir-Darjes, të cilat atëherë ishin ende shumë më të pasura me ujë, semitët gjatë Eufratit dhe Tigris — bënë me kopetë e kuaajve, deveve, gomarëve, gjedheve, dhenve, dhive e derrave një pasuri, që donte vetëm një mbikëqyrje dhe një kujdes shumë të thjeshtë që të shtohesh gjithnjë më tepër dhe që të jepte një ushqim shumë të bollshëm qumështi dhe mishi. Të gjitha mjetet e mëparshme për të siguruar ushqimin tani bëhen të dorës së dytë; gjahu, që më parë ishte një nevojë e domosdoshme, u bë tani një luks.

Po kujt i përkiste kjo pasuri e re? Në fillim, pa dyshim, gjinisë. Por prona private e kopeve do të jetë zhvilluar prej kohësh. Është vështirë të themi nëse autori i të ashtuquajturit Libër i parë i Moisiut e quan te patriarkun Abraham pronar të kopeve të tij në bazë të së drejtës së tij si kryetar i një komune familjare apo në bazë të cilësisë së tij si kryetar i vërtetë dhe i trashëgueshëm i gjinisë. Një gjë është e sigurt, se ne nuk duhet ta parafytyrojmë atë si një pronar në kuptimin e sotëm të fjalës. S'ka dyshim gjithashtu se në pra-

gun e historisë së dokumentuar ne kudo gjejmë kope që janë një pronë e veçantë e kryetarëve të familjeve, ashtu siç gjejmë edhe vepra artistike të kohës së barbarisë, orendi metalike, sende luksi dhe, më në fund, bagëti njerëzore — skllëvër.

Sepse tani ishte shpikur edhe skllavëria. Për njeriun e shkallës së ulët të barbarisë skllavi ishte pa vlerë. Prandaj indianët e Amerikës silleshin në këtë kohë me armiqtë e mundur fare ndryshe nga ç'silleshin me ta në një shkallë më të lartë të zhvillimit. Burrat ata i vrisnin ose i pranonin si vëllezër në fisin e ngadhënjimtarëve; femrat i merrnin për gra ose i pranonin në ndonjë mënyrë tjetër si anëtare të fisit të vet bashkë me fëmijët që kishin shpëtuar. Në këtë shkallë fuqia punëtore e njeriut nuk jep ende një tepriçë të dukshme mbi shpenzimet që duhen për mbajtjen e saj. Me fillimin e rritjes së gjësë së gjallë, me punimin e metaleve, me mjeshtërinë e endjes dhe, më në fund, me punimin e tokës gjendja ndryshoi. Me fuqinë punëtore, veçanërisht kur kopetë u bënë përfundimisht pasuri e familjes, ndodhi po ajo gjë që ndodhi me gratë, të cilat më parë mund të gjendeshin shumë lehtë dhe që tani kishin një vlerë këmbimi dhe filluan të blehen. Familja nuk shtoej aq shpejt sa gjëja e gjallë. Për të ruajtur gjënë e gjallë, tani duheshin njerëz më shumë; për këtë qëllim mund të përdorej robi i luftës, i cili mund të shtoej po aq mirë, si edhe gjëja e gjallë.

Këto pasuri, sapo që kaluan një herë në zotërimin privat të familjeve të veçanta dhe u shtuan shpejt, i dhanë një grusht të shëndoshë shoqërisë së mbështetur në martesën me çifte dhe në gjininë amtare. Martesa me çifte futi në familjen një element të ri. Pranë nënës së vërtetë ajo vuri atin e vërtetë, i cili mund të themi se ishte bile më autentik se sa disa „etër” të kohës së sotme. Sipas ndarjes së punës në familje, që ekzistonte atëherë, burrit i binte barra që të gjente

ushqimin dhe veglat e punës të domosdoshme për këtë gjë dhe, prandaj, edhe e drejta e pronësisë mbi këto të fundit; kur prishej martesë, ai këto i merrte me vete, kurse gruas i mbeteshin orenditë shtëpiake. Prandaj, sipas zakonit të shoqërisë së atëhershme, burri ishte edhe pronar i burimit të ri të ushqimit — i gjësë së gjallë dhe më vonë i veglës së re të punës — i skllëvërve. Por, sipas zakonit të asaj shoqërie, fëmijët e tij nuk mund të bëheshin trashëgimtarë të tij, sepse puna e trashëgimit qëndronte kështu si do të themi më poshtë.

Sipas së drejtës amtare, d.m.th. derisa origjina llogaritej vetëm nga vija e nënës, dhe sipas rregullit filletar të trashëgimit në gjini, trashëgimtarë të anëtarit të fisit, që vdiste, ishin të afërmit e tij. Pasuria duhej të mbetej brenda gjinisë. Meqë sendet e trashëgimit ishin të pakta, ka të ngjarë që ato në praktikë t'i trashëgonin prej kohësh njerëzit më të afërt, d.m.th. — të afërmit nga ana e nënës. Porse fëmijët e burrit, që vdiste, nuk ishin të gjinisë së tij, por të gjinisë së nënës së tyre; ata trashëgonin nga ajo në fillim bashkë me gjithë të afërmit e nënës, më vonë, ndoshta, — në radhë të parë; por at nuk mund të trashëgonin nga i ati i tyre, sepse nuk ishin të gjinisë së tij dhe pasuria e atit të tyre duhej të mbetej brenda gjinisë. Kështu pas vdekjes së pronarit të kopeve, kopetë e tij duhej t'u kalonin në radhë të parë vëllezërve të tij dhe motrave të tija dhe fëmijëve të motrave të tija ose pasardhësve të motrave të nënës së tij. Kurse fëmijët e tij mbeteshin pa trashëgim.

Kështu, me shtimin e pasurive shtojë, nga njëra anë, rëndësia e pozitës së burrit në familje më tepër se ajo e gruas dhe, nga ana tjetër, krijohet tendenca për ta përdorur këtë pozitë të përforcuar që të ndryshohej rendi i zakonshëm i trashëgimit në dobi të fëmijëve. Por kjo nuk mund të bëhej, derisa origjina

llogaritej sipas së drejtës amtare. Prandaj kjo e drejtë duhej hequr, dhe ajo u hoq. Kjo nuk ka qenë aq e vështirë, siç na duket neve sot, sepse ky revolucion — një nga revolucionet më rrënjësore që ka jetuar njerëzimi, — nuk kishte nevojë të prekte asnjë nga anëtarët e gjallë të gjinisë. Të gjithë anëtarët e gjinisë mund të mbeteshin edhe pastaj ashtu siç kishin qenë më parë. Mjaftonte të vendosej se në të ardhmen pasardhësit e anëtarëve meshkujt të gjinisë duhej të mbeteshin në gjini, kurse pasardhësit e anëtarëve femra duhej të përjashtoheshin prej saj dhe të shkonin në gjininë e atit të tyre. Me këtë hiqej përcaktimi i origjinës nga vija e gruas dhe e drejta e trashëgimit sipas vijës së nënës dhe futej përcaktimi i origjinës nga ana e burrit dhe e drejta e trashëgimit sipas vijës së atit. Ne nuk dimë asgjë se si u bë dhe kur u bë ky revolucion te popujt e kulturuar. Ky revolucion i përket plotësisht epokës parahistorike. Por që ky revolucion është bërë, provohet më tepër se sa duhet nga të dhënat e gjurmëve të shumta të së drejtës amtare, që ka mbledhur sidomos Bahofeni; se sa lehtë bëhet ky revolucion, na e tregon shembulli i një serie të tërë fisesh indiane, ku ky revolucion është bërë tani vonë dhe po bëhet ende pjesërisht nën ndikimin e pasurisë që shtohet dhe të mënyrës së jetesës që ka ndryshuar (kallimi nga pyjet në stepa), dhe pjesërisht nën ndikimin moral të qytetërimit dhe të misionarëve. Nga tetë fiset e pellgut të Misurit gjashtë fise mbajnë origjinën dhe njohin të drejtën e trashëgimit nga vija e burrit, dhe dy ende nga vija e gruas. Te fiset shauni, majani dhe delavar është rrënjësor një zakon, sipas të cilit fëmijëve u vënë një emër nga të gjinisë së atit të tyre, që kështu ata të hyjnë në gjininë e atit të tyre dhe të bëhen trashëgimtarë të tij. „Është një kazuistikë e lindur te njeriu që ky të ndërrojë sendet, duke ndërruar emrat e tyre, dhe të gjejë shtigje për të prishur tradi-

tën brenda kufijve të traditës, kur interesi i drejtpërdrejtë shërben si një shtytje e mjaftueshme për ta bërë këtë! (Marks)¹⁷¹. Nga kjo u shkaktua një ngatërrësë e madhe, që mund të zhdukej dhe me të vërtetë pjesërisht u zhduk me kalimin në të drejtën atërore. „Ky duket të jetë përgjithësisht kalimi më i natyrshëm” (Marks)¹⁷². Sa për atë çka mund të na thonë juristët, që përdorin metodën krahasuese mbi mënyrën se si u bë ky kalim te popujt e kulturuar të Botës së Vjetër, — për këtë, natyrisht, kemi pothuajse vetëm hipoteza, — shih M. Kovalevski, „Vështrim mbi origjinën dhe mbi zhvillimin e familjes dhe të pronës”, Stokholm 1890.

Përmbysja e së drejtës amtare ka qenë *disfatë e madhe historike botërore e seksit femëror*. Burri mori në dorë frenat e sundimit edhe në shtëpi dhe grua-ja e humbi pozitën e vet të respektuar, u kthye në shërbëtoare, në skllave të epsheve të tij, u bë një vegël e thjeshtë për të pjellë. Kjo pozitë e poshtëruar e gruas, që shfaqet lakuriq sidomos te grekët e epokës heroike dhe — ca më tepër — te grekët e epokës klasike, gradualisht është zburuar në mënyrë hipokrite dhe vende-vende është paraqitur në një formë më të butë, por kurrë nuk është zhdukur.

Rezultati i parë i pushtetit të vetëm të burrave, që u vendos në këtë mënyrë, shfaqet në formën e ndër-mjetme të familjes patriarkale, që lindi tani. Karakteristika kryesore e saj nuk është poligamia, për të cilën do të flasim më poshtë, por

„organizimi i një numri të caktuar personash, të lirë dhe jo të lirë, në një familje që i nënshtrohet pushtetit atëror të kryetarit të familjes. Te semitët ky kryetar familjeje rron në poligami, njerëzit jo të lirë kanë gra dhe fëmijë, dhe qëllimi i gjithë këtij organizimi është që të ruajë kopetë brenda një territori të caktuar¹⁷³.”

Tipari kryesor për këtë familje është futja e njerëzve jo të lirë në të dhe pushteti atëror; prandaj tipi i përsosur i kësaj forme të familjes është familja romake. Fjala familia në fillim nuk ka kuptimin e idealit të filistinut të sotëm ideal, që nuk është veçse një kombinim i sentimentalizmit dhe i grindjeve shtëpiake; te romakët në fillim ajo nuk ka të bëjë bile as edhe me bashkëshortët dhe me fëmijët e tyre, por vetëm me skllëverit. Famulus do të thotë skllav shtëpiake, dhe familia quhen gjithë skllëverit që janë vetëm të një njeriu. Që në kohën e Gajit familia, id est patrimonium (d.m.th. trashëgim), trashëgohej me testament. Këtë shprehje romakët e shpikën për të karakterizuar organizmin e ri shoqëror, kryetari i të cilit ishte zot i gruas dhe i fëmijëve dhe i disa skllëvërve dhe që kishin, në saje të pushtetit atëror romak, të drejtën mbi jetën dhe mbi vdekjen e të gjithë këtyre njerëzve.

„Kështu, kjo shprehje nuk është më e vjetër se sistemi familjar i fiseve latine, i veshur me mburojë hekuri, që lindi pas vënies në përdorim të bujqësisë dhe legalizimit të skllavërisë dhe pas ndarjes së italikëve arianë nga grekët”¹⁷⁴.

Marksi këtu shton: „Familja e sotme përmban në thelb jo vetëm skllavërinë (servitus), por edhe bujkorësinë, sepse ajo që në fillim ka të bëjë me detyrimet bujqësore. Ajo përmban në *miniaturë* të gjithë antagonizmat, të cilët zhvillohen më vonë në shkallë të gjerë në shoqërinë dhe në shtetin e saj”¹⁷⁵.

Kjo formë familjeje është një kalim nga familja me çifte në monogami. Për të siguruar besnikërinë e gruas, dhe si rrjedhim, edhe për të pasur një atësi të sigurt, gruaja i nënshtrohet pa kushte pushtetit të burrit; kur ai e vret, ai ushtron vetëm të drejtën e vet.

Me familjen patriarkale ne hyjmë në fushën e historisë së shkruar dhe bashkë me këtë në një fushë ku jurisprudenca krahasuese mund të na japë një ndih-

më të madhe. Dhe me të vërtetë këtu ajo ka sjellë një përparim të madh. Maksim Kovalevski („Vështrim mbi origjinën dhe mbi zhvillimin e familjes dhe të pronës”, Stokholm 1890, f. 60—100) na ka dhënë provën se komuna shtëpiake patriarkale, që gjendet edhe sot në Serbi dhe në Bullgari me emrin „Zádruga” (që do të thotë afërsisht miqësi) ose „Bratstvo” (vëllezëri) dhe në një formë të ndryshme te popujt e Lindjes, ka qenë shkalla e kalimit prej familjes, që lindi nga martesat me grupe dhe që ishte mbështetur në të drejtën amtare, të familja e veçantë e botës së sotme. Kjo mund të quhet si një gjë e provuar të paktën për popujt e kulturuar të Botës së Vjetër, për arianët dhe për semitët.

Zadruga e sllavëve të Jugut është shembulli më i mirë, që ekziston ende, i një komune të tillë familjare. Ajo përmbledh disa breza, që rrjedhin nga një atë, bashkë me gratë e veta, dhe të gjitha ata rrojnë së bashku në një shtëpi, i punojnë së bashku arat e veta, ushqehen dhe vishen nga zahiretë e përbashkëta dhe kanë së bashku tepricën e të ardhurave. Komuna është nën drejtimin e lartë të të zotit të shtëpisë (*domaćin*), i cili e përfaqëson në botën e jashtme, ka të drejtë të shesë sende të vogla, mban arkën dhe ka përgjegjësi si për të, ashtu edhe për mbarëvajtjen e gjithë ekonomisë. Ai zgjidhet dhe nuk është medoemos më plaku. Gratë dhe punët e tyre drejtohen nga zonja e shtëpisë (*domaćinica*), që zakonisht është gruaja e zotit të shtëpisë. Edhe ajo luan një rol me rëndësi, shpeshherë një rol vendimtar në zgjedhjen e burrave për vajzat e komunës. Por pushteti më i lartë në komunë përqëndrohet në këshillin e familjes, në kuvendin e gjithë anëtarëve të rritur të komunës — si gra, ashtu dhe burra. Përpara këtij kuvendi jep llogari i zoti i shtëpisë; ky kuvend merr vendime të prera, gjykon anëtarët e ko-

munës, vendos për blerjet e për shitjet më me rëndësi, sidomos për blerjet e për shitjet e tokës etj.

Vetëm afro dhjetë vjet përpara u provua se komuna të tilla të mëdha familjare vazhdojnë të ekzistojnë edhe në Rusi¹⁷⁶, tani të gjithë pranojnë se ato janë rrënjosur aq thellë në zakonet popullore ruse, sa edhe komuna fshatare. Ato figurojnë në kanunin më të lashtë rus, në „Pravdën” e Jarosllavit¹⁷⁷ nën po atë emër (vervj) që kanë në kanunet e Dalmacisë¹⁷⁸; për to flitet edhe në burimet historike poloneze dhe çeke.

Sipas Hëslerit („Institucionet e së drejtës gjermane”), edhe te gjermanët njësi ekonomike fillestare nuk është familja e veçantë në kuptimin e sotëm, por komuna shtëpiake, që përbëhet nga disa breza me familjet e tyre dhe që përmban në gjirin e vet shpesh edhe njerëz jo të lirë. Edhe familja romake i shembëllen këtij tipi dhe prandaj në këto kohët e fundit vihet në dyshim shumë si pushteti absolut i të zotit të shtëpisë, ashtu edhe mungesa e të drejtave kundrejt tij e anëtarëve të tjerë të familjes. Edhe te keltët e Irlandës ka pasur, siç duket, komuna të tilla familjare; në Francë ato kishin mbetur në Niverne me emrin parçonneires deri në revolucionin francez, kurse në Fransh-Kontë ato nuk janë zhdukur ende fare edhe sot. Në krahinën e Luanit (departamenti i Sonës dhe i Luarës) ka shtëpi të mëdha fshatare me një sallë qendrore të përbashkët shumë të lartë, që arrin deri në çati, dhe me oda për të fjetur rreth e rrotull, ku ngjiten nëpër shkallë me 6—8 këmbëza dhe ku rrojnë disa breza të së njëjtës familje.

Në Indi komuna shtëpiake me punim të përbashkët të tokës përmendet nga Nearku në kohën e Aleksandrit të Madh dhe ajo ekziston edhe sot po në atë vend, në Penxhab, dhe në gjithë krahinat veriperëndimore të vendit. Në Kaukaz Kovalevski ka mundur të provojë ekzistencën e saj. Në Algjeri ajo ekziston ende

te kabilët. Ajo gjendej, si duket, edhe në Amerikë; mendohet se ajo mund të gjendet në „calpullis” të Meksikës së vjetër, që përshkruan Surita¹⁷⁹; përkundrazi, Kunovi („Ausland” Nr. 42—44, 1890)¹⁸⁰ ka provuar fare qartë se në Peru, në kohën e pushtimit të saj, ka ekzistuar një lloj institucioni si marka* (për çudi, edhe këtu ajo quhej marca, ku ka pasur një ndarje periodike të tokës së punuar, d.m.th. një punim individual të tokës.

Sidoqoftë, komuna shtëpiake patriarkale me pronë të përbashkët të tokës dhe me punim të përbashkët të saj fiton tani një rëndësi fare të ndryshme nga ajo që kishte më parë. Ne nuk mund të dyshojmë më për rolin e madh që ka lojtur ajo te popujt e kulturuar dhe te disa popujt të tjerë të Botës së Vjetër gjatë kalimit nga familja e mbështetur në të drejtën amtare në familjen e veçantë. Më poshtë do të kthehemi përsëri në përfundimin e mëtejshëm të Kovalevskit, sipas të cilit kjo komunë ka qenë edhe një shkallë kalimtare, prej së cilës është zhvilluar komuna fshatare ose komuna-markë me punimin individual të tokës prej familjeve të veçanta dhe me ndarjen në fillim periodike dhe pastaj përfundimtare të arave dhe të kullotave.

Për jetën familjare brenda këtyre komunave shtëpiake duhet të shënojmë se, të paktën në Rusi, dihet se të zotët e shtëpisë e shpërdorjnë së tepërmi pozitën e vet kundrejt grave të reja të komunës, sidomos kundrejt nuseve, dhe shpesh me to formojnë një harem të vetin; këngët popullore ruse flasin mjaft për këtë çështje.

Para se të flasim për monogaminë, që zhvillohet shpejt me rënien e së drejtës amtare, do të themi edhe disa fjalë për poligaminë dhe për poliandrinë. Të dyja

* *Markë* — komunë fshatare te gjermanët; krahinë kulltare. *Red. Përkth.*

këto forma të martesës mund të jenë vetëm përjashtime, — si të thuash, objekte historike të luksit, — duke përjashtuar, ndoshta, vetëm ato raste kur ato në ndonjë vend mund të paraqiten krah për krah njëra me tjetrën, gjë që, siç dihet, nuk ndodh. Pra, meqenëse burrat e përjashtuar nga poligamia nuk mund të ngushulloheshin me gratë që kishin mbetur të tepërta për shkak të poliandrisë, numri i burrave dhe i grave, pavarësisht nga institucionet shoqërore, deri atëherë ishte pothuajse i njëjtë, por as njëra as tjetra formë e martesës nuk mundi të bëhej një formë e përgjithshme. Në të vërtetë, poligamia e burrit ka qenë, si duket, një produkt i skllavërisë dhe ishte kufizuar vetëm për disa persona që kishin një pozitë të privilegjuar. Në familjen patriarkale semite rron në poligami vetëm patriarku dhe, shumë-shumë, disa nga djemtë e tij, të tjerët duhet të kënaqen me një grua. Kështu ndodh edhe sot në gjithë Lindjen; poligamia është një privilegj i të pasurve dhe i parisë, dhe ajo realizohet kryesisht duke blerë skllave; shumica e popullit rron në monogami. Një përjashtim i tillë është edhe poliandria në Indi dhe në Tibet; prejardhja e saj nga martesë me grupe, që është pa dyshim një gjë interesante, duhet të studjohet edhe më tej. Megjithatë, në praktikën e vet poliandria dallohet për një tolerancë shumë më të madhe se regjimi i xhelozisë në haremet muhamedane. Kështu, të paktën te nairët në Indi tre, katër ose më tepër burra, megjithëse kanë vetëm një grua të përbashkët, secili prej tyre mund të ketë, bashkë me tre ose më shumë burra të tjerë, një grua të dytë, të tretë, të katërt etj. Është çudi se si Mak-Lenani, kur i përshkruan këto klube martesë, ku mund të jesh njëkohësisht anëtar i disa klubeve, nuk ka zbuluar kategorinë e re të *martesës me klube*. Por ky zakon i martesave me klube nuk është aspak një poliandri e vërtetë; përkundrazi, siç e ka vënë re Zhiro-Tëloni, kjo është vetëm

një formë e veçantë e martesës me grupe; burrat rrojnë në poligami, gratë rrojnë në poliandri.

4. *Familja monogame.* Ajo lind nga familja me çifte, siç u shpjegua më sipër, në periudhën midis shkallës së mesme dhe shkallës së lartë të barbarisë; fitorja e saj përfundimtare është një nga shenjat e para të fillimit të epokës së qytetërimit. Ajo është e bazuar në sundimin e burrit dhe ka si qëllim të theksuar lindjen e fëmijëve, atësia e të cilëve të dihet me siguri; kjo është e domosdoshme, sepse fëmijët, me kohë, si trashëgimtarë të drejtpërdrejtë, duhet të marrin në zotërim pasurinë e atit të vet. Ajo ndryshon nga martesë me çifte, meqenëse lidhjet e martesës janë shumë më të qëndrueshme dhe tani ato nuk prishen me dëshirën e cilësdo palë. Tani, si rregull, vetëm burri mund të prishë martesën dhe të përzërë gruan. E drejta e pabesisë në martesë është e siguruar për burrin edhe sot, të paktën, sipas zakonit (Kodi i Napoleonit i jep shprehimisht këtë të drejtë burrit, derisa ky nuk e shpie gruan, me të cilën bashkëjeton, në shtëpinë bashkëshortore¹⁸¹) dhe me zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë kjo e drejtë zgjerohet edhe më tepër; në qoftë se gruas i kujtohet praktika e dikurshme e marrëdhënieve seksuale dhe dëshiron ta përsërisë atë, ajo dënohet shumë më rëndë se sa ndonjëherë përpara.

Forma e re e familjes shfaqet në tërë rreptësinë e vet te grekët. Ndërsa, siç thotë Marksi¹⁸², pozita e perëndeshave në mitologji tregon një periudhë më të lartë dhe të respektuar, në periudhën heroike ne e gjejmë gruan të poshtëruar nga sundimi i burrit dhe nga konkurrenca e skllaveve. Mjafton të lexosh në „Odisenë” se si Telemaku i pret fjalën nënës së vet dhe e shtërngon të heshtë¹⁸³. Te Homeri gratë e reja, që kapen në luftë, bëhen viktima të epsheve të fitimtarëve; krerët ush-

tarakë me radhë dhe sipas rangut të tyre zgjedhin ato më të bukurat; gjithë „Iliada”, siç dihet, është thurur mbi grindjen midis Akilit dhe Agamemnonit për një skllave të tillë. Bashkë me çdo hero pak a shumë të shënuar të Homerit përmendet edhe vajza që është kapur në luftë dhe me të cilën ai rron në tendën e vet. Këto vajza i shpien me vete në atdhe dhe shtëpinë bashkëshortore, siç bën, për shembull, Agamemnoni me Kasandrën¹⁸⁴ të Eskili; djemtë, që lindin me këto skllave, marrin një pjesë të vogël të trashëgimit të atit dhe njihen si qytetarë të lirë; Teukri është një djalë i tillë jo i ligjshëm i Telamonit dhe ka të drejtë të mbajë emrin e t'et. Bashkëshortja duhet që t'i durojë të gjitha këto, kurse ajo vetë duhet të ruajë rreptësisht papërlyeshmërinë dhe besnikërinë bashkëkohore. Megjithëse gruaja greke e epokës heroike gëzon një respekt më të madh se sa gruaja e epokës së qytetërimit, megjithatë ajo, në fund të fundit, i shërben burrit vetëm si nëna e trashëgimtarëve të tij të ligjshëm, si nikoqire kryesore e shtëpisë dhe mbikëqyrëse e skllaveve, të cilat ai mund t'i përdorë pas dëshirës si dashnore, dhe në të vërtetë i përdor. Pikërisht ekzistenca e skllavërisë krahas me monogaminë, prania e skllaveve të reja dhe të bukura, që i përkisnin plotësisht burrit, i dha që në fillim monogamisë një karakter specifik duke e bërë një monogami *vetëm për gratë*, por jo për burrat. Këtë karakter ka ajo edhe sot e kësaj dite.

Për grekët e mëvonshëm duhet bërë një ndryshim midis dorianëve dhe jonianëve. Dorianët, për të cilët si shembull klasik shërben Sparta, kanë në disa pikëpamje marrëdhënie martesë edhe më të vjetra se ato që përshkruhen të Homeri. Në Spartë ekziston martesë me çifte, që është ndryshuar sipas pikëpamjeve të atjeshme mbi shtetin dhe që në shumë pika na kujton ende martesën me grupe. Martesat shterpe pri-

shen: mbreti Anaksandrid (rreth 560 vjet para erës sonë), që kishte një grua shterpë, mori një të dytë dhe mbante dy shtëpi; po në atë kohë mbreti Ariston, që kishte dy gra shterpe, mori një të tretë, mirëpo la një nga të parat. Nga ana tjetër, disa vëllezër mund të kishin një grua të përbashkët; një njeri, të cilit i pëlqente më tepër gruaja e mikut të vet, mund ta kishte këtë grua së bashku me të, dhe konsiderohej si një gjë e pëlqyer t'ja lije një „hamshori” të shëndoshë, siç do të shprehej Bismarku, edhe kur ky nuk ishte bashkëqytetar. Plutarku thotë në një vend se si një spartane i dërgon burrit të vet një adhurues që kërkonte dashurinë e saj; nga kjo mund të nxjerrim përfundimin — sipas Shëmanit — se ka pasur një liri edhe më të madhe zakonesh. Prandaj një shkelje e vërtetë e besnikërisë bashkëkohore dhe pabesia nga ana e gruas prapa shpinës së burrit nuk ishte dëgjuar. Nga ana tjetër, Sparta, të paktën në kohën e vet më të mirë, nuk njihte skllëvër shtëpiakë, skllëvërit helotë rronin më vete në prona, prandaj për spartiatët¹⁸⁵ kishte më pak ngasje për të përdorur gratë e skllëvërve. Prandaj është e natyrshme që, për shkak të këtyre kushteve, gratë në Spartë të kishin një pozitë shumë më të nderuar se sa gratë e tjera greke. Gratë spartane dhe një pjesë e zgjedhur e hetereve* të Athinës kanë qenë të vetmet gra në Greqi, për të cilat të vjetrit flasin me respekt dhe fjalët e të cilave ata i quajnë të denja që t'i përmendin.

Krejt ndryshe qëndronte puna te jonianët, për të cilët është karakteristike Athina. Vajzat i mësonin vetëm të turrnin, të endnin dhe të qepnin, dhe shumëshumë të mësonin pak shkrim e këndim. Ato rronin pothuajse të mbyllura, rrinin vetëm në shoqërinë e

* *Hetere* — „mike”, grua me sjellje të lira, që shoqërohej me burra në Greqinë e vjetër. *Red. Përkth.*

grave të tjera. Dhomat e grave gjendeshin në një pjesë të ndarë të shtëpisë, në katin e sipërm ose prapa, ku burrat, sidomos të huajt, nuk hynin lehtë dhe ku gratë largoheshin kur vinin në shtëpi burra. Gratë nuk dilnin nga shtëpia pa qenë të shoqëruara nga një skllave; në shtëpi ato ishin me të vërtetë nën roje; Aristofani përmend qentë mollosë, të cilët i mbanin për të trembur ata që donin të shkelnin besnikërinë bashkëshortore¹⁸⁶, dhe në qytetet e Azisë, për t'i mbikëqyrur gratë, mbanin eunukë, të cilët në kohën e Herododit fabrikoheshin për tregëti në ishullin Hios dhe, sipas Vaksmutit, jo vetëm për barbarët. Te Euripidi gruaja quhet oikurema¹⁸⁷, d.m.th. send për punët e shtëpisë (kjo fjalë është asnjënjë), dhe për athinasin ajo me të vërtetë, po të lëmë mënjanë lindjen e fëmijëve, nuk ishte gjë tjetër veçse shërbëtorja kryesore. Burri merrej me stërvitje gjimnastikore, me punë shoqërore, prej të cilave gruaja ishte përjashtuar; ai, përveç kësaj, kishte shpesh në dispozicion të vet edhe skllave, dhe në periudhën e lulëzimit të Athinës — edhe një prostitucion të përhapur shumë, që sidoqoftë mbrohej nga shteti. Pikërisht në bazë të këtij prostitucioni u zhvilluan në Greqi të vetmet figura të gruas greke, të cilat me mendjen e tyre dhe me shijet e tyre artistike u ngritën aq lart mbi nivelin e përgjithshëm të grave të kohës së vjetër, sa edhe spartanet me karakterin e tyre. Por fakti që femra duhej të bëhej më parë herere për t'u bërë grua e vërtetë, është dënimi më i rreptë kundër familjes athinase.

Kjo familje athinase me kohë u bë një model, sipas të cilit organizonin jetën e vet shtëpiake jo vetëm jonianët e tjerë, por pak nga pak edhe gjithë grekët e metropolit dhe të kolonive. Por, megjithëse ishin të mbyllura dhe nën vërejtje, gratë greke mjaft shpesh gjenin raste për t'i gënjyer burrat e vet, kurse këta, që kishin turp të shfaqnin të paktën dashurinë më të

vogël kundrejt grave të veta, dëfrenin duke bërë aventura të ndryshme dashurie me hetere; por poshtërimi i grave mori hakun e vet dhe i poshtëroi vetë burrat, derisa ata, më në fund ranë në një pederasti të fëlliqur dhe shnderuan perënditë e veta, si dhe veten e vet, me mitin e Ganimedit.

Kjo ka qenë origjina e monogamisë, me sa mund ta ndjekim te populli më i qytetëruar dhe më i zhvilluar i kohës së lashtë. Ajo nuk ka qenë aspak fryt i dashurisë seksuale individuale, me të cilën ajo nuk kishte absolutisht asgjë të përbashkët, sepse martesat, si dhe më parë, mbeteshin martesë me leverdi. Ajo ka qenë forma e parë e familjes, në bazë të së cilës qëndronin jo kushte natyrale, por kushte ekonomike, pikërisht fitorja e pronës private mbi pronën e mëparshme të përbashkët, që ishte zhvilluar vetiu. Sundimi i burrit në familje dhe lindja e fëmijëve, që do të ishin vetëm të tij dhe që do të trashëgonin pasurinë e tij, — ky ka qenë qëllimi i vetëm i monogamisë, siç e shprehin haptazi grekët. Nga të gjitha anët e tjera ajo ishte një barrë për ta, një detyrim kundrejt perëndive, shtetit dhe të parëve të tyre, që ata duhej ta përmbushnin. Në Athinë ligji parashikonte jo vetëm martesën, por edhe përmbushjen nga ana e burrit të një minimumi të caktuar të të ashtuquajturave detyrime bashkëshortore.

Kështu, monogamia shfaqet në histori jo si një pajtim midis burrit dhe gruas dhe aq më pak si forma më e lartë e martesës. Përkundrazi. Ajo shfaqet si skllavërimi i një seksi nga seksi tjetër, si shpallja e kontradiktës midis sekseve, që deri atëherë nuk ishte parë në gjithë historinë e mëparshme. Në një dorëshkrim të vjetër të pabotuar, të hartuar prej Marksit dhe prej meje më 1846, unë gjej këto fjalë: „Ndarja e parë e punës ka qenë midis burrit dhe gruas për të prodhuar fëmijë”¹⁸³. Kësaj tani unë mund t'i shtoj:

antagonizmi i parë i klasave në histori bie në një kohë me zhvillimin e antagonizmit midis burrit dhe gruas në monogami, dhe shtypja e parë e klasës bie në një kohë me skllavërimin e seksit femëror nga seksi mashkullor. Monogamia ka qenë një përparim i madh historik, por njëkohësisht me të fillon, bashkë me skllavërimin dhe me pasurinë private, epoka që vazhdon edhe sot, në të cilën çdo progres është njëkohësisht edhe një regres relativ, kur mirëqenia dhe zhvillimi i disave arrihet me çmimin e vuajtjeve dhe të shtypjes së të tjerëve. Monogamia është ajo celulë e shoqërisë së qytetëruar, me anën e së cilës ne mund të studjojmë natyrën e antagonizmave dhe të kontradiktave që zhvillohen plotësisht brenda kësaj shoqërie.

Liria e vjetër relative e marrëdhënieve seksuale nuk u zhduk aspak me fitoren e martesës me çifte ose edhe të monogamisë.

„Sistemi i vjetër i martesës, që ishte mbyllur në kufij më të ngushtë nga zhdukja e ngadalshme e grupeve punaluanë, mbeti gjithnjë një rreth, brenda të cilit zhvillohej familja, dhe pengoi zhvillimin e saj deri në agimin e qytetërimit... ajo u zhduk, më në fund, duke kaluar në një formë të re heterizmi, e cila edhe në periudhën e qytetërimit i ndjek njerëzit, si një hije e errët që bie mbi familjen”¹⁸⁹.

Me heterizëm Morgani kupton marrëdhënie seksuale jashtë martesës që ekzistojnë *krahas me monogaminë*, marrëdhënie seksuale burrash me gra të pamartuara, që siç dihet, lulëzojnë në format më të ndryshme gjatë gjithë periudhës së qytetërimit dhe që kthehen gjithnjë më tepër në një prostitucion të hapët. Ky heterizëm rrjedh drejtpërdrejt nga martesë me grupe, nga ajo sakrificë, me të cilën gratë duke iu dhënë të tjerëve fitonin të drejtën e papërlyeshmërisë. Të jepej gruaja për të holla ishte në fillim një akt fetar; kjo bëhej në tempullin e perëndeshës së dashu-

risë, dhe paratë në fillim shkonin në thesarin e tempullit. Hijerodulet¹⁹⁰ e Anaititit në Armeni, të Afroditës në Korint, si edhe kërcimtarët fetare të Indisë që rrinin pranë tempujve, të ashtuquajturat bajadera (portugalisht bailadeira — kërcimtare) kanë qenë prostitutat e para. T'u jepeshin burrave të tjerë në fillim ishte një detyrë për çdo grua, më vonë kjo praktikohet vetëm nga këto priftëresha, që zëvendësonin të gjitha të tjerat. Te popuj të tjerë heterizmi e ka origjinën e vet në lirinë seksuale që kishin vajzat përpara martesës dhe, si rrjedhim, është gjithashtu një mbeturinë e martesës me grupe, që ka ardhur deri te ne, por vetëm me një rrugë tjetër. Me lindjen e pabarazisë në pasuri, d.m.th. që në shkallën e lartë të barbarisë, del në shesh aty-këtu, krahas me punën e skllavit, edhe puna me mëditje dhe, bashkë me të, si një rrjedhim i domosdoshëm, prostitucioni profesional i grave të lira krahas me barrën e detyrueshme të skllaveve që t'u jepen burrave. Kështu, trashëgimi që i ka lënë martesë me grupe qytetërimit, është me dy faqe, siç është me dy faqe, me dy kuptime, e ndarë më dysh, kontradiktore edhe çdo gjë që ka pjellë qytetërimi: nga njëra anë — monogamia, dhe nga ana tjetër — heterizmi me formën e vet më të fundit — prostitucionin. Heterizmi është një institucion shoqëror ashtu si dhe çdo tjetër institucion shoqëror; ai siguron ekzistencën e mëtejshme të lirisë së vjetër seksuale — në dobi të burrave. Heterizmi, që në të vërtetë jo vetëm durohet, por edhe praktikohet gjerësisht, sidomos nga klasat sunduese, dënohet vetëm me fjalë. Por ky dënim në të vërtetë nuk drejtohet kundër burrave që kanë pjesë në këtë mes, por vetëm kundër grave; ato i përbuzin dhe i dëbojnë nga shoqëria, që kështu të shpallin përsëri, si ligj kryesor të shoqërisë, sundimin absolut të burrave mbi seksin femëror.

Por bashkë me këtë zhvillohet kontradikta e dytë brenda vetë monogamisë. Krahas me burrin, që zbu-kuron ekzistencën e vet me heterizmin, qëndron grua-ja e neveritur. Njëra anë e kontradiktës nuk mund të kuptohet pa anën tjetër, ashtu si nuk është e mundur të kesh në dorë një mollë të tërë, pasi të kesh ngrënë gjysmën e saj. Por, siç duket, burrat nuk ishin të kë-tij mendimi derisa gratë i sollën në vete. Bashkë me monogaminë dalin dy tipe karakteristike shoqërore, dy tipe të përhershme, që nuk ishin njohur më parë: i dashuri i përhershëm i gruas dhe burri me brirë. Bu-rrat fituan kundër grave, por të mundurat morën për-sipër bujarisht që t'i kurorëzojnë fitimtarët. Krahas me monogaminë dhe me heterizmin një fenomen sho-qëror i pashmangshëm u bë edhe shkelja e besnikëri-së bashkëshortore, që ndalohej, dënohej rreptësisht, por që nuk mundi të çrrënjosej. Atësia e sigurt e fë-mijëve vazhdoi, si edhe më parë, të bazohej shumë-shumë në bindjen morale, dhe, për të zgjidhur kontra-diktën e pazgjidhshme, Kodi i Napoleonit vuri artiklu-llin 312:

„L'enfant conçu pendant le mariage a pour père le mari” — „Fëmija i zënë gjatë martesës ka për ba-ba burrin”.

Ky është rezultati i fundit i ekzistencës tremijë-vjeçare të monogamisë.

Kështu, kur familja e veçantë i mbetet besnike origjinës së vet historike dhe kur në bazë të sundimit absolut të burrit shprehet qartë kontradikta midis bu-rrit dhe gruas, kjo familje e veçantë na jep në minia-turë tablonë e kontrasteve dhe të kontradiktave, bre-nda të cilave lëviz shoqëria, që është ndarë në klasa me fillimin e epokës së qytetërimit dhe të cilat kjo shoqëri nuk është e zonja as t'i zgjidhë as t'i kapër-cejë. Unë këtu, kuptohet, flas vetëm për ato raste të

monogamisë kur jeta bashkëshortore shkon, me të vërtetë, sipas rregullave të karakterit që ka pasur në fillim ky institucion, por gruaja këtu revoltohet kundër sundimit të burrit. Që nuk ndodh kështu në të gjitha martesat, këtë gjë nuk mund ta dijë asnjëri më mirë se filistini gjerman, i cili nuk është i zoti të mbajë sundimin në shtëpinë e vet, ashtu si edhe në shtet; prandaj gruaja e tij me plot të drejtë merr në duart e veta pushtetin e burrit, për të cilin ai nuk është i denjë. Megjithatë, atij i duket se qëndron shumë më lart nga shoku i vet francez — shok në fatkeqësi — të cilit shpeshherë i ndodh shumë më keq se atij.

Megjithatë, familja e veçantë nuk ka marrë aspak kudo dhe kurdoherë formën e theksuar klasike që ka pasur te grekët. Te romakët, të cilët si pushtues të ardhshëm të botës kishin një pikëpamje më të gjerë mbi sendet, ndonëse më pak të stërholluar se grekët, gruaja gëzonte një liri dhe një respekt më të madh. Romaku ishte i mendimit se besnikëria bashkëshortore ishte mjaft e siguruar nga pushteti që ai kishte mbi jetën dhe mbi vdekjen e gruas së vet. Përveç kësaj, këtu gruaja njësoj si edhe burri mund ta prishte martesën, po të dëshironte. Por përparimi më i madh në zhvillimin e monogamisë u bë, pa dyshim, me hyrjen e gjermanëve në arenën historike dhe u bë sepse te gjermanët, ndoshta për shkak të varfërisë së tyre, monogamia, siç duket, atëherë nuk ishte zhvilluar ende plotësisht nga martesë me çifte. Ne nxjerrim këtë përfundim, duke u bazuar në këto tri rrethana që përmend Taciti. Së pari, me gjithë shenjtërinë e martesës, — „ata kënaqen me një grua, gratë rrojnë të rrethuara me papërlyeshmëri”, por te gjermanët ishte përhapur edhe poligamia midis fisnikëve dhe krerëve të fiseve, ashtu siç pamë te amerikanët, ku ekzistonte martesë me çifte. Së dyti, kalimi nga e drejta amtare te e drejta atërore duhet të jetë bërë aty vetëm pak

kohë para kësaj, sepse vëllai i nënës — farefisi mashkull më i afërmi sipas së drejtës amtare — quhej ende te ata pothuajse si njeriu më i afërm se vetë ati, dhe kjo pajtohej me pikëpamjen e indianëve të Amerikës, te të cilët Marksi, siç thoshte shpesh ai vetë, gjeti kyçin për të kuptuar të kaluarën tonë të lashtë. Dhe, së treti, gratë te gjermanët gëzonin një respekt të madh dhe ushtronin një ndikim të madh në çështjet shoqërore, gjë që është drejtpërdrejt në kundërshtim me sundimin e burrave, që karakterizon monogaminë. Nga kjo pikëpamje gjermanët pothuajse nuk ndryshojnë nga spartanët, te të cilët, siç e pamë më sipër, martesat me çifte gjithashtu nuk ishte zhdukur ende plotësisht. Kështu, edhe në këtë pikëpamje bashkë me gjermanët arriti të sundojë mbi botën një element krejt i ri. Monogamia e re, që u zhvillua mbi gjermadhat e botës romake në procesin e përzierjes së popujve, e veshi pushtetin e burrit me forma më të buta dhe u dha grave, të paktën nga ana e jashtme, një pozitë më të respektuar dhe më të lirë nga ç'kishte njohur ndonjëherë lashtësia klasike. Kështu për herë të parë u krijua mundësia që, në bazë të monogamisë — brenda saj, krahas me të dhe kundër saj, sipas rrethanave,— të arrihet një përparim më i madh moral, që ne ia detyrojmë asaj: dashuria seksuale individuale moderne, që nuk njihej në gjithë historinë e mëparshme.

Por ky përparim u shkaktua pa dyshim nga fakti se gjermanët ishin ende në periudhën e familjes me çifte dhe sollën në monogami, me sa ishte e mundur, pozitën që kishte gruaja në familjen me çifte; ky përparim nuk është shkaktuar aspak nga një prirje natyrale legjendare, e çuditshme e gjermanëve për një pastërti morale, prirje që në thelb konsiston në faktin se martesat me çifte në të vërtetë nuk ka ato kontradiktat morale të theksuara që ka monogamia. Përkundrazi, gjermanët në periudhën e dyndjeve të veta,

veçanërisht në dyndjet në drejtim të juglindjes, te nomadët e stepave të Detit të Zi, ranë shumë poshtë nga pikëpamja morale dhe morën nga këta, përveç mjesh-tërisë së tyre për të hipur në kalë, edhe vese të shëm-tuara kundër natyrës, siç dëshmon në mënyrë katego-rike Amiani për tajfalët dhe Prokopi për herulët¹⁹¹.

Por në qoftë se nga të gjitha format e familjes, që dihen, monogamia ka qenë e vetmja formë, në të cilën mund të zhvillohej dashuria seksuale moderne, kjo nuk do të thotë se kjo e fundit u zhvillua në të vetëm e ve-tëm ose të paktën kryesisht si dashuri midis bashkë-shortëve. Vetë natyra e një monogamie të qëndrueshme me sundimin e burrit e përjashtonte këtë gjë. Për të gjitha klasat historikisht aktive, d.m.th. për të gjitha klasat sunduese lidhja e martesës mbetet ashtu siç ka qenë që në kohën e martesës me çifte, — një marrë-veshje që bëjnë prindërit. Dhe forma e parë e dashuri-së seksuale, që shfaqet historikisht si pasion, dhe që mund ta ketë çdo njeri (të paktën ata të klasave sun-duese), pasioni, si forma më e lartë e prirjes seksu-ale, — dhe që përbën karakterin e tij specifik, — kjo formë e parë e saj, dashuria kalorsiane e kohës së mesme, nuk ka qenë aspak një dashuri bashkëshor-tore. Përkundrazi. Në formën e vet klasike, te provan-salët, dashuria kalorsiake rreh me të gjitha forcat e veta të shkelë besnikërinë bashkëshortore dhe poetët e saj i thurin lavdi. Lulja e poezisë provansale¹⁹² të dashurisë kanë qenë „albaset” (albas), gjermanisht këngët e agimit. Ato përshkruajnë me ngjyra të gjalla se si një kalorës fle në shtratin e bukuroshes së vet, që është gruaja e botës, dhe jashtë qëndron roja, që e lajmëron kalorësin se po afrohet agimi (alba), që kë-shtu ai të dalë pa e vënë re njëri; pastaj vjen skena e ndarjes, që është çasti kulminant i këngës. France-zët e Veriut dhe gjermanët tanë trima e përvetësuan këtë lloj poezie bashkë me mënyrën e dashurisë ka-

lorsiake, që i përgjigjet kësaj poezie, dhe plaku ynë Volfram fon Eshenbah ka bërë rreth po kësaj teme çapkëne tri këngë shumë të bukura, që më pëlqejnë më tepër se tri poemat e tij të gjata heroike.

Sot martesë në botën borgjeze bëhet dy llojesh. Në vendet katolike prindërit, si dhe më parë, i gjejnë djalin të ri borgjez një grua të përshtatshme, dhe kemi, natyrisht, si rezultat zhvillimin më të plotë të kontradiktës së monogamisë: një lulëzim të madh të heterizmit nga ana e burrit, dhe nga ana e gruas një lulëzim të madh të shkeljes së besnikërisë bashkëshortore. Kisha katolike e ka hequr ndarjen, siç duket, nga që u bind se kundër shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, si dhe kundër vdekjes, nuk ka asnjë ilaç. Përkundrazi, në vendet protestante djali borgjez, si rregull i përgjithshëm, ka një liri pak a shumë më të madhe për të zgjedhur një grua nga klasa e vet; prandaj si bazë të martesës këtu, deri në një farë pike, mund të kemi dashurinë, gjë që e kërkon edhe mirësjellja karakteristike për hipokrizinë protestante. Këtu heterizmi nuk zbatohet nga burri me energji aq të madhe, dhe pabesia e gruas nuk haset aq shpesh. Por meqenëse në çdo formë martesë njerëzit mbeten po ata që kanë qenë përpara martesës, dhe meqenëse borgjezia e vendeve protestante në shumicën e tyre janë filistej, kjo monogami protestante, edhe në rastet më të mira, është vetëm një bashkëjetesë bashkëshortore shumë e mërzitshme, që e quajnë lumtëri familjare. Pasqyra më e mirë e këtyre dy formave të martesës është romani: për formën katolike — romani francez, për formën protestante — romani gjerman. Si në njërin, ashtu edhe në tjetrin „ai e merr atë”: në romanin gjerman djali i ri merr vajzën, në romanin francez burri merr një palë brirë. Por nuk dihet mirë gjithmonë se kush prej tyre mbetet në pozitën më të keqe. Dhe prandaj mërzia e romanit gjerman e tmerron borgje-

zin francez jo më pak se sa e tmerron filistinin gjerman „imoraliteti” i romanit francez. Megjithatë, këto kohët e fundit, qëkurse „Berlini po bëhet një qytet i përbotshëm”, romani gjerman ka filluar të flasë me më pak druajtje për heterizmin dhe për pabesinë bashkëshortore, që atje ka shumë kohë që njihen.

Por në të dyja rastet martesat varet nga gjendja e klasës së palëve të interesuara dhe prandaj është gjithnjë një martesë me llogari. Kjo martesë me llogari në të dyja rastet kthehet mjaft shpesh në një prostitucion fare të hapët — nganjëherë për të dy palët dhe shumë më shpesh për gruan, e cila ndryshon nga një kurtizane e zakonshme vetëm sepse ajo nuk e jep trupin e vet ashtu siç jep një punëtore me mëditje punën që i paguhet me copë, por e shet trupin e vet një herë e mirë si skllave. Dhe për të gjitha martesat me llogari mund të përsërisim fjalët e Furjesë:

„Ashtu si në gramatikë dy mohime na japin një pohim, ashtu edhe në moralin bashkëshortor dy prostitucione na japin një virtyt”.¹⁹³

Dashuria seksuale mund të bëhet dhe bëhet me të vërtetë një rregull në marrëdhëniet me gratë vetëm midis klasave të shtypura, d.m.th. sot — në gjirin e proletariatit, pavarësisht nga fakti nëse njihen apo jo zyrtarisht këto marrëdhënie. Por në këto raste zhduken edhe të gjitha bazat e monogamisë klasike. Këtu nuk ka asnjë pronë, kurse monogamia dhe sundimi i burrave janë krijuar pikërisht për të ruajtur dhe për të trashëguar pronën; prandaj këtu nuk ka asnjë shtytje për të vendosur sundimin e burrit. Për më tepër, këtu nuk ka as mjete për këtë gjë: e drejta borgjeze, që mbron këtë sundim, ekziston vetëm për të pasurit dhe për marrëdhëniet e tyre me proletarët; për këtë duhen para dhe për shkak të varfërisë së punëtorit nuk ka asnjë vlerë për marrëdhëniet e punëtorit ku-

ndrejt gruas së vet. Këtu rolin vendimtar e luajnë marrëdhënie krejt të ndryshme personale dhe shoqërore. Dhe, përveç kësaj, qëkurse industria e madhe e detyroi gruan që të lërë shtëpinë, të dalë në tregun, e punës, të shkojë në fabrikë dhe shumë herë të bëhet edhe mbështetja e familjes, u zhduk çdo bazë për mbeturinat e fundit të sundimit të burrit në shtëpitë proletare, përveç një farë brutaliteti në sjelljen kundrejt grave, që është rrënjosur që me hyrjen e monogamisë. Kështu, familja e proletarit nuk është më një familje monogame në kuptimin e ngushtë të kësaj fjale, edhe kur kemi një dashuri shumë të madhe dhe një besnikëri të përhershme nga të dy palët dhe me gjithë bekimet e ndryshme kishtarë dhe shekullore. Prandaj edhe bashkudhëtarët e përjetshëm të monogamisë, heterizmi dhe pabesia bashkëshortore, këtu luajnë një rol shumë të vogël; gruaja në të vërtetë e fitoi përsëri të drejtën e prishjes së martesës, dhe kur palët nuk mund të merren vesh, ato preferojnë të ndahen. Me një fjalë, martesa proletare është monogame në kuptimin etimologjik të kësaj fjale, por aspak në kuptimin historik të saj.

Mirëpo juristët tanë thonë se me përparimin e legjislacionit po zhduket gjithnjë më tepër çdo arsye ankimi nga ana e grave. Legjislacionet e vendeve të sotme të qytetëruara pranojnë gjithnjë më tepër, e para, se martesa, që të jetë e vlefshme, duhet të jetë një kontratë e lidhur vullnetarisht midis dy palëve dhe, e dyta, se gjatë gjithë bashkëjetesës bashkëshortore të dy palët duhet të kenë po ato të drejta dhe detyra kundrejt njëra-tjetrës. Në qoftë se këto dy kushte do të zbatoheshin në mënyrë konsekuente, gratë do të mund të kishin gjithshka që do të dëshironin.

Ky argumentim thjesht juridik është krejt si ai që përdor borgjezi republikan radikal kur i bën thirrje herë pas here proletarit që të rrijë i qetë. Kontrata e

punës gjoja bëhet vullnetarisht nga të dy palët. Ajo konsiderohet si e bërë vullnetarisht, sepse ligji në kartë i vë të dy palët në kushte të barabarta. Pushteti që ka në dorë njëra nga palët në bazë të pozitës së saj si klasë, shtypja që për shkak të kësaj i bëhet, pra, palës tjetër, gjendja e vërtetë ekonomike e të dy palëve — për të gjitha këto s'pyet ligji. Dhe sa kohë që është në fuqi kontrata e punës, të dy palët duhet të kenë të drejta të barabarta, derisa asnjë palë nuk heq dorë shprehimisht nga të drejtat e veta. Ligji prapë nuk do të dijë asgjë, në qoftë se pozita ekonomike e detyron punëtorin që të heqë dorë edhe nga dukja e fundit e barazisë.

Përsa i përket martesës edhe ligji më përparimtar kënaqet plotësisht kur palët e interesuara formalisht japin pëlqimin e vet për martesë. Se ç'ndodh prapa skenës juridike, ku shfaqet jeta reale, si arrihet kjo marrëveshje e lirë — për këtë ligj dhe juristët mund të mos shqetësohen. Kurse një krahasim i thjeshtë i së drejtës në vendet e ndryshme duhet t'i tregojë juristit se ç'është në të vërtetë kjo marrëveshje e lirë. Në ato vende ku ligji u siguron fëmijëve trashëgimin e detyrueshëm të një pjese të pasurisë së prindërve, ku ata, si rrjedhim, nuk mund të mbeten pa trashëgim, — në Gjermani, në vendet ku ekziston e drejta franceze dhe në vende të tjera, — fëmijët, kur martohen, duhet të kenë pëlqimin e prindërve. Në vendet ku ekziston e drejta angleze dhe ku sipas ligjit nuk duhet pëlqimi i prindërve për martesë, prindërit kanë liri të plotë testamenti mbi pasurinë e vet dhe, po të duan, mund t'i lënë fëmijët e vet pa asnjë trashëgim. Por është e qartë se, megjithkëtë dhe madje pikërisht për këtë arsye, në ato klasa ku ka se ç'të trashëgohet, — në Angli dhe në Amerikë — liria e martesës në të vërtetë nuk është aspak më e madhe se në Francë dhe në Gjermani.

Puna nuk qëndron më mirë me barazinë juridike të të drejtave të burrit dhe të gruas në martesën. Pa-barazia e të drejtave midis tyre, që e kemi trashëguar nga marrëdhëniet shoqërore të mëparshme, nuk është shkak, por rezultati i skllavërimit ekonomik të gruas. Në ekonominë e vjetër shtëpiake komuniste, që përmblihte shumë çifte bashkëshortore me fëmijët e tyre, drejtimi i kësaj ekonomie, që i ishte besuar gruas, ishte po aq një veprimtari shoqërore e domosdoshme, sa edhe gjetja e ushqimit nga ana e burrave. Me lindjen e familjes patriarkale dhe edhe më tepër me lindjen e familjes së veçantë monogame, puna ndryshoi. Drejtimi i ekonomisë shtëpiake e humbi karakterin e vet shoqëror. Ai nuk kishte të bënte më me shoqërinë. Ai u bë një *punë private*; gruaja u bë shërbëtorja kryesore dhe u përjashtua nga pjesëmarrja në prodhimin shoqëror. Vetëm industria e madhe e kohës sonë i hapi asaj përsëri — dhe vetëm proletares — rrugën e prodhimit shoqëror, por në një mënyrë të tillë që, kur ajo përmbush detyrat e veta të shërbimit privat në familje, ajo mbetet jashtë prodhimit shoqëror dhe nuk mund të fitojë asgjë, ndërsa kur dëshiron të marrë pjesë në punën shoqërore dhe të fitojë për llogari të vet, atëherë ajo nuk është në gjendje të kryejë detyrat e veta familjare. Edhe nga kjo pikëpamje gjendja e gruas është njësoj si në fabrikë, ashtu edhe në të gjitha degët e punës, duke përfshirë edhe mjekësinë dhe avokaturën. Familja e veçantë e sotme është bazuar në skllavërinë shtëpiake të gruas, të hapët ose të maskuar, dhe shoqëria e sotme është një masë e përbërë fund e krye nga familje të veçanta, që janë molekulat e saj. Burri sot në shumicën e rasteve duhet të fitojë, të ushqejë familjen, të paktën në rrethin e klasave të pasura, dhe kjo i jep atij një pozitë sunduese, që nuk ka nevojë për asnjë privilegj juridik të veçantë. Ai në familje është borgjezi, gruaja për-

faqëson proletariatin. Por në fushën e industrisë karakteri specifik i zgjedhës ekonomike, që rëndon mbi proletariatin, shfaqet në gjithë ashpërsinë e vet vetëm atëherë kur zhduken të gjitha privilegjet e veçanta të klasës kapitaliste, që njihen me ligj, dhe vendoset me ligj një barazi e plotë të drejtash për të dyja klasat; republika demokratike nuk e zhduk antagonizmin midis të dyja klasave — ajo, përkundrazi krijon vetëm terrenin, mbi të cilin zhvillohet lufta për zgjidhjen e këtij antagonizmi. Gjithashtu karakteri i veçantë i sundimit të burrit mbi gruan në familjen e sotme dhe domosdoshmëria, si dhe mënyra e vendosjes së një barazie të vërtetë shoqërore për të dy palët do të dalin në dritë të plotë vetëm atëherë kur bashkëshortët do të kenë të drejta të plota të barabarta nga pikëpamja juridike. Atëherë do të duket se kushti i parë paraprak i çlirimit të gruas është kthimi i gjithë seksit femëror në prodhimin shoqëror, dhe kjo, nga ana e vet, kërkon që familja e veçantë të mos jetë më si një njësi ekonomike e shoqërore.

* * *

Pra, kemi tri forma kryesore të martesës, që u përgjigjen në përgjithësi tri shkallëve kryesore të zhvillimit të njerëzimit. Egërsisë i përgjigjet martesë me grupe, barbarisë — martesë me çifte, qytetërimin — monogamia e plotësuar nga pabesia bashkëshortore dhe nga prostitucioni. Në shkallën e lartë të barbarisë midis martesës me çifte dhe monogamisë futet sundimi i burrave mbi skllavet dhe poligamia.

Siç duket nga të gjitha ato që thamë deri tani, veçoria e përparimit, që shfaqet në këto ndryshime konsekuente të formave, është se liria seksuale, karakteristike për martesën me grupe, u hiqet gjithnjë më te

për grave, dhe jo burrave. Dhe me të vërtetë, martesat me grupe për burrat ekzistojnë në fakt edhe sot e kësaj dite. Ajo që për burrat quhet një krim dhe sjell me vete pasoja të rënda ligjore dhe shoqërore, për burrat quhet si një nder ose, në rastin më të keq, si një njollë morale pa rëndësi, që e mbajnë me kënaqësi. Por sa më tepër heterizmi tradicional ndryshon në kohën tonë nën ndikimin e prodhimit kapitalist të mallrave dhe i përshtatet këtij të fundit, sa më tepër ai kthehet në një prostitucion të hapët, aq më i madh është ndikimi zvetënues i tij. Dhe ç'është e vërteta, burrat i zvetëron shumë më tepër se gratë. Prostitucioni korrupton midis grave vetëm ato fatkeqe që bien viktima të tij dhe këto shumë më pak se sa kujtohet zakonisht. Por, nga ana tjetër, ai prish karakterin e gjithë meshkujve. Kështu, për shembull, një fejesë e gjatë është për dhëndrrin në nëntë të dhjetat e rasteve një shkollë e vërtetë përgatitëse e pabesisë bashkëshortore.

Por ne po shkojmë drejt një revolucioni shoqëror, në të cilin bazat ekonomike të monogamisë, që kanë ekzistuar deri më sot, do të zhduken në mënyrë po aq të pashmangshme, sa edhe bazat e asaj që e plotësojnë — të prostitucionit. Monogamia lindi nga përqëndrimi i pasurive të mëdha në një dorë, pikërisht — në duart e burrit, dhe nga kërkesa për t'ua lënë trashëgim këtë pasuri fëmijëve të këtij burri, dhe jo të një tjetri. Për këtë ishte e nevojshme monogamia e gruas dhe jo e burrit, sepse kjo monogami e gruas nuk pengonte aspak poligaminë e hapët ose të fshehtë të burrit. Por revolucioni shoqëror, që kemi përpara, duke kthyer në pronë shoqërore, të paktën, pjesën më të madhe të pasurive të patundshme, që trashëgohen — mjetet e prodhimit, — do ta çojë deri në minimum gjithë këtë shqetësim për trashëgiminë. Por meqë monogamia ka rrjedhur nga shkaqet ekono-

mike, a do të zhduket ajo kur të zhduken këto shkaqe?

Nuk do të ishte e pathemeltë t'i përgjigjeshim kësaj pyetjeje se ajo jo vetëm që nuk do të zhduket, por, përkundrazi, vetëm atëherë do të realizohet plotësisht. Sepse bashkë me shndërrimin e mjeteve të prodhimit në pronë shoqërore do të zhduket edhe puna me mëditje edhe proletariati, dhe, si rrjedhim, edhe nevoja e domosdoshme për një numër të caktuar grash, që mund të llogariten me statistikë, që të shesin trupin e vet për para. Prostitucioni do të zhduket, kurse monogamia, në vend që të zhduket edhe ajo, bëhet, më në fund, një realitet — edhe për burrat.

Kështu gjendja e burrave, sidoqoftë, do të ndryshojë shumë. Por edhe në gjendjen e grave, të të gjitha grave, do të bëhen ndryshime të mëdha. Me kalimin e mjeteve të prodhimit në pronë të përbashkët, familja e veçantë nuk do të jetë më një njësi ekonomike e shoqërisë. Ekonomia shtëpiake private do të kthehet në një degë shoqërore të punës. Kujdesi për fëmijë dhe edukimi i tyre do të bëhen një çështje shoqërore; shoqëria do të kujdeset njësoj për të gjithë fëmijët, qofshin të lindur nga martesë apo jo. Për këtë arsye do të zhduket shqetësimi për „pasojat” që sot përbëjnë momentin shoqëror më esencial, — moral dhe ekonomik, — që e pengon një vajzë t'i jepet burrit që dashuron pa frikë e pa rrezik. A nuk do të jetë ky një shkak i mjaftueshëm për një zhvillim gradual marrëdhëniesh seksuale më të lira dhe bashkë me këtë edhe për një opinion shoqëror më pak të rreptë kundrejt nderit të vajzave dhe turpit të grave? Dhe, më në fund, a nuk pamë ne se në botën e sotme monogamia dhe prostitucioni, ndonëse janë antiteza, por antiteza të pandara, janë polet e të njëjtit sistem shoqëror? A mund të zhduket prostitucioni pa shpënë në greminë bashkë me veten e vet edhe monogaminë?

Këtu hyn në veprim një moment i ri, i cili në kohën e zhvillimit të monogamisë edhe në ekzistonte, ekzistonte vetëm në embrion: dashuria seksuale individuale.

Para kohës së mesme as që mund të bëhej fjalë për dashuri seksuale individuale. Kuptohet vetëvetiu se bukuria fizike, marrëdhëniet miqësore, prirjet e përbashkëta etj. kanë zgjuar te njerëzit me seks të ndryshëm tendencën e një bashkimi seksual, se si për burrat, ashtu edhe për gratë nuk ishte një gjë fare pa rëndësi se me cilin ata i kishin këto marrëdhënie shumë intime. Por kjo ishte shumë e shumë larg nga dashuria e vërtetë seksuale e sotme. Gjatë gjithë kohës së lashtë martesat i bënin prindërit e atyre që martoheshin, dhe këta e pranonin këtë pa kundërshtim. Ajo pak dashuri bashkëshortore, që ekzistonte në kohën e lashtë, nuk ishte një prirje subjektive, por një detyrë objektive, nuk ishte baza e martesës, por plotësimi i saj. Marrëdhënie dashurie në kuptimin e sotëm të fjalës në kohën e lashtë ka pasur vetëm jashtë shoqërisë zyrtare. Teokriti dhe Moskhu, Longu në „Dafnis dhe Kloë“¹⁹⁴ këndojnë gëzime; dhe vuajtjet e dashurisë së barinjve; por këta ishin vetëm skllëvër që nuk merrnin pjesë në punët e shtetit, në sferën e jetës së qytetarit të lirë. Por, përveç lidhjeve të dashurisë midis skllëvërve, ne kemi lidhje dashurie vetëm si një produkt të shkatërrimit të botës së lashtë, që po vdiste, por edhe këtu me gra që janë jashtë shoqërisë zyrtare, — me hetere, d.m.th. me të huaja, ose me skllave të çliruara: në Athinë — në prakun e rënies së saj, në Romë — në kohën e perandorisë. Në goftë se midis qytetarëve dhe qytetareve të lirë ka pasur me të vërtetë lidhje dashurie, kjo bëhej duke shkelur besnikërinë bashkëshortore. Dhe për poetin klasik të dashurisë në kohën e lashtë, për Anakreontin plak, dashuria seksuale në kuptimin tonë ishte një gjë aq te-

për indiferente, saqë për të ishte një gjë indiferente edhe seksi i qenies që dashuronte.

Dashuria e sotme seksuale ndryshon kryekëput nga pasioni i thjeshtë seksual, nga erosi* i të lashtëve. Së pari, ajo kërkon nga qenia që dashuron dashuri reciproke; në këtë pikëpamje gruaja gjendet në pozitë të barabartë me burrin, kurse në kohën e erosit antik nuk kërkohesh aspak gjithnjë pëlqimi i saj. Së dyti, forca dhe vazhdimësia e dashurisë seksuale janë aq të mëdha, saqë mospasja e shoqi-shoqit dhe ndarja u duken të dy palëve fatkeqësi e madhe, në mos fatkeqësia më e madhe; ata vënë në rrezik çdo gjë, edhe jetën e tyre, që të kenë shoqi-shoqin, gjë që në kohën e lashtë ngjante vetëm në rastet e shkeljes së besnikërisë bashkëshortore. Dhe, më në fund, lind një kriter i ri moral për të çmuar e për të gjykuar lidhjet seksuale: nuk pyesin vetëm nëse janë lidhje me martesë apo jashtë martesës, por edhe nëse kanë lindur apo jo nga një dashuri e përbashkët. Natyrisht, në praktikën feudale osë borgjeze ky kriter nuk respektohet më mirë se sa kriteret e tjera morale, — nuk e çajnë këkën për të. E pranojnë këtë kriter, si dhe gjithë kriteret e tjera morale, por vetëm në teori, në letër. Dhe hëpërhë nuk mund të kërkohet më tepër.

Mesjeta fillon aty ku qëndroi bota e lashtë me fillimet e saj të dashurisë seksuale, fillon me shkeljen e besnikërisë bashkëshortore. Ne përshkruam më sipër dashurinë kalorslake që krijoi këngët e agimit. Nga kjo dashuri që përpiqet të prishë martesën, deri te dashuria që duhet të jetë baza e martesës, kemi ende një rrugë të gjatë, që kalorësia nuk e bëri dot deri në fund. Edhe po të shkojmë nga popujt mendjelehtë romanë te gjermanët e virtytshëm, ne shohim në poemën „Kënga e Nibelungëve” se Krimhilda, ndonë-

* *Eros* — perëndi e dashurisë, dashuri. *Red. Përkth.*

se fshehurazi, është dashuruar me Sigfridin jo më pak se ai me të, megjithatë, kur i thotë Gunteri se ai ka dhënë për të fjalën një kalorësi, emrin e të cilit ai nuk e përmend, ajo i përgjigjet vetëm kështu:

„Ju nuk kemi nevojë të më luteni; si të më urdhëroni, ashtu do të bëj gjithnjë; atë që do të më jepni Ju, im zot, për burrë, atë do të marr me gjithë qejf”.¹⁹⁵

Asaj as që i shkon ndër mend se këtu mund të merrej parasysh dashuria e saj. Gunteri kërkon të martohet me Brunhildën dhe Etzeli — me Krimhildën, të cilat nuk i kanë parë kurrë; pikërisht kështu edhe në „Gudrun”¹⁹⁶ Zigebanti nga Irlanda kërkon të martohet me norvegjezen Ute, Heteli nga Hegelingen — me Hildën nga Irlanda dhe më në fund Sigfridi nga Morlandi, Hartmuti nga Ormania dhe Hervigu nga Zelanda kërkojnë që të tre të martohen me Gudrunën; dhe vetëm këtu kjo e fundit vendos lirisht në favor të Hervigut. Zakonisht, një princi të ri nusen ia gjejnë prindërit kur ata janë gjallë; në rast të kundërt, ai e gjen vetë, duke u këshilluar me vasalët e mëdhenj, mendimi i të cilëve në të gjitha këto raste ka një peshë të madhe. Dhe nuk mund të ishte ndryshe. Për një kalorës ose një baron, si edhe për vetë princin sundues, martesja ishte një akt politik, një rast për të shtuar fuqinë e tij me aleanca të reja; rolin vendimtar duhej ta luanin interesat e shtëpisë, dhe jo dëshirat personale. Si ishte e mundur që në këto kushte fjalën e fundit në çështjen e martesës ta kishte dashuria?

Kështu ka qenë edhe për byrgerin e esnafeve të qyteteve mesjetare. Pikërisht privilegjet që e mbronin, rregulloret e esnafeve që krijonin gjithfarë kufizimesh, kufijtë artificialë që e ndanin atë juridikisht këtu — nga esnafet e tjera, atje — nga shokët e vet të esnafit dhe, përveç kësaj, — nga kallfët dhe nga çirakët e vet,

— e ngushtonin mjaft rrethin ku ai mund të gjente një grua të përshtatshme. Dhe cila ishte nusja më e përshtatshme, kjo çështje zgjidhej në këtë sistem të koklavitur, pa fjalë, jo nga dëshira e tij individuale, por nga interesi i familjes.

Kështu, në shumicën e madhe të rasteve lidhja e martesës deri në fund të mesjetës mbeti ashtu siç kishite qenë që në fillim, — një çështje që nuk zgjidhej nga vetë ata që martoheshin. Në fillim njerëzit lundin të martuar — të martuar me një grup të tërë të seksit tjetër. Në format më të vonshme të martesës me grupe ka të ngjarë të ketë ekzistuar po kjo gjendje, vetëm se grupi është ngushtuar gjithnjë më tepër. Në martesën me çifte, si rregull, janë nënat që merren vesh për të martuar fëmijët e vet; edhe këtu vendosnin duke pasur parasysh lidhje të reja farefisnie, të cilat duhej t'i siguronin çiftit të ri një pozitë më të fortë në gjini dhe në fis. Dhe kur me fitoren e pronës private mbi punën kolektive dhe me interesimin për trashëgim zunë një pozitë sunduese e drejta atërore dhe monogamia, — atëherë lidhja e martesës filloi të varej fund e krye nga rrethana ekonomike. *Forma* e martesës me të blerë zhduket, por në të vërtetë kjo martesë shtrihet edhe më tepër, sepse jo vetëm gruaja, por edhe burri çmohet jo sipas cilësive të tij personale, por sipas pasurisë së tij. Në praktikën e klasave sunduese qysh në fillim nuk ishte dëgjuar kurrë që prijet reciproke të palëve të qëndronin mbi arësyet e tjera si bazë e martesës. Një gjë e tillë hasej, ndoshta, vetëm në romanet ose te klasat e shtypura, të cilat nuk i kishin në hesap.

E tillë ishte gjendja kur prodhimi kapitalist, duke filluar që nga koha e zbulimeve gjeografike, nëpërmjet zhvillimit të tregëtisë së përbotshme dhe të manufakturës, hyri në fazën e përgatitjes për sundim botëror. Mund të mendohej se kjo mënyrë e lidhjes së marte-

save do të ishte për të mënyra më e përshtatshme, dhe në të vërtetë kështu ishte. Megjithatë — ironia e historisë së përbotshme është e pashtershme — pikërisht prodhimit kapitalist iu desh të hapte këtu një të çarë vendimtare. Duke shndërruar çdo gjë në mall, prodhimi kapitalist i zhduku të gjitha marrëdhëniet e lashta, të trashëguara nga e kaluara; në vend të zakoneve të trashëguara, në vend të së drejtës historike ai vuri shitjen dhe blerjen, marrëveshjen „e lirë”. Juristi anglez H. S. Mejn pandehte se bëri një zbulim shumë të madh kur tha se gjithë përparimi ynë, në krahasim me epokat e mëparshme, qëndron në kalimin from status to contract* — nga një gjendje e trashëguar në një gjendje të caktuar me marrëveshje të lirë, që megjithatë, — për sa kjo është e vërtetë përgjithësisht, — ishte thënë me kohë në „Manifestin komunist”¹⁹⁷.

Por marrëveshje mund të lidhin vetëm njerëz që janë në gjendje të vendosin lirisht për veten e vet, për aktet dhe për pasurinë e vet dhe kanë të drejta të barabarta midis tyre. Një nga veprat më me rëndësi të prodhimit kapitalist ka qenë pikërisht krijimi i këtyre njerëzve „të lirë” dhe „të barabartë”. Ndonëse kjo në fillim u bë vetëm në mënyrë gjysmë të ndërgjegjshme dhe pastaj u vesh me rrobe fetare, megjithatë që nga koha e reformës luteriane dhe kalviniste zuri vënd mirë teza se njeriu vetëm atëherë ka përgjegjësi të plotë për aktet e veta, kur i ka bërë këto akte plotësisht me vullnet të lirë, dhe se është një detyrë morale kundërshtimi ndaj çdo detyrimi për të bërë një akt imoral. Po si pajtohej kjo me praktikën e mëparshme të lidhjes së martesave? Sipas kuptimit borgjez, martesë ishte një marrëveshje, një ujdj juridike, dhe madje ajo më e rëndësishmja, sepse ajo përcaktonte përjetë fatin e trupit dhe të shpirtit të dy njerëzve. Është

* — nga statuti në marrëveshje. *Red.*

e vërtetë se në atë kohë formalisht kjo ujdj bëhej vullnetarisht; nuk bëhej pa pëlqimin e palëve. Por dihej shumë mirë se si jepej ky pëlqim dhe kush e lidhte martesën në të vërtetë. Mirëpo, në qoftë se duhej një vendim me të vërtetë i lirë për të lidhur marrëveshjet e tjera, pse të mos duhej një gjë e tillë edhe për ta lidhur këtë marrëveshje? A nuk kishin të drejtë të vendosnin lirisht për veten e vet, për trupin e vet dhe për organet e veta dy të rinj që do të lidheshin? A nuk u bë një modë për hir të kalorësisë dashurisë seksuale dhe a nuk u bë dashuria bashkëshortore forma e saj e drejtë borgjeze në kundërshtim me dashurinë kalorsiake, që ishte lidhur me pabesinë bashkëshortore? Po në qoftë se detyra e bashkëshortëve është që ta duan shoqi-shoqin, a nuk është vallë gjithashtu edhe detyrë e tyre që të martohen me njëri-tjetrin e jo me ndonjë tjetër? Dhe a nuk qëndronte vallë e drejta e atyre që dashuroheshin më lart se e drejta e prindërve, e të afërmeve, e mesitëve dhe e shkesëve të ndryshëm? Dhe në qoftë se e drejta e zgjedhjes së lirë personale u fut pa ceremoni në sferën e kishës dhe të fesë, a mund të qëndronte ajo përpara pretendimit të padurueshëm të brezit më të vjetër për të vendosur për trupin, shpirtin, pasurinë, lumtërinë dhe fatkeqësinë e brezit të ri?

Të gjitha këto pyetje nuk mund të mos shtroeshin në atë kohë kur ishin dobësuar të gjitha lidhjet e vjetra të shoqërisë dhe ishin tronditur të gjitha idetë e trashëguara nga e kaluara. Bota menjëherë u bë pothuajse dhjetë herë më e madhe; në vend të një çerekut të hemisferit, tani përpara syrit të evropianëve të Perëndimit qëndronte gjithë lëmshi i dheut, dhe këta nxituan të rrëmbenin edhe shtatë çerekët e tjerë. Dhe bashkë me kufijtë e vjetër të ngushtë të atdheut ranë gjithashtu edhe pengesat mijëvjeçare të mënyrës tradicionale mesjetare të të menduarit. Përpara syrit të jashtëm dhe të brendshëm të njeriut u hap një ho-

rizont shumë e shumë i gjerë. Ç'rëndësi mund të kishin nami si njeri i ndershëm dhe privilegjet e respektuara të esnafëve, të trashëguara brez pas brezi, ç'rëndësi kishin këto për një djalë të ri, që e tërhiqnin pasuritë e Indisë, minierat e floririt dhe të argjendit në Meksikë dhe në Potosi? Ajo ishte për borgjezinë koha e kalorësve endacakë; edhe ajo jetonte romantizmin e vet dhe ëndrrat e veta të dashurisë, por në mënyrën borgjeze dhe, në fund të fundit, me qëllime borgjeze.

Rrethanat u zhvilluan në mënyrë të tillë, që borgjezia në rritje e sipër sidomos në vendet protestante, ku ishte tronditur më tepër sistemi ekzistues, filloi gjithnjë më tepër të pranonte lidhjen e marrëveshjes së lirë edhe për martesën dhe e realizoi këtë në mënyrën që e përshkruam më sipër. Martesa mbeti një martesë klase, por brenda kufijve të klasës palëve iu dha një farë lirie për të zgjedhur. Edhe në letër, në teorinë e moralit dhe në përfytyrimin poetik, nuk kishte asgjë që të ishte rrënjosur aq thellë sa imoraliteti i çdo martese, që nuk bazohet në dashurinë seksuale të njëri-tjetrit dhe në pëlqimin me të vërtetë të lirë ë bashkëshortëve. Me një fjalë, martesa me dashuri u shpall si një e drejtë e njeriut, dhe jo vetëm një droit de l'homme* por, si përjashtim, edhe si një droit de la femme**.

Por kjo e drejtë e njeriut në një pikëpamje ndryshonte nga të gjitha të ashtuquajturat të drejta të tjera të njeriut. Ndërsa këto të fundit në praktikë shtriheshin vetëm në klasën sunduese — në borgjezinë, dhe zhdukeshin fare drejtpërdrejt ose tërthorazi për klasën e shtypur — proletariatin, këtu përsëri u duk iro-

* Lojë fjalësh: „droit de l'homme” do të thotë „e drejtë e njeriut” dhe „e drejtë e burrit”. Red.

** e drejtë e gruas. Red.

nia e historisë. Klasa sunduese mbetet e skllavëruar nga ndikime ekonomike që dihen, dhe prandaj në gjirin e kësaj kemi, vetëm si përjashtim, martesë që janë lidhur me të vërtetë lirisht, kurse këto martesë midis klasës së shtypur, siç e pamë, janë një rregull.

Kështu, liria e plotë në lidhjen e martesave mund të bëhet një realizim i përgjithshëm vetëm atëherë kur zhdukja e prodhimit kapitalist dhe e raporteve të pronës, që ka krijuar prodhimi kapitalist, do të zhduket të gjitha arësyet ekonomike të dorës së dytë, që luajnë një rol shumë të rëndësishëm edhe sot në zgjedhjen e bashkëshortit. Atëherë nuk do të mbetet asnjë motiv tjetër përveç dashurisë për shoqi-shoqin.

Meqenëse dashuria seksuale nga natyra e vet është e jashtëzakonshme, — ndonëse kjo gjë sot respektohet vetëm nga gruaja, — atëherë martesë e bazuar në dashurinë seksuale është nga natyra e vet një monogami. Ne pamë se sa të drejtë kishte Bahofeni që e quante kalimin nga martesë me grupe në monogami si një përparim, të cilin ua detyrojmë sidomos grave; vetëm kalimi nga martesë me çifte në monogami u detyrohet burrave; nga pikëpamja historike ai në thelb solli një keqësim të gjendjes së grave dhe lehtësoi pabesinë e burrave. Prandaj sapo të zhduken arësyet ekonomike, për shkak të të cilave gratë janë pajtuar me këtë pabesi të zakonshme të burrave, — kujdesi për ekzistencën e tyre dhe ca më tepër për të ardhmen e femijëve të tyre, — barazia e të drejtave të gruas, që do të arrihet si rezultat i këtij ndryshimi, do të favorizojë, po të gjykojmë në bazë të eksperiencës së mëparshme, në një shkallë shumë më të madhe një monogami të vërtetë të burrave se sa një poliandri të grave.

Por këtu nga monogamia do të zhduken patjetër ato tipare karakteristike që kjo i ka nga origjina e vet — nga raportet e pronës, dhe pikërisht, së pari, sundimi i burrit dhe, së dyti, pazgjidhmëria e martesës.

Sundimi i burrit në martesë është vetëm një pasojë e thjeshtë e sundimit të tij ekonomik dhe do të zhduket vetëvetiu bashkë me këtë të fundit. Pazgjidhmëria e martesës është pjesërisht një rrjedhim i kushteve ekonomike, në të cilat ka lindur monogamia, pjesërisht një trashëgim nga koha kur lidhja e këtyre kushteve ekonomike me monogaminë nuk kuptohej ende drejt dhe ekzagjerohej nga feja. Ajo sot shkelet me mijëra herë. Në qoftë se martesë morale është vetëm martesa me dashuri, atëherë mbetet martesë morale vetëm ajo martesë ku dashuria vazhdon të ekzistojë. Por zgjatja e dashurisë seksuale individuale është shumë e ndryshme për individë të ndryshëm, sidomos për burrat, dhe kur ndjenja shteron fare ose është zbrapsur nga një dashuri e re e zjarrtë, atëherë ndarja bëhet një gjë e mirë si për të dy palët, ashtu edhe për shoqërinë. Vetëm se duhen shpëtuar njerëzit nga bredhja nëpër llumin e panevojshëm të një procesi për ndarje.

Në këtë mënyrë, ajo që mund të supozojmë ne tani mbi format e marrëdhënieve seksuale pas zhdukjes së prodhimit kapitalist, ka sidomos një karakter negativ, kufizohet në shumicën e rasteve me atë që do të zhduket. Por ç'do të dalë si gjë e re? Kjo do të duket kur të rritet një brez i ri: një brez burrash, që nuk do të kenë kurrë rast në jetën e vet të blejnë një grua me para ose me mjete të tjera të pushtetit shoqëror, dhe një brez grash, që nuk do të kenë kurrë rast t'i jepen një burri për arësye të tjera, përveçse nga dashuria e vërtetë, ose të mos duan t'i jepen një burri që dashurojnë nga frika e pasojave ekonomike. Kur të lindin këta njerëz, ata nuk do ta çajnë kokën për të gjitha ato që sot ua parashtrojnë si një detyrë morale; ata do të dinë vetë se si të veprojnë dhe në përputhje me këtë do të përpunojnë vetë opinionin e vet shoqëror për aktet e cilitdo prej tyre, — dhe këtu vëmë pikë.

Por të kthehemi te Morgani, prej të cilit u larguam mjaft. Studimi historik i institucioneve shoqërore, që zhvillohen në periudhën e qytetërimit, del jashtë kuartit të librit të tij. Prandaj ai flet fare shkurt për fatin e monogamisë në këtë periudhë. Edhe ai e konsideron zhvillimin e mëtejshëm të familjes monogame si një farë përparimi, si një afrim drejt të drejtave të barabarta të sekseve, por nuk është i mendimit se ky qëllim është arritur që tani. Por, — thotë ai. —

„po të pranojmë faktin se familja ka përkthyer katër forma njëra pas tjetrës dhe gjendet tani në formën e pestë, del pyetja: a do të mbahet gjatë kjo formë në të ardhmen? Këtu ka vetëm një përgjegje — ajo duhet të zhvillohet bashkë me zhvillimin e shoqërisë dhe duhet të ndryshohet bashkë me ndryshimin e shoqërisë, pikërisht ashtu siç ka qenë edhe në të kaluarën. Duke qenë produkt i një sistemi shoqëror të caktuar, ajo do të pasqyrojë shkallën e zhvillimit të tij kultural. Meqenëse familja monogame që nga fillimi i qytetërimit e këtej është përmirësuar mjaft, dhe kjo duket sidomos në kohët e reja, atëherë, të paktën, mund të marrim me mend se ajo është në gjendje të përsoset edhe me tej, derisa të arrihet barazia e të dy sekseve. Në qoftë se familja monogame në një të ardhme të largët nuk do të jetë në gjendje më të plotësojë nevojat e shoqërisë, në këtë rast nuk mund të parashikojmë që më parë se ç'karakter do të ketë pasardhësja e saj¹⁹⁸.

III

GJINIA E IROKEZËVE

Kalojmë tani në një zbulim tjetër të Morganit, që ka, të paktën, po aq rëndësi sa edhe rindërtimi i formës primitive të familjes në bazë të sistemeve të afërisë. Morgani provoi se bashkimet gjinore brenda fisit që kanë emra kafshësh te indianët e Amerikës, në të vërtetë janë identike me genea të grekëve dhe me gentes të romakëve; se forma amerikane është forma fillestare, kurse forma greko-romane është një formë e mëvonshme, që rrjedh prej saj; se gjithë organizimi shoqëror i grekëve dhe i romakëve të kohës më të lashtë me gjininë e vet, me fratrinë* dhe fisin ka ngjashmëri të plotë me organizimin e indianëve të Amerikës; e gjinia është një institucion i përbashkët për të gjithë barbarët, deri në kohën kur hynë në epokën e qytetërimit dhe madje edhe më vonë (me sa mund të gjejkojmë sipas burimeve që kemi). Pasi u provua kjo, u sqaruan menjëherë pikat më të vështira të his-

* *Fratri* — grup gjinësh. *Red. Përkth.*

torisë më të lashtë greke dhe romake dhe njëkohësisht u zbuluan papritur para syve tanë tiparet kryesore të rendit shoqëror të epokës primitive përpara formimit të *shtetit*. Sado i thjeshtë që duket ky zbulim pasi ta kesh njohur, Morgani e bëri këtë vetëm kohët e fundit; në librin e vet të mëparshëm, që doli në vitin 1871, ai nuk kishte hyrë ende në këtë të fshehtë, zbulimi i së cilës i shtërngoi që atëherë të mbyllnin gojën përkohësisht historianët anglezë të epokës primitive, që zakonisht janë aq të sigurt në veten e vet.

Fjala latine gens, që Morgani e përdor kudo për të treguar këtë bashkim gjinor, rrjedh, si edhe fjala greke genos, që ka po atë kuptim, nga rrënja e përbashkët ariane gan (gjermanisht kan, sepse këtu, sipas rregullës së përgjithshme, në vend të g ariane duhet të kemi k), që do të thotë „me pjellë”. Fjalët gens, genos, sanskritisht drehanas, gotisht kuni (sipas rregullës që përmendëm më sipër), kyn në skandinavishten e vjetër dhe në anglo-sanksonishten, kin anglisht, künne në gjermanishten letrare të mesjetës kanë gjithashtu kuptimin gjini, origjinë. Por gens në latinishten dhe genos në greqishten përdoren në mënyrë të veçantë për të treguar një bashkim gjinor, që krenohet me origjinën e përbashkët (në këtë rast prej një të pari të përbashkët) dhe që me disa institucione shoqërore dhe fetare formon një bashkësi të veçantë, origjina dhe natyra e së cilës kanë mbetur, të paktën deri më sot, të paqarta për të gjithë historianët tanë.

Pamë më sipër, kur studjuam familjen punaluane, se çfarë përbërjeje ka gjinia në formën e vet fillestare. Ajo përbëhet nga të gjithë ata që me anë të martesës punaluane dhe në bazë të pikëpamjeve, që medoemos sundojnë në këtë martesë, formojnë pasardhësit e njohur të një nëne të parë themeluese të gjinisë. Meqenëse në këtë formë të familjes ati nuk mund të caktohet me siguri, njihet vetëm vija e gruas. Meqenëse

vëllezërit nuk mund të martohen me motrat e veta, por vetëm me gra të një origjine tjetër, atëherë, sipas së drejtës amtare, fëmijët e lindur me këto gra të huaja mbeten jashtë gjinisë. Në këtë mënyrë, brenda një bashkimi gjinor mbeten vetëm pasardhësit e *bijave* të çdo brezi; pasardhësit e bijve shkojnë në gjinitë e nënave të veta. Ç'bëhet ky grup prej një gjaku, kur ai formohet si një grup më vete kundrejt grupeve të tjera të ngjashme brenda fisit?

Si formë klasike të kësaj gjinie fillestare Morgani merr gjininë e irokezëve, veçanërisht gjininë e fisit seneka. Në këtë fis kemi tetë gjini që mbajnë emra kafshësh: 1) Ujku, 2) Ariu, 3) Breshka, 4) Kastori, 5) Dri, 6) Shepka, 7) Çapka, 8) Skifteri. Çdo gjini ka këto zakone:

1. Gjinia zgjedh sahemin e vet (plakun në kohë paqeje) dhe prijësin e vet (prijësin ushtarak). Sahemi duhej të zgjidhej brenda vetë gjinisë dhe detyra e tij trashëgohej brenda gjinisë, sepse, me t'u liruar ky vend, duhej të plotësohej menjëherë; prijësi ushtarak mund të zgjidhej edhe jashtë gjinisë, dhe nganjëherë mund të mos kishte fare të tillë. Si sahem kurrë nuk zgjidhej biri i sahemit të mëparshëm, sepse te irokezët sundonte e drejta amtare, dhe prandaj biri ishte i një gjinie tjetër, por shpesh zgjidhej i vëllai i sahemit të mëparshëm ose biri i motrës së tij. Në zgjedhjet merrnin pjesë të gjithë — burra dhe gra. Por zgjedhjet duhej të aprovoheshin nga shtatë gjini të tjera, dhe vetëm pas kësaj i zgjedhuri vendosej në detyrë në mënyrë solemne nga këshilli i përgjithshëm i bashkimit të irokezëve. Rëndësia e këtij akti do të duket më vonë. Pushteti i sahemit brenda gjinisë ishte një pushtet atëror, i një natyre thjesht morale; ai nuk kishte mjete detyrimi. Njëkohësisht, ai, nga detyra që kishte, ishte anëtar i këshillit të fisit seneka, si edhe anëtar i këshillit të përgjithshëm të bashkimit të irokezëve.

Prijësi ushtarak mund të jepte urdhëra vetëm në kohën e fushatave ushtarake.

2. Gjinia kur të dojë e heq sahemin dhe prijësin ushtarak. Edhe kjo vendoset së bashku nga burrat e nga gratë. Funkionarët që hiqen bëhen pas kësaj, si gjithë të tjerët, luftëtarë të thjeshtë, persona privatë. Edhe këshilli i fisit mund ta heqë sahemin, madje kundër vullnetit të gjinisë.

3. Asnjë nga anëtarët e gjinisë nuk mund të marrë grua brenda gjinisë. Ky është rregulli kryesor i gjinisë, lidhja që e mban të bashkuar; kjo është shprehja negative e një gjëje shumë të përcaktuar, e afërisë së gjakut, në bazë të së cilës individët që i bashkon kjo bëhen një gjini. Me zbulimin e këtij fakti të thjeshtë Morgani zbuloi i pari thelbin e gjinisë. Se sa pak e kuptonin deri atëherë thelbin e gjinisë, duket nga sa është thënë më parë për të egrit dhe për barbarët, ku njësitë e ndryshme, prej të cilave formohet rendi gjinor, i fushin pa i kuptuar dhe pa ndryshim në një thes me emrat: fis, klan, tum etj., duke shtuar shpesh se brenda një njësie të tillë martesë është e ndaluar. Kjo krijoi një konfuzion të tmerrshëm, ku zoti Mak-Lenan mundi të delte në rolin e Napoleonit për të vendosur rregullin me këtë urdhër të prerë: të gjitha fiset ndahen në fise brenda të cilave martesë është e ndaluar (egzogame), dhe në fise brenda të cilave martesë lejohej (endogame). Kështu, pasi e ngatërroi fare gësh-tjen, ai u zhyt në studime të stërholluara për të gjetur se cila nga të dyja kategoritë e veta absurde ishte më e vjetër — ekzogamia apo endogamia. Me zbulimin e gjinisë, të mbështetur në afërinë e gjakut dhe, si pasojë, në pamundësinë e martesës midis anëtarëve të saj, ky absurditet u zhduk vetëvetiu. Natyrisht, në shkallën e zhvillimit, në të cilën ne i gjejmë irokezët,

ndalimi i martesës brenda gjinisë respektohet në mënyrë absolute.

4. Pasurinë e të vdekurve e merrnin anëtarët e tjerë të gjinisë, ajo duhej të mbetej brenda gjinisë. Mëqenëse sendet që mund të linte pas vdekjes një irokez ishin të pakta, trashëgimin e tij e ndanin midis tyre anëtarët e gjinisë që ishin më të afërm me të; kur vdiste një burrë — vëllezërit dhe motrat e tij të një barku dhe vëllai i nënës; kur vdiste një grua — fëmijët e saj dhe motrat e saj të një barku, por jo vëllezërit. Po për këtë arsye burri dhe gruaja nuk mund të trashëgonin njëri nga tjetri, si edhe fëmijët — nga ati i tyre.

5. Anëtarët e një gjinie e kishin për detyrë të ndihmonin shoqi-shoqin, të mbronin njëri-tjetrin dhe sidomos të përkrahnin shoqi-shoqin kur merrnin hak për dëmin që u shkaktonte një i huaj. Për të mbrojtur sigurinë e vet, individit mbështetej te gjinia dhe mund të kishte besim në të; kush e fyente atë, kishte fyer gjithë gjininë. Këtej, nga lidhjet e gjakut që kishin gjinia, lindi detyra e gjakmarrjes, që pranohej pa kushte nga irokezët. Kur një njeri nga një gjini tjetër vriste një anëtar të gjinisë, gjithë gjinia e të vrarit kishte për detyrë të merrte gjakun. Në krye bëhej një orvatje për pajtim; këshilli i gjinisë së vrasësit mbli-dhej dhe i propozonte këshillit të gjinisë së të vrarit që të pajtoheshin, duke shfaqur më shpesh keqardhjen e vet dhe duke propozuar dhurata të mëdha. Kur pranohej propozimi, atëherë çështja merrte fund. Në rast të kundërt, gjinia që kishte pësuar humbjen caktonte një ose disa gjakmarrës, të cilët kishin për detyrë të gjurmonin dhe të vrisnin vrasësin. Kur bëhej kjo, gjinia e të vrarit nuk kishte të drejtë të ankohej, çështja quhej e përfunduar.

6. Gjinia ka emra të caktuar ose një sërë emrash, që mund t'i përdorë në gjithë fisin vetëm kjo gjini,

kështu që emri i çdo njeriu tregon njëkohësisht se ç'gjinië i përket. Me emrin e gjinisë janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme edhe të drejtat e gjinisë.

7. Gjinia mund të adoptojë të huaj dhe kështu t'i pranojë ata si anëtarë të gjithë fisit. Robërit e luftës, që nuk i vrisnin, bëheshin kështu, në bazë të adoptimit të tyre në një nga gjinitë, anëtarë të fisit seneka dhe fitonin me këtë të gjitha të drejtat e gjinisë dhe të fisit. Adoptimi bëhej me propozimin individual të anëtarëve të gjinisë, me propozimin e burrave që e pranonin të huajin si vëlla ose si motër, ose me propozimin e grave që e pranonin atë si fëmijë të vet; për aprovimin e një adoptimi të tillë duhej që pranimi i tij në gjini të bëhej në mënyrë solemne. Shpeshherë disa gjini, që ishin dobësuar për shkak të kushteve të jashtëzakonshme, në këtë mënyrë forcoheshin numerikisht përsëri duke adoptuar me shumicë nga një gjini tjetër, me pëlqimin e kësaj të fundit. Te irokezët pranimi solemn në gjini bëhej në një mbledhje publike të këshillit të fisit, që në fakt kthehej në një ceremoni fetare.

8. Është e vështirë të provohet nëse gjinitë indiane kanë të kremte fetare të veçanta; por ceremonitë fetare të indianëve janë të lidhura pak a shumë me gjininë. Në kohën e të gjashtë të kremteve fetare të përvitshme të irokezëve, sahemët dhe prijësit ushtarakë të çdo gjinie, në bazë të funksioneve të veta, quheshin si „mbrojtësit e besës” dhe kishin funksione priftërore.

9. Gjinia ka një vend të përbashkët ku varrosen të vdekurit. Irokezët e shtetit Nju-Jork, të shtërnguar nga të gjitha anët prej të bardhëve, tani nuk kanë më një vend ë tillë, por më parë e kishin. Indianë të tjerë e kanë edhe sot, si, për shembull, tuskarorët, që janë të afërm me irokezët dhe që, ndonëse janë të krishterë, në varrezat e veta kanë një radhë më vete për çdo gjini.

ni, dhe varrosin në një radhë me fëmijët nënën, por jo atin. Edhe te irokezët gjithë gjinia e të vdekurit merr pjesë në varrosje, kujdeset për varrin, për ligjëratat mbi varr etj.

10. Gjinia ka një këshill, që është një mbledhje demokratike e të gjithë anëtarëve të rritur të gjinisë, burra e gra, që kanë të drejtë të barabartë votimi. Ky këshill zgjidhje dhe hiqte sahemët e prijësit ushtarakë, si edhe „mbrojtësit“ e tjerë të „besës“; ai merrte vendime mbi larjen e gjakut (wergeld) ose mbi gjakun që duhej marrë për vrasjen e anëtarëve të gjinisë; ai pranonte të huajin në gjini. Shkurt, ai ishte pushteti më i lartë i gjinisë.

Këto janë funksionet e një gjinie tipike indiane.

„Të gjithë anëtarët e saj janë njerëz të lirë, që e kanë për detyrë të mbrojnë lirinë e shoqi-shoqit; duke qenë se të gjithë kanë të drejta personale të barabarta, as saheми as prijësi ushtarak nuk pretendojnë të kenë ndonjë epërsi; ata formojnë një vëllazëri të lidhur me nyje gjaku. Liria, barazia, vëllazëria, ndonëse kjo kurrë nuk ka qenë formuluar, ishin parimet kryesore të gjinisë, dhe gjinia, nga ana e vet, ishte njësia e një sistemi të tërë shoqëror, baza e shoqërisë së organizuar indiane. Me këtë shpjegohet ndjenja e pathyer e pavarësisë dhe e dinjitetit personal, që secili duhet t'ua njohë indianëve¹⁹⁹.

Në kohën e zbulimit të Amerikës indianët e gjithë Amerikës Veriore ishin organizuar në gjini që mbështeteshin në të drejtën amtare. Vetëm te disa fise, si, për shembull, te fisi dakota, gjinitë ishin në rënie e sipër dhe te disa të tjera, si te fiset oxhibva, omaha, ato ishin organizuar në bazë të së drejtës atërore.

Te shumë fise indiane, që kanë më tepër se pesë ose gjashtë gjini, ne hasim grupe më vete me tri, katër ose më tepër gjini në secilin; Morgani e quan këtë grup fratri (vëllazëri), duke përkthyer besnikërisht fja-

lën indiane me një fjalë greke. Kështu, fisi seneka ka dy fratri; në të parën bëjnë pjesë gjinitë 1—4, në të dytën — gjinitë 5—8. Një studim më me hollësi na tregon se këto fratri janë më tepër gjinitë-nëna, në të cilat ndahej në fillim fisi; sepse me ndalimin e martesave brenda gjinisë çdo fis duhej të përmbante medemos të paktën dy gjini që të ishte në gjendje të ekzistonte më vete. Me shumëzimin e fisit, çdo gjini, nga ana e vet, ndahej në dy ose më tepër gjini, të cilat tani bëheshin më vete, kurse gjinia-nënë, ku hyjnë të gjitha gjinitë-bija, vazhdon të ekzistojë si fratri. Në fisin seneka dhe në shumicën e indianëve të tjerë gjinitë e një fratrie konsiderohen si gjini-motra, kurse gjinitë e fratrisë tjetër janë për ta gjini-kushërira, — emra që në sistemin amerikan të afërisë, siç e pamë më sipër, kanë një kuptim shumë real e të qartë. Në fillim asnjë seneka nuk mund të merrte grua brenda fratrisë së vet, por ky zakon ka kohë që është hequr dhe është në fuqi vetëm brenda gjinisë. Sipas një gojëdhane të fisit seneka, gjinitë e para, nga të cilat dolën gjinitë e tjera, ishin gjinitë „Ariu” dhe „Dreri”. Pasi zuri rrënjë një herë ky organizim i ri, ai u ndryshua sipas nevojave; kur shuheshin gjinitë e një fratrie, për plotësimin e saj shpeshherë transferoheshin në këtë fatri gjini të tëra nga fratri të tjera. Prandaj në fise të ndryshme ne gjejmë gjini me emra të njëjlojtë, të grupuara në mënyrë të ndryshme në fratribë.

Te irokezët funksionet e fratrive pjesërisht kanë një karakter shoqëror, pjesërisht një karakter fetar. 1) Në lojën me top fratribë vihen njëra kundër tjetrës; secila nxjerr lojtarët e vet më të mirë, të tjerët ndjekin lojën të ndarë sipas fratrive dhe vënë bast midis tyre për fitoren e lojtarëve të tyre. 2) Në këshillin e fisit sahemët dhe prijësit ushtarakë të çdo fratrie rrinë bashkë, një grup kundrejt tjetrit, çdo orator flet duke iu drejtuar përfaqësuesve të çdo fratrie si një kor-

porate më vete. 3) Kur në fis ndodhte një vrasje, dhe vrasësi dhe i vrari nuk ishin të një fratrie, atëherë gjinia e dëmtuar shpesh u bënte thirrje gjinive-motra të veta, ato atëherë mblidhnin këshillin e fratrisë dhe i drejtoheshin fratrisë tjetër si një tërësi, që kështu ajo, nga ana e vet, të mblidhte këshillin e vet për të zgjidhur çështjen. Kështu, fratria këtu del përsëri si një gjini-nënë dhe me shpresë më të madhe për sukses se sa një gjini e veçantë e dalë prej saj, që ishte më e dobët. 4) Kur vdisnin njerëz të shquar, fratria e kundërt merrte përsipër organizimin e varrosjes dhe ceremonitë e rastit, kurse anëtarët e fratrisë së atij që kishte vdekur merrnin pjesë si të afërm, të cilëve u kishte rënë zia. Kur vdiste një sahem, fratria e kundërt njoftonte këshillin e bashkimit të irokezëve se vendi ishte bosh. 5) Edhe në zgjedhjet e sahemit dilte në skenë këshilli i fratrisë. Aprovimi i zgjedhjes nga gjinitë-motra quhej si një gjë që kuptohej vetëvetiu, por gjinitë e fratrisë tjetër mund të bënin kundërshtime. Në këtë rast mblidhej këshilli i kësaj fratrie; kur ai e gjente kundërshtimin me vend, zgjedhjet quheshin pa vlerë. 6) Përpara irokezët kishin mistere të veçanta fetare, që të bardhët i quanin medicine-lodges*. Këto mistere në fisin seneka kremtoheshin nga dy vëllazëri fetare, që bënin pranimin e anëtarëve të rinj me një ceremoni të veçantë; në secilën nga dy fratribë kishte një vëllazëri të tillë. 7) Në qoftë se, siç është pothuajse e sigurt, katër linages (gjinitë), të cilat në kohën e pushtimit²⁰⁰ banonin në katër lagjet e Tlaskalit, ishin katër fratri, kjo provon se, ashtu si fratribë te grekët dhe bashkime të tilla gjinore te gjermanët, ishin gjithashtu njësi ushtarake; këto katër linages venin në luftë, secila e rreshtuar më vete, në uniformë të veçantë dhe me flamurin e vet, nën kryesinë e prijësit të vet.

* mbledhje të magjistarëve. *Red.*

Ashtu si disa gjini formojnë një fratri, kështu edhe disa fratri, po të merret forma klasike, formojnë një fis; në disa raste fiseve, që janë dobësuar mjaft, u mungon hallka e mesme — fratiria. Që karakterizon, pra, një fis indian në Amerikë?

1. Territori i vet dhe emri i vet. Çdo fis kishte, përveç vendit të ndejtjes së vet të vërtetë, edhe një territor të madh për gjah dhe për peshkim. Përtej kufijve të këtij territori kishte një zonë të gjerë asnjënjëse, që shtrihej deri në tokën e fisit fqinj; te fiset me gjuhë të afërme kjo zonë ishte më e ngushtë; te fiset që nuk ishin të afërme me gjuhë, ajo ishte më e gjerë. Kjo zonë ishte njësoj si pylli kufitar i gjermanëve, si shkretëtira që krijuan rreth e rrotull territorit të vet suevët e Cezarit; ishte njësoj si isarnholt (danisht jarnved, limes Danicus) midis danezëve dhe gjermanëve, si pylli sakson dhe branibor (sllavisht — „pyll mbrojtës”), nga ku mori emrin e vet Brandenburgu, midis gjermanëve dhe sllavëve. Zona që ishte ndarë kështu me kufijt jo aq të përcaktuar, përbënte tokën e përbashkët të fisit, njihej si e tillë nga fiset fqinje dhe vetë fisi e mbronte nga pushtimet. Në praktikë karakteri i papërcaktuar i kufijve më tepër bëhej i papërshtatshëm vetëm atëherë kur popullsia shtohej shumë. — Emrat e fiseve, siç duket, më shumë krijoreshin rastësisht se sa zgjidbeshin me qëllim; me kohë shpeshherë ndodhte që fiset fqinje i jepnin një fisi një emër të ndryshëm nga ai që kishte vetë fisi. ashtu sikundër gjermanëve emrin e parë të përgjithshëm historik „gjermanë” ua dhanë keltët.

2. *Dialekti* i veçantë, që e kishte vetëm ky fis. Në të vërtetë fisi dhe dialekti në thelb përputhen; formimi rishtazi i fiseve dhe i dialekteve me anë të ndarjes vazhdoi të bëhej në Amerikë edhe pak kohë më parë e ndoshta nuk ka mbaruar edhe sot. Atje ku dy fise të dobësuar shkoheshin në një, ndodh që në të njëjtin fis

të flasin, si përjashtim, në dy dialekte shumë të afërme. Forca numerike mesatare e fiseve amerikane është më pak se 2 000 frymë. Por fisi çiroki ka 26 000 frymë, që është numri më i madh i indianëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që flasin në një dialekt.

3. E drejta për të vënë në detyrë në mënyrë solemne sahemët dhe prijësit ushtarakë që zgjidhen nga gjinitë.

4. E drejta e heqjes së tyre, madje kundër dëshirës së gjinisë së tyre. Meqenëse këta sahemë dhe prijës ushtarakë janë anëtarë të këshillit të fisit, këto të drejta të fisit kundrejt tyre kuptohen vetëvetiu. Atje ku është formuar një bashkim fisesh dhe të gjitha fiset që bëjnë pjesë në të janë përfaqësuar në këshillin e bashkimit, këto të drejta i shkojnë këtij këshilli.

5. Idetë fetare të përbashkëta (mitologjia) dhe ceremonitë e kultit të përbashkëta.

„Indianët kanë qenë në mënyrën e tyre barbare një popull fetar²⁰¹.”

Mitologjia e indianëve deri më sot nuk është studjuar ende në mënyrë kritike; figurave të tyre fetare — shpirtrave të ndryshëm — ata u jepnin pamje njerëzore, por shkalla e ulët e barbarisë, në të cilën ata ndodheshin, nuk njihen ende përfytyrime konkrete, të ashtuquajturit idhuj. Ky ishte një kult i natyrës dhe i spontanitetit, që po zhvillohej drejt politeizmit. Fiset e ndryshme kishin të kremtet e veta të rregullta me forma të caktuara kulturi, dhe pikërisht — me valle dhe me lojra, sidomos vallet ishin një pjesë kryesore e këtyre të kremteve fetare; çdo fis i kremtonte festat e veta më vete.

6. Këshilli i fisit për të shqyrtuar çështjet e përbashkëta. Ai përbëhej nga të gjithë sahemët dhe pri-

jësit ushtarakë të gjinive, që ishin përfaqësuesit e tyre të vërtetë, sepse ata mund të hiqeshin në çdo kohë; ai i bënte mbledhjet botërisht, i rrethuar nga anëtarë të tjerë të fisit, të cilët kishin të drejtë të merrnin pjesë në bisedimet dhe të shprehnin mendimin e vet; vendimin e merrte këshilli. Si rregull, çdo i pranishëm po të donte mund të fliste, edhe gratë mund të shfaqnin mendimet e veta me anë të një oratori të ngarkuar prej tyre. Te irokezët vendimi përfundimtar duhej të merrej njëzëri, ashtu siç ishte edhe në komunitat-marka gjermane në zgjidhjen e disa çështjeve. Në kompetencat e këshillit të fisit hynte sidomos rregullimi i marrëdhënieve me fiset e tjera; ai pranonte dhe dërgonte përfaqësitë, shpallte luftën dhe bënte paqen. Kur puna shkonte deri në luftë, luftën e bënin sidomos vullnetarët. Në parim çdo fis quhej në gjendje lufte me çdo fis tjetër, me të cilin ai nuk kishte lidhur një traktat paqeje të veçantë. Fushatat ushtarake kundër armiqsh të tillë organizoheshin më tepër nga disa luftëtarë të shquar; ata organizonin një valle ushtarake, dhe kushdo që merrte pjesë në këtë valle shpallte kështu se do të merrte pjesë në fushatë. Çeta organizohej menjëherë dhe nisej për luftë. Edhe mbrojtja e territorit të fisit që sulmohej bëhej më tepër nga çeta vullnetare. Nisja për në fushatë dhe kthimi i këtyre çetave prej saj shoqërohej gjithnjë me festa publike. Për fushata të tilla nuk duhej pëlqimi i këshillit, as e kërkonin as e jepnin. Kemi po ato fushata të veçanta të çetave gjermane, ashtu si na i përshkruan Taciti²⁰², vetëm se te gjermanët këto çeta kanë marrë një karakter më të qëndrueshëm, përbëjnë një bërthamë të qëndrueshme që organizohet që në kohë paqeje dhe rreth së cilës në kohë lufte grumbullohen vullnetarë të tjerë. Këto çeta ushtarake rrallë kishin një numër të madh njerëzish; fushatat më me rëndësi të indianëve, madje edhe në distanca të largëta, bëhe-

shin me forca të vogla ushtarake. Kur disa nga këto çeta bashkoheshin për një ndërmarrje të madhe, secila prej tyre i bindej vetëm prijësit të vet; uniteti i planit të fushatës sigurohej në një mënyrë ose në një tjetër nga një këshill i këtyre prijësve. Në këtë mënyrë luftonin në bregun e Rinit të Sipërm edhe allamanët e shekullit IV, siç na e përshkruan Amian Marcelini.

7. Në disa fise ne gjejmë një kryetar epror, ndonëse, kompetencat e tij janë shumë të vogla. Ky ishte një nga sahemët, i cili, në rastet kur duhej vepruar shpejt, duhej të merrte masa të përkohshme derisa të mblidhej këshilli dhe të merrte një vendim përfundimtar. Këtu ne kemi një figurë të parë të zbetë, por që më të shumtën e herës nuk u zhvillua, të një funksionari me pushtet ekzekutiv; ky, siç do ta shohim, në shumicën e rasteve, në mos kudo, u zhvillua nga prijësi ushtarak më i lartë.

Shumica dërmuese e indianëve të Amerikës nuk vajti më tej nga bashkimi në fise. Fiset e tyre të vogla, të ndara midis tyre nga zona kufitare shumë të gjera, të dobësuar nga luftëra të vazhdueshme, zinin një hapësirë shumë të madhe me pak njerëz. Bashkimet midis fiseve të afërta bëheshin vende-vende për një nevojë të përkohshme dhe prisheshin me zhdukjen e kësaj nevoje. Por në disa krahina fise, të cilat më parë kishin qenë të afërta, por që më vonë ishin ndarë, bashkoheshin përsëri në bashkime të qëndrueshme, duke hedhur kështu hapin e parë drejt formimit të kombit. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës formën më të zhvilluar të një bashkimi të tillë ne e gjejmë te irokezët. Duke lënë viset në perëndim të Missipit, ku ata ka të ngjarë të përbënin një degë të grupit të madh gjinor dakota, pas shtegëtimesh të gjata u vendosën në shtetin e sotëm të Nju-Jorkut dhe u ndanë në pesë fise: seneka, kajuga, onondaga, onejda

dhe mohauki. Ata merreshin me peshkim, me gjah e me një kulturë primitive kopshtarie dhe banonin në fshatra shpesh të mbrojtura me gardhe. Numri i tyre kurrë nuk kapërcente 20 000 veta; në të pesë fiset kishte disa gjini të përbashkëta; ata flisnin në dialekte mjaft të afërta të një gjuhe dhe zinin një territor të tërë, që ishte pjesëtuar midis pesë fiseve. Meqenëse ky territor nuk kishte shumë kohë që ishte pushtuar prej tyre, veprimet e përbashkëta të këtyre fiseve kundër fiseve të dëbuara prej tyre u bënë diçka e natyrshme, u bënë zakon. Kështu shumë-shumë deri në fillim të shekullit XV u zhvillua një „lidhje e përjetshme” — një bashkim, i cili i ndërgjegjshëm për forcën e vet mori menjëherë një karakter mësymës dhe në kulmin e fuqisë së vet, aty nga viti 1675, pushtoi hapësirat e mëdha që ishin rreth e rrotull, pjesërisht duke dëbuar dhe pjesërisht duke ngarkuar popullsinë e tyre me haraç. Bashkimi i irokezëve është organizimi shoqëror më i zhvilluar që kanë krijuar indianët, pa e pasë kaluar shkallën e ulët të barbarisë (pra, duke përjashtuar meksikanët, meksikanët e rinj²⁰³ dhe peruanët). Karakteristikat kryesore të këtij bashkimi ishin këto:

1. Bashkimi i përjetshëm i pesë fiseve të afërta në gjak, duke pasur si bazë një barazi të plotë dhe pavarësinë në të gjitha çështjet e brendshme të fisit. Kjo afëri gjaku ishte baza e vërtetë e bashkimit. Nga të pesë fiset tri fise quheshin fise-etër dhe ishin vëllezër midis tyre; dy të tjerët quheshin fise-bij dhe ishin gjithashtu fise-vëllezër midis tyre. Tri gjini — më të vjetrat — përfaqësoheshin ende nga anëtarë të gjallë në të pesë fiset, tri gjini të tjera — në tri fise; anëtarët e cilësdo prej këtyre gjinive quheshin të gjithë vëllezër në të pesë fiset. Gjuha e përbashkët, që kishte ndryshime vetëm në dialektet, ishte shprehja dhe prova e një origjine të përbashkët.

2. Organi i bashkimit ishte këshilli i bashkimit, që përbëhej nga 50 sahemë, të barabartë nga pozita dhe nga nderi; ky këshill merrte vendime përfundimtare mbi të gjitha çështjet e bashkimit.

3. Këta 50 sahemë me themelimin e bashkimit u ndanë nëpër fise e nëpër gjini të ngarkuar me detyra të reja, të krijuara posaçërisht për qëllimet e bashkimit. Kur lirohej një vend, gjinia përkatëse zgjidhte një tjetër njeri si zëvendës dhe mund ta hiqte në çdo kohë; por të drejtën për t'i vendosur në detyrë e kishte këshilli i bashkimit.

4. Këta sahemë të bashkimit ishin gjithashtu sahemë të fiseve të veta dhe kishin të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votës në këshillin e fisit.

5. Të gjitha vendimet e këshillit të bashkimit duhej të merreshin njëzëri.

6. Votimi bëhej me fise, kështu që çdo fis dhe në çdo fis të gjithë anëtarët e këshillit duhej të votonin njëzëri, që vendimi të kishte vlerë.

7. Secili nga të pesë këshillat e fisit mund të thërriste këshillin e bashkimit, kurse ky vetë nuk mund të mbledhej me iniciativën e vet.

8. Seancat bëheshin përpara popullit të mbledhur; çdo irokez mund të merrte fjalën, kurse vendimi merrej vetëm nga këshilli.

9. Në bashkim nuk kishte një kryetar epror personal, një person që të ishte në krye të pushtetit ekzekutiv.

10. Por bashkimi kishte dy prijës ushtarakë eprore me kompetenca të barabarta dhe me pushtet të barabartë (dy „mbretërit” e spartanëve, dy konsujt në Romë).

Ky ishte rendi shoqëror, në të cilin irokezët kanë jetuar më tepër se 400 vjet dhe në të cilin rrojnë edhe sot. Unë e përshkrova me hollësi këtë rend, duke ndjekur Morganin, sepse këtu ne kemi mundësinë që të studjojmë organizimin e një shoqërie, e cila nuk njeh ende *shtet*. Shteti kërkon një pushtet publik të veçantë, të ndarë nga tërësia e anëtarëve që e përbëjnë përherë. Prandaj Maureri, duke u udhëhequr nga një nihatje e sigurt, e quan markën gjermane si një institucion thjesht shoqëror, krejt të ndryshëm nga shteti, ndonëse në pjesën më të madhe ka shërbyer më vonë si bazë për këtë të fundit, — Maureri në të gjitha veprat e veta studjon lindjen graduale të pushtetit publik nga organizimi fillestar — dhe krahas me këtë organizim — i markës, i fshatit, i çiflikut dhe i qytetit. Te indianët e Amerikës Veriore ne shohim se si një fis, që në fillim ishte i bashkuar, dalëngadalë përhapet në një kontinent të tërë; se si fiset, duke u ndarë, shndërrohen në popuj, në grupe të tëra fisesh, se si ndryshojnë gjuhët, duke u bërë jo vetëm të pakuptueshme midis tyre, por edhe duke humbur pothuajse çdo gjurmë të unitetit të mëparshëm, se si krahas me këtë një gjini brenda fisit ndahet në disa gjini, gjinitë-nëna të vjetra mbeten në formë fratrie, por emrat e këtyre gjinive të lashta mbeten gjithnjë po ato në fise shumë të largëta nga pikëpamja territoriale dhe të ndara me kohë midis tyre — „Ujku” dhe „Ariu” mbeten emra gjinish në shumicën e fiseve indiane. Dhe të gjitha këtyre fiseve u përgjigjet përgjithësisht organizimi shoqëror që përshkruam më sipër, vetëm se shumë prej tyre nuk kanë arritur ende deri në një bashkim fisesh të afërta.

Por ne shohim gjithashtu se kur kemi si qelizë bazë të shoqërisë gjininë, atëherë pothuajse me një domosdoshmëri të pashmangshme, — sepse është fare e natyrshme, — nga kjo qelizë zhvillohet gjithë

struktura e gjinive, e fratrive, e fisit. Që të tria grupet përfaqësojnë shkallë të ndryshme të afërisë së gjakut, dhe secilido prej tyre është i mbyllur në vetëvete dhe vetë i drejton punët e veta, por është gjithashtu një plotësim për tjetrin. Rrethi i çështjeve që është në dorën e tyre, përmbledh të gjitha çështjet shoqërore të një njeriu që gjendet në shkallën e ulët të barbarisë. Prandaj, kur gjejmë në një popull gjininë si qelizë bazë të shoqërisë, ne duhet të kërkojmë aty edhe organizimin fisnor të ngjashëm me atë që është përshkruar këtu; edhe atje ku ka mjaft burime, si te grekët dhe te romakët, ne jo vetëm do ta gjejmë këtë organizim, por edhe do të bindemi se, edhe kur këto burime mungojnë, krahasimi me organizimin shoqëror amerikan na i shpjegon të gjitha dyshimet dhe enigmat.

Dhe ç'organizim i mrekullueshëm është ky rendi gjinor me gjithë thjeshtësinë e vet naive! Pa ushtarë, xhandarë dhe policë, pa bujarë, mbretër, mëkëmbës, prefektë ose gjykatës, pa burgje, pa procese gjyqësore — çdo gjë ecën sipas rregullit të caktuar. Të gjitha grindjet dhe keqkuptimet zgjidhen nga kolektivi i atyre që u takojnë këto çështje, — nga gjinia ose nga fisi, ose nga gjinitë e ndryshme midis tyre; dhe vetëm si një mjet të fundit dhe të rrallë kemi marrjen e gjakut, forma e qytetëruar e së cilës është dënimi ynë me vdekje me të gjitha të mirat dhe të metat e qytetërimit. Ndonëse çështje të përbashkëta ka më tepër se sot, — sepse ekonomia shtëpiake në shumë familje është e përbashkët dhe komuniste, toka është pronë e gjithë fisit, vetëm kopshtet e vogla lihen përkohësisht për ekonominë shtëpiake, — megjithatë, nuk ka asnjë gjurmë të aparatit tonë administrativ të fryrë dhe të ndërlikuar. Të gjitha çështjet i zgjidhin vetë personat e interesuar dhe në shumicën e rasteve zakoni shekullor i ka rregulluar me kohë. Nuk mund

të ketë të varfër dhe nevojtarë — ekonomia komuniste dhe gjinia i dinë detyrat e veta kundrejt pleqve, të sëmurëve dhe të gjymtuarve në luftë. Të gjithë janë të barabartë dhe të lirë, pa përjashtuar as gratë. Skllëvër nuk ka ende; si rregull, nuk ka ende as skllavërim të fiseve të huaja. Kur irokezët, aty nga viti 1651, mundën fisin eri dhe „kombin asnjës”²⁰⁴, ata u propozuan që të hynin në bashkimin e tyre si anëtarë me të drejta të plota; vetëm kur të mundurit s’e pranuan këtë propozim, ata u dëbuan nga krahina e tyre. Dhe ç’burra e ç’gra pjell kjo shoqëri, na e tregon admirimi i të gjithë të bardhëve, që kanë pasur të bëjnë me indianët e padegjeneruar, për ndjenjën e dinjitetit personal, për sinqeritetin, për forcën e karakterit dhe për trimërinë e këtyre barbarëve.

Shembuj të kësaj trimërie ne pamë tani vonë në Afrikë. Kafërët-zulu disa vjet më parë, si edhe nubianët disa muaj më parë — fise në të cilat institucionet e gjinisë nuk janë zhdukur ende, — bënë atë që nuk mund ta bëjë asnjë ushtri evropiane²⁰⁵. Të armatosur vetëm me shtiza dhe me patërshana, pa armë zjarri, ata nën breshërin e plumbave të armëve të shpejta të këmbësorisë angleze — që njihet nga të gjithë si e para në botë për luftim në formacione të mbyllura — u hodhën mbi bajonetat, shumë herë i shkatërruan radhët e saj dhe bile e zbrapsën, me gjithë pabarazinë shumë të madhe në armatime, megjithëse ata nuk bëjnë shërbim ushtarak dhe nuk dinë se ç’është stërviija ushtarake. Se sa mund të durojnë ata dhe ç’mund të bëjnë, na e tregojnë ankimet e anglezëve, që thonë se një kafër ecën në ditë më tepër dhe më shpejt se kali. „Edhe muskuli i vogël i tij, i fortë dhe i regjur si çelik, duket si një kamxhik i thurur”, — thotë një piktor anglez.

Kështu ishin njerëzit dhe kështu ishte shoqëria njerëzore përpara se të ndahej në klasa të ndryshme.

Dhe po të krahasojmë gjendjen e tyre me gjendjen e një shumice të madhe njerëzish të sotëm të qytetëruar, do të shohim se kemi një ndryshim shumë të madh midis proletarit ose fshatarit të varfër të sotëm dhe anëtarit të lirë të gjinisë në kohën e lashtë.

Kjo është njëra anë e çështjes. Por të mos harrojmë se ky organizim ishte i dënuar të vdiste. Ai nuk shkoi më tej fisit; formimi i bashkimit të fiseve do të thotë fillim i shkatërrimit të tij, siç do ta shohim dhe siç u duk në orvatjet e irokezëve për të skllavëruar fise të tjera. Çdo gjë që ishte jashtë fisit, ishte jashtë ligjit. Kur nuk kishte një traktat paqeje, midis fiseve mbretëronte lufta, dhe kjo luftë bëhej me egërsinë që e dallon njeriun nga kafshët e tjera dhe që vetëm më vonë u zbut pak nën ndikimin e interesave materiale. Rendi gjinor në lulëzim të plotë, siç e pamë në Amerikë, presupozonte një prodhim fare të pazhvilluar, pra, një popullsi fare të rrallë në një hapësirë shumë të madhe, pra, një nënshtrim pothuajse të plotë të njeriut ndaj natyrës së jashtme, që i qëndron përkundrajt dhe që atij i duket e huaj e nuk e kupton, gjë kjo që pasqyrohet në idetë fetare naive foshnjare. Fisi mbetet një kufi për njeriun si kundërshtim të huaji nga një fis tjetër, ashtu edhe kundërshtim vetes së vet: fisi, gjinia dhe institucionet e tyre ishin të shenjta dhe të paprekshme, ishin pushteti epror, që e kishte dhënë natyra, të cilit individ i nënshtronte pa kushte në ndjenjat e veta, në mendimet e veta dhe në veprimet e veta. Sado madhështorë që dalin përpara nesh njerëzit e kësaj epoke, megjithatë ata nuk ndryshojnë fare midis tyre, ata nuk janë shpikur ende, siç thotë Marks, nga kërthiza e komunës primitive. Pushteti i kësaj komune primitive duhej thyer, — dhe ai u thye. Por ai u thye nën ndikime të tilla, që nën duken drejtpërdrejt si një rënie, si një mëkat në krahasim me lartësinë e thjeshtë morale të rendit të vje-

tër gjinor. Interesat më të ulëta — lakmia vulgare, epshet brutale për qejfe, neqesllëku, grabitja egoiste e pasurisë së përbashkët — pagëzojnë shoqërinë e re, shoqërinë e qytetëruar, shoqërinë me klasa; mjetet më të turpshme — kusaria, dhuna, dinakëria, tradhëtia — brejnë shoqërinë e vjetër dhe pa klasa të gjinive dhe e shpien në shkatërrim. Dhe vetë shoqëria e re gjatë 2500 vjetëve të ekzistencës së vet nuk ka qenë gjë tjetër veçse zhvillimi i një pakice të vogël në kurriz të një shumice të madhe të shfrytëzuar dhe të shtypur, dhe ajo mbetet e tillë në një shkallë edhe më të madhe se kurrë ndonjëherë më parë.

IV

GJINIA GREKE

Grekët, si pellazgët dhe popuj të tjerë të afërm me ta, ishin organizuar që në kohën parahistorike sipas së njëjtës seri organike që ishin organizuar edhe amerikanët; gjini, fratri, fis, bashkim fisesh. Fratri mund të mos kishte, si te dorianët, bashkim fisesh mund të mos ishte formuar ende kudo, por në të gjitha rastet qeliza kryesore ishte gjinia. Në kohën kur grekët dolën në arenën e historisë, ata ishin në prakun e qytetërimit; midis tyre dhe fiseve amerikane, për të cilat folëm më sipër, janë pothuajse dy periudha të mëdha zhvillimi, dy periudha të tëra, me të cilat grekët e epokës heroike ishin përpara irokezëve. Prandaj gjinia e grekëve nuk është aspak gjinia arkaike e irokezëve; vula e martesës me grupe fillon të humbasë në mënyrë të dukshme. E drejta amtare i kishte lënë vendin së drejtës atërore; dhe me këtë pasuria private, që po lindte, kishte hapur të çarën e parë në rendin gjinor. E çara e dytë ka qenë pasojë e natyrshme e së parës; sepse me hyrjen e së drejtës atërore pasuria e

një trashëgimtareje të pasur duhej t'i shkonte me martesën e saj të shoqit, pra, në një gjini tjetër; kjo shkallmonte bazën e gjithë së drejtës gjinore dhe jo vetëm lejonte, por e bënte në këtë rast të domosdoshme që një vajzë të merrte burrë brenda gjinisë së vet për të ruajtur pasurinë e vet në dobi të gjinisë.

Sipas historisë së Greqisë të Grotit gjinia e Athinës, veçanërisht, mbështetej në këto themele:

1. Të krennte fetare të përbashkëta dhe e drejta ekskluzive e priftërinjve për të kryer ritet e shenjta për nder të një perëndie të caktuar, që thuhej se ishte e para e gjinisë dhe si e tillë kjo perëndi kishte një emër të veçantë.

2. Një vend të përbashkët varrimi (krahaso „Evbulidin” e Demostenit).²⁰⁶

4. Detyra për të ndihmuar, për të mbrojtur dhe për të përkrahur shoqi-shoqin në rast dhunimi.

5. E drejta dhe detyra e shoqi-shoqit në disa raste për t'u martuar brenda gjinisë, sidomos për vajzat jetime ose për trashëgimtarët.

6. Zotërimi, të paktën në disa raste, i një pasurie të përbashkët me një arkont (plak) dhe me një arkëtar më vete.

Pastaj disa gjini bashkoheshin në një fratri, por jo aq ngushtë; mirëpo edhe këtu ne shohim të drejta dhe detyra të këtij lloji ndaj shoqi-shoqit, sidomos ushtrimin e përbashkët të disa ceremonive fetare dhe të drejtën e ndjekjes kur vritej një anëtar i fratrisë. Të gjitha fratrilitë e një fisi kishin, nga ana e vet, të krennte të shenjta të përbashkëta, që përsëriteshin rregullisht, nën kryesinë e një filobazileus (plak i fisit), që zgjidhej nga gjiri i fisnikëve (eupatridëve).

Kështu thotë Groti. Kurse Marksi shton: „Por edhe në gjininë greke nxjerr kryet në mënyrë të duk-

shme i egri (për shembull, irokezi)''.²⁰⁷ Atë mund ta shohim edhe më mirë, po të vazhdojmë studimin tonë.

Në të vërtetë gjinia greke ka edhe këto karakteristika:

7. Njohja e origjinës sipas së drejtës atërore.

8. Ndalimi i martesave brenda gjinisë, me përjashtim të martesave me trashëgimtarët. Ky përjashtim dhe formulimi i tij si ligj provojnë se rregulli i vjetër ishte ende në fuqi. Kjo rrjedh gjithashtu nga një rregull i detyrueshëm për të gjithë, sipas të cilit një grua, kur martohej, hiqte dorë nga pjesëmarrja në ritet fetare të gjinisë së vet dhe merrte pjesë në ritet e burrit, në fratrinë e të cilit ajo bënte pjesë. Sipas kësaj që thamë dhe siç thotë në një vend Dikearku²⁰⁸, martesa jashtë gjinisë ishte një rregull, kurse Bekeri në „Harikles” thotë se asnjëri nuk mund të martohej brenda gjinisë së vet.

9. E drejta e gjinisë për adoptim; ajo ushtrohej me anë të adoptimit nga një familje, por duke respektuar formalitetet publike, dhe vetëm si përjashtim.

10. E drejta për të zgjedhur dhe për të hequr pleqtë. Ne dimë se çdo gjini kishte arkontin e vet. Që kjo detyrë të trashëgohej në disa familje të caktuara, për këtë nuk flitet gjëkund. Deri në fund të epokës së barbarisë duhet gjithnjë të marrim me mend se nuk ka pasur një trashëgim të ngurtë të detyrave, sepse kjo nuk pajtohet aspak me rregullin, sipas të cilit të pasurit dhe të varfërit brenda gjinisë kishin të drejta plotësisht të barabarta.

Jo vetëm Groti, por edhe Niburi, Momzeni dhe gjithë historianët e tjerë të lashtësisë klasike nuk i kanë dalë mbanë problemit të gjinisë. Sado që ata i kanë përshkruar me besnikëri shumë nga tiparet e gjinisë, gjithnjë kanë parë në gjininë një grup familjesh dhe për këtë arsye nuk kanë mundur të kuptojnë natyrën

dhe origjinën e gjinisë. Në rendin gjinor familja kurrrë nuk ka qenë dhe nuk mund të ishte një qelizë e sistemit shoqëror, sepse burri dhe gruaja bënin pjesë medoemos në dy gjini të ndryshme. Gjinia hynte e tërë në fratri, fratria — në fis; familja hynte gjysma në gjininë e burrit dhe gjysma në gjininë e gruas. Edhe shteti në të drejtën e vet publike nuk e njeh familjen dhe ajo deri më sot ekziston vetëm si objekt i së drejtës private. Mirëpo, gjithë shkenca jonë historike deri më sot niset nga një hipotezë absurde, që është bërë e paprekshme, sidomos në shekullin XVIII, sipas së cilës familja e veçantë monogame, e cila është vështirë që të jetë më e vjetër se periudha e qytetërimit, ka qenë bërthama, rreth së cilës është kristalizuar dalëngadalë shoqëria dhe shteti.

„Pastaj duhet t'i themi zotit Grot, — shton Marksi, — se, ndonëse grekët i nxirrnin gjinitë e veta nga mitologjia, këto gjini ishin më të vjetra se mitologjia e krijuar prej tyre bashkë me perënditë dhe me gjysmëperënditë e saj”²⁰⁹.

Morganit i pëlqen të citojë Grotin, sepse ai është një autoritet dhe një dëshmitar që meriton besim të plotë. Groti tregon pastaj se çdo gjini e Athinës kishte një emër, që e kishte trashëguar nga ai që kujtohej se ishte i pari i saj, se deri te Soloni në të gjitha rastet, dhe pas Solonit, kur nuk kishte testament, anëtarët e gjinisë gennëtes të atij që vdiste trashëgonin pasurinë e tij dhe se, kur vritej njeri, ndjekja e kriminelit përpara gjyqit ishte një e drejtë dhe një detyrë në radhë të parë për të afërmit e të vrarit, pastaj për anëtarët e tjerë të gjinisë dhe, më në fund, për anëtarët e fratrisë:

„Të gjitha ligjet e lashta të Athinës, që dimë, janë hazuar në ndarjen në gjini dhe në fratri”.

Origjina e gjinive nga të parë të përbashkët i ka bërë „dijetarët filistej” (Marks)²¹⁰ ta vrasin mendjen

shumë. Merret vesh se, duke i quajtur këta të parë si genie thjesht mitologjike, ata nuk mund të shpjegojnë aspak formimin e gjinisë nga një sërë familjesh që rronin pranë njëra-tjetrës, por që ishin të ndara, madje në fillim as edhe të afërme midis tyre, mirëpo ata duhet ta zgjidhin këtë problem për të shpjeguar sado pak ekzistencën e gjinisë. Kështu ata bien në një rreth vicioz me fraza boshe pa mundur të shkojnë më larg se kjo tezë: gjenealogjia, natyrisht, është një mit, por gjinia ekziston në të vërtetë, dhe më në fund te Groti gjejmë (fjalët në kllapa i përkasin Marksit):

„Ne vetëm rrallë dëgjojmë për këtë gjenealogji, sepse atë e përmendin botërisht vetëm në disa raste, veçanërisht solemne. Por edhe gjinitë me më pak rëndësi kishin ritet e veta fetare” (çudi, zoti Grot!), „dhe një të parë të përbashkët — një mbinjeri, dhe një gjenealogji të përbashkët, ashtu si dhe gjinitë më të përmendura” (sa e çuditshme qenka kjo, zoti Grot, te gjinitë me më pak rëndësi!) „plani kryesor dhe baza ideale” (jo ideal, i nderuar zotni, por carnal, më thjesht — *mishërore!*) „ishin njësoj në të gjitha gjinitë”²¹¹

Përgjegjen e Morganit për këtë çështje Marksi e përmbledh me këto fjalë: „Sistemi i afërisë së gjakut, që i përgjigjet gjinisë në formën e saj fillestare, — dhe te grekët, si te të gjithë të vdekshmit e tjerë ka qenë dikur një formë e tillë, — siguronte që gjithë anëtarët e gjinive të dinin marrëdhëniet e afërisë midis tyre. Ata që në vegjëli i mësonin praktikisht këto fakte me rëndësi shumë të madhe për ta. Me lindjen e familjes monogame kjo u harrua. Emri i gjinisë krijonte një gjenealogji, pranë së cilës gjenealogjia e një familjeje të veçantë nuk kishte asnjë rëndësi. Ky emër i gjinisë tani duhej të dëshmonte për origjinën e përbashkët të atyre që mbanin këtë emër; por gjenealogjia e gjinisë shkante aq larg në thellësinë e kohës, sa që anëtarët e saj nuk mund të provonin tani afërinë

që ekzistonte me të vërtetë midis tyre, përveç disa rasteve të pakta, kur kishin të parë të përbashkët në një kohë jo të largët. Vetë emri ishte një provë e origjinës së përbashkët dhe një provë e sigurt, me përjashtim të rasteve të adoptimit. Përkundrazi, mohimi i vërtetë i çdo afërie midis anëtarëve të gjinisë, siç bëjnë Groti* dhe Niburi, që e kanë kthyer gjininë në një produkt të shpikjes së thjeshtë dhe të poezisë, u ka hije vetëm dijetarëve „idealë”, d.m.th. njerëzve të kalemmit, të mbyllur në kabinetet e tyre. Meqenëse zinxhiri i breznive, sidomos me lindjen e monogamisë, shkon deri në kohë shumë të largëta dhe realiteti i një kohe të shkuar pasqyrohet në figurat fantastike të mitologjisë, së këtejmi këta burra të mirë filistej kanë nxjerrë dhe vazhdojnë të nxjerrin përfundimin se gjeonealogjia fantastike krijoi gjinitë reale²¹².

Fratrìa, si dhe te amerikanët, ishte gjinia-nënë e ndarë në disa gjini-bija, që i bashkonte dhe shpeshherë i nxirrte të gjitha këto gjini prej një të pari të përbashkët. Kështu, sipas Grotit,

„të gjithë njerëzit e një moshe anëtarë të fratrisë Hekatea kishin po një perëndi si të parë të tyre në të gjashtëmbëdhjetin brez”.

Prandaj të gjitha gjinitë e kësaj fratrìe ishin tamam gjini-motra. Fratrinë e gjejmë edhe te Homeri si njësi ushtarake në atë pjesë të njohur, ku Nestori e këshillon Agamemnonin: Vendosi njerëzit sipas fiseve dhe fratrive, që fratrìa t'i ndihmojë fratrisë, fisi fisit²¹³. Përveç kësaj, fratrìa kishte të drejtën dhe detyrën e ndjekjes në rast vrasjeje të një anëtari të fratrìsë; si rrjedhim, në një epokë më të lashtë ajo kishte

* Në dorëshkrimin e Marksit në vend të Grotit është përmendur shkencëtari i Greqisë së Vjetër (shek. II i erës sonë) Poluksi, të cilat i referohet shpesh Groti. *Red.*

dhe detyrën e marrjes së gjakut. Pastaj ajo kishte festa dhe vende të shenjta të përbashkëta, dhe përgjithësisht zhvillimi i gjithë mitologjisë greke nga kultit i vjetër arian tradicional i natyrës në të vërtetë ishte lidhur me gjinitë dhe me fratrinë, në gjirin e të cilave u bë ky zhvillim. Pastaj fratria kishte edhe plakun e vet (phatriarchos) dhe, sipas dë Kulanzhit, thirrte mbledhje të përbashkëta, merrte vendime të detyrueshme, kishte pushtet gjyqësor dhe administrativ. Edhe shteti i mëvonshëm, që nuk e njuh gjininë, fratrinë i la disa funksione publike me karakter administrativ.

Disa fratri të afërta përbëjnë një fis. Në Atikë kishte katër fise; në çdo fis kishte tri fratri dhe në çdo fratri — tridhjetë gjini. Një caktim kaq i imtë i grupeve kërkon një ndërhyrje me ndërjegje dhe me plan në rendin e sendeve që ishte krijuar vetiu. Si, kur dhe përse u bë kjo gjë, — për këtë hesht historia greke, për këtë edhe vetë grekët kanë ruajtur kujtime vetëm që nga epoka heroike e këtej.

Formimi i dialekteve të ndryshme të grekët, të grumbulluar ngushtë në një territor relativisht të vogël, pati një zhvillim më të vogël se në pyjet e gjera të Amerikës; por edhe këtu ne shohim se në një unitet më të madh janë bashkuar vetëm fiset me një dialekt kryesor të përbashkët; madje edhe në Atikën e vogël ne kemi një dialekt më vete, që më vonë mbizotëroi si gjuhë e përbashkët në gjithë prozën greke.

Në poemat e Homerit i gjejmë fiset greke në shumicën e rasteve të bashkuara në popullsi të vogla, në gjirin e të cilave gjinitë, fratrinë dhe fiset ruajnë ende plotësisht pavarësinë e vet. Ata rronin tani në qytete të fortifikuara me mure; numri i popullsisë shtoej bashkë me zmadhimin e kopeve, me zgjerimin e bujqësisë dhe me hapat e parë të zejtarisë; bashkë me këtë u shtuan edhe ndryshimet pasurore, dhe bashkë me

to edhe elementi aristokratik në gjirin e demokracisë së lashtë primitive. Këto popullsi të vogla luftonin parrështur për të pushtuar toka më të mira, si dhe, natyrisht, për plaçkë lufte; skllavërimi i robërve të luftës ishte tani një institucion i njohur.

Organizimi i qeverimit të këtyre fiseve dhe popullsive ishte ky:

1. Organi i përhershëm i pushtetit ishte *këshilli*, bulë, i cili në fillim, siç duket, përbëhej nga pleqtë e gjinive, dhe më vonë, kur numri i tyre u shtua tepër, — nga pjesa e zgjedhur e këtyre pleqve, gjë që bëri të mundshëm zhvillimin dhe përforcimin e elementit aristokratik; sepse pikërisht kështu na e përshkruan Dionisi këshillin e epokës heroike, që përbëhej nga fisnikë (kratistoi)²⁴. Për çështjet me rëndësi këshilli merrte vendime të prera; kështu, për shembull, te Eskilli këshilli i Tebës merr një vendim të prerë që, në kushtet e krijuara, t'i bëheshin funerale nderi Eteoklit dhe që kufoma e Polinikut t'u hidhej qenve²⁵. Më vonë, kur u krijua shteti, ky këshill u kthye në senat.

2. *Kuvendi i popullit (agora)*. Pamë te irokezët se populli, burra e gra, rrinë rrotull kuvendit të këshillit dhe, duke marrë pjesë në bisedimet sipas rregullit të caktuar, ndikojnë, në këtë mënyrë, mbi vendimet e tij. Te grekët e Homerit ky „rrethim” [Umstand], që të përdorim një shprehje të vjetër gjyqësore gjermane, u zhvillua tani në një kuvend të vërtetë popullor, siç ndodhi edhe te gjermanët e vjetër. Ky kuvend mbli dhej nga këshilli për të vendosur mbi çështje me rëndësi; çdo burrë mund të merrte fjalën. Vendimi merrrej duke ngritur duart (shih „Lutëset” e Eskilit) ose me britmë. Kuvendit i përkiste pushteti i lartë në instancë të fundit, sepse, siç thotë Shëmani („Lashtësitë greke”),

„kur është puna për një çështje, për kryerjen e së cilës duhet bashkëpunimi i popullit, Homeri nuk na tregon asnjë mënyrë me të cilën populli mund të detyrohet ta bëjë këtë gjë kundër vullnetit të vet”.

Porse në atë kohë, kur çdo mashkull i rritur në fis ishte një luftëtar, nuk kishte ende një pushtet publik të ndarë nga populli që mund të vihej kundër popullit. Demokracia primitive ishte gjithnjë në lulëzim të plotë, dhe prej këndej duhet të nisemi kur gryojmë mbi pushtetin dhe mbi pozitën si të këshillit, ashtu edhe të basileusit.

3. *Prijësi ushtarak* (basileus). Marksi për këtë çështje thotë: „Dijetarët e Evropës, në shumicën e tyre shërbëtorë të lindur të oborreve, e kthejnë basileusin në monark në kuptimin e sotëm të kësaj fjale. Kundër kësaj proteston republikani janki Morgan. Ai, në mënyrë shumë ironike, por fare të vërtetë, thotë për Gladstonin e pispillosur dhe për veprën e tij „Rinia e botës”:

„Zoti Gladston na i paraqet prijësit grekë të epokës heroike si mbretër dhe princër, duke shtuar se ata ishin edhe zhenelmenë; por ai vetë duhet të pranojë se përgjithësisht zakonet ose ligjet e parandjes aty e gjejmë, me sa duket, mjaft, por jo në mënyrë tepër të prerë”²¹⁶

Duhet menduar se me këto rezerva e drejta e parandjes do t'i duket edhe vetë zotit Gladston si mjaft e zhveshur nga çdo kuptim, megjithëse jo në mënyrë tepër të prerë.

Ne pamë se si qëndronte puna me trashëgiminë e detyrave të pleqve të irokezët dhe të indianë të tjerë. Të gjitha detyrat jepeshin me anë të zgjedhjeve, në shumicën e rasteve brenda gjinisë, dhe meqë ishin të trashëgueshme, brenda kufijve të kësaj të fundit. Për plotësimin e vendeve vakante, filluan pak nga pak të

preferonin më të afërmit — vëllanë ose birin e motrës, po të mos kishte arësye që t'i linin jashtë. Prandaj, në qoftë se te grekët, ku sundonte e drejta atërore, detyra e basileusit zakonisht i shkonte djalit ose njërit nga djemtë, kjo provon vetëm se bijtë kishin mundësinë e trashëgimit në bazë të zgjedhjeve në kuvendin e popullit, por nuk provon aspak se këtu kemi një trashëgim të ligjshëm pa zgjedhje nga ana e popullit. Në këtë rast ne gjejmë te irokezët dhe te grekët embrionin e parë të familjeve të shquara fisnike brenda gjinisë, dhe te grekët, përveç kësaj, edhe embrionin e parë të asaj që do të bëhej prijësia e trashëgueshme ose monarkia. Prandaj mund të mendohej se te grekët basileusi ose zgjidhej nga populli, ose të paktën duhej të aprovohej nga organet e njohura prej tij — nga këshilli ose nga agora, siç bëhej për „mbretin” (rex) në Romë.

Në „Iliadën” „sunduesi i burrave”, Agamemnoni, nuk është mbreti më i lartë i grekëve, por kryekomandant i ushtrisë së bashkuar përpara një qyteti të rrethuar. Për këtë pozitë të tij flet në një vend të njohur Odiseu kur midis grekëve lindën grindje: nuk është mirë të ketë shumë kryetarë, një duhet të komandojë, etj. (më poshtë kemi vargun e mirënjohur mbi skeptrin, por ai është shtuar më vonë²¹⁷). „Odiseu këtu nuk mban ndonjë leksion mbi formën e qeverimit, por kërkon që në luftë t'i binden komandantit. Te grekët, të cilët përpara Trojës ishin vetëm një ushtri, agora zhvillohet në mënyrë mjaft demokratike: Akili, duke folur për dhuratat, d.m.th. për ndarjen e plaçkës, këtë detyrë gjithnjë nuk ia ngarkon Agamemnonit ose ndonjë basileusi tjetër, por „bijve të akejve”, d.m.th. popullit. Epitetet „i lindur nga Zeusi”, „i ushqyer nga Zeusi” nuk provojnë asgjë, sepse çdo gjini e shpie origjinën e vet te një perëndi, dhe gjinia e kryetarit të fisit te perëndia „më e shquar”, në këtë rast — te Zeusi. Edhe ata që nuk janë të lirë personalisht, si, për

shembull, bariu i derrave Eumeos e të tjerë, janë „të perëndishëm” (dioi dhe theioi), dhe kjo në „Odise”, d.m.th. shumë më vonë se koha që përshkruhet në „Iliadën”; po këtu në „Odise” quhet „hero” edhe kasneci Milios, si edhe këngëtori i verbër Demodok*. Shkurt, fjala basileia, që shkrimtarët grekë e përdorin për të treguar pushtetin e ashtuquajtur mbretëror të Homeri (sepse shenja dalluese kryesore e këtij pushteti është prijësia ushtarake), pushtet krahas të cilit ekziston këshilli i udhëheqësve dhe kuvendi i popullit, do të thotë vetëm demokraci ushtarake²¹⁸ (Mar-ks).

Basileusi, përveç funksioneve të prijësit ushtarak, kishte dhe funksionet e priftit dhe të gjyqtarit; këto të fundit nuk ishin të përcaktuara mirë, të parat ai i kishte si përfaqësuesi më i lartë i fisit ose i bashkimit të fiseve. Për të drejtat qytetare, administrative nuk bëhet fjalë kurrë, por sig duket, duke pasur këtë funksion, basileusi ishte edhe anëtar i këshillit. Kështu, nga pikëpamja etimologjike është fare e drejtë që fjala „basileus” të përkthehet me fjalën gjermane „König”, sepse fjala „König” (Kuning), rrjedh nga Kuni, Künne dhe do të thotë „plak i fisit”. Por „basileus” i Greqisë së Vjetër nuk ka fare kuptimin e sotëm të fjalës „König” (mbret). Tukididi e quan basileian e kohës së lashtë shprehimisht patrikë, d.m.th. që rrjedh nga gjinitë, dhe thotë se ajo kishte të drejta të përcaktuara mirë, d.m.th. të kufizuara²¹⁹. Dhe Aristoteli thotë se basileia e epokës heroike ishte prijës mbi të lirët, dhe basileusi ishte prijës ushtarak, gjykatës dhe krye-

* Në dorëshkrimin e Marksit vazhdon kjo frazë e harruar nga Engelsi: termi „koiranos” (χοίρανος), që Odisheu e përdor njësoj si termin „basileus” kur flet për Agamemnonin, do të thotë gjithashtu vetëm „komandant i ushtrisë në kohë lufte”. Red.

prift²⁰; prandaj ai nuk kishte pushtet qeveritar në kuptimin e mëvonshëm*.

Shohim, kështu, se në rendin grek të epokës heroike organizimi i vjetër gjinor është gjithnjë plotësisht në fuqi, por, njëkohësisht, shohim edhe fillimin e shembjes së tij: ne shohim këtu të drejtën atërore me trashëgimin e pasurisë nga ana e fëmijëve, gjë që favorizoi grumbullimin e pasurisë në familje dhe e bëri familjen një forcë përballë gjinisë; shohim ndikimin e kundërt të ndryshimeve pasurore mbi organizimin e qeverimit me anë të formimit të embrioneve të para të aristokracisë së trashëgueshme dhe të pushtetit mbretëror; shohim skllavërinë, në fillim vetëm të robërve të luftës, por që hap mundësinë për të skllavëruar bashkanëtarët e fiseve, madje edhe të gjinive; shohim fillimin e degjenerimit të luftës së vjetër midis fiseve në një grabitje sistematike në tokë dhe në det të gjësë së gjallë, të skllëvërve dhe të thesareve, dhe kthimin e kësaj lufte në një zana të rregullt; me një fjalë, shohim se pasuria çmohet dhe nderohet si e mira e të mirave dhe rendi i vjetër gjinor shpërdorohet për të justifikuar grabitjen e pasurive me forcë. Mungonte vetëm një gjë: një institucion që të siguronte nga traditat komuniste të rendit gjinor jo vetëm pasuritë e fi-

* Ashtu si basileusin grek, edhe prijësin ushtarak të acetekëve e kanë paraqitur si monark modern. Morgani është i pari që u bën një kritikë historike tregimeve të spanjollëve, të cilat në fillim bazoheshin në një kuptim të shtrembëruar dhe ishin të zmadhuara, më vonë edhe krejt të rreme. Ai provon se meksikanët ishin në shkallën e mesme të barbarisë, por se ishin në një shkallë më të lartë se indianët pueblos të Meksikës së Re, dhe se rendi i tyre shoqëror, me sa mund të gjykojmë nga tregimet e shtrembëruara, ishte ky: një bashkim prej tri fisesh, që u kishte vënë haraç disa fiseve të tjera që i kishte nënshtruar, dhe që qeverisej vetë nga këshilli i bashkimit dhe nga prijësi ushtarak i bashkimit, të cilin spanjollët e kthyen në „perandor“.

tuara rishtazi të individëve, jo vetëm të shenjtëronte pronën private, që përpara çmohej aq pak, dhe ta shpallte këtë shenjtërim si qëllimin më të lartë të çdo shoqërie njerëzore, por t'u vinte edhe vulën e njohjes nga gjithë shoqëria formave të reja të fitimit të pronës, që po zhvilloheshin njëra pas tjetrës, dhe si rrjedhim edhe grumbullimit të pasurisë që shtohej parrështur; mungonte një institucion që të përjetësonte jo vetëm ndarjen e shoqërisë në klasa, që kishte filluar, por edhe të drejtën e klasës së pasur për të shfrytëzuar të varfërit dhe sundimin e së parës mbi këta të fundit.

Dhe një institucion i tillë doli. U shpik *shteti*.

V

LINDJA E SHTETIT TË ATHINËS

Se si u zhvillua shteti, pjesërisht duke shndërruar organet e rendit gjinor, pjesërisht duke i eliminuar me anë organesh të reja dhe, më në fund, duke i zëvendësuar fare me organe të vërteta të pushtetit shtetëror; se si vendin e „popullit të armatosur”, në kuptimin e vërtetë të fjalës, që mbrohej me forcat e veta në gjinitë, në fratritë dhe në fiset e veta, e zuri „pushteti publik” i armatosur, që varej nga këto organe shtetërore dhe prandaj mund të drejtohej edhe kundër popullit, — të gjitha këto, të paktën në shkallën fillestare, ne nuk mund t'i shohim asgjëkundi më mirë se në Athinën e Vjetër. Ndryshimin e formave në përgjithësi e ka përshkruar Morgani, kurse analizën e përmbajtjes ekonomike, që ka shkaktuar këtë ndryshim formash, në pjesën më të madhe më duhet ta shtoj unë.

Në epokën heroike katër fiset e athinasve ishin vendosur veç e veç në disa krahina të Atikës; edhe dymbëdhjetë fratritë, që përbënin këto fise, kishin, siç duket, ende vendbanime të veçanta në dymbëdhjetë qy-

tetet e Kekropit. Organizimi i qeverimit ishte njësoj si në epokën heroike; kuvendi i popullit, këshilli i popullit, basileusi. Që në epokën kur fillon historia e shkruar, toka ishte ndarë dhe ishte bërë pronë private, siç e do natyra e prodhimit të mallrave, që ishte mjaft i zhvilluar në fund të shkallës së lartë të barbarisë, dhe natyra e tregëtisë së mallrave, që i përgjigjet këtij prodhimi. Krahas me drithin prodhohej edhe verë dhe vaj; tregëtia detare në detin Egje po dilte gjithnjë më tepër nga duart e finikasve dhe po binte më tepër në duart e banorëve të Atikës. Me shitjen e blerjen e tokës, me zhvillimin e mëtejshëm të ndarjes së punës midis bujqësisë dhe zejtarisë, tregëtisë dhe lu ndrimit, anëtarët e gjinive, të fratrive dhe të fiseve u përzien shumë shpejt; në territorin e fratrisë dhe të fisit u vendosën banorë, të cilët, megjithëse ishin bashkatdhetarë, nuk u përkisnin këtyre bashkimeve dhe, pra, ishin të huaj në vendbanimin e vet. Sepse në kohë pageje çdo fratri dhe çdo fis i qeveriste vetë punët e veta, pa iu drejtuar këshillit popullor ose basileusit në Athinë. Por ata që rronin në territorin e fratrisë ose të fisit, pa bërë pjesë në to, natyrisht nuk mund të merrnin pjesë në këtë qeverim.

Të gjitha këto e çrregulluan aq tepër funksionimin normal të organeve të rendit gjinor, saqë edhe në epokën heroike u desh që të merreshin masa për t'i zhdukur. U bë një organizim i ri, që thuhet se ka pasur si autor Tezeun. Ndryshimi qëndronte, para së gjithash, në faktin se në Athinë u krijua një qeverim qendror, d.m.th. një pjesë e çështjeve që deri atëherë ishin në kompetencën e pavarur të fiseve, u shpallën si çështje me rëndësi të përgjithshme dhe u lanë në kompetencë të këshillit të përgjithshëm, që vepronte në Athinë. Me këtë athinasit shkuan në zhvillimin e vet më përpara se gjithë popujt autoktonë të Amerikës: në vend të një bashkimi të thjeshtë fisesh që rroj-

në pranë shoqi-shoqit, u bë shkrirja e tyre në një pull të vetëm. Në lidhje me këtë lindi në Athinë një e drejtë popullore e përgjithshme, që ngrihej mbi zakonet juridike të fiseve dhe të gjinive të veçanta; qytetari athinas, si i tillë, fitoi disa të drejta të caktuara dhe një mbrojtje të re juridike edhe në atë tokë ku ai ishte i ardhur nga një fis i huaj. Por me këtë u bë hapi i parë drejt shembjes së rendit gjinor, sepse qe hapi i parë që shpuri më vonë në pranimin e qytetarëve, të cilët ishin të huaj për fiset e gjithë Atikës, që ishin dhe mbeteshin fund e krye jashtë organizimit gjinor të Athinës. Një gjë e dytë, që i vishet Tezeut, ishte ndarja e gjithë popullit, pavarësisht nga gjinia, nga fratria ose nga fisi, në tri klasa: eupatridë ose fisnikë, geomorë ose bujq, dhe demiurgë ose zejtarë, dhe dhënia fisnikëve e së drejtës ekskluzive për të mbajtur detyrat publike. Mirëpo kjo ndarje, përveç së drejtës që kishin fisnikët për të mbajtur detyra publike, nuk dha ndonjë rezultat, sepse ajo nuk caktonte asnjë ndryshim të drejtash midis klasave. Por ajo ka një rëndësi të madhe, sepse zbulon përpara nesh elemente të reja shoqërore që ishin zhvilluar pa u kuptuar. Ajo tregon se mbajtja e detyrave shoqërore të gjinive nga anëtarët e disa familjeve, që ishte bërë zakon, u bë tani një e drejtë, që nuk kundërshtojë shumë, e këtyre familjeve për të mbajtur detyra shoqërore; se këto familje, që ishin edhe pa këtë të fuqishme nga pasuria e vet, filluan të grumbulloheshin jashtë gjinive të veta në një klasë më vete të privilegjuar dhe se këto pretendime të tyre u shenjtëruan nga shteti që ishte ende vetëm në embrion. Pastaj ajo tregon se ndarja e punës midis fshatarëve dhe zejtarëve ishte përforcuar aq tepër, sa që ia pakësonte rëndësinë shoqërore ndarjes së mëparshme në gjini dhe në fise. Ajo, më në fund, shpall kontradiktën e papajtueshme midis shoqërisë së gjinive dhe shtetit; orvatja e parë e formi-

mit të shtetit është prishja e lidhjeve të gjinisë, duke i ndarë anëtarët e çdo gjinie në të privilegjuar dhe në të paprivilegjuar, dhe këta të fundit në dy klasa sipas punës së tyre duke i vënë, kështu, në kundërshtim midis tyre.

Historia politike e mëtejshme e Athinës deri te Soloni dihet shumë pak. Detyra e basileusit e humbi rëndësinë e vet; në krye të shtetit dolën arkontët, që zgjidheshin nga rrethi i fisnikëve. Pushteti i aristokracisë u forcua gjithnjë më tepër, derisa, rreth vitit 600 para erës sonë, u bë i padurueshëm. Mjeti kryesor për të shtypur lirinë e popullit ishin paraja dhe fajdeja. Vendbanimi kryesor i aristokracisë ishte Athina dhe rrethet e saj, ku tregëtia detare, dhe bashkë me të kusaria detare, që praktikohesh gjithnjë kur ishte rasti, i pasuruan ata dhe e përqëndruan paranë në duart e tyre. Ekonomia monetare, që zhvillohej këtej, hynte, si një gjezap përvëlues, në komunat fshatare, në mënyrën e tyre të jetesës, të trashëguar nga kohët e lashta dhe të bazuar në ekonominë natyrale. Rendi gjinor nuk pajtohet fare me ekonominë monetare; rrënim i fshatarëve të vegjël të Atikës qëlloi në një kohë me dobësimin e lidhjeve të vjetra të gjinisë, që i mbronte ata. Seneti dhe hipoteka mbi tokën (sepse athinasit kishin shpikur tani edhe hipotekën) nuk pyesnin as për gjininë as për fratrinë. Dhe rendi i vjetër gjinor nuk njihte as para as kapar as borxhe në të holla. Prandaj sundimi gjithnjë më i madh i aristokracisë me anë të parasë përpunoi një të drejtë të re zakonore për të siguruar kreditorin kundër borxhliut, për të shenjtëruar shfrytëzimin e fshatarëve të vegjël prej atyre që kishin para. Në fushat e Atikës kudo ngriheshin shtylla me mbishkrime, ku shënohej se akësh tokë i ishte lënë peng akësh njeriu për akësh shumë të hollash. Arat që nuk kishin mbishkrime të tilla, ishin shitur në shumicën e tyre për mospagesë brenda

afatit të hipotekës ose të përqindjeve dhe ishin bërë pronë e aristokratit fajdexhi; fshatari mund të ishte i kënaqur kur e lejonin të mbetej në tokën e tij si qiramarrës dhe të rronte me një të gjashtën e produktit të punës së vet, kurse pesë të gjashtat e tjera ia paguante pronarit të ri për qira. Por ka edhe më tepër. Kur shuma që nxirrej nga shitja e tokës nuk mbulonte borxhin ose kur huaja nuk ishte garantuar me peng, atëherë borxhliu ishte i shtërnguar të shiste fëmijët e vet jashtë shtetit si skllëvër, për të larë borxhin. Shitja e fëmijëve prej atit ka qenë fryti i parë i së drejtës atërore dhe i monogamisë! Dhe kur gjakpërësi nuk kënaqej edhe me kaq, ai mund të shiste si skllav edhe vetë borxhlinë. Ky ka qenë agimi i shkëlqyer i qytetërimit të popullit të Athinës.

Më parë, kur kushtet e jetës së popullit i përshtateshin ende rendit gjinor, një përmbysje e tillë ishte e pamundur; kurse tani ajo u bë, por nuk dihet se si. Të kthehemi për një çast te irokezët tanë. Atje as që mund ta merrnin me mend një gjendje që tani u ishte imponuar athinasve, si të thuash, pa pjesëmarrjen e tyre dhe pa dyshim kundër vullnetit të tyre. Atje mënyra e prodhimit të mjeteve të jetesës, që vit për vit mbetej e pandryshueshme, nuk mund të lindte kurrë konflikte të tilla, që dukeshin sikur ishin imponuar nga jashtë, një kontradiktë të tillë midis të pasurve dhe të varfërve, midis shfrytëzuesve dhe të shfrytëzuarve. Irokezët ishin ende shumë larg sundimit të natyrës, por brenda disa kufijve të natyrës, që kishin rëndësi për ta, ata ishin zotër të prodhimit të vet. Përveç rasteve kur nuk bëhej bereqeti në kopshtet e tyre të vogla, përveç kur shteronin rezervat e peshkut në liqenjtë dhe në lumenjtë e tyre dhe kur pakësohej shumë gjahu në pyjet e tyre, ata e dinin që më parë se ç'mund të nxirrnin me mënyrën e vet të gjetjes së mjeteve të jetesës. Kjo mënyrë duhej t'u sigu-

ronte mjete jetese — kur pak, kur me bollëk, por ajo kurrë s'mund të çonte në përmbysje shoqërore të parapashikuara, në prishjen e lidhjeve të gjinisë, në ndarjen e anëtarëve të një gjinie dhe të një fisi në klasa të kundërta në luftë midis tyre. Prodhimi vërtitej brenda kufijve shumë të ngushtë, por produkti ndodhej fund e krye në pushtetin e prodhuesve. Kjo ishte një e mirë shumë e madhe e prodhimit të epokës së barbarisë, një e mirë që me shfaqjen e epokës së qytetërimit humbi. Detyra e brezave të ardhshëm është që ta fitojnë përsëri këtë të mirë, por këtë radhë mbi bazën e sundimit të fuqishëm që ka sot njeriu mbi natyrën dhe mbi bazën e një shoqërie të lirë që tani mund të realizohet.

Ndryshe ishte puna me grekët. Prona private mbi kopetë dhe mbi sendet e luksit solli me vete këmbimin midis individëve, shndërrimin e produkteve në *mallra*. Dhe këtu kemi embrionin e gjithë përmbysjes që pasoi. Sapo që prodhuesit filluan të mos e harxhonin vetë drejtpërdrejt produktin e vet, por filluan ta jetëronin me anë të këmbimit, ata humbën pushtetin e vet mbi këtë produkt. Ata tani nuk dinin ç'do të bëhej me të. U krijua mundësia për ta përdorur produktin kundër prodhuesit, për shfrytëzimin dhe për skllavërimin e tij. Prandaj asnjë shoqëri nuk mund ta ruajë për një kohë të gjatë pushtetin mbi prodhimin e vet dhe kontrollin mbi pasojat shoqërore të procesit të prodhimit të vet, po të mos zhdukë këmbimin midis individëve.

Se sa shpejt pas lindjes së këmbimit midis individëve dhe shndërrimit të produkteve në mallra fillon të shfaqet pushteti i produktit mbi prodhuesin e tij — këtë athinasit e provuan në veten e vet. Bashkë me prodhimin e mallrave lindi dhe lërimi i tokës nga individë me forcat e veta, dhe me këtë lindi për së shpejti edhe prona private individuale mbi tokën. Pastaj

doli paraja, malli i përgjithshëm, me të cilin këmbeshin gjithë mallrat e tjera. Por, duke shpikur paranë, njerëzve nuk u shkonte ndër mend se ata bashkë me këtë krijonin një forcë të re shoqërore, një forcë të vetme e të përgjithshme, përpara së cilës do të përgjunjet gjithë shoqëria. Dhe kjo forcë e re, që lindi përnjëherë pa dijen dhe kundër vullnetit të krijuesve të saj, i bëri athinasit që të ndjenin sundimin e vet me tërë brutalitetin e rinisë së vet.

Ç'mund të bëhej atëherë? Rendi i vjetër gjinor jo vetëm ishte i pafuqishëm kundër përparimit nga dhënjimtar të parasë, ai ishte gjithashtu fare i pazoti që të gjente brenda kuadrit të vet të paktën një vend për sende të tilla si paraja, kreditorët dhe borxhlinjtë, marrja e borxheve me detyrim. Por forca e re shoqërore ekzistonte, dhe dëshirat e mira, dëshirat e zjarrta për të kthyer kohën e vjetër, kohën e mirë nuk ishin në gjendje që të zhduknin as paranë as fajdenë. Dhe përveç kësaj, në rendin gjinor ishin bërë disa të çara të tjera të dorës së dytë. Brez pas brezi anëtarët e gjinive dhe të fratrive të ndryshme u përzien gjithnjë më tepër midis tyre në gjithë territorin e Atikës dhe sidomos në vetë qytetin e Athinës, megjithëse edhe tani athinasi mund t'i shiste një njeriu, që s'ishte anëtar i gjinisë së tij, tokat, por jo shtëpinë e tij. Me zhvillimin e mëtejshëm të industrisë dhe të këmbimit u zhvillua gjithnjë më tepër ndarja e punës midis degëve të ndryshme të prodhimit: bujqësisë, zejtarisë, dhe në zejtari — midis llojeve të saj të panumërta: tregëtisë, lundrimit etj.; tani popullsia ndahej sipas punës në grupe mjaft të qëndrueshme; secili prej tyre kishte interesa të reja të përbashkëta, për të cilat nuk kishte vend brenda gjinisë ose fratrisë dhe për t'i kryer këto duheshin, si rrjedhim, detyra të reja. Numri i sklleverve ishte shtuar shumë dhe në këtë kohë, ka të ngjarë, ishte shumë më i madh se numri i athi-

nasve të lirë; rendi gjinor në fillim nuk dinte fare se ç'ishte skllavëria, dhe prandaj nuk dinte se ç'mjete duheshin për të mbajtur nën zgjedhë këtë masë njerëzish jo të lirë. Dhe, më në fund, tregëtia tërhiqte në Athinë shumë të huaj, të cilët u vendosën këtu, sepse fitohej lehtë; në bazë të rregullave të vjetra, edhe ata ishin pa të drejta dhe pa mbrojtje dhe, me gjithë tolerancën tradicionale, ishin një element i turbullt, një element i huaj në mes të popullit.

Me një fjalë, rendi gjinor po merrte fund. Shoqëria çdo ditë dilte gjithnjë më tepër nga rrethi i tij; ai nuk mundi të ndalonte as të zhdukte edhe të këqiat më të mëdha që shfaqeshin në sytë e gjithë botës. Por ndërkaq ishte zhvilluar, pa u kuptuar, shteti. Grupe të reja, të krijuara nga ndarja e punës në fillim midis qytetit dhe fshatit, dhe pastaj midis degëve të ndryshme të punës në qytet, krijuan organe të reja për mbrojtjen e interesave të tyre; u krijuan detyra të ndryshme. Pastaj shtetit të ri, për të bërë luftëra të vogla dhe për të mbrojtur anijet tregëtare, i duhej pikësëpari një forcë ushtarake e vet, që për athinasit detarë mund të ishte në fillim vetëm një forcë detare. U krijuan, nuk dihet sa kohë përpara Solonit, naukraritë, rrethe të vogla territoriale, dymbëdhjetë në çdo fis; çdo naukrari duhej të jepte, të armatoste dhe të kompletonte me ekuipazh një anije lufte dhe, përveç kësaj, të jepte dhe dy kalorës. Ky institucion shkallmonte rendin gjinor nga dy pikëpamje: së pari, ai krijonte një pushtet publik, që tani nuk përkonte më thjeshtësisht me tërë popullin e armatosur; së dyti, ai e ndau për herë të parë popullin për qëllime shoqërore jo sipas grupeve të gjinive, por sipas bashkëjetesës territoriale. Se ç'rëndësi ka pasur kjo, do të duket nga ato që do të themi më poshtë.

Mëqenëse rendi gjinor nuk mund t'i jepte popullit të shfrytëzuar asnjë ndihmë, atëherë nuk mbetej

për të veçse shteti që po lindte. Dhe ky me të vërtetë e dha këtë ndihmë me anë të organizimit të qeverimit që bëri Soloni e që u forcua njëkohësisht përsëri në dëm të rendit të vjetër. Soloni, — këtu nuk na intereson mënyra si u bë reforma e tij e vitit 594 para erës sonë, — hapi serinë e të ashtuquajturave revolucione politike, dhe e bëri këtë pikërisht duke prekur marrëdhëniet e pronës. Të gjitha revolucionet që janë bërë deri më sot, kanë qenë revolucione për të mbrojtur një lloj prone kundër një lloji tjetër. Ato nuk mund të mbronin një lloj të pronës, pa prekur tjetrën. Në kohën e revolucionit të madh francez u sakrifikuara pronat feudale për të shpëtuar pronën borgjeze; në revolucionin që bëri Soloni, e pësoi prona e kreditorëve në dobi të pronës së borxhlinjve. Borxhet u deklaruan të paqena. Ne nuk i dimë mirë hollësitë, por Soloni lëvdohet në vjershat e veta se ai i hoqi shtyllat e hipotekave nga tokat e rënduara me borxh dhe ktheu prapë në atdhe njerëzit që ishin shitur jashtë dhe kishin ikur atje prej borxheve. Kjo mund të bëhej duke shkelur sheshit të drejtën e pronës. Dhe, me të vërtetë, të gjitha të ashtuquajturat revolucione politike, nga i pari deri te i fundit, u bënë për të mbrojtur një pronë të *një* lloji me anë të konfiskimit, që quhet edhe vjedhje, të një prone të një lloji *tjetër*. Kështu, nuk ka dyshim se prona private mundi të ruhej gjatë dy mijë e pesëqind vjetëve vetëm duke shkelur të drejtën e pronës.

Por tani duhej ndaluar përsëritja e një skllavërimi të tillë të athinasve të lirë. Kjo u bë në radhë të parë me masa të përgjithshme, si, për shembull, duke ndaluar dëshmitë e detyrimeve, ku vihej peng vetë borxhliu. Pastaj u caktua sasia më e madhe e pronës së tokës, që mund të kishte një person, për të kufizuar deri në një farë pike lakminë e pangopur të arisokracisë për të shtënë në dorë tokat e fshatarëve. Pa-

staj u bënë ndryshime edhe në vetë rendin; nga këto ndryshime neve na duken më me rëndësi këto:

Këshilli u bë me katërqind anëtarë, njëqind për çdo fis; kështu baza këtu mbetet gjithnjë fisi. Por kjo qe e vetmja pikë e rendit të vjetër që mori shteti i ri. Sa për të tjerat, Soloni i ndau qytetarët në katër klasa sipas pronës së tokës dhe të ardhurave të saj; 500, 300 dhe 150 medimne drithë (1 medimne = afro 41 litra) ishin të ardhurat minimale të tri klasave të para; ata që kishin më pak të ardhura ose nuk kishin fare tokë, bënë pjesë në klasën e katërt. Të gjitha detyrat mund t'i zinin vetëm përfaqësuesit e tri klasave të para, por detyrat më të larta mund t'i zinin vetëm përfaqësuesit e klasës së parë; klasa e katërt kishite të drejtë vetëm që të fliste dhe të votonte në kuvendin e popullit, por pikërisht këtu zgjidheshin të gjithë nëpunësit, këtu ata duhej të raportonin mbi vepërimtarinë e tyre, këtu bëheshin të gjitha ligjet, dhe këtu klasa e katërt përbënte shumicën. Privilegjet aristokratike u përsëritën pjesërisht si privilegje pasurie, por populli ruajti për vete pushtetin vendimtar. Pastaj ndarja në katër klasa shërbeu si bazë për organizimin e ri të ushtrisë. Dy klasat e para nxirrnin kalorinë, klasa e tretë duhej të shërbente si këmbësori e armatosur rëndë, klasa e katërt — si këmbësori e armatosur lehtë e manevrueshme ose në flotë dhe merrte, ndoshta, për shërbimin e vet edhe rrogë.

Pra, këtu futet në organizimin e qeverimit një element fare i ri — prona private. Të drejtat dhe detyrat e qytetarëve filluan të caktoheshin sipas madhësisë së pronës së tyre tokësore, dhe sa më shumë filluan të fitonin influencë klasat e pasura, aq më shumë filluan të mënjanoheshin njësitë e vjetra të bazuara në afëri gjaku; rendi gjinor pësoi një disfatë të re.

Por matja e të drejtave politike sipas pasurisë nuk ishte aspak një nga ato parime pa të cilat nuk mund të ekzistojë shteti. Ndonëse ky parim ka lojtur një rol të madh në historinë e organizimit shtetëror, megjithatë shumë shtete, dhe pikërisht shtetet më të zhvilluara, kanë bërë dhe pa të. Edhe në Athinë ai lojti një rol vetëm të përkohshëm; që nga koha e Aristidhit çdo qytetar mund të ushtronte çdo detyrë²²¹.

Në tetëdhjetë vjetët e mëvonshëm shoqëria e Athinës u zhvillua dalëngadalë në drejtimin që ndoqi pastaj gjatë shekujve të ardhshëm. Fajdeja e tokës, që kishte lulëzuar përpara Solonit, u kufizua; gjithashtu edhe koncentrimi i jashtëzakonshëm i pronës së tokës. Tregëtia dhe zejtaria bashkë me artizanatin, që zhvillohej në përpjesëtime gjithnjë më të mëdha me anë të punës së skllëvërve, u bënë degët kryesore të prodhimit. Njerëzit u bënë më të zgjuar. Në vend që të shfrytëzonin si më parë në mënyrë të ashpër bashkëqytetarët e vet, tani filluan të shfrytëzonin sidomos skllëverit dhe blerësit e mallrave të Athinës jashtë saj. Pasuria e tundshme, pasuria që përbëhej nga paratë, nga skllëverit dhe nga anijet, shtohej gjithnjë më tepër, por tani ajo nuk shërbente më vetëm si mjet për të fituar pronë tokësore, siç qe në kohën e parë, kur kishte përgjithësisht një fushë të kufizuar, — ajo u bë një qëllim në vetëvete. Kjo, nga njëra anë, krijoi në personin e klasës së re — të pasanikëve që merreshin me industri e me tregëti — një konkurrencë fitimtare kundër pushtetit të vjetër të aristokracisë, dhe, nga ana tjetër, u hoqi mbështetjen e fundit mbeturinave të rendit të vjetër gjinor. Gjinitë, fratritë dhe fiset, anëtarët e të cilave ishin shpërndarë tani në të gjithë Atikën dhe ishin përzier midis tyre, nuk ishin më aspak të përshtatshëm për rolin e njëjësive politike; shumica e qytetarëve të Athinës nuk bënë pjesë në asnjë gjini; këta ishin njerëz të ardhur, të cilët,

ndonëse kishin marrë të drejtën e qytetarisë, nuk ishin pranuar në asnjë nga bashkimet e vjetra gjinore; krahas me këtë kishte ende një numër të ardhurish të huaj, që shtoheshin parreshtur dhe që ishin marrë ndorje²².

Ndërkaq lufta midis partive vazhdonte; aristokracia përpiquej të kthente privilegjet e mëparshme dhe për një kohë të shkurtër fitoi, derisa revolucioni i Klisthenit (viti 509 përpara erës sonë) e përmbysi atë përfundimisht dhe bashkë me të edhe mbeturinat e fundit të rendit gjinor²³.

Organizimi i ri i qeverimit i Klisthenit nuk e njih-te ndarjen në katër fise të vjetra, që bazoheshin në gjinitë dhe në fratritë. Vendin e tyre e zuri një organizim krejt i ri në bazë të ndarjes së qytetarëve vetëm sipas vendbanimit të tyre, organizim që ishte provuar nga naukraritë. Tani ajo që kishte rëndësi vendimtare nuk ishin bashkimet gjinore, por vetëm vendbanimi i përhershëm; nuk ndahej populli, por territori; banorët nga pikëpamja politike u bënë një shtojcë e thjeshtë e tokës.

Gjithë Atika u nda në njëqind rrethe komunale ose deme, që qeveriseshin vetë. Qytetarët që rronin në çdo deme (demotët), zgjidhnin plakun (demarkun) dhe një arkëtar, si edhe tridhjetë gjykatës që kishin fuqi të gjykonin çështje të vogla. Demet kishin edhe tempullin e vet dhe perëndinë e vet mbrojtëse ose heroin e vet, për të cilin ata zgjidhnin edhe priftërinj. Në çdo deme pushteti më i lartë i takonte mbledhjes së demotëve. Siç thotë me të drejtë Morgani, ky ishte prototipi i komunës qytetare amerikane, që qeverisej vetë²⁴. Shteti që po lindte në Athinë filloi me atë njësi, ku arrin shteti i sotëm si rezultat i zhvillimit të tij më të lartë.

Dhjetë njësi të tilla, deme, përbënin një fis, i cili tani, ndryshe nga fisi i vjetër i gjinive, quhej fis te-

rritorial. Ai ishte jo vetëm një organizatë politike që qeverisej vetë, por edhe një organizatë ushtarake; ai zgjidhte filarkun*, ose kryetarin e fisit, që komandon-te kalorësinë, taksiaarkun, që komandon-te këmbësorinë dhe strategun, që komandon-te të gjitha forcat e armatosura që mblihdeshin në tokën e fisit. Pastaj ai armatoste pesë anije ushtarake me ekuipazh dhe me komandant dhe kishte si mbrojtës të shenjtë një hero atik, me emrin e të cilit quhej dhe ai vetë. Më në fund, ai zgjidhte pesëdhjetë përfaqësues në këshillin e Athinës.

Të gjitha këto kurorëzoheshin me shtetin e Athinës, që qeverisej nga një këshill, i përbërë nga pesë-qind përfaqësues të zgjedhur të dhjetë fiseve, dhe në instancë të fundit — nga kuvendi i popullit, ku mund të hynte dhe ku kishte të drejtë vote çdo qytetar i Athinës; krahas me këtë kishte arkontë dhe funksionarë të tjerë, që drejtonin degë të ndryshme të administratës dhe punët e gjyqit. Në Athinë nuk kishte një kryetar të pushtetit ekzekutiv.

Me futjen e këtij organizimi të ri të qeverimit dhe me pranimin e një numri tepër të madh banorësh që ishin marrë ndorje — pjesërisht të ardhur, pjesërisht skllëvër të lënë të lirë — organet e rendit gjinor u mënjantuan nga drejtimi i çështjeve publike; ato degjeneruan në lidhje me karakter privat dhe në shoqëri fetare. Por influenza morale, pikëpamjet e trashëguara dhe mënyra e mendimit të epokës së vjetër të gjinive jetuan gjithnjë për një kohë të gjatë në traditat dhe u shuan vetëm dalëngadalë. Kjo u duk në një nga institucionet e pastajme të shtetit.

Pamë se një karakteristikë kryesore e shtetit është pushteti publik, i ndarë nga masa e popullit. Në atë kohë Athina kishte vetëm një ushtri popullore dhe një

* — nga fjala greqishte „fila” — fis. *Red.*

flotë që e nxirrte drejtpërdrejt populli; ushtria dhe flota ishin një mbrojtje kundër armiqve të jashtëm dhe mbanin në zgjedhë skllëverit, që tani përbënin shumicën e madhe të popullsisë. Në fillim pushteti publik ekzistonte për qytetarët vetëm si polici, e cila është atëherë sa edhe shteti; për këtë arsye francezët naivë të shekullit XVIII nuk thoshin popuj të qytetëruar, por popuj të policuar (nations policiées)*. Prandaj athinasit njëkohësisht me shtetin e vet krijuan edhe policinë, një xhandarmëri të vërtetë të përbërë nga harkëtarë kalorës e këmbësorë — landjeger, siç i quajmë në Gjermaninë Jugore dhe në Zvicër. Por kjo xhandarmëri formohej prej *skllëverish*. Ky shërbim policor i dukej athinasit të lirë një gjë atëherë poshtëruese, sa që ai donte më mirë të arrestohej nga një skllav i armatosur se sa të merrej ai vetë me këtë punë atëherë të turpshme. Këtu shfaqej edhe një herë mënyra e mendimit të jetës së vjetër të fiseve. Shteti nuk mund të ekzistonte pa polici, por ai ishte ende i ri dhe nuk gëzonte ende një autoritet moral të mjaftueshëm për ta bërë të ndershëm një zanat që ish-antëtarëve të shoqërisë së gjinive u dukej patjetër si një gjë e ndyrë.

Lulëzimi i shpejtë i pasurisë, i tregëtisë dhe i industrisë dëshmon se sa i përshtatshëm ishte shteti, i formuar në vijat e veta kryesore për gjendjen e re shoqërore të athinasve. Antagonizmi i klasave, në të cilin tani bazoheshin institucionet shoqërore dhe politike, nuk ishte më një antagonizëm midis aristokracisë dhe popullit të thjeshtë, por një antagonizëm midis skllëverve dhe të lirëve, midis banorëve që ishin marrë ndorje dhe qytetarëve me të drejta të plota. Në kohën e lulëzimit më të madh të Athinës numri i

* Lojë fjalësh: „police” — i qytetëruar, „police” — polici. *Red.*

përgjithshëm i qytetarëve të lirë, me gjithë gra e fëmijë, ishte afro 90 000 frymë, kurse, nga ana tjetër, kishte 365 000 skllevër të dy sekseve dhe 45 000 banorë që ishin marrë ndorje — të huaj dhe skllevër të lënë të lirë. Kështu, për çdo qytetar mashkull dhe të rritur kishte të paktën 18 skllevër dhe më tepër se 2 banorë që ishin marrë ndorje. Numri i madh i skllevërve rridhte nga fakti se shumë prej tyre punonin së bashku në manufaktura, në lokale të mëdha, nën vërejtjen e mbikëqyrësve. Por me zhvillimin e tregëtisë dhe të industrisë u bë grumbullimi dhe përqëndrimi i pasurive në pak duar, u shtua varfërimi i masave të qytetarëve të lirë, të cilëve nuk u mbetej veçse të zgjidhnin: ose të hynin në konkurrencë me punën e skllevërve, duke u marrë vetë me një zanat, gjë që quhej e turpshme, e ulët dhe që, nga ana tjetër, nuk premtonte shumë, ose të bëheshin lypës. Ata ndoqën rrugën e fundit — që në ato kushte ishte e domosdoshme — dhe meqenëse ata përbënin masën e popullsisë, kjo çoi në shkatërrim edhe gjithë shtetin e Athinës. Pra, nuk ishte demokracia që e shpuri në shkatërrim Athinën, siç thonë dhaskenjtë pedantë evropianë që tundin bishtin përpara monarkëve, por skllavëria, që e bëri punën e qytetarit të lirë një gjë të përbuzur.

Lindja e shtetit të Athinës është një shembull tipik i veçantë për formimin e shtetit në përgjithësi, sepse ajo, nga njëra anë, bëhet në një formë të kulluar, pa asnjë ndërhyrje të jashtme ose të brendshme me dhunë, — uzurpimi i përkohshëm i pushtetit nga Pisistrati nuk la asnjë gjurmë²²⁵, — nga ana tjetër, sepse në këtë rast një formë shumë e zhvilluar e shtetit, republika demokratike, lind drejtpërdrejt nga shoqëria gjinore dhe, më në fund, sepse ne i njohim mirë të gjitha hollësitë kryesore të formimit të këtij shteti.

VI

GJINIA DHE SHTETI NË ROMË

Nga legjenda e themelimit të Romës duket se aty në fillim u vendosën disa gjini latine (sipas legjendës — njëqind), të bashkuara në një fis, të cilave së shpejti iu shtua një fis sabelian, që përbëhej gjoja edhe ai nga njëqind gjini, dhe më vonë edhe një fis i tretë, që përbëhej nga elementë të ndryshëm dhe që kishte gjithashtu, sipas legjendës, njëqind gjini. Gjithë tregimi, në vështrimin e parë, dëshmon se këtu nuk ka pasur asgjë të formuar në mënyrë të natyrshme, përveç gjinisë, por edhe kjo në disa raste ka qenë vetëm një degë e gjinisë-nënë të vjetër, që vazhdonte të ekzistonte në atdheun e vjetër. Fiset mbajnë vulën e formimit artificial, por në pjesën më të madhe nga elementë të një gjaku dhe sipas shembullit të fisit të vjetër, që lindi vetiu dhe nuk u krijua artificialisht; me këtë nuk përjashtohet mundësia që bërthama e secilit nga këto fise të ketë qenë një fis i vjetër i vërtetë. Hallka e ndërmjetme, fratria, përbëhej nga dhjetë gjini dhe quhej kuri; kësajsoj ato ishin tridhjetë.

Franohet nga të gjithë se gjinia romake ishte po ai institucion, si edhe gjinia greke; në qoftë se gjinia greke është zhvillimi i mëtejshëm i asaj qelize shoqërore, formën primitive të së cilës ne e gjejmë te lëkurëkuqtë e Amerikës, atëherë kjo është e vërtetë, patjetër, edhe për gjininë romake. Prandaj ne këtu mund të flasim më shkurt.

Gjinia romake, të paktën në kohën më të lashtë të ekzistencës së qytetit, kishte këtë organizim:

1. E drejta e anëtarëve të gjinisë për trashëgim nga shoqi-shoqi; pasuria mbetej brenda gjinisë. Meqenëse në gjininë romake, si edhe në gjininë greke, sundonte e drejta atërore, pasardhësit nga vija e gruas përjashtoheshin nga trashëgimi. Sipas ligjeve të Dymbëdhjetë tabelave²²⁶, që është monumenti më i vjetër me shkrim i së drejtës romake, që dimë ne, në radhë të parë trashëgonin fëmijët si trashëgimtarë të drejtpërdrejtë; kur mungonin ata — agnatët (të afërmit nga vija e *burrit*), dhe kur mungonin këta — anëtarët e gjinisë. Në të gjitha rastet pasuria mbetej brenda gjinisë. Ne shohim këtu se si hyjnë dalëngadalë në zakonin e gjinive disa norma të reja juridike, që lindën nga shtimi i pasurisë dhe nga monogamia: e drejta e hershme e barabartë e trashëgimit për gjithë anëtarët e gjinisë, në fillim — dhe, si thamë më sipër, shumë shpejt — kufizohet në praktikë në agnatët dhe, më në fund, në fëmijët dhe në pasardhësit e tyre nga vija e mashkullit; në Dymbëdhjetë tabelat kjo, kuptohet vetëvetiu, shfaqet së prapthi.

2. Një vend të përbashkët për të varrosur të vdekurit. Gjinia patrice e Klaudëve, kur erdhi e u vendos në Romë nga qyteti Regil, mori përveç tokës edhe një vend të përbashkët në qytet për varrim. Edhe në kohën e Augustit kokën e Varit²²⁷, që u vra në pyllin e Teutoburgut, e sollën në Romë dhe e vunë në

gentilitius tumulus* — gjinia (e Kuinktilëve) kishte, pra, ende një varr të veçantë.

3. Të kremte fetare të përbashkëta. Këto sacra gentilitia** janë të njohura.

4. Detyrimi për të mos u martuar brenda gjinisë. Duket se në Romë kjo nuk u bë kurrë një ligj i shkruar, por mbeti një zakon. Nga shumica e madhe e çifteve bashkëshortore të Romës, emrat e të cilëve janë ruajtur deri më sot, asnjë nuk ka një emër gjinie të njëlojtë edhe për burrin edhe për gruan. Edhe e drejta e trashëgimit e vërteton këtë rregull. Gruaja, kur martohet, i humbet të drejtat agnate, del jashtë gjinisë së vet; as ajo as fëmijët e saj nuk mund të jenë trashëgimtarë të atit të saj ose të vëllezërve të kësaj të fundit, sepse në rast të kundërt gjinia atërore do të humbiste një pjesë të trashëgimit. Kjo ka kuptim vetëm po ta zëmë se gruaja nuk mund të martohet me një bashkanëtar të gjinisë.

5. Zotërimi i përbashkët i tokës. Kjo në kohën primitive ka ekzistuar gjithnjë, derisa nuk filluan të ndanin tokat e fisit. Në fiset latine ne gjejmë toka që pjesërisht janë të fisit, pjesërisht të gjinisë, pjesërisht të ekonomive shtëpiake, që në atë kohë është e vështirë të kenë qenë familje të veçanta. Thonë se Romuli ka qenë i pari që e ka ndarë tokën midis individëve, përafërsisht nga një hektar (dy jugerë) për njeri. Por më vonë ne gjejmë toka që janë pasuri e përbashkët e gjinive, pa përmendur tokën e shtetit, rreth së cilës vjen rrotull gjithë historia e brendshme e republikës.

6. Detyra që kanë anëtarët e gjinisë për të mbrojtur dhe për të ndihmuar shoqi-shoqin. Historia e

* — varret e gjinisë. *Red.*

** — të kremte të shenjta të gjinisë. *Red.*

shkruar na tregon vetëm mbeturinat e këtij zakoni; shteti romak që në fillim doli në shesh me një forcë të tillë të madhe, saqë e drejta e mbrojtjes kundër padrejtësive kaloi në duart e tij. Kur u arrestua Api Klaudi, gjithë gjinia e tij mbajti zi, edhe ata që ishin armiq personalë të tij. Në kohën e Luftës së dytë punike²²⁸ gjinitë u bashkuan për të çliruar me të holla anëtarët e vet që ishin zënë robër, por senati i ndaloi.

7. E drejta për të mbajtur emrin e gjinisë. Kjo mbeti deri në kohën e perandorisë; skllëvërve të lënë të lirë u lejohej të merrnin emrin e gjinisë së ish-zotërve të tyre, por pa fituar të drejtat e anëtarëve të gjinisë.

8. E drejta për të pranuar në gjini të huajt. Kjo bëhej me adoptimin e tyre nga një familje (si te indianët), gjë që binte me vete pranimin e tyre në gjini.

9. E drejta për të zgjedhur dhe për të hequr plakun nuk përmendet asgjëkund. Por meqenëse në periudhën e parë të ekzistencës së Romës të gjitha detyrat merreshin me zgjedhje ose me emërim, duke filluar nga mbreti që zgjidhej, dhe meqenëse priftërinjtë e kurive zgjidheshin gjithashtu nga kuritë, ne mund të themi po këtë gjë edhe për pleqtë (principes) e gjinive, ndonëse zgjedhja në gjini nga gjiri i së njëjtës familje mund të ishte bërë si rregull.

Këto ishin funksionet e gjinisë romake. Përveç kallimit në të drejtën atërore, që tani ishte kryer, këto riprodhojnë besnikërisht të drejtat dhe detyrat e gjinisë irokeze; edhe këtu „nxjerr kryet irokezi”²²⁹.

Po tregojmë vetëm me një shembull ç’konfuzion idesh mbi rendin gjinor romak mbretëron edhe sot midis historianëve tanë më të përmendur. Në veprën e Momzenit mbi emrat personalë romakë të epokës republikane dhe të Augustit („Studime mbi historinë e Romës”, Berlin, 1864, vëll. I) thuhet kështu:

„Përveç gjithë anëtarëve të gjinisë të seksit mashkullor, duke përjashtuar, natyrisht, sklleverit, por jo ata që i kishin pranuar në gjini dhe që ishin marrë ndorje, emri i gjinisë shtrihet edhe mbi gratë... Fisi” (siç e përkthen këtu Momzeni fjalën gens) „është... një bashkësi që ka një origjinë të përbashkët — të vërtetë ose të marrë me mend ose edhe të tri-luar — që është lidhur me festa të përbashkëta, me varre të përbashkëta dhe me trashëgim të përbashkët, një bashkësi ku mund dhe duhej të bënin pjesë të gjithë ata individë që ishin të lirë personalisht, dhe, prandaj, edhe gratë. Është vështirë vetëm të përcaktosh emrin e gjinisë së grave të martuara. Natyrisht, kjo vështirësi nuk ekzistonte derisa gruaja nuk mund të martohej veçse me një anëtar të gjinisë së vet, dhe, siç është provuar, për një kohë të gjatë për gruan ishte më e vështirë të martohej jashtë gjinisë se sa brenda saj, sepse kjo e drejtë e martesës jashtë gjinisë — gentis enuptio — edhe në shekullin VI gjithnjë jepej për shpërblim si një privilegj personal... Por atje ku ka pasur martesë të tilla jashtë gjinisë, gruaja në epokën e lashtë, siç duket, duhej të shkonte në fisin e burrit. Nuk ka asnjë dyshim se gruaja, në martesën e vjetër fetare, hyn plotësisht në komunën juridike dhe fetare të burrit dhe del nga komuna e vet. Kush nuk e di se gruaja e martuar humbet të drejtën e marrjes dhe të lënies së trashëgimit në gjininë e vet, por hyn në lidhje trashëgimi me burrin e vet, me fëmijët e vet dhe përgjithësisht me anëtarët e gjinisë së tyre? Dhe në qoftë se ajo adoptohet nga burri dhe hyn në familjen e tij, si mund të mbetet ajo e huaj për gjininë e tij?” (f. 8-11).

Kështu, Momzeni thotë se gratë romake të një gjinie mund të martohehin në fillim vetëm brenda gjinisë së vet, se, si rrjedhim, gjinia romake paska qenë endogame dhe jo ekzogame. Kjo pikëpamje, që është në kundërshtim me të gjitha ato që dimë për këtë çështje te popujt e tjerë, bazohet kryesisht, në mos tërësisht, vetëm në një pjesë të një libri të Livit (libri XXXIX, kap. 19)²³⁰, që ka shkaktuar shumë diskutime dhe që thotë se senati në vitin 568 nga theme-

limi i qytetit, d.m.th. në vitin 186 para erës sonë, vendosi:

„uti Feceniae Hispalae datio, deminutio, gentis enuptio, tutoris optio item esset quasi ei vir testamentum dedisset; utique ei ingenuo nubere liceret, neu quid ei qui eam duxisset, ob id fraudi ignominiaeve esset”, — „që Fecenia Hispala të ketë të drejtë të disponojë mbi pasurinë e vet, ta pakësojë, të martohet jashtë gjinisë dhe të zgjedhë një tutor, ashtu sikur burri i saj” (që ka vdekur) „t’ia ketë lënë këtë të drejtë me testament; që ajo të mund të martohet me një njeri që ka lindur i lirë dhe që për atë që do ta marrë për grua kjo gjë të mos quhet një akt i keq ose një turp”.

Kështu, nuk ka dyshim se këtu Fecenisë, një skllaveje të lënë të lirë, i jepet e drejta që të martohet jashtë gjinisë. Gjithashtu nuk ka asnjë dyshim se nga kjo gjë rrjedh se burri kishte të drejtë t’i linte me testament gruas së vet të drejtën që të martohej pas vdekjes së tij jashtë gjinisë. Por jashtë cilës gjini?

Në qoftë se gruaja ishte e detyruar të martohej brenda gjinisë së vet, siç kujton Momzeni, atëherë ajo edhe pas martesës mbetet në këtë gjini. Por, së pari, pikërisht kjo tezë mbi endogaminë e gjinisë duhet të provohet. Dhe, së dyti, në qoftë se gruaja duhej të martohej brenda gjinisë së vet, atëherë, natyrisht, edhe burri duhej të martohej brenda gjinisë së vet, sepse ndryshe nuk do të gjente grua. Por atëherë del se burri mund t’i linte gruas së vet me testament një të drejtë që nuk e kishte as ai vetë; kjo nga pikëpamja juridike është një absurditet. Edhe Momzeni e kupton këtë dhe prandaj bën këtë hipotezë:

„për t’u martuar jashtë gjinisë, ka të ngjarë se duhej nga pikëpamja juridike jo vetëm pëlqimi i atij që kishte pushtetin, por edhe i të gjithë anëtarëve të gjinisë” (f. 10, shënimi).

Kjo, së pari, është një hipotezë shumë e guximshme dhe, së dyti, ajo është në kundërshtim me tek-

stin e qartë të pjesës që cituam më sipër; senati i jep asaj këtë të drejtë në vend të burrit, ai i jep asaj pikërisht as më shumë as më pak se ç'mund t'i jepte burri i saj, por ajo që i jep asaj senati është një e drejtë absolute, që nuk është lidhur me asnjë kufizim tjetër, kështu që, po ta përdorë ajo këtë të drejtë, edhe burri i saj i ri nuk duhet të vuajë nga kjo gjë; senati madje ngarkon konsujt dhe pretorët, të tani-shëm dhe të ardhshëm, të kujdesen që asaj të mos i ndodhë asnjë gjë e papëlqyer në lidhje me këtë. Kështu hipoteza e Momzenit nuk mund të pranohet kurrësesi.

Ose ta zëmë se gruaja martohet me një burrë të një gjinie tjetër, por ajo vetë mbetet në gjininë e vet të mëparshme. Atëherë, sipas pjesës që cituam më sipër, burri i asaj do të kishte të drejtë ta lejonte gruan të martohet jashtë gjinisë së vet. Kjo do të thotë se ai do të kishte të drejtë të merrte vendim për çështjet që i takonin një gjinie ku ai vetë nuk bënte pjesë fare. Edhe kjo është një gjë absurde, për të cilën as që vlen të flasim më gjatë.

Mbetet vetëm kjo hipotezë: gruaja në martesën e parë u martua me një burrë të një gjinie tjetër dhe me këtë martesë ajo hyri patjetër në gjininë e burrit, siç e pranon në të vërtetë edhe Momzeni për raste të tilla. Atëherë të gjitha marrëdhëniet reciproke bëhen të qarta përnjëherë. Gruaja, e cila për shkak të martesës është shkëputur nga gjinia e vet e mëparshme dhe është pranuar në bashkimin gjinor të burrit, ka aty një pozitë fare të veçantë. Megjithëse ajo është anëtare e gjinisë, nuk ka me këtë gjini afëri gjaku; vetë karakteri i pranimit të saj e përjashton atë që më parë nga ndalimi i përgjithshëm për t'u martuar brenda gjinisë, ku ajo hyri pikërisht me anë të martesës; pastaj ajo është pranuar në bashkimin gjinor, që gëzon të drejtat e përgjithshme të trashëgimisë dhe,

në rast se vdes i shoqi, trashëgon pasurinë e tij, d.m.th. pasurinë e një anëtari të gjinisë. A ka gjë më të natyrshme se sa rregulli, sipas të cilit ajo, për të ruajtur pasurinë brenda gjinisë, është e detyruar të martohet me një anëtar të gjinisë së burrit të vet të parë dhe jo me një tjetër? Dhe në qoftë se duhet të bëhet një përjashtim, atëherë kush mund të jetë aq kompetent që ta autorizojë gruan të bëjë një gjë të tillë përveçse burri i saj i parë, që i lë këtë pasuri? Në çastin kur ai i lë asaj një pjesë të pasurisë dhe njëkohësisht e lejon që ta transferojë këtë pjesë të pasurisë në një gjini tjetër me anë të martesës ose si pasojë të martesës, atëherë kjo pasuri është ende e tij; pra, ai s'bën gjë tjetër veçse vendos mbi pronën e vet. Sa për gruan dhe për marrëdhëniet e saj kundrejt gjinisë së burrit të saj, atë e futi në këtë gjini pikërisht burri me një akt të vullnetit të vet të lirë — me martesën; prandaj është gjithashtu e natyrshme që pikërisht ai të jetë personi që mund t'i japë asaj të drejtë të dalë nga kjo gjini me një martesë të dytë. Me një fjalë, puna del e thjeshtë dhe kuptohet vetëvetiu sapo të hedhim poshtë idenë kurioze të karakterit endogam të gjinisë romake dhe të pranojmë, bashkë me Morganin, se kjo gjini ka qenë në fillim një gjini ekzogame.

Mbetet edhe një hipotezë e fundit, që ka pasur edhe ajo përkrahësit e vet dhe, ndoshta, më shumë se të tjerat: citati gjoja thotë vetëm

„se shërbëtoret, që ishin lënë të lira (libertae), pa leje të veçantë nuk mund e gente enubere“ (të martoheshin jashtë gjinisë) „ose të bënin ndonjë akt tjetër, i cili, duke qenë i lidhur me capitis deminutio minima*, të sillte me vete daljen e libertas nga lidhja e gjinisë“ (Lange, „Lashtësitë romake“, Berlin, 1856, I, f. 195, ku në lidhje me këtë pjesë të Livit, që cituam, përmend Hushken).

* — humbjen e të drejtave familjare. *Red.*

Në qoftë se kjo hipotezë është e drejtë, atëherë kjo pjesë nuk provon asgjë për pozitën e romakeve që kishin lindur të lira, dhe atëherë nuk mund të bëhet fjalë aspak për detyrën e këtyre të fundit që të martohen brenda gjinisë.

Shprehja *enuptio gentis* gjendet vetëm në këtë pjesë dhe asgjëkundi tjetër në gjithë letërsinë romake; fjala *enubere* — të martohesh jashtë — gjendet vetëm tri herë te Livi, por pa asnjë lidhje me gjininë. Ideja fantastike, se gjoja romaket mund të martoheshin vetëm brenda gjinisë, ka lindur vetëm nga kjo pjesë e Livit. Por kjo ide nuk i qëndron dot kritikës. Sepse ose kjo pjesë ka të bëjë me kufizime të veçanta për skllavet e lëna të lira, dhe atëherë nuk provon asgjë për ato që kishin lindur të lira (*ingenuae*); ose kjo pjesë ka vlerë edhe për ato që kishin lindur të lira, dhe atëherë provon më tepër se gruaja, si rregull i përgjithshëm, martohesh jashtë gjinisë së vet, por me martesën hynte në gjininë e burrit; pra, flet kundër Momenit dhe në dobi të Morganit.

Edhe afro treqind vjet pas themelimit të Romës lidhjet gjinore ishin ende aq të shëndosha, sa që një gjini patricësh, gjinia e Fabianëve, me lejen e senatit mori përsipër me forcat e veta një ekspeditë ushtarake kundër qytetit fqinj Veji. Thuhet se 306 Fabianë morën pjesë në ekspeditë dhe se që të gjithë u vranë në një pritë; mbeti gjallë vetëm një djalë i vogël, që vazhdoi gjininë.

Siç thamë, dhjetë gjini përbënin fratrinë, e cila këtu quhej *kuri* dhe kishte funksione shoqërore më me rëndësi se sa *fratria* greke. Çdo *kuri* kishte ceremonitë e veta fetare, tempujt e vet dhe priftërinjtë e vet; këta të fundit të gjithë së bashku përbënin një nga kolegjet romake të priftërinjve. Dhjetë *kuri* përbënin fisin, i cili ka të ngjarë të kishte në fillim, si dhe fiset e tjera latine, kryetarin e vet të zgjedhur —

prijësin ushtarak dhe kryepriftin. Që të tria fiset së bashku përbënin popullin romak — *populus romanus*.

Kështu, në popullin romak mund të bënte pjesë vetëm ai që ishte anëtar i një gjinie, dhe nëpërmjet gjinisë së vet — anëtar i një kurie dhe i një fisi. Organizimi i qeverimit i këtij populli në fillim ka qenë ky: çështjet shoqërore në krye i drejtonte senati, i cili, siç e ka vënë re mirë për herë të parë Niburi, përbëhej nga pleqtë e treqind gjinive²³¹; dhe pikërisht për këtë arsye ata, si pleq të gjinive, quheshin etër, patres, dhe të gjithë së bashku — senat (këshilli i pleqve nga fjala *senexplak*). U bë zakon që pleqtë të zgjidheshin gjithnjë nga po ajo familje e gjinisë, dhe kjo krijoi edhe këtu të parën aristokraci të gjinive; këto familje quheshin patricë dhe pretendonin të drejtën ekskluzive për të hyrë në senat dhe për të zënë të gjitha detyrat e tjera. Fakti që populli me kohë i pranoi këto pretendime dhe që ato u bënë një e drejtë reale, gjeti shprehjen e vet në një legjendë, sipas së cilës Romuli u fali senatorëve të parë dhe pasardhësve të tyre patriciatin me privilegjet e tij. Senati, si edhe bulë në Athinë, kishte të drejtë të vendoste për shumë çështje dhe diskutonte më parë për ato që kishin më tepër rëndësi, sidomos për ligjet e reja. Këto të fundit pastaj vendoseshin përfundimisht nga kuvendi i popullit, që quhej *comitia curiata* (mbledhje e kurive). Populli mbledhej grupe-grupe sipas kurive dhe, ndoshta, në çdo kurë sipas gjinive; kur merreshin vendime, secila nga të tridhjetë kuritë kishte një votë. Mbledhja e kurive pranonte ose hidhte poshtë të gjitha ligjet, zgjidhte gjithë funksionarët e lartë, edhe *rex-in* (të ashtuquajturin mbret), shpallte luftën (por paqen e bënte senati) dhe si gjyqi më i lartë mernte vendime të prera mbi apelimin e palëve në të gjitha rastet kur ishte puna për dënimin me vdekje të një qytetari romak. Më në fund, krahas me senatin dhe

me kuvendin e popullit vinte rex-i, i cili ishte tamam si basileusi grek dhe nuk ishte aspak një monark pothuajse absolut*, siç e përfytyron Momzeni²³². Ai ishte edhe prijës ushtarak, kryepriift dhe kryetar i disa gjyqeve. Ai nuk kishte aspak të drejtë në fushën e qeverimit civil ose pushtet mbi jetën, mbi lirinë dhe mbi pronën e qytetarëve, veçse kur ato rridhnin nga pushteti disiplinor i prijësit ushtarak ose nga pushteti i kryetarit të gjyqit në lidhje me zbatimin e një vendimi. Detyra e rex-it nuk trashëgohej; përkundrazi, në fillim ai zgjidhej, ndoshta me propozimin e paraardhësit të vet, nga mbledhja e kurive, dhe pastaj në mbledhjen e dytë e vendosnin në detyrë me madhështi. Që ai mund edhe të hiqej, e provon fati i Tarkuin Kryelartit.

Ashtu si edhe grekët e epokës heroike, romakët në kohën e të ashtuquajturve mbretër kishin një demokraci ushtarake të bazuar në gjinitë, në fratrinitë dhe në fiset dhe që ishte zhvilluar nga këto. Është e vërtetë se kuritë dhe fiset ishin pjesërisht formacione artificiale, por ato ishin krijuar sipas modeleve të vërteta, të dala vetiu, të shoqërisë, prej së cilës ato kishin lindur dhe që i rrethonte ende nga të gjitha anët. Dhe megjithëse aristokracia patriciane, që ishte

* Latinisht *rex* i përgjigjet kelto-islandishtes *righ* (plaku i fisit) dhe gotishtes *reiks*; që fjala e fundit, si në fillim edhe fjala gjermanisht *Fürst* (njëlloj si anglisht — *first*, danisht — *förste*, d.m.th. „i pari”), do të thoshte gjithashtu plaku i gjinisë ose i fisit, dukej nga fakti se gotët qysh në shekullin IV kishin një fjalë të veçantë për mbretin e kohës së pastajme, për prijësin ushtarak të gjithë popullit: *thiudans*. Artakserksi dhe Irodi në biblën e përkthyer nga Ulfila kurrë nuk quhen *reiks*, por vetëm *thiudans* dhe shteti i perandorit Tiber — kurrë *reiki*, por *thiudinassus*. Të dy këta terma shkrihen në një emër, në emrin gotik *thiudans* ose, siç e përkthejmë ne jo saktë, të mbretit *Thiudareiks*, *Theodorik*, d.m.th. *Ditrih*.

zhvilluar vetiu, tani kishte një terren të shëndoshë nën këmbët e veta, megjithëse rex-ët përpiqeshin pak e nga pak t'i zgjeronin kompetencat e veta, të gjitha këto nuk e ndryshojnë karakterin themelor fillestar të rendit, dhe këtu është gjithë puna.

Ndërkaq, popullsia e qytetit të Romës dhe të krahinës së Romës, që ishte zgjeruar në saje të pushtimeve, shtohet pjesërisht nga imigrimi, pjesërisht nga popullsia e krahinave të nënshtruara, sidomos të rrethëve latine. Të gjithë këta shtetas të rinj (për klientët këtu nuk po flasim) ishin jashtë gjinive, kurive dhe fiseve të vjetra dhe, prandaj, nuk bënë pjesë në populus romanus, në popullin romak të mirëfilltë. Ata personalisht ishin njerëz të lirë, mund të kishin pronë toke, duhej të paguanin taksa dhe të bënë shërbimin ushtarak. Por ata nuk mund të zinin asnjë detyrë dhe nuk mund të merrnin pjesë as në mbledhjen e kurive as në ndarjen e tokave të pushtuara të shtetit. Ata përbënin plebsin, që nuk kishte asnjë të drejtë politike. Për shkak të numrit të tyre, që shtohet gjithnjë më tepër, të stërvitjes së tyre ushtarake dhe të armatosjes së tyre, ata u bënë një forcë e madhe kërcënuese për populus-in e vjetër, të cilit tani i ishte kufizuar fare çdo shtim me elementë të ardhur nga jashtë. Përveç kësaj, siç duket, toka ishte ndarë pothuajse njësoj midis populus-it dhe plebsit, kurse pasuria tregtare dhe industriale, që nuk ishte ende e zhvilluar shumë, gjendej kryesisht në duart e plebsit.

Për shkak të errësirës së dendur që mbulon gjithë historinë e lashtë legjendare të Romës, — errësirë që është shtuar edhe më tepër nga orvatjet pragmatikoro-racionaliste të interpretimit dhe nga përshkrimet e po këtij lloji të shkrimtarëve të pastajmë me kulturë juridike, veprat e të cilëve na shërbejnë si burime. — nuk mund të themi asgjë të saktë as për kohën as për zhvillimin dhe as për rrethanat e lindjes së atij revo-

lucioni që i dha fund rendit të vjetër gjinor. Një gjë është e sigurt, se shkakut i saj i kishte rrënjët në luftën midis plebsit dhe popullit.

Me organizimin e ri të qeverimit, që i atribuohet mbretit Serv Tuli dhe që mbështetej në modele greke, veçanërisht në Solonin, u krijua një kuvend i ri i popullit, në të cilin merrnin pjesë ose përjashtoheshin pa dallim popullit dhe plebejtë, duke u mbështetur vetëm në faktin nëse bënë apo jo shërbimin ushtarak. Gjithë popullsia mashkull, që ishte e detyruar të bënte shërbimin ushtarak, u nda sipas pasurisë në gjashtë klasa. Madhësia minimale e pasurisë për secilën nga të pesë klasat ishte: I — 100 000 ase*, II — 75 000, III — 50 000, IV — 25 000, V — 11 000 ase, që, sipas Dyro de la Mal, bëjnë afro 14 000, 10 500, 7 000, 3 600 dhe 1 570 marka²³³. Klasa e gjashtë, proletarët, përbëhej nga ata që kishin pak dhe që ishin të lirë nga shërbimi dhe nga taksat. Në kuvendin e ri të popullit të centurive (comitia centuriata) qytetarët rreshtoheshin ushtarakisht, si të thuash, në grupe prej 100 vetash në centuritë e veta, dhe çdo centuri kishte një votë. Por klasa e parë nxirrte 80 centuri, e dyta — 22, e treta — 20, e katërta — 22, e pesta — 30; së gjashtës për sy e faqe iu dha edhe asaj një centuri. Përveç kësaj, kalorësit, që dilnin nga qytetarët më të pasur, përbënin 18 centuri, gjithsej 193 centuri; për të pasur shumicën, mjaftonin 97 vota. Mirëpo vetëm kalorësit dhe klasa e parë së bashku kishin 98 vota, d.m.th. shumicën; kur ata ishin në një mendje, të tjerët as që i pyesnin, vendimi merrej pa ta.

Tani të gjitha të drejtat politike të kuvendit të mëparshëm të kurive (përveç disa të drejtave nominale) i kaluan kuvendit të ri të centurive; kuritë dhe gjinitë që i përbënin, ranë kështu, si dhe në Athinë, në

* As — monedhë e romakëve të vjetër. *Red. Përkth.*

rolin e vllaznive private dhe fetare të thjeshta dhe si të tilla tërhiqnin zvarrë jetën e tyre edhe për një kohë të gjatë, kurse kuvendi i kurive shpejt u zhduk fare. Për të larguar nga shteti edhe tri fiset e vjetra të gjinive, u krijuan katër fise territoriale, që rronin secili më vete në lagje të veçanta të qytetit dhe kishin një sërë të drejtash politike.

Kështu në Romë u prish, përpara se të hiqej i ashtuquajturi pushtet i mbretërve, rendi i vjetër shoqëror, që mbështetej në lidhjet personale të gjakut, dhe në vend të tij u krijua një organizim i ri me të vërtetë shtetëror, që kishte si bazë ndarjen territoriale dhe ndryshimet pasurore. Pushteti publik këtu ishte përqëndruar në duart e qytetarëve, që bënë shërbimin ushtarak, dhe ishte drejtuar jo vetëm kundër skllëvërve, por edhe kundër të ashtuquajturve proletarë, që nuk pranoheshin në shërbimin ushtarak dhe nuk kishin armë.

Në kuadrin e këtij rendi të ri, që u zhvillua më tej vetëm më vonë, kur u dëbua mbreti i fundit, Tarkuin Kryelarti, që kishte uzurpuar pushtetin e vërtetë mbretëror, dhe kur mbreti u zëvendësua me dy prijës ushtarak (me konsujt), që kishin pushtet të barabartë (si te irokezët), — në kuadrin e këtij rendi zhvillohet gjithë historia e Republikës romake me gjithë luftërat e saj midis patricëve dhe plebejve për të zënë detyrat dhe për të pasur pjesë në tokat e shtetit, me shkrirjen, më në fund, të aristokracisë patriciane në klasën e re të pronarëve të mëdhenj të tokës dhe të manjatëve financiarë, të cilët pak e nga pak gllabëruan gjithë tokën e fshatarëve të rrënuar nga shërbimi ushtarak, lëronin me skllëvër pronat tokësore të mëdha, që kishin lindur në këtë mënyrë, shkretuan Italinë dhe kështu i hapën rrugën jo vetëm pushtetit të perandorëve, por edhe pasardhësve të tyre — barbarëve gjermanë.

VII

GJINIA E KELTEVE DHE E GJERMANEVE

Këtu nuk kemi vend të hyjmë në hollësi mbi institucionet e rendit gjinor, që ekzistojnë edhe sot e kësaj dite ndër popuj të ndryshëm të egër dhe barbarë, në një formë pak a shumë të kuilluar, ose mbi gjurmët e këtyre institucioneve në historinë e vjetër të popujve të kulturuar të Azisë. Si ato si këto i gjejmë kudo. Mjafton të tregojmë disa shembuj. Përpara se të dinim ç'është gjinia, Mak-Lenani, i cili u mundua më tepër se të gjithë për ta ngatërruar këtë çështje, provoi ekzistencën e saj dhe përgjithësisht e përshkroi drejt te kallmukët, çerkezët, samojedët* dhe te tre popujt indianë — varalët, magarët dhe munipurët²³⁴. Para ca kohe M. Kovalevski e zbuloi dhe e përshkroi te pshavët, hevsurët, svanetët dhe te fiset e tjera të Kaukazit²³⁵. Këtu ne po kufizohemi me disa vërejtje të shkurtëra mbi ekzistencën e gjinisë te keltët dhe te gjermanët.

* Kështu quheshin më parë nencët. *Red.*

Nga ligjet më të lashta të keltëve, ato që janë ruajtur na e tregojnë gjininë ende plot jetë; në Irlandë ajo edhe sot të paktën instinktivisht jeton në ndërjegjen e popullit, qëkurse anglezët e prishën me forcë; në Skoci ajo ishte ende në lulëzim të plotë edhe në mesin e shekullit të kaluar dhe këtu ajo u zhduk vetëm me armët, me legjislacion dhe me gjyqet e anglezëve.

Ligjet e vjetra të Uelsit, që janë shkruar shumë qindra vjet përpara pushtimit anglez²⁶, më i voni në shekullin XI, dëshmojnë se toka lërohej në mënyrë të përbashkët nga fshatra të tëra, ndonëse kjo ishte një mbeturinë e rrallë e një zakoni që përpara ishte përhapur kudo: çdo familje kishte pesë akra* që i punonte vetë; krahas me këtë një copë tokë e punonin së bashku dhe të korrat i ndanin. Nuk ka dyshim se këto komuna fshatare janë gjini ose nëndarje të gjinive; këtë e provon analogjia midis Irlandës e Skocisë, edhe sikur një verifikim i ri i ligjeve të Uelsit, të cilin nuk kam kohë ta bëj (shënimet e mia janë të vitit 1869)²⁷, të mos e vërtetonte këtë gjë drejtpërdrejt. Por burimet e Uelsit, si edhe burimet irlandeze provojnë drejtpërdrejt se në shekullin XI martesat me çifte të keltët nuk ishte zëvendësuar ende aspak nga monogamia. Në Uels vetëm pas shtatë vjetësh një martesë bëhej e pazgjydhshme ose, më mirë, nuk mund të prishej kur këtë e kërkonte njëra nga palët. Kur mungonin vetëm tri net për të mbushur shtatë vjet, bashkëshortët mund të ndaheshin. Atëherë bëhej ndarja e pasurisë: gruaja ndante, burri zgjidhte pjesën e vet. Orenditë shtëpiake ndaheshin sipas disa rregullave shumë kurioze. Kur martesat prishej nga burri, atëherë ai duhej t'i kihente gruas pajën e saj dhe disa sende të tjera; kur prishej nga gruaja, ajo merrte më pak.

* — akra — masë toke në Angli dhe në Amerikën Veriore barazi me 4 047 m². *Red. Përkth.*

Nga fëmijët burri merrte dy, gruaja — një, të mesmin. Kur gruaja pas ndarjes martohej përsëri, dhe burri i parë kërkonte ta merrte prapë, ajo duhej të shkonte me të, edhe po qe se ajo kishte vënë një këmbë në shtratin e ri bashkëshortor. Por në qoftë se ata kishin jetuar bashkë shtatë vjet, atëherë ata bëheshin burrë e grua edhe sikur më parë të mos ishin bërë formalitetet e martesës. Papërllyeshmëria e vajzave përpara martesës nuk respektohej aspak në mënyrë të rreptë dhe as nuk kërkohej; rregullat që kanë të bëjnë me këtë, ishin të një natyre shumë çapkëne dhe nuk i përgjigjen fare moralit borgjez. Kur gruaja shkelte besnikërinë bashkëshortore, burri mund ta rrihte (një nga tri rastet kur atij i lejohej kjo gjë, përndryshe ai dënohej), por pastaj ai nuk kishte të drejtë të kërkonte më tepër, sepse

„për një faj kërkohet ose larja e fajit ose hakmarrja, por jo që të dyja bashkë”.²³⁸

Shkaqet për të cilat gruaja mund të kërkonte ndarjen, pa humbur asnjë nga të drejtat e saj në ndarjen e pasurisë, ishin shumë të ndryshme: mjaftonte që burrit t'i mbante erë goja. Shpërblimi me para, që i paguhej kryetarit të fisit ose mbretit, për të drejtën e natës së parë (gobr merch, nga rrjedh marcheta e kohës së parë, frëngjisht — marquette) luan një rol të madh në kodin e ligjeve. Gratë gëzonin të drejtë vote në kuvendet e popullit. Duhet të shtojmë se ekzistenca e rregullave të tilla është provuar edhe për Irlandën; se edhe atje kanë qenë shumë të përhapura martesat e përkohshme, dhe gruas, kur ndahej, i siguroheshin avantazhe të mëdha, të caktuara mirë, madje edhe një shpërblim për punën e saj në ekonominë shtëpiake; se atje ekzistonte „një grua e parë” krahas me gra të tjera dhe nuk bëhej asnjë dallim, kur ndahej trashëgimi, midis fëmijëve me martesë dhe fëmijë-

ve jashtë martesës. Pra, këtu kemi tablonë e një martesë me çifte, në krahasim me të cilën forma e martesës që ekziston në Amerikën Veriore na duket e rreptë, gjë që në shekullin XI nuk është e çuditshme për një popull, i cili në kohën e Cezarit jetonte gjithnjë në martesë me grupe.

Ekzistenca e gjinisë irlandeze (sept, fisi quhej claine, klan) është vërtetuar, dhe kjo gjini është përshkruar jo vetëm në kodet e vjetra të ligjeve, por edhe nga juristët anglezë të shekullit XVII, të cilët ishin dërguar në Irlandë për të kthyer tokat e klaneve në pronë të mbretit të Anglisë. Toka deri në këtë kohë kishte mbetur pronë e përbashkët e klanit ose e gjinisë, në qoftë se s'ishte bërë ende një zotërim privat i kryetarëve. Kur vdiste një anëtar i gjinisë dhe, si rrjedhim, shuhej një ekonomi, plaku (caput cognationis, siç e quanin juristët anglezë) bënte një ndarje të re të gjithë tokës midis ekonomive që mbeteshin. Kjo ndarje e re, ndoshta, bëhej përgjithësisht sipas rregullave që ishin në fuqi në Gjermani. Edhe sot nëpër fshatra ka ara që i nënshtrohen sistemit të quajtur rundale dhe që 40 ose 50 vjet përpara ishin të shumta. Fshatarët, qiramarrësit individualë të tokës, që përpara i përkiste gjithë gjinisë dhe që pasta j e rrëmbyen pushtuesit anglezë, paguajnë secili qira për pjesën e vet, por i bashkojnë gjithë arat dhe luadhet e tokave të veta së bashku, i ndajnë sipas pozitës dhe cilësisë në „Gewanne”, siç quhen në Mozellë, dhe i japin secilit pjesën e tij në çdo „Gewanne”; kënetat dhe kullotat përdoren së bashku. Edhe 50 vjet më parë herë pas here, nganjëherë çdo vit, bëheshin rindarje. Plani i kufijve të një fshati të tillë, që i nënshtrohej sistemit rundale, i shembëllen krejt një komune fshatare gjermane (Gehöferschaft) në Mozellë ose në Hohwald. Gjinia vazhdon të rrojë edhe në „factions”⁴. Fsha-

* — „partitë”. Red.

tarët irlandezë shpeshherë ndahen në parti, të cilat dallohen nga ndryshime që në dukje s'kanë asnjë kuptim ose janë absurde, fare të pakuptueshme për anglezët dhe që, siç duket, nuk kanë tjetër qëllim përveç ndeshjeve popullore që organizohen midis këtyre partive në ditët e festave. Kjo është një ringjallje artificiale, një zëvendësim i mëvonshëm i gjinive të zhdukura, që dëshmon në mënyrën e vet për vitalitetin e instinktit të trashëguar të gjinisë. Megjithatë, në disa vende anëtarët e një gjinie rrojnë gjithnjë bashkë në territorin e vjetër; kështu, edhe në vjetët 1830-40 shumica e madhe e banorëve të kontesë Monahan kishte gjithsejt katër llagape familjesh, d.m.th. rridhte nga katër gjini ose klane*.

* Ato pak ditë, që kalova në Irlandë²³⁹, unë kuptova përsëri në mënyrë të gjallë se sa të thella janë ende në popullsinë fshatare të këtij vendi idetë e epokës së gjinive. Pronari i tokës, të cilit fshatari i merr tokën me qira, është për këtë të fundit gjithnjë si një farë prijës klan, që duhet të administrojë tokën për interesin e të gjithëve; fshatari i paguan atij një tribut në formë qiraje, por në rast nevojë ai duhet të marrë ndihmë prej tij. Gjithashtu atje çdo njeri që është më i pasur, e ka për detyrë të ndihmojë fqinjët e vet që kanë më pak, kur ata kanë nevojë. Kjo ndihmë nuk është lëmoshë, ajo është një e drejtë e anëtarit të klanit që ka më pak për të kërkuar nga një anëtar më i pasur ose nga kryetari i klanit. Kuptohen ankimet e ekonomistëve dhe të juristëve që thonë se nuk është e mundur t'i fusësh në kokë fshatarit irlandez idenë e pronës borgjeze të sotme; një pronë ku ka vetëm të drejta dhe asnjë detyrë, nuk i hyn në kokë irlandezit. Por gjithashtu kuptohet pse irlandezët, kur bien befaz me këto ide kaq naive të rendit gjinor në qytetet e mëdha të Anglisë ose të Amerikës, në një rreth me pikëpamje morale dhe juridike fare të ndryshme, — pse këta irlandezë e humbasin aq lehtë toruan në çështjet e moralit dhe të së drejtës, humbasin çdo mbështetje dhe shpesh bëhen me shumicë viktima të zvetënimit moral. (*Shënim i Engelsit për botimin e vitit 1891.*)

Në Skoci rendi gjinor u zhduk në kohën e shtypjes së kryengritjes së vitit 1745²⁴⁰. Mbetet gjithnjë për të studjuar se cilën hallkë të këtij rendi përfaqëson klani skocez, por që ky përbënte një hallkë të këtij rendi, për këtë nuk ka asnjë dyshim. Ky plan i Skocisë mialore na del përpara, si të ishte i gjallë, në romanet e Valter Skotit. Ky klan, — thotë Morgani, —

„është një tip i përsosur i gjinisë për organizimin e tij dhe për frymën e tij, një shembull i shquar i pushtetit të jetës së gjinive mbi anëtarët e gjinisë... Në grindjet dhe në gjaqet e tyre, në ndarjen e territorit sipas klaneve, në shfrytëzimin e përbashkët të tokës, në besnikërinë e anëtarëve të klanit kundrejt kryetarit dhe shoqi-shoqit, në gjejmë karakteristikat e shoqërisë së gjinive, që shfaqen kudo... Origjina ilogariteje sipas së drejtës atërore, kështu që fëmijët e burrave mbeteshin në klan, kurse fëmijët e grave shkonin në klanet e etërve të tyre”²⁴¹

Por që në Skoci më parë ka sunduar e drejta amtare, provohet nga fakti se, sipas fjalëve të Bedës, në familjen mbretërore të piktëve trashëgimi bëhej nga vija e gruas²⁴². Bile një mbeturinë e familjes punaluanë ishte ruajtur si te uelsët, ashtu edhe te skotët, deri në mesjetë në formën e së drejtës së natës së parë, të cilën mund ta përdorte kundrejt çdo nuseje kryetari i klanit ose mbreti si përfaqësues i fundit i burrave të përbashkët të dikurshëm, në qoftë se për këtë të drejtë nuk ishte dhënë shpërblisë.

* * *

Nuk ka dyshim se gjermanët deri në dyndjen e popujve ishin organizuar në gjini. Ata, siç duket, kishin pushtuar tokën midis Danubit, Rinit, Vistulës dhe detrave të Veriut vetëm pak shekuj përpara erës sonë; cimbrët dhe teutonët gjendeshin gjithnjë në dyndje

e sipër, dhe suevët zunë vend mirë vetëm në kohën e Cezarit. Për këta të fundit Cezari thotë shprehimisht se ata u vendosën sipas gjinisë dhe grupesh gjinësh (gentibus cognationibusque)²⁴³, dhe në gojën e një romaku nga gens Julia* kjo fjalë gentibus ka një kuptim të prerë dhe kategorik. Kjo ishte e vërtetë për të gjithë gjermanët; edhe në provincat e pushtuara romake ata, siç duket, vendoseshin sipas gjinive. Në „Të drejtën allemane” vërtetohet se në tokën e pushtuar në jug të Danubit populli u vendos sipas gjinësh (genealogiae)²⁴⁴; genealogia është përdorur këtu krejt po në atë kuptim si marka ose komuna fshatare e mëvonshme. Para pak kohe Kovalevski shfaq mendimin se këto genealogiae ishin komuna të mëdha shtëpiake, midis të cilave ishte ndarë toka dhe prej të cilave vetëm më vonë u zhvillua komuna fshatare²⁴⁵. Po këtë mund të themi atëherë edhe për fära, një fjalë, me të cilën burgundët dhe langobardët, — pra, një fis gotik dhe një fis herminonik ose fis i Gjermanisë së Epërme, — shprehnin pothuajse po atë gjë, në mos krejt atë gjë që shpreh fjala genealogia në „Të drejtën allemane”. A kemi përpara me të vërtetë një gjini apo një komunë shtëpiake — kjo ka nevojë të studjohet më mirë.

Monumentet e gjuhës nuk na sqarojnë mirë nëse kanë pasur gjermanët një shprehje të përgjithshme për gjininë dhe cila ka qenë pikërisht kjo fjalë. Nga pikëpamja etimologjike fjalës genos të grekërve, gens të latinëve u përgjigjet fjala gotishte kuni dhe künne në gjermanishten letrare të mesjetës, dhe kjo fjalë përdoret po në këtë kuptim. Në kohët e së drejtës amtare të shpie fakti se emri „grua” rrjedh po nga ajo rrënjë: greqisht gyne, sllavisht zēna, gotisht qvino, në skandinavishten e vjetër kona, kuna. — Te langobar-

* — gjinia e Julëve. *Red.*

dët dhe te burgundët, siç thamë më sipër, ne gjejmë fjalën fära, që Grimi thotë se vjen nga rrënja hipotetike fisian — të pjellur. Unë do të preferoja të nisesha nga një prejardhje më e qartë, nga faran — udhëtoj*, shtegëtoj, kthehem, si një fjalë që tregon një pjesë të masës në shtegëtim, të përbërë, natyrisht, vetëm nga të afërm, — një fjalë që pas shumë shekuj udhëtimesh në fillim në Lindje, pastaj në Perëndim kaloi dalëngadalë mbi vetë komunën gjinore. — Pastaj kemi në gotishte sibja, — në anglosanksonishten sib, në gjermanishten e vjetër letrare sippa, sippa — i afërm**. Në skandinavishten e vjetër kemi vetëm shumësin sifjar — njerëz të një gjinie; në njëjës gjendet vetëm si emër i perëndeshës Sif. — Dhe, më në fund, ne gjejmë një tjetër shprehje në „Këngën e Hildebrandit”²⁴⁶, pikërisht aty ku Hildebrandi pyet Hadubrandin:

„Kush është yt atë në mes të burrave në popull... ose prej ç’gjinie je?” („eddo huëllihes enuo-sles du sis”).

Në qoftë se ka pasur një fjalë të përgjithshme gjermane për të treguar gjininë, kjo fjalë do të ketë qenë si fjala gotike kuni; për këtë tezë flet jo vetëm identiteti me shprehjet përkatëse të gjuhëve të afërme, por edhe fakti se që këtej rrjedh fjala kuning — mbret***, që në fillim do të thotë plaku i gjinisë ose i fisit. Sibja, i afërm, me sa duket, nuk duhet marrë parasysh; të paktën sifjar në skandinavishten e vjetër nuk do të thotë vetëm të afërm me gjak, por dhe të afërm me krushqi, d.m.th. përfshin anëtarët të paktën e dy gjinive: kështu, vetë fjala sif nuk mund të tregonte gjininë.

* — gjermanisht fahren. *Red.*

** — gjermanisht Sippe. *Red.*

*** — gjermanisht König. *Red.*

Si te meksikanët e te grekët, ashtu edhe te gjermanët qoftë reparti i kalorsisë, qoftë kolona në formë pyke e këmbësorisë rreshtoheshin në formacione luftimi sipas bashkimeve gjinore; kur Taciti thotë: sipas familjeve dhe grupeve gjinore²⁴⁷, kjo shprehje e papërcaktuar shpjegohet me faktin se në kohën e tij në Romë gjinia kishte kohë që nuk ishte më një njësi e gjallë.

Një rëndësi vendimtare ka një pjesë e librit të Tacitit, ku thuhet se vëllai i nënës e quan nipin e vet si bir të vet; madje disa i konsiderojnë lidhjet e gjakut midis ungjit nga ana e nënës dhe të nipit më të shenjtë dhe më të ngushtë se lidhjen midis atit dhe birit, kështu që, kur kërkojnë njerëz si peng, djali i motrës quhet si një garanci më e madhe se sa biri i atij që duan ta lidhin me një garanci. Këtu ne kemi një mbeturinë të gjallë të gjinisë, të organizuar sipas së drejtës amtare, d.m.th. sipas së drejtës fillestare, që karakterizon në mënyrë të veçantë gjermanët*. Kur anëtari i një gjinie të tillë jepte birin e vet si peng për një de-

* Natyrën veçanërisht të ngushtë të lidhjes midis ungjit nga ana e nënës dhe nipit, që e ka origjinën në kohën e së drejtës amtare dhe që e gjejmë te shumë popuj, grekët e njohin vetëm nga mitologjia e periudhës heroike. Sipas Diodorit (IV, 34), Meleagri vret bijtë e Testit, vëllezërit e nënës së vet Altea. Kjo e konsideron këtë akt si një krim aq të rëndë, saqë mallëkon vrasësin, birin e vet, dhe kërkon nga perënditë vdekjen e tij. „Siç tregojnë, perënditë i përmbushën dëshirat e saj dhe i dhanë fund jetës së Meleagrit”. Sipas fjalëve të po këtij Diodori (IV, 43 e 44), argonautët nën komandën e Heraklit zbresin në Thrakë dhe shohin atje se Fineu, i shtyrë nga gruaja e vet e dytë, mundon dy bijtë e vet, që i kanë lindur nga gruaja e parë, Kleopatra Boreade, të cilën e kishte dëbuar. Por midis argonautëve kishte dhe Boreadë, vëllezër të Kleopatrës, d.m.th. vëllezërit e nënës së atyre që mundoheshin. Ata menjëherë marrin anën e nipërve të vet, i lirojnë dhe vrasin rojën²⁴⁸.

tyrim solemn dhe i biri binte viktimë e shkeljes së besës nga ana e t'et, kjo ishte vetëm puna e atit. Po kur viktima ishte biri i motrës, kjo shkelte të drejtën më të shenjtë të gjinisë; njeriu më i afërm në gjak i djalit ose i të riut, ai që duhej ta mbronte atë më parë se gjithë të tjerët, bëhej fajtor i vdekjes së tij; ky ose nuk duhej ta vinte atë peng ose duhej që ta mbante besën e lidhur. Do të mjaftonte vetëm kjo pjesë edhe sikur të mos kishim asnjë gjurmë tjetër të rendit gjinor te gjermanët.

Një pjesë nga „Völuspå”²⁴⁹ e skandinavëve të vjetër, që është kënga e perëndimit të perëndive dhe e fundit të botës, ka një rëndësi edhe më vendimtare, sepse është shkruar 800 vjet më vonë. Në këtë „Vegim të profeteshës”, ku, siç e kanë provuar tani Bangu dhe Buge²⁵⁰, pleksen edhe elemente të krishterimit kur përshkruhet epoka e degjenerimit të përgjithshëm dhe e rënies morale pas së cilës vjen katastrofa e madhe, thuhet:

„Broedhr munu berjask ok at bönum verdask,
munu *systrungar* sifjum spilla”.

„Vëllezërit do të luftojnë midis tyre dhe do të vrasin shoqi-shoqin, *fëmijët e motrave* do të prishin lidhjen gjinore”.

Systrungr — do të thotë bir i motrës së nënës dhe takti që këta, fëmijët e motrave, të mohojnë afërinë e gjakut midis tyre, i duket poetit një krim më i madh se vëllavrasja. Ky vendim i krimit është shprehur në fjalën *systrungar*, që thekson afërinë nga ana e nënës; po të kishte në vend të saj *syskina-börn* — fëmijët e vëllezërve dhe të motrave — ose *syskina-synir* — bijtë e vëllezërve dhe të motrave, atëherë vargu i dytë do të tregonte në krahasim me vargun e parë jo një rëndim, por një zbutje. Kështu, edhe në kohët e viki-geëve¹⁵², kur lindi „Vegimi i profeteshës”, në Skandi-

navi nuk ishte zhdukur ende kujtimi i së drejtës amtare.

Por në kohën e Tacitit të gjermanët, që, të paktën ai i njihnte më mirë, e drejta amtare i kishte lëshuar vendin së drejtës atërore; fëmijët trashëgonin nga i ati; kur nuk kishte fëmijë, trashëgonin vëllezërit dhe ungjërit nga ana e atit dhe e nënës. Pjesëmarrja në trashëgim e vëllait të nënës është lidhur me ruajtjen e zakonit që sapo përmendëm, dhe provon gjithashtu se sa e re ishte gjithnjë atëherë e drejta atërore të gjermanët. Gjurmët e së drejtës amtare i gjejmë deri vonë në mesjetë. Edhe në atë kohë, siç duket, nuk kishte dhe aq besim në atësinë, sidomos ndër bujkrobërit; kështu kur një feudal i kërkonte një qyteti, për shembull Augusburgut, Bazelit e Kajzerslauternit, që t'i kthente prapë një bujkrob që kishte ikur, atëherë, për të vërtetuar se ai ishte me të vërtetë bujkrob, duhej të betoheshin gjashtë veta nga më të afërmit e tij në gjak dhe vetëm nga ana e nënës (Maurer, „Organizimi i qyteteve”, I, f. 381).

Një gjurmë tjetër të së drejtës amtare, që ishte në të shuar e sipër, mund ta shohim në respektin e gjermanëve kundrejt seksit femëror, që për romakët ishte një gjë pothuajse e pakuptueshme. Vajzat nga familje fisnike quheshin si pengu më i sigurt në besëlidhjet me gjermanët; ideja se gratë dhe vajzat e tyre mund të ziheshin rob dhe mund të binin në skllavëri, ishte për ta një gjë e tmerrshme dhe zgjonte më tepër se çdo gjë tjetër burrërinë e tyre në luftë; gruaja për ta është një gjë e shenjtë dhe profetike; ata çmojnë këshillën e saj edhe në punët më me rëndësi; kështu, Veleda, priftëresha e fisit të brukterëve në Lipe, ishte shpirti i gjithë kryengritjes së batavëve, kur Civilis në krye të gjermanëve dhe të belgjianëve lëkundti sundimin romak në gjithë Galinë²⁵¹. Në shtëpi, sundimi i gruas duket se është i padiskutueshëm; është e vërtetë

të se gjithë barra e punëve shtëpiake bie mbi të, mbi pleqtë dhe mbi fëmijët; burri vete për gjah, pi ose rri pa punë. Kështu thotë Taciti; por meqenëse ai nuk thotë se kush e punonte tokën dhe deklaroi në mënyrë kategorike se skilleverit paguanin vetëm një teloznë, por nuk kishin asnjë angari, shumica e burrave të rritur prapëseprapë duhej të bënin atë punë të vogël që kërkonte bujqësia.

Forma e martesës ishte, siç u tha më sipër, një martesë me çifte, që po i afrohej dalëngadalë monogamisë. Një monogami të rreptë nuk kishte ende, sepse parisë i lejohej poligamia. Papërlëshmëria e vajzave respektohej përgjithësisht në mënyrë të rreptë (në kundërshtim me keltët), dhe Taciti shprehet gjithashtu me simpati të veçantë për karakterin e pagjidhshëm të lidhjes bashkëshortore të gjermanët. Si arsye për ndarje ai nuk tregon veçse pabesinë e gruas. Por tregimi i tij këtu ka shumë mungesa dhe, përveç kësaj, duket tepër qartë se ky tregim shërben si pasqyrë virtyti për romakët e korruptuar. Një gjë është e sigurt: në qoftë se gjermanët ishin në pyjet e veta kalorës të pashoq të virtytit, mjaftonte vetëm kontakti më i vogël me botën e jashtme që të binin në nivelin e evropianëve të tjerë mesatarë; midis botës romake gjurma e fundit e rreptësisë së zakoneve u zhduk shumë më shpejt se gjuha gjermane. Për këtë mjafton të lexosh Grigorin e Turit. Kuptohet vetëvetiu se në pyjet virgjëra të Gjermanisë nuk mund të sundonin epshet e stërholluara pa masë, si në Romë, dhe, kështu, gjermanët edhe nga kjo pikëpamje kishin vetija që s'i kishin romakët, edhe në qoftë se nuk mund të themi se ata kanë qenë të përmbajtur në punët seksuale, gjë që kurrë dhe asgjëkundi nuk ka qenë një rregull i përgjithshëm për një popull të tërë.

Nga rendi gjinor ridhte detyra për të trashëguar jo vetëm miqësitë, por edhe armiqësitë e atit dhe të

të afërmve; gjithashtu trashëgohej edhe vergeld-i (larja e gjakut), d.m.th. një gjobë që paguhej në vend që të merrej gjaku për vrasje ose për gjymtime. Vergeld-i, që qysh një brez përpara nesh quhej si një institucion i veçantë i gjermanëve, tani është konstatuar te qindra popuj si një formë e përgjithshme për të zbutur gjaqet që rridhnin nga rendi gjinor. Vergeld-in si edhe detyrimin për ta pritur mikun, ne e gjejmë, midis të tjerave, edhe te indianët e Amerikës; përshkrimi i mikpritjes te Taciti („Germania”, kap. 21) është pothuajse edhe në hollësitë njësoj si tregimi i Morganit mbi mikpritjen e indianëve të vet.

Diskutimet e zjarrta dhe pa fund rreth çështjes nëse i kishin ndarë përfundimisht gjermanët e kohës së Tacitit tokat e veta apo jo, dhe si duhen kuptuar ato pjesë nga librat që kanë të bëjnë me këtë çështje, — këto diskutime sot i takojnë së kaluarës. Nuk ia vlen barra qiranë të përmendet kjo çështje tani që është provuar pothuajse te gjithë popujt se ka ekzistuar punimi i përbashkët i tokës nga ana e gjinisë dhe më vonë nga komuna familjare komuniste, që, sipas Cezarit, ekzistonte te suevët²⁵², dhe se ky sistem u zëvendësua nga ndarja e tokës midis familjeve të veçanta me rindarje periodike të kësaj toke, tani që u provua se kjo rindarje periodike e tokës së punueshme vende-vende është ruajtur në Gjermani deri më sot. Në qoftë se gjermanët në 150 vjet, që ndajnë tregimin e Cezarit nga dëshmitë e Tacitit, kaluan nga punimi i përbashkët i tokës, që Cezari thotë shprehimisht se ekzistonte te suevët (ata nuk kanë fare ara të ndara ose private, thotë ai), në punimin e tokës nga familje të veçanta duke e rindarë çdo vit këtë tokë, ky është me të vërtetë një përparim mjaft i madh; kalimi nga punimi i përbashkët i tokës në pronën e plotë private të tokës në një kohë kaq të shkurtër dhe pa asnjë ndërhyrje nga jashtë na duket fare i pamundshëm.

Prandaj unë lexoj te Taciti vetëm atë që ai e thotë shkurt: ata këmbejnë (ose ndajnë përsëri) çdo vit tokën e punueshme, dhe prapë mbetet e lirë mjaft tokë e përbashkët²⁵³. Kjo është shkalla e bujqësisë dhe e përvetësimit të tokës që i përgjigjet plotësisht rendit gjinor të gjermanëve të asaj kohe.

Këtë paragraf të fundit e kam lënë të pandryshuar, ashtu si ka qenë në botimet e para. Gjatë kësaj kohe çështja ka marrë një tjetër rrugë. Qëkurse Kovalevski (shih më sipër, f. 44*) provoi se komuna shtëpiake patriarkale ishte përhapur gjerësisht, në mos kudo, si një shkallë e ndërmjetme midis familjes komuniste me të drejtë amtare dhe familjes së sotme të veçuar, çështja nuk shtrohet më, siç shtrohej më parë në diskutimin midis Maurrerit e Vajcit, — nëse toka ishte pronë e përbashkët apo pronë private, por se cila ka qenë forma e pronës së përbashkët. Nuk ka asnjë dyshim se në kohën e Cezarit të suedët kishte jo vetëm pronë të përbashkët, por edhe pushim të përbashkët të tokës me forca të përbashkëta. Mund të diskutohet edhe për një kohë të gjatë nëse ka qenë njësi ekonomike gjinia apo komuna shtëpiake apo ndonjë grup tjetër i ndërmjetmë i përbërë nga të afërm, apo kanë ekzistuar sipas kushteve të tokës të tria këto grupe? Po ja, na del Kovalevski dhe thotë se gjendja e përshtuar nga Taciti nuk i përgjigjet ekzistencës së komunës-markë ose të komunës fshatare, por të komunës shtëpiake; vetëm nga kjo e fundit shumë më vonë, si rezultat i shtimit të popullsisë, u zhvillua komuna fshatare.

Sipas këtij mendimi, territoret e banuara nga gjermanët, të cilat ata i kishin zënë në kohën e romakëve, si edhe tokat që ata ua morën më vonë romakëve, nuk ishin fshatra, por komuna të mëdha fa-

* — Shih këtë vëllim, f. 228. *Red.*

miljare, të cilat përbëheshin nga disa breza që punonin një tokë të caktuar dhe që përdornin bashkë me fqinjët, si një markë të përbashkët, lëndinat rreth e rrotull. Pjesa ku Taciti flet për këmbimin e tokës së punueshme duhet marrë atëherë me të vërtetë në kuptimin agronomik: komuna punonte çdo vit një copë tjetër, dhe tokën që kishte punuar një vit më parë e linte të pushonte ose e linte fare djerr. Me një popullsi të rrallë mbeteshin gjithnjë mjaft lëndina të lira, kështu që grindjet për tokë ishin të kota. Vetëm pas një shekulli; kur numri i anëtarëve të komunave shtëpiake u shtua aq tepër, saqë në kushtet e atëhershme të prodhimit nuk mund të mbahej më një ekonomi e përbashkët, këto komuna u ndanë; arat dhe livadhet që deri atëherë kishin qenë të përbashkëta, tani filluan të ndaheshin, ashtu siç dihet, midis ekonomive shtëpiake të veçanta, që lindën në këtë kohë, në fillim përkohësisht, më vonë — përgjithnjë, kurse pyjet, kullostat dhe ujërat mbetën të përbashkëta.

Për Rusinë ky zhvillim nga pikëpamja historike na duket se është provuar plotësisht. Sa për Gjermaninë dhe, në radhë të dytë, për vendet e tjera gjermanike, nuk mund të mohojmë se kjo hipotezë nga shumë pikëpamje i shpjegon më mirë burimet dhe i zgjidh më lehtë vështirësitë se sa pikëpamja që ka sunduar deri më sot, sipas së cilës ekzistenca e komunës fshatare arritka deri në kohën e Tacitit. Dokumentat më të vjetër, si për shembull Codex Laureshamensis²⁵⁴, përgjithësisht shpjegohen shumë më mirë me anën e komunës shtëpiake se sa me komunën-markë fshatare. Nga ana tjetër, ky shpjegim, nga ana e vet, krijon vështirësi të reja dhe ngre probleme të reja, që mbeten ende për t'u zgjidhur. Këtu vetëm studime të reja mund të shpien në një zgjidhje përfundimtare; megjithatë, unë nuk mund të mohoj se komuna shtëpiake, si një shkallë e ndërmjeme, ka shumë të ngjarë të

ketë ekzistuar edhe në Gjermani, në Skandinavi dhe në Angli.

Ndërsa te Cezari gjermanët pjesërisht sapo ishin vendosur, dhe pjesërisht kërkonin një vend për t'u vendosur përgjithnjë, në kohën e Tacitit ata kishin një shekull të tërë që ishin vendosur në një vend; në përputhje me këtë kemi pa dyshim një progres në prodhimin e mjeteve të jetesës. Ata rrojnë në shtëpi me trarë, veshja e tyre është ende shumë primitive, është veshja e banorëve të pyjeve; gunë e leshtë, lëkurë bishe; gratë dhe paria mbanin të linta. Ushqimi i tyre është qumështi, mishi, pemët e egra dhe, siç shton Plini, qulli i thekrës²⁵⁵ (edhe sot e kësaj dite është një gjellë kombëtare kelte në Irlandë dhe në Skoci). Pasuria e tyre ishte gjëja e gjallë, por e një race të keqe: gjedhët ishin të vegjël, të shëmtuar, pa brirë; kuajt ishin të vegjël dhe vraponin keq. Paraja përdorej rrallë e pak, dhe vetëm paraja romake. Floririn dhe argjendin ata nuk e punonin dhe as që e çmonin; hekuri gjendej rrallë dhe, të paktën, te fiset e Rinit dhe të Danubit, duket se importohej pothuajse krejt dhe nuk nxirrej në vend. Shkronjat runike* (që imitonin shkronjat greke ose latine) njiheshin vetëm si shkrim i fshehtë dhe përdroreshin vetëm për magji fetare. Bëheshin ende njerëz fli. Me një fjalë, këtu kemi një popull që sapo ka kaluar nga shkalla e mesme e barbarisë në shkallën e lartë. Por ndërsa te fiset që kufizonin drejtpërdrejt me romakët zhvillimi i pavarur i prodhimeve metalike dhe tekstile u pengua nga lehtësia e importimit të produkteve të industrisë romake, në Verilindje, në bregun e detit Balltik, ky prodhim ishte zhvilluar me siguri. Armët — shpatë e hekurt dhe e gjatë, parzmorë, kaskë e argjendë etj. — që u

* Shkronjat runike — geramat e alfabetit të vjetër të gjermanëve dhe të skandinavëve. *Red. Përkth.*

gjetën në kënetat e Shlezvigut bashkë me monedha romake të fundit të shekullit II, si edhe sendet metalike gjermane, që u përhapën në saje të dyndjes së popujve, janë produkte të një arti mjaft të zhvilluar dhe fare origjinal edhe në ato raste kur imitojnë në fillim modelet romake. Shpërngulja në Perandorinë e qytetëruar Romake i dha fund kudo kësaj industrie vendase, me përjashtim të Anglisë. Se sa uniform ka qenë ky prodhim në lindjen dhe në zhvillimin e tij, duket, për shembull, nga kopsat prej bronci; kopsat që janë gjetur në Burgundi, në Rumani, në bregun e detit Azov mund të kishin dalë, si edhe kopsat angleze dhe suedeze, nga po ajo punishte, dhe nuk ka dyshim se ato kanë origjinë gjermane.

Shkallës së lartë të barbarisë i përgjigjet edhe organizimi i qeverimit. Sipas Tacitit, kudo kishte një këshill pleqsh (principes), që zgjidhte punë të vogla, dhe punët më me rëndësi i pregatiste që të zgjidheshin nga kuvendi i popullit; ky i fundit në shkallën e ulët të barbarisë, të paktën atje ku e njohim, të amerikanët, ekzistonte vetëm për gjininë, por jo për fisin ose për bashkimin e fiseve. Pleqtë gjithnjë dallohen shumë nga prijësit ushtarakë (duces), krejt si të irokezët. Të parët rrojnë tani pjesërisht me dhurata ndëri, si gjë e gjallë, drithë etj., që u sjellin anëtarët e fisit; ata zgjidhen, si në Amerikë, në pjesën më të madhe nga e njëjta familje; kalimi në të drejtën atërore favorizon, si në Greqi dhe në Romë, shndërrimin e ngadalshëm të parimit të zgjedhjes në të drejtë trashëgimore, duke favorizuar kështu lindjen e një familjeje aristokrate në çdo gjini. Kjo aristokraci e lashtë, e ashtuquajtura aristokraci fisnore, u zhduk në shumicën më të madhe në kohën e dyndjeve të popujve ose menjëherë pas këtyre. Prijësit ushtarakë zgjidheshin, pavarësisht nga origjina e tyre, vetëm sipas zotësisë. Ata kishin pushtet të vogël dhe duhej të tërhiqnin të

tjerët me shembullin e vet; Taciti thotë shprehimisht se në ushtri pushtetin disiplinor në kuptimin e vërtetë e kishin priftërinjtë. Pushteti i vërtetë ishte përqëndruar në duart e kuvendit të popullit. Kryeson mbreti ose plakut i fisit; populli vendos: *jo* — me të murmuritur, *po* — duke brohoritur dhe duke përpjekur armët. Kuvendi i popullit është njëkohësisht edhe gjyq; këtu paraqiten dhe zgjidhen ankimet, këtu jepen dënimet me vdekje, dhe ky dënim jepej vetëm kundër burracakëve, tradhëtarëve dhe atyre që kishin vese kundër natyrës. Në gjinitë dhe në nëndarjet e tjera gjyqin e bën gjithë kolektivi nën kryesinë e plakut, i cili, si edhe në gjithë gjyqet e hershme gjermane, ishte vetëm udhëheqës i procesit dhe mund të bënte vetëm pyetje; te gjermanët gjithnjë dhe kudo vendimin e jep-te gjithë kolektivi.

Që nga koha e Cezarit ishin formuar bashkime fisheshe; disa prej tyre kishin dhe mbretër; prijësi ushtarak më i lartë, si edhe te grekët dhe te romakët, përpiquej të vendoste tiraninë dhe nganjëherë ia arrinte qëllimit. Këta uzurpatorë fatlumë, megjithatë, nuk ishin aspak sundimtarë absolutë; por ata tani fillonin të thyenin zinxhirët e rendit gjinor. Ndërsa më parë skllëverit e lënë të lirë përgjithësisht kishin një pozitë të ulët, sepse ata nuk mund të bënin pjesë në asnjë gjini, tani skllëverit favoritë të mbretërve të rinj shpesh arrinin të kishin pozita të larta, pasuri dhe nder. Po kjo gjë ndodhi pas pushtimit të Perandorisë Romake dhe prijësit ushtarakë, që tani janë bërë mbretër në vende të mëdha. Te frankët skllëverit dhe skllëverit e liruar të mbretit luanin një rol të madh në fillim në oborrin e mbretit, dhe pastaj në shtet; një pjesë e madhe e aristokracisë së re ka rrjedhur prej tyre.

Një institucion që ndihmoi lindjen e pushtetit të mbretit ishte çeta. Ne pamë te lëkurëkuqtë e Amerikës se krahas me rendin gjinor krijohen bashkime të

veçanta që luftojnë për llogari të vet. Këto bashkime të veçanta të gjermanët u bënë me kohë lidhje të përhershme. Një prijës ushtarak, që kishte fituar famë, mblihte rreth vetes një grup të rinjsh që kishin lakmi për plaçkë; këta duhej të ishin besnikë kundrejt personit të tij, ashtu si edhe ai kundrejt tyre. Prijësi i mbante me ushqim dhe u jepte dhurata, caktonte një farë hierarkie midis tyre; për ekspedita të vogla ata i shërbenin si gardë personale që ishte kurdoherë gati për luftë, për ekspedita më të mëdha kishte një trup oficerësh të gatshëm. Sado të dobëta që të ishin këto çeta dhe sado të dobëta u treguan me të vërtetë, më vonë, për shembull, të Odoakri në Itali, megjithatë në ato kemi embrionin e prishjes së lirisë popullore të vjetër, dhe pikërisht këtë rol ato kanë lojtur në kohën e dyndjeve të popujve dhe pas tyre. Sepse, së pari, ato ndihmuan lindjen e pushtetit të mbretit; së dyti, siç thotë Taciti, ato mund të mbaheshin si një e tërë e organizuar vetëm me luftëra të përhershme dhe me ekspedita për grabitje. Grabitja u bë një qëllim. Në qoftë se udhëheqësi i çetës nuk kishte ç'të bënte në vendet rreth e rrotull, ai shkante me njerëzit e vet të popuj të tjerë, ku bëhej luftë dhe mund të bënin plaçkë; trupat ndihmëse gjermane, që luftonin me masa të mëdha nën flamurin romak, madje edhe kundër gjermanëve, ishin formuar pjesërisht nga të tilla çeta. Sistemi i mercenarëve, që është një turp dhe një mallëkim i gjermanëve, ishte shfaqur këtu tani në formën e vet të parë. Pas pushtimit të Perandorisë Romake këta luftëtarë të mbretërve formuan, bashkë me shërbëtorët e oborrit, që vinin nga radhët e njerëzve jo të lirë dhe nga romakët, pjesën e dytë kryesore të aristokracisë së mëvonshme.

Kështu, përgjithësisht, fiset gjermane të bashkuara në popuj kishin po atë organizim qeverimi që kishin grekët e epokës heroike dhe romakët e epokës

së të ashtuquajturve mbretër: kuvendin e popullit, këshillin e pleqve të gjinive dhe prijësin ushtarak, që tani përpiqet të ketë një pushtet mbretëror të vërtetë. Ky ishte organizimi më i zhvilluar i qeverimit, që mund të bëhej në kushtet e rendit gjinor; ky ishte një organizim qeverimi shembullor i shkallës së lartë të barbarisë. Sapo që shoqëria doli jashtë kufijve, brenda të cilëve ky organizim qeverimi e përmbushte misionin e vet, mori fund edhe rendi gjinor; ai u përmbys dhe vendin e tij e zuri shteti.

VIII

FORMIMI I SHTETIT TË GJERMANËVE

Gjermanët, sipas Tacitit, ishin një popull shumë i madh në numër. Një ide të përafërt mbi numrin e popujve të ndryshëm gjermanë na e jep Cezari; ai thotë se numri i uzipetëve dhe i tenkterëve, që u shfaqën në bregun e majtë të Rinit, ishte 180 000 frymë, bashkë me gratë dhe me fëmijët. Pra, afro 100 000 frymë për çdo popull më vete*, që është shumë më tepër se, për shembull, numri i përgjithshëm i irokezëve në periudhën e lulëzimit të tyre, kur ata, duke qenë më pak se 20 000 frymë, u bënë tmerri i gjithë vendit, që nga Liqenjtë e mëdhenj deri në Ohajo dhe në Potomak.

* Shifra që jepet këtu vërtetohet në një vend nga Diodori, ku flet për keltët e Galisë: „Në Gali rrojnë shumë popullsi që kanë një numër të ndryshëm. Më të mëdhatë arrijnë afërsisht deri në 200 000 frymë, dhe më të voglat — 50 000” (Diodorus Siculus, V, 25). Pra, mesatarisht — 125 000; popujt e ndryshëm galë, për shkak të shkallës së zhvillimit të tyre më të lartë, duhen konsideruar patjetër pak më të mëdhenj se ata gjermanë.

Po të duam të shënojmë në hartë se si ishin vendosur popujt më të njohur që rrinin afër Rinit, sipas tregimeve që kanë ardhur deri te ne, atëherë do të shohim se çdo popull prej tyre më vete zë mesatarisht territorin e një rrethi administrativ prusian, d.m.th. afro 10 000 kilometra katrorë ose 182 milje gjeografike katrore. Por Germania Magna* e romakëve, deri në Vistula, përmbledh në shifra të rrumbullakta 500 000 kilometra katrorë. Me 100 000 frymë si mesatare për çdo popull numri i përgjithshëm i popullsisë së Germania Magna duhej të arrinte deri në pesë milion; kjo shifër e madhe për popujt barbarë; për kushtet tona — dhjetë frymë për një kilometër katror, ose 550 për një milje gjeografike katrore, është shumë e vogël. Por me këtë nuk mbaron aspak numri i gjermanëve që rronin në atë kohë. Ne dimë se gjatë Karpateve deri në grykën e Danubit rronin popuj gjermanë të grupit të fiseve gotike — bastarnët, peukinët dhe të tjerë, që ishin aq të shumtë, sa që Plini i quante si grupi i pestë kryesor i fiseve gjermane²⁵⁶; këto fise që 180 vjet para erës sonë u bënë mercenarë në shërbim të mbretit të Maqedonisë, Perseut, në vjetët e parë të mbretërisë së Augustit u futën deri në rrethet e Adrianopolit. Po ta caktojmë numrin e tyre vetëm në një milion, atëherë ka të ngjarë që numri i gjermanëve në fillim të erës sonë të ketë qenë, të paktën, gjashtë milion.

Pasi u vendosën në Gjermani, popullsia e tyre duhet të jetë shtuar me një shpejtësi gjithnjë më të madhe; vetëm përparimet që përmendëm më sipër në fushën e prodhimit mund ta provojnë këtë gjë. Zbulimet që janë bërë në kënetat e Shlezvigut, po të marrim parasysh monedhat romake që janë gjetur aty, janë të shekullit III. Kështu, në këtë kohë në bregun e detit Balltik ishte zhvilluar gjerësisht prodhimi i me-

* Germania e Madhe, *Red.*

taleve dhe i sendeve tekstile, kishte një tregëti të gjallë me Perandorinë Romake dhe më të pasurit jetonin në një farë luksi — të gjitha këto tregojnë se ka pasur një popullsi më të dendur. Afërsisht në këtë kohë fillon sulmi i përgjithshëm i gjermanëve në gjithë vijën e Rinit, të kufirit të fortifikuar romak dhe të Danubit, nga Deti i Veriut deri te Deti i Zi, që është një provë e drejtpërdrejtë se popullsia e gjermanëve, që përpiquej të zgjeronte kufijtë e vet, shtohet gjithnjë më tepër. Treqind vjet zgjati lufta, gjatë së cilës pjesa më e madhe e popujve gotikë (përveç gotëve skandinavë dhe burgundëve) u drejtuan për në Juglindje dhe formuan krahun e majtë të një vije të gjatë ofensive, në qendrën e së cilës gjermanët e epërm (herminonët) u futën në Danubin e Sipërm, dhe në krahun e djathtë iskevonët, që tani quheshin frankë — u futën në Rin; Britania u pushtua nga ingevonët. Në fund të shekullit V për gjermanët ishte hapur rruga për të hyrë në Perandorinë Romake, që ishte dobësuar dhe kishte mbetur pa gjak e pa fuqi.

Më sipër ne qëndruam pranë djepit të qytetërimit të vjetër grek dhe romak. Tani jemi pranë varrit të tij. Zdrukthi rrafshues i sundimit romak mbi botën kishte shkuar shekuj me radhë mbi të gjitha vendet e pellgut të Mesdheut. Atje ku gjuha greke nuk bënte rezistencë, të gjitha gjuhët kombëtare duhej t'i lëshonin vendin një latinishteje të prishur, u zhdukën të gjitha dallimet kombëtare, nuk kishte më galë, iberë, ligurë, norike²⁵⁷ — të gjithë ata u bënë romakë. Qeverimi romak dhe e drejta romake i zhdukën kudo bashkimet e lashta gjinore, dhe krahas tyre edhe mbeturinat e fundit të pavarësisë lokale dhe kombëtare. Qytetaria romake e re nuk jepte asgjë në vend të kësaj; ajo nuk shprehte asnjë kombësi, por ishte vetëm shprehja e mungesës së kombësisë. Kudo gjendeshin elementet e kombësive të reja; dialektet latine të pro-

vincave të ndryshme largoheshin gjithnjë më tepër midis tyre; kufijtë e natyrshëm, që i kishin bërë njëherë Italinë, Galinë, Spanjën, Afrikën krahina më vete, ekzistonin ende dhe ndjehej prania e tyre. Por nuk kishte asgjëkundi një forcë që t'i bashkonte këto elemente në kombe të reja; nuk kishte ende asgjëkundi një gjurmë zotësie për zhvillimin, asnjë forcë rezistence, pa le që energji krijuese nuk kishte fare. Për shumicën e madhe të njerëzve që jetonin në një territor shumë të madh e vetmja lidhje që i bashkonte ishte shteti romak, por ky me kohë ishte bërë armiku dhe shtypësi më i keq i tyre. Provincat e shkatërruan Romën; Roma vetë u kthye në një qytet provincial si gjithë të tjerat, një qytet i privilegjuar, por jo më një qytet sundues, një qytet që nuk ishte më qendra e një perandorie të përbotshme, që s'ishte më as selia e perandorëve dhe e mëkëmbësve të tyre, të cilët tani rronin në Konstantinopol, në Trir, në Milano. Shteti romak ishte bërë një maqinë e ndërlikuar gjigante, që shërbente vetëm për të shtrydhur shtetasit. Taksat, detyrimet shtetërore dhe rekuizimet e ndryshme e zhytnin popullsinë në një varfëri gjithnjë më të madhe; këtë zgjedhë e forconte dhe e bënte të padurueshme lakmia e pangopur e mëkëmbësve, të tagrambledhësve, e ushtarëve. Ja deri ku arriti shteti romak dhe sundimi i tij mbi botën: ai e bazonte të drejtën e ekzistencës së vet në mbajtjen e rregullit brenda dhe në mbrojtjen nga jashtë kundër barbarëve; por rregulli i tij ishte më keq se çdo çrregullim, dhe barbarët, nga të cilët shteti romak thoshte gjoja se i mbronte qytetarët, priteshin nga këta të fundit si shpëtimtarë.

Gjendja e shoqërisë nuk ishte më pak e dëshpëruar. Duke filluar që nga kohët e fundit të republikës, sundimi romak bazohej në një shfrytëzim të pamëshirshëm të provincave të pushtuara; perandoria jo vetëm që nuk e zhduku këtë shfrytëzim, por, përku-

ndrazi, e ngriti në sistem. Sa më tepër që shkante tatëpjetë perandoria, aq më tepër shtoheshin taksat dhe detyrimet, aq më të patundshme bëheshin grabitjet dhe lakmia e pangopur e nëpunësve. Tregëtia dhe industria kurrë nuk kishin qenë një punë e romakëve që sundonin mbi popujt; vetëm në punën e fajdesë ata kapërcyen çdo gjë që kishte qenë përpara tyre dhe pas tyre. Ajo që ata kishin gjetur dhe që kishte mbetur nga tregëtia u zhduk nga lakmia e pangopur e nëpunësve; ajo që mundi të shpëtonte gjendej në pjesën lindore greke të perandorisë, që nuk hyn në rrethin e studimit tonë. Një varfërim i përgjithshëm, rënia e tregëtisë, e zejtarisë dhe e artit, pakësimi i popullsisë, shkretimi i qyteteve, zbritja e bujqësisë në shkallën më të ulët — ky ishte rezultati i fundit i sundimit të përbotshëm të Romës.

Bujqësia, dega vendimtare e prodhimit në gjithë botën e lashtë, tani mori përsëri, më tepër se kurrë, një rëndësi të tillë. Në Itali grumbuj shumë të mëdhenj pronash tokësore (latifundet), të cilat pas rënies së republikës zinin pothuajse gjithë territorin, ishin përdorur në dy mënyra: ose për kullotë, ku popullsia ishte zëvendësuar me dhen e me qe, mbikëqyrja e të cilëve kërkonte vetëm një numër të vogël skllëvërish; ose si vila*, ku një shumicë e madhe skllëvërish merreshin me kopshtari në shkallë të gjerë — pjesërisht për të kënaqur nevojat e pronarëve të tyre, që jetonin në luks, pjesërisht për të shitur në tregjet e qyteteve. Kullotat e mëdha mbetën dhe madje u zgjeruan; pronat tokësore-vila dhe kopshtaria kishin marrë tatëpjetën bashkë me varfërimin e pronarëve të tyre dhe me shkretimin e qyteteve. Ekonomia e latifundeve, që ishte bazuar në punën e skllavit, nuk sillte më të ardhura; por në këtë kohë ajo ishte e vetmja

* Vila — çiflik i romakëve të vjetër. *Red. Përkth.*

formë e mundshme për një ekonomi të madhe bujqësore. Ekonomia e vogël u bë përsëri e vetmja formë e bujqësisë që sillte fitime. Njëra pas tjetrës vilat u ndanë në parcela të vogla, të cilat u jepeshin qiramarrësve, që mund t'i trashëgonin brez pas brezi për një shumë të caktuar, ose ato i merrnin partiarit, të cilët ishin më tepër administratorë se sa qiramarrës, dhe merrnin për punën e vet një të gjashtën dhe nganjëherë vetëm një të nëntën e produktit. Por këto parcela të vogla ua jepnin më shumë kolonëve, që paguan çdo vit një shumë të caktuar, ishin të lidhur me tokën dhe mund të shiteshin bashkë me gjithë parcelën; është e vërtetë se ata nuk ishin skllëvër, por nuk ishin as edhe të lirë, nuk mund të martoheshin me të lirë, dhe martesat midis tyre nuk quheshin të ligjshme, por konsideroheshin, si martesat e skllëvërve, një bashkëjetesë e thjeshtë (contubernium). Ata ishin paraardhësit e bujkrobëve të kohës së mesme.

Skllavërisë antike i kaloi koha. As në bujqësinë e madhe as në manufakturat e qyteteve ajo nuk sillte më të ardhura që t'ia vlenin mundimin, — tregu për produktet e saj u zhduk. Kurse në bujqësinë e vogël dhe në zejtarinë e vogël, që zëvendësonte tani prodhimin shumë të madh të kohës së lulëzimit të perandorisë, nuk kishte vend për një numër të madh skllëvërisht. Vetëm për skllëvërit që shërbenin në ekonomitë shtëpiake dhe për jetën luksoze të të pasurve kishte ende vend në shoqëri. Por skllavëria, që po shuhej, ishte ende në gjendje të impononte mendimin se çdo punë prodhuese ishte si punë skllavi, si një punë që nuk u kishte hije romakëve të lirë, siç ishin tani që të gjithë. Si rezultat, nga njëra anë, — u shtua numri i skllëvërve të lënë të lirë, që ishin të tepërt dhe që u bënë një barrë, dhe, nga ana tjetër, — u shtua numri i kolonëve dhe i të lirëve të varfëruar (që na kujtojnë

poor whites* të ish-shteteve skllavopronare të Amerikës). Krishterimi nuk është aspak fajtor për zhdukjen e ngadalshme të skllavërisë antike. Ai shekuj me radhë e pranoj skllavërinë në Perandorinë Romake dhe më vonë kurrë nuk i ka penguar të krishterët që të bëjnë tregëtinë e skllavëve: as gjermanët në Veri as venedikasit në detin e Mesdheut, dhe as që ka penguar më vonë tregëtinë e zezakëve**. Skllavëria nuk jepte më fitim dhe prandaj u zhduk. Por skllavëria në vdekje e sipër la pas thumbin e vet me helm: përbuzjen e punës prodhuese nga ana e njerëzve të lirë. Bota romake hyri në një qorrrokak: skllavëria po bëhej nga pikëpamja ekonomike një gjë e pamundshme, puna e të lirëve nga pikëpamja morale, përbuzej. E para nuk kishte më fuqi, e dyta nuk mund të bëhej ende forma kryesore e prodhimit shoqëror. Nga kjo situatë mund të dilej vetëm me një revolucion rrënjësor.

Në provincat gjendja nuk ishte më e mirë. Më shumë njoftime kemi për Galinë. Këtu bashkë me kolonët kishte ende fshatarë të vegjël që ishin të lirë. Për t'u siguruar nga dhuna e nëpunësve, e gjykatësve dhe e fajdexhinjve, ata shpesh kërkonin mbrojtjen, patronazhin e një njeriu të fuqishëm; kështu bënë jo vetëm fshatarët veç e veç, por edhe komuna të tëra, saqë perandorët në shekullin IV shumë herë nxirrnin edikte që e ndalonin këtë gjë. Por ç'u jepte kjo atyre që kërkonin ndihmë? Patroni u vinte si kusht që ata t'i jepnin të drejtën e pronës mbi tokat e tyre, dhe ai si shpërblim u siguronte këtyre përdorimin e kësaj toke përjetë. Këtë marifet e mësoi edhe kisha e shenjtë,

* të bardhët e varfër. *Red.*

** Sipas fjalëve të peshkopit Liutprand nga Kremona, në shekullin X në Verdun, pra, në Perandorinë e shenjtë Gjermane, dega kryesore e industrisë ishte fabrikimi i eunukëve, të cilët eksportoheshin me fitime të mëdha në Spanjë për haremet arabe²⁵⁸.

që e përdori me zell në shekujt IX dhe X për të zgjeruar mbretërinë e zotit dhe çifliqet e veta. Është e vërtetë se aty nga viti 475 peshkopi Salvian nga Marseja revoltohet kundër një grabitjeje të tillë dhe thotë se zgjedha e nëpunësve romakë dhe e pronarëve të mëdhenj të tokës është bërë aq e padurueshme, saqë shumë „romakë” ikin në vendet e pushtuara nga barbarët dhe se qytetarët romakë, që vendosen atje, nga asgjë tjetër nuk kanë frikë më tepër se sa mos bien përsëri nën sundimin romak²⁵⁹. Që prindërit në atë kohë për shkak të varfërisë i shisnin shpeshherë fëmijët e vet si skllavër, provohet nga një ligj që u shpall kundër këtij zakoni.

Barbarët gjermanë, si shpërblim për lirimën e romakëve nga shteti i tyre, u muarën dy të tretat e gjithë tokës dhe e ndanë midis tyre. Ndarja bëhej sipas rregullave të rendit gjinor; nga shkakut i numrit relativisht të vogël të pushtuesve, toka shumë të gjera mbeteshin pa u ndarë, pjesërisht si pasuri e gjithë popullit, pjesërisht si pasuri e fiseve dhe e gjinive të veçanta. Brenda çdo gjinie arat dhe livadhet ndaheshin me short midis ekonomive individuale në pjesë të barabarta; ne nuk dimë nëse janë bërë më vonë ndarje të tjera, sidoqoftë ato pas pak kohe nuk u bënë më në provincat romake dhe disa prej tyre u bënë pronë private që mund të shitej — alod. Pyjet dhe kullotat mbetën të pandara, i përdornin të gjithë së bashku; ky përdorim i përbashkët i tyre, si edhe mënyra e punimit të arave të ndara rregulloheshin sipas zakonit të vjetër dhe sipas vendimeve të gjithë komunës. Sa më tepër rronte gjinia në fshatin e vet dhe sa më tepër përziheshin pak e nga pak gjermanët dhe romakët, aq më tepër lidhjet e gjakut humbisnin rëndësinë përpara lidhjeve territoriale; gjinia u shkri në komunën-markë, ku mjaft shpesh duken ende gjurmët e origjinës së saj nga afëria e anëtarëve të komunës. Kështu

në mënyrë të padukshme, të paktën në ato vende ku qëndroi komuna-markë — në veri të Francës, në Angli, në Gjermani dhe në Skandinavi, — organizimi gjinor u ndërrua në një organizim territorial dhe prandaj ishte tani në gjendje që t'i përshtatej shtetit. Po ky organizim, megjithatë, e ruajti karakterin e vet demokratik, që ishte formuar vetiu dhe që dallonte gjithë rendin gjinor, madje edhe në atë trajtë të degjeneruar, që iu imponua më vonë, mbeten gjurmët e tij, që u bënë në duart e të shtypurve një armë që ka mbetur deri më sot.

Kështu, në qoftë se lidhja e gjakut në gjini e humbi shpejt rëndësinë e vet, kjo ngjau sepse në fisin dhe në gjithë popullin organet e tij gjithashtu u degjeneruan si pasojë e pushtimit. Ne e dimë se sundimi mbi të nënshtuarit nuk pajtohet me rendin gjinor. Këtu ne e shohim këtë në një shkallë të gjerë. Popujt gjermanë, që u bënë zotër të provincave romake, duhej të organizonin qeverimin e territoreve të pushtuara prej tyre. Por ata as nuk mund t'i futnin masat romake në bashkimet gjinore, as që mund t'i sundonin me anën e këtyre të fundit. Në krye të organeve lokale romake të qeverimit, që në fillim në pjesën më të madhe vazhdonin të ekzistonin gjithnjë, duhej vënë në vend të shtetit romak një pushtet tjetër, dhe ky mund të ishte vetëm një tjetër shtet. Prandaj organet e rendit gjinor duhej të shndërroheshin në organe shteti dhe, të shtyrë nga rrethanat, u shndërruan shumë shpejt. Por përfaqësuesi më i afërt i popullit pushtues ishte prijës ushtarak. Mbrojtja e krahinës së pushtuar nga rreziku i brendshëm dhe i jashtëm kërkonte forcimin e pushtetit të tij. Erdhi koha që pushteti i prijësit ushtarak të bëhej pushtet mbretëror, dhe kjo gjë u bë.

Të ndalemi në mbretërinë e frankëve. Këtu populli fitimtar i frankëve salikë shtiu plotësisht në dorë

jo vetëm pronat e gjera të shtetit romak, por edhe gjithë tokat e gjera që nuk ishin ndarë ende midis komunave të rretheve të mëdha dhe të vogla [Gau] dhe të komunave-marka, — veçanërisht të gjitha pyjet e mëdha. Puna e parë që bëri mbreti i frankëve, i cili nga prijës i thjeshtë ushtarak më i lartë u bë një monark i vërtetë, ishte se ai e bëri këtë pasuri të popullit një pasuri të mbretit, ia vodhi popullit dhe ia ndau si dhuratë ose ia dorëzoi çetës së vet. Kjo çetë, e cila në fillim përbëhej nga garda e tij ushtarake personale dhe nga prijës ushtarakë të tjerë më të ulët, u zmadhua shpejt jo vetëm me romakë, d.m.th. me galë të romanizuar, të cilët u bënë shpejt të domosdoshëm për të, sepse dinin të shkruanin, kishin kulturë, dinin gjuhën e folur romake të vendit dhe gjuhën letrare latine, si edhe të drejtën e vendit; ajo u mbush gjithashtu edhe me skllëvër, me bujkrobër dhe me skllëvër të lënë të lirë, të cilët përbënin personelin e oborrit të tij dhe prej të cilëve ai zgjidhte favoritët e vet. Të gjithë këta merrnin tokat e popullit, më parë në pjesën më të madhe i merrnin si dhurata, më vonë në formë beneficësh,²⁶⁰ dhe në fillim, zakonisht, për gjithë kohën sa rronte mbreti; kështu në kurriz të popullit po krijohet baza e një aristokracie të re.

Por puna nuk mbaroi me kaq. Një shtet kaq i madh nuk mund të qeverisej me mjetet e rendit të vjetër gjinor; këshilli i pleqve, kur nuk ishte zhdukur me kohë, nuk mund të mblidhej dhe shpejt u zëvendësua me rrethin e përhershëm të mbretit; kuvendi i vjetër i popullit u ruajt ende vetëm sa për sy e faqe, por edhe ky u bë gjithnjë më tepër vetëm një kuvend i prijësve ushtarakë të nënshtruar ndaj mbretit dhe i aristokracisë së re që kishte lindur. Fshatarët e lirë, që kishin tokë dhe që përbënin shumicën e popullit frank, ishin katandisur keq nga luftërat e përhershme midis tyre dhe nga luftërat për pushtim, sidomos në

kohën e Karlit të Madh, pikërisht ashtu si fshatarët romakë në kohën e fundit të republikës. Këta fshatarë, të cilët në fillim përbënin gjithë ushtrinë dhe pas pushtimit të tokës së Francës bërthamën e saj kryesore, në fillim të shekullit IX ishin varfëruar aq tepër, saqë edhe një e pesta e fshatarëve mezi ishte në gjendje të merrte pjesë në ekspedita. Vendin e fshatarëve të lirë, që ngriheshin kur i thërriste vetë mbreti, e zuri një ushtri, të cilën e përbënin njerëz të shërbimit ushtarak nga aristokracia e re, si edhe fshatarë të varur, pasardhësit e atyre që më parë nuk njihnin zot tjetër përveç mbretit, dhe që qysh më parë përgjithësisht nuk njihnin asnjë zot, as edhe mbretin. Në kohën e pasardhësve të Karlit shtresa e fshatarëve frankë u shkatërrua deri në fund nga luftërat e brendshme, nga dobësia e pushtetit të mbretit dhe nga uzurpimet e partisë, të cilëve u ishin shtuar dhe kontët e distriktive të emëruar prej Karlit²⁶¹, që përpiqeshin t'i bënin detyrat e veta të trashëgueshme, dhe, më në fund, nga sulmet e normanëve. Pesëdhjetë vjet pas vdekjes së Karlit të Madh Mbretëria e frankëve shtrihej nën këmbët e normanëve aq e pafuqishme, sa edhe Perandoria Romake nën këmbët e frankëve katër shekuj përpara.

Dhe jo vetëm dobësia përpara armiqve të jashtëm, por edhe rregulli ose, më mirë të themi, çrregulli i brendshëm shoqëror ishte thujse po ashtu. Fshatarët e lirë frankë u katandisën po në atë gjendje që ishin katandisur paraardhësit e tyre, kolonët romakë. Të rrënuar nga luftërat dhe nga grabitjet, ata u shtërnguan të kërkonin mbrojtjen e aristokracisë së re ose të kishës, sepse pushteti i mbretërve ishte tepër i dobët që t'i mbronje; por këtë mbrojtje ata u shtërnguan ta blenin shtrenjtë. Ashtu si edhe më parë fshatarët e Galisë, ata u shtërnguan t'i jepnin mbrojtësit të drejtën e pronës mbi tokën e tyre, të cilën e merr-

nin përsëri me qira me kushte të ndryshme dhe jo të qëndrueshme, por gjithnjë duke plotësuar detyrimet dhe duke paguar teloznën; pasi ranë në një varësi të tillë, ata pak e nga pak humbën edhe lirinë e vet personale; pas disa brezash ata u bënë, në shumicën e tyre; bujkrobër. Se sa shpejt u zhduk shtresa e fshatarëve të lirë, duket nga libri i pronave të tokës të abacisë* Sen-Zhermen-de-Pre, që atëherë ndodhej afër Parisit dhe që sot është brenda në Paris, i hartuar nga Irminoni²⁶². Në pronat e tjera të kësaj abacie, të përhapura rreth e rrotull, kishte atëherë, kur rronte Karli i Madh, 2 788 ekonomi, që ishin pothuajse vetëm frankësh me emra gjermanë. Dhe ndër këta kishte 2 080 kolonë, 35 litë, 220 skillevër dhe vetëm 8 banorë të lirë! Zakoni, që Salviani e kishte shpallur si një zakon kundër zotit, sipas të cilit mbrojtësi e detyronte fshatarin që t'i jepte të drejtën e pronës mbi tokën e tij dhe pastaj ia jepte këtë tokë fshatarit, që ta përdorte vetëm sa ishte gjallë, tani praktikohet kudo prej kishës kundrejt fshatarëve. Angaritë, që tani po bëheshin gjithnjë më tepër një gjë e zakonshme, kishin si prototip të tyre angaritë e romakëve, punët e detyrueshme në dobi të shtetit²⁶³, qoftë edhe detyrimet që kryenin anëtarët e komunës-markë gjermane për të ndërtuar ura, rrugë dhe për qëllime të tjera të përgjithshme. Kështu, masa e popullsisë pas katërqind vjetësh, siç duket, u kihye prapë në pikën e nisjes.

Por kjo vetëm provonte, së pari, se diferencimi dhe ndarja shoqërore e pronës në Perandorinë Romake të kohës së rënies i përgjigjej plotësisht nivelit të atëhershëm të prodhimit në bujqësi dhe në industri, pra, ishin të pashmangshme; së dyti, se ky nivel i prodhimit gjatë katërqind vjetëve nuk pati as zbritje as

* *Abaci* — manastir murgjish, që ka në krye një abat.
Red. Përkth.

ngritje me rëndësi, dhe prandaj krijoi medoemos po atë ndarje të pronës dhe po ato klasa të popullsisë. Në shekujt e fundit të ekzistencës së Perandorisë Romake qyteti e humbi sundimin e vet të mëparshëm mbi fshatin dhe nuk e fitoi përsëri këtë sundim në shekujt e parë të sundimit të gjermanëve. Kjo nënkupton një shkallë të ulët zhvillimi si në bujqësi, ashtu dhe në industri. Një gjendje e tillë e përgjithshme krijon medoemos pronarë të mëdhenj të tokës, që kanë pushtetin, dhe fshatarë të vegjël të varur prej tyre. Eksperimentet e shumta që Karli i Madh bëri me vilat e famshme perandorake, por të cilat nuk lanë pothuajse asnjë gjurmë, provojnë se sa pak mundësi kishte për t'i imponuar një shoqërie të tillë ekonomike e latifundeve romake me skllavë, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër — ekonominë e madhe të re me punë angari. Këto eksperimente i vazhduan vetëm manastiret, dhe vetëm atje ato dhanë fryte; mirëpo manastiret ishin organizma shoqërorë anormalë të bazuar në beqarinë; ato mund të jepnin rezultate të jashtëzakonshme, por pikërisht për këtë arsye mbeteshin dhe ato vetë përjashtime.

Dhe megjithatë, gjatë këtyre katërqind vjetëve një përparim u bë. Në qoftë se edhe në fund të periudhës ne gjejmë pothuajse po ato klasa kryesore që kishte edhe në fillim, njerëzit, që i përbënin këto klasa, u bënë të tjerë. U zhduk skllavëria antike, u zhdukën njerëzit e lirë të rënë në mjerim, që e përbuznin punën si një punë skllavi. Midis kolonit romak dhe bujkrobit të ri qëndronte fshatari i lirë frank. „Kujtimet e padobishme dhe lufta e kotë” e botës romake, që kishte marrë tatëpjetën, vdiqën dhe u varrosën. Klasat shoqërore të shekullit IX u formuan jo në batkun e një qytetërimi që kishte marrë të tatëpjetën, që po vdiste, por në mundimet e lindjes së një qytetërimi të ri. Brezi i ri — si zotërinjtë, ashtu edhe shërbë-

torët — në krahësim me paraardhësit e tyre romakë ishte një brez burrash. Marrëdhëniet midis pronarëve të fuqishëm të tokës dhe fshatarëve që vareshin prej tyre, këto marrëdhënie, që në Romë shpënë në shkatërrimin e pashmangshëm të botës antike, u bënë tani pikënisje e një zhvillimi të ri. Dhe pastaj, sado të pafrytshëm që duken këta katërqind vjet, ata lanë një rezultat të madh: kombësitë e sotme, riorganizimin dhe diferencimin e njerëzimit në Evropën Perëndimore për historinë e ardhshme. Gjermanët me të vërtetë e ngjallën përsëri Evropën, dhe për këtë arsye prishja e shteteve, që u bë në periudhën gjermane, nuk mori fund me pushtimin normano-saracin, por me zhvillimin e mëtejshëm të beneficive dhe të marrëdhënieve të ndorjes (komendat)²⁶⁴ në feudalizëm dhe me një shtim aq të madh të popullsisë, sa që s'u deshën më tepër se dyqind vjet për të zëvendësuar humbjet e mëdha të kryqëzatave.

Por ç'ishte ky mjet magjik dhe misterioz, me të cilin gjermanët i dhanë Evropës, që po vdiste, një forcë jetësore të re? Mos ishte kjo një forcë çudibërëse, që e kishte vetiu raca gjermane, siç thotë historiografia jonë shoviniste? Jo, aspak. Gjermanët ishin, sidomos atëherë, një racë ariane me zotësi të madhe dhe, përveç kësaj, jeta e tyre ishte në zhvillim të plotë. Por Evropën e përtërinë jo karakteristikat e veçanta kombëtare të tyre, por vetëm barbaria e tyre, rendi i tyre gjinor.

Zotësia e tyre personale, trimëria e tyre, dashuria e tyre për liri dhe instinkti demokratik, që i nxiste të shihnin në të gjitha çështjet publike punët e veta, — me një fjalë, të gjitha ato cilësi që i kishin humbur romakët dhe vetëm në saje të të cilave mundën të formoheshin nga llumi i botës romake shtete të reja dhe të zhvilloheshin kombësi të reja, — a nuk ishin të gj-

tha këto tiparet karakteristike të barbarit në shkallën e lartë, frytet e rendit të tij gjinor?

Në qoftë se gjermanët e ndryshuan formën anti-ke të monogamisë, e zbutën sundimin e burrit në familje, i dhanë gruas një pozitë më të lartë, që nuk e kishte pasur kurrë në botën klasike, — ç'i bëri ata të aftë për këtë gjë, në mos barbaria e tyre, zakonet e tyre të gjinisë, mbeturinat e tyre ende të gjalla të epokës së të drejtës amtare?

Në qoftë se ata, të paktën në tri vendet më me rëndësi, në Gjermani, në Francën Veriore dhe në Angli; ditën të ruanin dhe të fushnin në shtetin feudal një pjesë të rendit gjinor në formën e komunës-markë dhe i dhanë kështu klasës së shtypur, fshatarëve, edhe në kohën e bujkrobërisë më të rëndë të kohës së mesme, një bashkim lokal dhe një mjet rezistence, që në formë të gatshme nuk i gjetën as skllëverit e vjetër as proletarët e sotëm, — atëherë nga doli kjo, në mos doli nga barbaria e tyre, në mos doli vetëm nga mënyra e vendosjes së tyre me gjini, që është një gjë karakteristike e periudhës së barbarisë?

Dhe, më në fund, në qoftë se ata e zhvilluan dhe e bënë një formë të përgjithshme formën e varësisë që ekzistonte në atdheun e tyre dhe që ishte një formë më e butë, drejt së cilës po shkonte gjithnjë më tepër skllavëria edhe në Perandorinë Romake, — një formë që, siç e vuri re për herë të parë Furjeja²⁶⁵, u jep të robëruarve një mjet për çlirimin e tyre gradual *si klasë* (fournit aux cultivateurs des moyens d'affranchissement collectif et progressif*), — një formë që për këtë arsye qëndronte shumë më lart se skllavëria, ku kishte mundësi të çlirohej menjëherë dhe pa një gjendje kalimi vetëm një person (bota e lashtë

* — u jep bujqve mjetet për çlirimin e tyre kolektiv dhe gradual. Red.

nuk njih zhdukjen e skllavërisë me anë të një krye-
ngritjeje fitimtare), kurse bujkrobërit e kohës së mes-
me në të vërtetë e arritën shkallë-shkallë çlirimin e vet
si klasë, — ç'gjëje ia detyrojmë ne të gjitha këto, në
mos barbarisë së tyre, për hir të së cilës ata nuk e
shpunë këtë varësi deri në një skllavëri të zhvilluar
plotësisht; as deri në formën antike të punës së sklla-
vit, as deri në skllavërinë shtëpiake të Lindjes?

Çdo gjë e gjallë, e fortë dhe e frytshme, që gjer-
manët i shartuan botës romake, i përkiste barbarisë.
Dhe me të vërtetë vetëm barbarët ishin në gjendje të
përtërinin botën e kalbur të një qytetërimi në rënie.
Dhe shkalla e lartë e barbarisë, ku kishin arritur dhe
ishin ngritur gjermanët përpara dyndjes së popujve,
ishte pikërisht shkalla më e përshtatshme për këtë
proces. Kjo i shpjegon të gjitha.

IX

BARBARIA DHE QYTETËRIMI

Deri tani ndoqëm shturjen e rendit gjinor në tre shembuj të mëdhenj veç e veç — te grekët, te romakët dhe te gjermanët. Le të studjojmë, më në fund, kushtet e përgjithshme ekonomike që shkallmuan organizimin gjinor të shoqërisë që në shkallën e lartë të barbarisë dhe që e zhdukën fare me ardhjen e qytetërimit. Këtu „Kapitali” i Marksit do të jetë po aq i domosdoshëm për ne, sa edhe libri i Morganit.

Gjinia, që lindi në shkallën e mesme të egërsisë dhe që vazhdoi të zhvillohej në shkallën e vet të lartë, arrin, me sa mund të gjejmojmë sipas burimeve tona, lulëzimin e vet në shkallën e ulët të barbarisë. Pra, me këtë shkallë të zhvillimit do të fillojmë edhe ne.

Te lëkurëkuqtë e Amerikës, që duhet të na shërbejnë si shembull, gjejmë një rend gjinor që është zhvilluar plotësisht. Fisi ndahej në disa gjini, më shpesh në dy gjini; këto gjini-nëna ndahen secila, me rritjen e popullsisë, në disa gjini-bija, kundrejt të cilave gjinia-nënë luan rolin e një fratrie; vetë fisi nda-

het në disa fise, në secilin prej tyre ne gjejmë përsëri, në pjesën më të madhe, gjinitë e mëparshme; bashkimi përmbledh, të paktën në disa raste, fise të afërme. Kjo organizatë e thjeshtë u përgjigjet plotësisht kushteve shoqërore, prej të cilave ajo lindi. Ajo nuk paraqet gjë tjetër veçse një grupim që rritet vetiu; ajo është në gjendje të zgjidhë të gjitha konfliktet që mund të dalin brenda një shoqërie të organizuar në këtë mënyrë. Konfliktet me botën e jashtme i zhduk lufta; ajo mund të marrë fund me zhdukjen e fisit, por jo me skllavërimin e tij. Madhështia e rendit gjinor, por mjekohësisht edhe karakteri i tij i kufizuar shfaqen në faktin se këtu nuk ka vend për sundim dhe për skllavërim. Brenda rendit gjinor nuk ka asnjë dallim midis të drejtave dhe detyrave; për indianin nuk ekziston pyetja nëse është një e drejtë apo një detyrë të marrë pjesë në punë shoqërore, në marrjen e gjakut ose në larjen e gjakut me para; një pyetje e tillë do t'i dukej atij po aq absurde, sa edhe pyetja: ç'është të ngrënët, gjumi, gjahu — një e drejtë apo një detyrë? Gjithashtu është e pamundur të ndash fisin dhe gjininë në klasa të ndryshme. Dhe kjo na shpie të studjojmë bazën ekonomike të këtij rendi.

Popullsia është shumë e rrallë; ajo është më e dendur vetëm në vendin e banimit të fisit; rreth këtij vendi shtrihet si një brez i gjerë, në radhë të parë, territori i gjahut, pastaj pylli mbrojtës asnjans, që e ndan fisin nga fiset e tjera. Ndarja e punës ka një origjinë thjesht të natyrshme; ajo ekziston vetëm midis sekseve. Burri lufton, vete për gjah dhe peshkon, gjen ushqimin dhe përgatit veglat që duhen për këtë gjë. Gruaja punon në shtëpi dhe merret me përgatitjen e ushqimit dhe të veshjes — gatuan, end, qep. Secili prej tyre është zot në punën e vet: burri — në pyll, gruaja në shtëpi. Secili është pronar i veglave që bën dhe që përdor vetë: burri është pronar i armës, i mje-

teve të gjahut dhe të peshkimit, gruaja është pronare e orendive shtëpiake. Ekonomia shtëpiake është mbi baza komuniste për disa familje dhe shpesh për shumë familje së bashku*. Ajo që bëhet dhe përdoret së bashku, është pronë e përbashkët: shtëpia, kopshti, lundra. Këtu, pra, dhe vetëm këtu, ekziston me të vërtetë „prona e krijuar me punën e vet”, e shpikur nga juristët dhe nga ekonomistët e shoqërisë së qytetëruar, — pretekst i fundit juridik, i gënjeshtërt, mbi të cilin bazohet ende prona e sotme kapitaliste.

Por njerëzit nuk qëndruan kudo në këtë shkallë. Në Azi ata gjetën kafshë që mund të zbuteshin dhe që pastaj mund të rriteshin si kafshë të buta. Femra e buallit të egër duhej gjuajtur, kurse e zbutura çdo vit pille një kotorr, dhe, përveç kësaj, jepte edhe qumësht. Për disa fise më të përparuara — arianët, semitët, ndoshta edhe turanikët** dega kryesore e punës në fillim u bë zbutja e kafshëve dhe vetëm pastaj rritja e gjësë së gjallë dhe ruajtja e saj. Fiset e barinjve u ndanë nga shumica tjetër e barbarëve: kjo që *e para ndarje e madhe shoqërore e punës*. Fiset e barinjve jo vetëm prodhonin më tepër se barbarët e tjerë, por edhe mjetet e jetesës, që prodhonin ata, ishin ndryshe. Ata kishin, në krahasim me të tjerët, jo vetëm qumësht, produkte të qumështit dhe mish në sasi shumë më të mëdha, por edhe lëkura, lesh, qime dhe një sasi fijesh të tjera dhe pëlhurash, që shtohesh gjithnjë më tepër me shtimin e lëndës së parë. Kjo e bëri të mundshëm për herë të parë një kë-

* Sidomos në bregun e detit veriperëndimor të Amerikës — shih Bankroftin. Në fisin hajda në ishullin e mbretëreshës Sharlota ka shtëpi me 700 veta. Te nutkat në një strehë rronin fise të tëra.

** *Turanikë* — banorët e fushave të Azisë Qendrore midis detit Kaspik dhe maleve të Azisë së brendshme. *Red. Përkth.*

mbim të rregullt. Në shkallët më të hershme të zhvillimit mund të bëhej vetëm një këmbim i rastit; një mjeshtëri e veçantë për fabrikimin e armëve dhe të veglave mund të shpinte në një ndarje të përkohshme të punës. Kështu, për shembulli, në shumë vende janë gjetur mbeturina, që s'ka dyshim se janë të punishteve për fabrikimin e veglave prej guri të kohës së fundit të epokës së gurit; mjeshtrit, që zhvillonin këtu mjeshtërinë e vet, ka të ngjarë të punonin për llogari të gjithë shoqërisë, siç bëjnë edhe sot zejtarët e përhershëm të komunave gjinore në Indi. Në këtë shkallë të zhvillimit këmbimi mund të lindte vetëm brenda fisit, por edhe në këtë rast ai ishte një fenomen i rrallë. Tani, përkundrazi, pas shkëputjes së fiseve të barinjve, ne i gjejmë gati të gjitha kushtet për një këmbim midis anëtarëve të fiseve të ndryshme, për zhvillimin e këmbimit dhe për përforcimin e tij si një institucion i rregullt. Në fillim këmbimi bëhej midis fiseve, me anë të pleqve të gjinive; po kur kopetë filluan të bëheshin pronë më vete, filloi gjithnjë më tepër të zotëronte, dhe, më në fund, u bë e vetmja formë e këmbimit — këmbimi midis individëve. Por objekti kryesor që këmbenin fiset e barinjve me fqinjët e vet, ishte gjëja e gjallë; gjëja e gjallë u bë një mall, me anën e të cilit çmoheshin gjithë mallrat e tjera dhe që kudo pranohej si këmbim me qejf, — me një fjalë, gjëja e gjallë mori funksionin e parë dhe lojti rolin e parasë që në këtë shkallë. Këtu duket q'karakter të domosdoshëm ka pasur dhe se sa shpejt është zhvilluar që me lindjen e këmbimit të mallrave nevoja për një mall të veçantë — për paranë.

Kopshtaria, që ka të ngjarë të mos e njihnin banorët e Azisë të shkallës së ulët të barbarisë, u shfaq këtu jo më vonë se në shkallën e mesme, si paraardhëse e bujqësisë. Klîma e Pllajës turanike nuk lejonte një jetë barinjsh pa zahire ushqimësh për kafshët në

kohën e dimrit, që është i gjatë dhe i egër prandaj kultura e livadheve dhe kultura e drithërave ishin këtu një kusht i domosdoshëm. Po këtë gjë mund të themi edhe për stepat në veri të Detit të Zi. Po në qoftë se në fillim drithi prodhohej për gjënë e gjallë, ai u bë shpejt një ushqim edhe për njeriun. Toka e punuar mbetej ende pronë e fisit dhe në fillim i jepej për përdorim gjinisë, pastaj gjinia ua jepte komunave shtëpiake, më në fund individëve; ata mund të kishin mbi të disa të drejta zotërimi, por jo më tepër.

Nga realizimet në fushën e veprimtarisë industria- le të kësaj shkalle kanë veçanërisht një rëndësi të madhe dy: e para — vegja, e dyta — shkrirja dhe punimi i metaleve. Bakri dhe kallaji, si edhe bronci që del nga bashkimi i këtyre të dyve, ishin metalet më me rëndësi; bronci jepte vegla dhe armë të përshtatshme, por nuk mundi të zhdukte veglat prej guri; këtë mund ta bënte vetëm hekuri, por hekurin ende nuk dinin ta nxirrnin. Për stoli dhe për sende të vyera filluan të përdornin floririn dhe argjendin, të cilët, si duket, që atëherë kishin më tepër vlerë se sa bakri dhe bronci.

Shtimi i prodhimit në të gjitha degët — në blegtori, në bujqësi, në zejtarinë shtëpiake — e bëri fuqinë punëtore të njeriut të ishte në gjendje të prodhonte një sasi më të madhe produktesh se sa duhe- shin për ta mbajtur këtë fuqi punëtore të njeriut. Bashkë me këtë, shtimi i prodhimit shtonte çdo ditë sasinë e punës që i takonte çdo anëtar i gjinisë, të komu- nës shtëpiake ose të familjes së veçantë. Lindi nevoja për fuqi punëtore të re. Lufta e gjeti këtë fuqi: robërit e luftës filluan t'i kthenin në skillevër. E para ndarje e punës bashkë me shtimin e prodhimitarisë së punës, dhe pra, edhe të pasurisë, dhe bashkë me zgjerimin e fushës së veprimtarisë prodhuese, në kushtet histori- ke të atëhershme, solli me vete në mënyrë të domos- doshme skillavërinë. Nga ndarja e parë e madhe shoqë-

rore e punës lindi edhe ndarja e parë e madhe e shoqërisë në dy klasa — në zotër dhe në skllëvër, në shfrytëzues dhe në të shfrytëzuar.

Si dhe kur u bënë kopetë nga pronë e përbashkët e fisit ose e gjinisë pronë e kryetarëve të familjeve të veçanta për këtë ne deri më sot nuk dimë asgjë. Por në përgjithësi ky kalim duhet të jetë bërë në këtë shkallë. Me shfaqjen e kopeve dhe të pasurive të tjera të reja në familje u bë një revolucion. Puna për të gjetur mjetet e jetesës kishte qenë kurdoherë punë e burrit, mjetet e punës i bënte ai dhe ishin pronë e tij. Kopetë ishin mjete të reja pune; zbutja e tyre në fillim, dhe më vonë kujdesi për to ishin punë e burrit. Prandaj gjëja e gjallë i përkiste atij; atij i përkisnin edhe mallrat dhe skllëvërit që merrte nga këmbimet më gjënë e gjallë. Gjithë teprica, që jepte tani puna, i mbetej burrit; gruaja gëzonte edhe ajo të mirat e kësaj teprice, por nuk kishte pjesë në pronë. Luftëtari dhe gjahtari „i egër” kënaqej në shtëpi me vendin e dytë pas gruas; bariu „më i butë”, duke u mburrur me pasurinë e vet, doli në vend të parë dhe gruan e vuri në vend të dytë. Dhe ajo nuk mund të ankohej. Ndarja e punës në familje shërbeu si bazë për ndarjen e pronës midis burrit dhe gruas; ajo mbeti siç kishte qenë dhe, megjithatë, ajo i përmbysi fare marrëdhëniet shtëpiake që kishin ekzistuar deri atëherë, vetëm sepse ndarja e punës jashë familjes ndryshoi. Po ajo arësye që më parë i siguronte gruas sundimin e saj në shtëpi — kufizimi i punës së saj me punën shtëpiake, — po ajo arësye tani e bëri të pashmangshëm sundimin e burrit në shtëpi; puna shtëpiake e gruas e humbi tani rëndësinë e vet në krahasim me punën e burrit për të gjetur mjetet e jetesës; puna e tij ishte çdo gjë, puna e saj — një shtesë jo aq e rëndësishme. Që këtu duket se çlirimi i gruas, barazimi i saj me burrin, është i pamundshëm dhe do të mbetet kështu,

derisa gruaja të mbetet jashtë punës prodhuese të shoqërisë dhe të kufizohet me punën private të shtëpisë. Çlirimi i gruas do të mund të bëhet vetëm atëherë kur ajo do të mund të marrë pjesë në prodhim në një shkallë të gjerë, në një shkallë shoqërore, dhe kur do të merret me punët e shtëpisë në një masë të vogël. Dhe kjo është bërë një gjë e mundshme vetëm me industrinë e madhe moderne, që jo vetëm lejon në proporcione të mëdha punën e gruas, por e kërkon drejt-përdrejt, dhe punën private të shtëpisë synon ta bëjë gjithnjë më tepër një prodhim shoqëror.

Kur u vendos në fakt sundimi i burrit, në shtëpi ranë edhe pengesat e fundit për pushtetin e tij të pakufizuar. Ky pushtet u konfirmua dhe u përjetësua me përmbysjen e së drejtës amtare, me hyrjen e së drejtës atërore, me kalimin e ngadalshëm nga martesat me çifte në monogami. Dhe kjo hapi një të çarë në rendin e vjetër gjinor: familja e veçantë u bë një forcë, dhe një forcë e rrezikshme, që u ngrit kundër gjinisë.

Hapi tjetër na shpie në shkallën e lartë të barbarisë, në atë periudhë kur të gjithë popujt e kulturuar jetojnë epokën e vet heroike, — epokën e shpatës së hekurt, si edhe të plugut dhe të sëpatës prej hekuri. Në shërbim të njeriut hyri hekuri, që është i fundit dhe më me rëndësi nga të gjitha llojet e lëndës së parë, që kanë lojtur një rol revolucionar në histori, i fundit — derisa doli patatja. Hekuri krijoi mundësinë për të mbjellë sipërfaqe të mëdha toke, për të kthyer hapësira të gjera pyjesh në ara; ai i dha zejtarit vegla aq të forta dhe të mprehta, sa që kundër tyre nuk mund të qëndronte asnjë gur, asnjë nga metalet e njohura në atë kohë. Të gjitha këto nuk u bënë përnjëherësh; hekuri i parë shpesh ishte më i butë se bronci. Prandaj armët dhe guri nuk u zhdukën veçse dalëngadalë; jo vetëm në „Këngën e Hildebrandit”, por edhe në betejën e Hastingsit më 1066 përdroreshin ende

sëpata prej guri.²⁶⁶ Por përparimi tani vazhdoi me një vrull të rrëmbyer, me ndërprerje më të vogla dhe më shpejt. Qyteti me shtëpi guri ose tullash, i rrethuar me mure, me kulla e me bedena prej guri, u bë qendra e fisit ose e bashkimit të fiseve; ky ishte një përparim shumë i madh në artin e ndërtimit, por bashkë me këtë edhe shenja e rrezikut që po shtohej dhe e nevojës për mbrojtje. Pasuria u shtua shpejt, por si pasuri individuale; në endjen, në punimin e metaleve dhe në zejet e tjera, që po ndaheshin gjithnjë më tepër nga njëra-tjetra, u shtua edhe më shumë varieteti dhe u përmirësua mjeshtëria e prodhimit; në bujqësi, përveç grurit, bimëve bishtajore dhe pemëve, tani u mësuan të nxirrnin edhe vaj e verë. Një veprimtari kaq e shumëllojshme nuk mund të ushtrohej po nga një person; u bë *e dyta ndarje e madhe e punës*: zejtaria u nda nga bujqësia. Shtimi i parreshtur i prodhimit, dhe bashkë me të edhe i prodhimtarisë së punës, e shtoi vlerën e fuqisë punëtore të njeriut; skllavëria, që sapo kishte lindur dhe gjendej aty-këtu në shkallën e mëparshme të zhvillimit, tani bëhet një pjesë kryesore e sistemit shoqëror; skllavërit nuk janë më ndihmës të thjeshtë; tani me dhjetëra i shpien të punojnë në ara dhe në punishte. Me ndarjen e prodhimit në dy degë të mëdha kryesore, bujqësi dhe zejtari, lind prodhimi drejtpërdrejt për këmbim, — prodhimi i mallrave, dhe bashkë me të edhe tregëtia jo vetëm brenda fisit dhe në kufijtë e tij, por edhe tregëtia me vendet përtej detit. Por të gjitha këto janë ende në një formë shumë të pazhvilluar; metalet e çmueshme fillojnë të bëhen një mall mbizotërues dhe i përgjithshëm, — bëhen para, por ato ende nuk i presin, por i këmbëjnë vetëm sipas peshës.

Ndryshimi midis të pasurve dhe të varfërve shfaqet krahas me ndryshimin midis të lirëve dhe skllavërve, me ndarjen e re të punës lind një ndarje e re

e shoqërisë në klasa. Ndryshimet pasurore midis kryetarëve të familjeve të veçanta shkallmojnë komunën e vjetër shtëpiake komuniste kudo që ajo kishte mbetur ende; bashkë me të zhduket edhe punimi i përbashkët i tokës me mjetet e kësaj komune. Arat u jepen në përdorim familjeve të veçanta — në krye përkohësisht, pastaj përgjithnjë, kalimi i tyre në pronë private të plotë bëhet dalëngadalë dhe krahas me kalimin e martesës me çifte në monogami. Familja e veçantë bëhet njësi ekonomike e shoqërisë.

Dendësia e popullsisë, që po shtohet, i detyron njerëzit të kenë një bashkim më të ngushtë si brenda, ashtu edhe kundrejt botës së jashtme. Bashkimi i fiseve të afërme bëhet kudo një gjë e domosdoshme dhe shpejt bëhet një gjë e domosdoshme madje edhe shkrirja e tyre dhe, si rrjedhim, shkrirja e teritoreve të veçanta të fiseve në një territor të përbashkët të gjithë popullit. Prijësi ushtarak i popullit — rex, basileus, thiudans — bëhet një funksionar i domosdoshëm dhe i përhershëm. Shfaqet kuvendi i popullit atje ku ende nuk ekzistonte. Prijësi ushtarak, këshilli, kuvendi i popullit formojnë organet e shoqërisë gjinore, e cila zhvillohet më tej në demokraci ushtarake. Ushtarake, sepse lufta dhe organizimi për luftë bëhen tani funksione të rregullta të jetës popullore. Pasuritë e fqinjve zgjojnë lakminë e popujve, për të cilët tani fitimi i pasurive është një nga qëllimet më me rëndësi të jetës. Ata janë barbarë: atyre grabitja u duket një gjë më e lehtë dhe bile më e ndershme se sa puna krijuese. Lufta, e cila më parë bëhej vetëm për të marrë hakën e një sulmi ose për të zgjeruar territorin e pamjaftueshëm, tani bëhet vetëm për grabitje, bëhet një zeje e përhershme. Jo më kot ngrihen mure të tmerrshme rreth qyteteve të reja të fortifikuara; në hendeqet e tyre hapet varri i rendit gjinor, kurse kullat e tyre ndeshin në qytetërim. Po kjo gjë ndodh edhe bre-

nda shoqërisë. Luftërat grabitqare forcojnë pushtetin e prijësit të lartë ushtarak, ashtu si edhe të prijësve të tjerë ushtarakë që varen prej tij; zgjedhja e päsardhësve të tyre, që, sipas zakonit, bëhej po nga ato familje, pak nga pak, sidomos me vendosjen e së drejtës atërore, bëhet një pushtet i trashëgueshëm, të cilin në fillim e durojnë, pastaj e pretendojnë dhe, më në fund, e uzurpojnë; vihen themelet e pushtetit mbretëror trashëgimtar dhe të aristokracisë trashëgimtare. Kështu organet e rendit gjinor dalëngadalë shkëputen nga rrënjët e tyre në popull, në gjini, në fratri, në fis, dhe gjithë rendi gjinor kthehet në të kundërtën e vet: nga një organizatë fisesh për të rregulluar lirisht punët e veta, ajo shndërrohet në një organizatë grabitjeje dhe shtypjeje të fqinjve, dhe, në përshtatje me këtë, organet e saj nga vegla të vullnetit popullor, bëhen organe të pavarura sundimi dhe shtypjeje kundër popullit të vet. Por kjo nuk do të kishte ndodhur kurrë, sikur të mos kishte qenë lakmia e pangopur për pasuri, që i ndau anëtarët e gjinisë në të pasur dhe në të varfër, në qoftë se „ndryshimet pasurore brenda një gjinie nuk do ta kishin shndërruar bashkësinë e interesave në antagonizëm midis anëtarëve të gjinisë” (Marks)²⁶⁷ dhe në qoftë se skllavëria, që po përhapej, nuk do të kishte sjellë një gjendje të tillë, që gjetja e mjeteve të jetesës me anë të punës vetjake të mos quhej si një veprimtari e përshtatshme vetëm për skllavin, më e turpshme se sa grabitja.

* * *

Ne erdhëm tani në prakun e qytetërimit. Ai hapet me një hap të ri përpara në ndarjen e punës. Në shkallën e ulët njerëzit prodhonin vetëm drejtpërdrejt për nevojat e veta; veprimet e këmbimit, që bëheshin rra-

llë, ishin veprime të veçuara dhe kishin të bënin vetëm me tepricat që mbeteshin rastësisht. Në shkallën e mesme të barbarisë, te popujt barinj ne gjejmë tani pasuri në formë të gjësë së gjallë, e cila, kur kope të janë pak a shumë të mëdha, krijon rregullisht një tepricë përmbi nevojat vetjake; njëkohësisht gjejmë edhe ndarjen e punës midis popujve barinj dhe fiseve të tjera të prapambetura, që nuk kanë kope; gjejmë kështu dy shkallë të ndryshme paralele të prodhimit, pra, edhe kushtet për një këmbim të rregullt. Në shkallën e lartë të barbarisë kemi një ndarje më të madhe të punës midis bujqësisë dhe zejtarisë, dhe njëkohësisht një prodhim gjithnjë më të madh produktesh drejtpërdrejt për këmbim, kështu që këmbimi midis prodhuesve individualë bëhet një nevojë jetësore për shoqërinë. Qytetërimi i siguron dhe i forcon të gjitha këto forma të ndarjes së punës, që kishin lindur përpara tij, sidomos duke ashpërsuar antagonizmin midis qytetit dhe fshatit (nga pikëpamja ekonomike mund të sundojë qyteti mbi fshatin, siç ishte në kohën e lashtë, ose fshati mbi qytetin, siç ishte në kohën e mesme), dhe shton një të tretë, një ndarje të punës që është karakteristike për qytetërimin dhe që ka një rëndësi vendimtare — krijon një klasë, e cila nuk merret me prodhim, por vetëm me këmbimin e produkteve, krijon *tregëtarët*. Deri atëherë shkaqet e formimit të klasave ishin të lidhura vetëm me prodhimin; ato i ndanin njerëzit që merreshin me prodhim në udhëheqës dhe në zbatues ose në prodhues më të mëdhenj dhe në prodhues më të vegjël. Këtu për herë të parë lind një klasë, e cila, pa marrë pjesë fare në prodhim, merr në dorë përgjithësisht drejtimin e prodhimit dhe nga pikëpamja ekonomike i nënshton prodhuesit, bëhet një ndërmjetës i pashmangshëm midis të dy prodhuesve dhe i shfrytëzon që të dy. Nën pretekstin e çlirimit të prodhuesve nga puna

dhe nga rreziku, që janë lidhur me këmbimin, nën pretekstin se produktet e tyre shiten në tregje të largëta në një shkallë më të gjerë dhe këssoj krijohet gjoja klasa më e dobishme e popullsisë, formohet një klasë parazitësh, një klasë shushunjash të vërteta në shoqëri, e cila si shpërblim për shërbimet e veta, që në të vërtetë janë shumë të vogla, merr ajkën e prodhimit, si në atdheun e vet, ashtu dhe jashtë, fiton shpejt pasuri shumë të madhe dhe një influencë në shoqëri sipas pasurisë së vet dhe pikërisht për këtë arsye në periudhën e qytetërimit fiton gjithnjë më tepër një pozitë të respektuar dhe një sundim gjithnjë më të madh në prodhim, derisa, më në fund, edhe ajo vetë nxjerr produktin e vet — krizat tregëtare periodike.

Megjithatë, në shkallën e zhvillimit që po studjojmë shtresa e tregëtarëve të rinj nuk ka ende parandjenjen e veprave të mëdha, për të cilat ajo është destinuar. Por ajo formohet dhe bëhet e domosdoshme, dhe kjo mjafton. Dhe bashkë me të del *paraja metalike*, monedha e prerë, dhe me parane metalike del një mjet i ri për sundimin e atij që nuk prodhon mbi prodhuesin dhe mbi prodhimin e tij. U gjend malli i mallrave, i cili përmban në formë të fshehtë të gjitha mallrat e tjera, një mjet magjik që mund të kthehet sipas dëshirës në çdo send tërheqës dhe të dëshiruar. Kush e kishte këtë mjet, ai sundonte mbi botën e prodhimit. Dhe kush e kishte në radhë të parë këtë? Tregëtari. Kultu i parasë ishte në duart e tij të sigurta. Ai mori përsipër të shpjegonte se të gjitha mallrat, dhe bashkë me to edhe të gjithë prodhuesit e mallrave, duhet të bien ndër këmbë me adhurim përpara parasë. Ai provoi në praktikë se të gjitha format e tjera të pasurisë janë vetëm një hije përpara këtij mishërimit të pasurisë, si e tillë. Kurrë më pastaj pushteti i parasë nuk është shfaqur me këtë brutalitet dhe me këtë forcë primitive, si në këtë periudhë të rinisë së saj.

Pas blerjes së mallrave me para doli huaja, dhe bashkë me të — përçindja dhe fajdeja. Dhe asnjë legjislacion i kohëve të mëvonshme nuk e hedh borxhiun në këmbët e kreditorit-fajdexhi kaq pa mëshirë dhe pa shpresë për shpëtim, sa legjislacioni i Athinës dhe i Romës në kohën e lashtë, — e si njëri dhe tjetri lindi vetiu si e drejtë zakonore, vetëm nën presionin e detyrimit ekonomik.

Krahas me pasurinë në mallra dhe në skllëvër, krahas me pasurinë në para tani doli edhe pasuria e tokës. E drejta e individëve për të zotëruar parcela tokash, që u ishin lënë në fillim nga gjinia ose nga fisi, tani u sigurua aq tepër, saqë këto parcela u bënë të tyret si pronë me të drejtë trashëgimi. Ajo që ata kërkonin më tepër në kohën e fundit ishte pikërisht çlirimi i parcelës nga të drejtat që kishte mbi të komuna gjinore, të drejta që ishin bërë një pengesë për ta. Këto pengesa u zhdukën, por menjëherë pas tyre u zhduk gjithashtu edhe prona e re mbi tokën. Pronë e plotë, e lirë mbi tokën nuk do të thoshte vetëm se ajo mund të zotërohej pa pengesa dhe pa kufi, por edhe se mund të shitej. Sa kohë që toka ishte pronë e gjinisë, nuk kishte një mundësi të tillë. Por, kur zotëruesi i ri i tokës e shkundi përgjithnjë zgjedhën e pronësisë supreme të gjinisë dhe të fisit, ai i preu gjithashtu edhe lidhjet, të cilat deri atëherë e kishin lidhur pazgjydhmërisht me tokën. Se ç'do të thoshte kjo, këtë gjë ia shpjegoi paraja, e cila u shpik njëkohësisht me pronën private mbi tokën. Tani toka mund të bëhej mall që shitet dhe vihet peng. Sapo që u vendos prona mbi tokën, menjëherë u shpik edhe hipoteka (shih Athinën). Ashtu sikundër pas gjurmëve të monogamisë shkojnë heterizmi dhe prostitucioni, ashtu, duke filluar që tani, hipoteka e ndjek këmba-këmbës pronën mbi tokën. Ju deshët një pronë toke të plotë, të li-

rë, që mund të shitej, — merreni, ja ku është: tu l'as voulu, George Dandin!*

Kështu bashkë me zgjerimin e tregëtisë, bashkë me paranë dhe me fajdenë, me pronën mbi tokën dhe me hipotekën pasuritë u përqëndruan dhe u centralizuan shpejt në duart e një klase të vogël, dhe krahas me këtë u shtua varfërimi i masave dhe numri i të varfërve. Aristokracia e re e pasurisë e hodhi përfundimisht në plan të dytë aristokracinë e vjetër gjinore (në Athinë, në Romë, te gjermanët), kur ajo nuk ishte shkrirë që në fillim me këtë të fundit. Dhe krahas me këtë ndarje të të lirëve në klasa sipas pasurisë u shtua, sidomos në Greqi, në një masë shumë të madhe numri i skllëvërve**, puna e detyrueshme e të cilëve përbënte bazën, mbi të cilën ngrihej superstruktura e gjithë shoqërisë.

Të shohim tani se ç'u bë me rendin gjinor gjatë këtij revolucioni shoqëror. Ai u tregua i pafuqishëm përpara elementeve të reja që kishin dalë pa ndihmën e tij. Kushti i parë i tij kishte qenë banimi i përbashkët i anëtarëve të një gjinie ose të një fisi në një territor ku rronin vetëm ata. Kjo ishte zhdukur me kohë. Kudo u përzier gjinitë dhe fiset, kudo midis qytetarëve të lirë rronin skllëvër, njerëz të marrë ndorje, të huaj. Mënyra e banimit të përhershëm në një vend, që u arrit vetëm nga fundi i shkallës së mesme të barbarisë, prishej vazhdimisht nga lëvizja dhe nga këmbimi i vendbanimit, të shkaktuara nga tregëtia, nga këmbimi i llojit të punës, nga shitja e pronës së tokës.

* — ti e kërkove, Zhorzh Danden! (Molier. „Zhorzh Danden”, akti I, skena e nëntë). *Red.*

** Për numrin e skllëvërve në Athinë shih më sipër, f. 117 (në këtë vëllim shih f. 288. *Red.*). Në Korint në epokën e lulëzimit të qytetit numri i skllëvërve arrinte deri në 460 000, në Eginë — deri në 470 000, në të dyja rastet ishte dhjetë herë më i madh se popullsia e lirë.

Anëtarët e komunave gjinore nuk mund të mblidheshin më së bashku për të vendosur mbi punët e veta të përbashkëta; vetëm disa gjëra pa rëndësi, si për shembull të kremtet fetare, mezi mund t'i bënin ende së bashku. Krahas me nevojat dhe me interesat për të cilat ishin krijuar dhe përshtatur bashkimet gjinore, si rezultat i revolucionit lindën nevoja dhe interesa të reja në kushtet e veprimtarisë prodhuese dhe të ndryshimeve të shkaktuara prej tij në strukturën shoqërore, nevoja dhe interesa që jo vetëm ishin të huaja për rendin e vjetër gjinor, por edhe në kundërshtim me të nga çdo pikëpamje. Interesat e grupeve të zejtarëve që kishin lindur nga ndarja e punës, nevojat e veçanta të qytetit në kundërshtim me fshatin kërkonin organe të reja; por secili prej këtyre grupeve përbëhej nga njerëz të gjinive, të fratrive dhe të fiseve të ndryshme, duke përfshirë madje edhe të huaj; prandaj këto organe duhej të formoheshin jashtë rendit gjinor, krahas me të, dhe njëkohësisht edhe kundër tij. — Dhe në çdo bashkim gjinor shfaqej përsëri ky konflikt interesash, që arriti kulmin e ashpërsisë së vet në bashkimin e të pasurve dhe të të varfërve, të fajdexhinjve dhe të borxhlinjve brenda një gjinie dhe brenda një fisi. — Kësaj i shtohej edhe një popullsi e re, një popullsi e madhe, që ishte e huaj për komunat gjinore, e cila, si në Romë, mund të bëhej një forcë për vendin dhe që, përveç asaj, ishte shumë e madhe në numër që të mund të futej pak nga pak në gjini dhe në fise të një gjaku. Kundrejt kësaj popullsie komunat gjinore qëndronin si korporata të mbyllura, të privileguara; demokracia, e cila në fillim kishte lindur vetiu, ishte kthyer në një aristokraci të urryer. — Më në fund, rendi gjinor u rrit nga një shoqëri që nuk njihte antagonizma të brendshëm dhe ishte i përshtatshëm vetëm për këtë shoqëri. Ai nuk kishte mënyra të tjera detyrimi përveç opinionit publik. Kurse këtu lindi një

shoqëri, e cila, për shkak të të gjitha kushteve ekonomike të jetës së saj, duhej të ndahej në të lirë dhe në skilevër, në të pasur shfrytëzues dhe në të varfër të shfrytëzuar, — një shoqëri e cila jo vetëm nuk mund t'i pajtonte këta antagonizma, por duhej t'i ashpërsonte edhe më tepër. Kjo shoqëri mund të ekzistonte vetëm në një luftë të parreshtur, të hapët midis këtyre klasave ose nën sundimin e një force të tretë, e cila, duke qëndruar gjoja mbi klasat kundërshtarë, t'i shtypte konfliktet e tyre të hapëta dhe të lejonte luftën e klasave shumë-shumë vetëm në fushën ekonomike, në të ashtuquajturën formë legale. Rendit gjinor i kaloi koha. Ai u shpartallua nga ndarja e punës dhe nga pasoja e saj — nga ndarja e shoqërisë në klasa. Ai u zëvendësua nga *shteti*.

* * *

Më sipër analizuam veç e veç tri format kryesore, në të cilat shteti ngrihet mbi gërmadhat e rendit gjinor. Athina përfaqëson formën më të kulluar, formën më klasike: këtu shteti lind drejtpërdrejt dhe kryesisht nga antagonizmat e klasave, që zhvillohen brenda vetë shoqërisë gjinore. Në Romë shoqëria gjinore shndërrohet në një aristokraci të mbyllur midis një plebsi shumë të madh në numër, që qëndron jashtë saj, pa të drejta, por me detyra; fitorja e plebsit shpartallon rendin e vjetër gjinor dhe mbi gërmadhat e tij ngre shtetin, në të cilin për së shpejti zhduken fare edhe aristokracia gjinore edhe plebsi. Më në fund, te gjermanët, që mundën Perandorinë Romake, shteti lind drejtpërdrejt nga pushtimi i tokave të huaja shumë të mëdha, ku rendi gjinor nuk jep asnjë mjet për t'i sunduar. Por meqenëse ky pushtim nuk është lidhur as me një luftë serioze kundër popullsisë së mëparshme

as me një ndarje më të përparuar të punës; meqenëse shkalla e zhvillimit ekonomik të popujve të nënshtruar dhe të pushtuesve është pothuajse njësoj dhe prandaj baza ekonomike e shoqërisë mbetet si më parë, rendi gjinor mund të vazhdojë të ruhet për shekuj me radhë në një formë të ndryshuar territoriale, si regjim i markës, dhe madje mund të përtërihet për një farë kohe në një formë më të dobësuar në gjinitë e mëvonshme fisnike dhe patriciane, madje edhe në gjinitë fshatare, si, për shembull, në Ditmarshen*.

Pra, shteti nuk është aspak një forcë që i është imponuar shoqërisë nga jashtë. Shteti gjithashtu nuk është „realiteti i idesë morale”, „figura dhe realiteti i arësyes”, siç thotë Hegeli²⁶⁹. Shteti është produkti i shoqërisë në një shkallë të caktuar të zhvillimit; shteti është pohimi se kjo shoqëri është ngatërruar në një kontradiktë të pazgjidhshme me veten e vet, është ndarë në antagonizma të papajtueshëm, nga të cilët nuk është në gjendje të shpëtojë. Por që këta antagonizma, këto klasa me interesa ekonomike të kundërta, të mos gllabërojnë njëri-tjetrin dhe shoqërinë në një luftë shterpë, për këtë gjë u bë e domosdoshme një forcë që të qëndronte, në dukje, mbi shoqërinë, një forcë që ta zbuste konfliktin, që ta mbante këtë konflikt brenda kufijve të „rendit”. Dhe kjo forcë, e dalë nga shoqëria, por që e vë veten mbi shoqërinë, që bëhet gjithnjë më e huaj për të, është shteti.

Në krahasim me organizimin e vjetër gjinor shteti dallohet, së pari, nga ndarja e shtetasve sipas *territorit*. Bashkimet e vjetra gjinore, që kishin lindur dhe që mbaheshin nga lidhja e gjakut, u bënë, siç e pamë,

* Historiani i parë, që ka pasur një ide qoftë edhe të përafërt për thelbin e gjinisë, ka qenë Niburi, dhe këtë gjë, — por edhe gabimet e tij, që e kanë burimin drejtpërdrejt këtu, — ai ia detyron njohjes së komunave gjinore të Ditmarshenit²⁶⁸.

të pamjaftueshme, më tepër sepse premisa e tyre, lidhja e anëtarëve të gjinisë me një territor të caktuar, ishte zhdukur me kohë. Territori mbeti, por njerëzit tani lëvizin. Prandaj si pikënisje u muar ndarja territoriale, dhe qytetarët i lanë të ushtronin të drejtat dhe detyrat e tyre shoqërore atje ku ata ishin vendosur, pavarësisht nga gjinia dhe nga fisi. Një organizim i tillë i qytetarëve sipas vendbanimit është diçka e përbashkët për të gjitha shtetet. Prandaj ai na duket si një gjë e natyrshme; por ne pamë se ç'luftë e ashpër dhe e gjatë u desh përpara se ai të vendosej në Athinë dhe në Romë në vend të organizimit të vjetër sipas gjinive.

Karakteristika e dytë dalluese është krijimi i një *pushteti publik*, i cili tani nuk përputhet më drejtpërdrejt me popullsinë e organizuar vetë si forcë e armatosur. Ky pushtet publik i veçantë është i domosdoshëm, sepse organizimi i armatosur vetëveprues i popullsisë u bë një gjë e pamundshme qëkurse shoqëria u nda në klasa. Edhe skllëverit bëjnë pjesë në popullsinë; 90 000 qytetarë të Athinës kundrejt 365 000 skllëverve përbëjnë vetëm një klasë të privilegjuar. Ushtria popullore e demokracisë së Athinës ishte një pushtet publik aristokratik kundrejt skllëverve dhe i mbante këta nën fre; por, për të mbajtur nën fre edhe qytetarët, u desh, siç thamë më sipër, një xhandarmëri. Ky pushtet publik ekziston në çdo shtet. Ai përbëhet jo vetëm nga njerëz të armatosur, por edhe nga shtojca materiale, nga burgje dhe institucione ndëshkimore të çdo lloji, që nuk njiheshin në shoqërinë e organizuar në gjini. Ai mund të jetë shumë i vogël, saqë pothuaj nuk duket, në shoqëritë ku antagonizmat e klasave ende nuk janë zhvilluar edhe në krahina të largëta, siç vihet re nganjëherë aty-këtu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pushteti publik forcohet sa më tepër ashpërsohen kontradiktat klasore brenda shtetit dhe

sa më tepër shtetet kufitare rriten dhe shtohet popullsia e tyre. Shikoni, për shembull, Evropën tonë të sotme, ku lufta e klasave dhe konkurrenca për pushtime e kanë ngritur pushtetin publik aq lart, saqë është rrezik të gllabërojë gjithë shoqërinë e madje edhe shtetin.

Për të mbajtur këtë pushtet publik, qytetarët duhet të paguajnë *taksa*. Këto nuk njiheshin fare në shoqërinë gjinore. Por ne sot i njohim ato fare mirë. Me zhvillimin e qytetërimit edhe taksat nuk mjaftojnë; shteti nxjerr kambiale për të ardhmen, merr hua, *hua shteti*. Dhe këtu Evropa plakë mund të na tregojë shumë gjëra.

Duke pasur në dorë pushtetin publik dhe të drejtën për të nxjerrë taksa, nëpunësit, si organe të shoqërisë, viben *mbi* shoqërinë. Atyre nuk u mjafton më respekti i lirë, i vullnetshëm, që tregohej kundrejt organeve të shoqërisë gjinore edhe sikur ata të mund ta fitonin këtë respekt; bartës të një pushteti që largohet nga shoqëria, ata duhet të fitojnë respektin kundrejt vetëvetes me ligje të jashtëzakonshme, me anën e të cilave bëhen veçanërisht të shenjtë dhe të paprekshëm. Polici më i humbur i një shteti të qytetëruar ka më tepër „autoritet” se të gjitha organet e shoqërisë gjinore së bashku; por monarku më i fuqishëm dhe burri më i madh i shtetit ose komandanti më i madh i ushtrisë në epokën e qytetërimit mund ta ketë zili plakun më të thjeshtë të një gjinie, i cili gëzon në shoqëri një respekt të pakundërshtueshëm dhe jo të fituar me shkop dhe i cili qëndron brenda shoqërisë, kurse të parët janë të shtërnguar të përfaqësojnë një gjë që është jashtë shoqërisë dhe mbi shoqërinë.

Meqenëse shteti lindi nga nevoja për të mbajtur nën fre antagonizmin midis klasave, meqenëse ai në të njëjtën kohë lindi në vetë konfliktet e këtyre klasave, si rregull i përgjithshëm ai është shtet i klasës më

të fuqishme që sundon ekonomikisht, i klasës që me ndihmën e shtetit bëhet klasë sunduese edhe politikisht dhe siguron, në këtë mënyrë, mjete të reja për të robëruar dhe për të shfrytëzuar klasën e shtypur. Kështu, shteti antik, para së gjithash, ishte shtet i skllavopronarëve për të shtypur skilevërit, shteti feudal ishte një organ i fisnikëve për të shtypur bujkrobërit dhe fshatarët e varur, kurse shteti i sotëm parlamentar është një vegël për shfrytëzimin e punës me mëditje nga kapitali. Megjithatë, si përjashtim ka periudha kur klasat që luftojnë midis tyre arrijnë një ekuilibër të tillë forcash, sa që pushteti shtetëror fiton përkohësisht një farë pavarësie kundrejt të dy klasave, duket si ndërmjetës midis tyre. E tillë është monarkia absolute e shekullit XVII dhe XVIII, që mban ekuilibrin midis fisnikëve dhe borgjezisë; i tillë është bonapartizmi i Perandorisë së parë dhe, sidomos, ai i Perandorisë së dytë në Francë, i cili ndërsente proletariatin kundër borgjezisë dhe borgjezinë kundër proletariatit. Realizimi më i ri në këtë fushë, ku sundues dhe të sunduar bëjnë njësoj një figurë komike, është Perandoria e re Gjermane e kombit bismarkian: këtu kapitalistë dhe punëtorë janë ekuilibruar midis tyre dhe që të dy palët mashtrohen njësoj në dobi të interesave të junkerëve provincialë të degjeneruar të Prusisë.

Përveç kësaj, në shumicën e shteteve që njihen në histori të drejtat e qytetarëve janë në përpjesëtim me pasurinë e tyre, dhe me këtë shpallet haptazi se shteti është një organizatë e klasës së pasur për mbrojtjen e saj nga klasa e varfër. Kështu ka qenë në Athinë dhe në Romë me ndarjen e tyre në kategori sipas pasurisë. Kështu ka qenë edhe në shtetin feudal të kohës së mesme, ku pozita politike caktohej sipas madhësisë së pronës së tokës. Kjo shprehet edhe në censin elektoral të shteteve parlamentare të sotme. Por ky pohim

politik i ndryshimeve pasurore nuk është aspak një gjë esenciale. Përkundrazi, ai karakterizon një shkallë të ulët të zhvillimit të shtetit. Forma më e lartë e shtetit, republika demokratike, e cila në kushtet tona të sotme po bëhet gjithnjë më tepër një nevojë e domosdoshme dhe që përfaqëson një formë shteti, në të cilën vetëm mund të çohet deri në fund lufta e fundit vendimtare midis proletariatit dhe borgjezisë, — kjo republikë demokratike tani zyrtarisht nuk i njeh fare ndryshimet pasurore. Këtu pasuria e përdor pushtetin e vet tërthorazi, por në mënyrë më të sigurt: nga njëra anë, në formën e korrupsionit të drejtpërdrejtë të nëpunësve, — shembull klasik është Amerika, — nga ana tjetër, në formën e aleancës midis qeverisë dhe bursës, e cila realizohet aq më lehtë, sa më tepër shtohen huatë e shtetit dhe sa më tepër shoqëritë aksionare përqëndrojnë në duart e veta jo vetëm transportin, por edhe vetë prodhimin dhe e bëjnë këtë bursë një qendër të vetën. Për këtë gjë, përveç Amerikës, si shembull të gjallë kemi Republikën Franceze të fundit, madje edhe Zvicra e urtë ka dhënë kontributin e vet në këtë lëmë. Por që për këtë aleancë vëllazërore midis qeverisë dhe bursës nuk nevojitet aspak një republikë demokratike, këtë e provon, përveç Anglisë, Perandoria e re Gjermane, ku nuk mund të themi se cilin ka ngritur më lart e drejta e përgjithshme e votimit: Bismarkun apo Blajhröderin. Më në fund, klasa pasanike sundon drejtpërdrejt me anën e së drejtës së përgjithshme të votimit. Derisa klasa e shtypur — pra, në këtë rast, proletariati — nuk është pjekur ende për çlirimin e vet, do të pranojë në shumicën e vet rendin shoqëror, që ekziston, si të vetmin rend të mundshëm dhe do të formojë politikisht bishtin e klasës kapitaliste, ajo do të përbëjë krahun e saj ekstrem të majtë. Por, duke u pjekur për çlirimin e vet, ajo krijon partinë e vet, zgjedh përfaqësuesit e vet dhe

jo përfaqësuesit e kapitalistëve. E drejta e përgjithshme e votimit është treguesi i pjekurisë së klasës punëtore. Në shtetin e sotëm ajo nuk mund dhe nuk do të japë kurrë më tepër; por edhe kjo mjafton. Ditën kur termometri i së drejtës së përgjithshme të votimit do të tregojë pikën e vlimit të punëtorët, ata, si dhe kapitalistët, do të dinë ç'të bëjnë.

Pra, shteti nuk ka ekzistuar gjithnjë. Ka pasur shoqëri që bënin edhe pa të, nuk kishin asnjë ide për shtetin dhe për pushtetin shtetëror. Në një shkallë të caktuar të zhvillimit ekonomik, që ishte lidhur në mënyrë të domosdoshme me ndarjen e shoqërisë në klasa, shteti për shkak të kësaj ndarjeje u bë një nevojë e domosdoshme. Tani ne po afrohemi me hapa të shpejtë drejt një shkalle të tillë të zhvillimit të prodhimit, në të cilën ekzistenca e këtyre klasave jo vetëm nuk është më një nevojë e domosdoshme, por po bëhet një pengesë e drejtpërdrejtë për prodhimin. Klasat do të zhduken në mënyrë po aq të pashmangshme, siç lindën në mënyrë të pashmangshme në të kaluarën. Me zhdukjen e klasave do të zhduket patjetër edhe shteti. Shoqëria, që do ta organizojë prodhimin në një mënyrë të re në bazë të një shoqate prodhuesish të lirë dhe të barabartë, do ta flakë gjithë maqinën e shtetit atje ku do ta ketë atëherë vendin e merituar: në muzeun e antikave, bashkë me çikrikun dhe me sëpatën prej bronci.

* * *

Pra, siç e thamë më sipër, qytetërimi është ajo shkallë e zhvillimit të shoqërisë, ku ndarja e punës, këmbimi midis individëve, që rrjedh prej saj, dhe prodhimi i mallrave, që i bashkon të dyja këto procese, arrijnë kulmin e lulëzimit dhe përmbysin gjithë shoqërinë e mëparshme.

Prodhimi në të gjitha shkallët e mëparshme të zhvillimit shoqëror kishte qenë kryesisht kolektiv, gjithashtu edhe konsumi ishte një shpërndarje e drejt-përdrejtë e produkteve brenda komunave komuniste të mëdha ose të vogla. Ky karakterkolektiv i prodhimit realizohej në një rreth shumë të ngushtë, por ai solli sundimin e prodhuesve mbi procesin e prodhimit të tyre dhe mbi produktin e prodhimit. Ata e dinë se ku vete ky produkt: ata e konsumojnë, ai nuk u del nga duart, dhe derisa prodhimi bëhet mbi këtë bazë, ai nuk mund të dalë mbi prodhuesin, nuk mund të pjellë forca fantastike, të huaja për të, siç ndodh zakonisht dhe në mënyrë të domosdoshme në epokën e qytetërimit.

Por në këtë proces të prodhimit futet dalëngadalë ndarja e punës. Ajo shkallmon karakterin kolektiv të prodhimit dhe të përvetësimit, ajo e bën përvetësimin privat një rregull që mbizotëron dhe bashkë me këtë krijon këmbimin midis individëve — si bëhet kjo, e studjuam më sipër. Dalëngadalë prodhimi i mallrave bëhet forma sunduese.

Në prodhimin e mallrave, që nuk është një prodhim për konsum vetiak, por për këmbim, produktet medoemos shkojnë dorë më dorë. Prodhuesi, kur këmben, jep produktin e vet; ai tani nuk di se ç'do të bëhet me të. Por kur si ndërmjetëse midis prodhuesve del paraja, dhe bashkë me paranë tregëtari, procesi i këmbimit bëhet edhe më i koklavitur, fati i fundit i produkteve bëhet edhe më i pasigurt. Tregëtarë ka shumë, por asnjë prej tyre nuk di ç'bën tjetri. Tani mallrat nuk shkojnë vetëm dorë më dorë, ato lëvizin treg më treg; prodhuesit e kanë humbur pushtetin mbi gjithë prodhimin e kushteve të jetës së tyre, por ky pushtet nuk ka shkuar as në duart e tregëtarëve. Produktet dhe prodhimi bien nën pushtetin e rastit.

Por rastësia është vetëm njëri pol i varësisë reciproke, poli tjetër i së cilës quhet domosdoshmëri. Në natyrë, ku gjithashtu duket sikur sundon rastësia, ne me kohë kemi aprovuar në çdo fushë të veçantë domosdoshmërinë dhe ligjshmërinë e brendshme, që dalin në shesh brenda kësaj rastësie. Por ajo që ka vlerë për natyrën, ka vlerë edhe për shoqërinë. Sa më tepër një veprimtari shoqërore, një sërë procesesh shoqërore shpëtojnë nga kontrolli i ndërgjegjshëm i njerëzve, dalin jashtë pushtetit të tyre, sa më tepër kjo veprimtari duket sikur është në pushtetin e rastësisë së kulluar, aq më tepër depërtojnë me një domosdoshmëri të natyrshme brenda kësaj rastësie ligjet e saj të brendshme që e karakterizojnë. Këto ligje sundojnë edhe mbi rastësitë e prodhimit të mallrave dhe të këmbimit të mallrave: kundrejt prodhuesit dhe pjesëmarrësit të veçuar në këmbim ato qëndrojnë si forca të huaja, në fillim edhe si forca të panjohura, natyra e të cilave ka ende nevojë të studjohet thellë dhe me kujdes. Këto ligje ekonomike të prodhimit të mallrave ndryshojnë në shkallët e ndryshme të zhvillimit të kësaj forme të prodhimit, por përgjithësisht gjithë periudha e qytetërimit zhvillohet nën shenjë të sundimit të tyre. Edhe sot produkti sundon mbi prodhuesit; edhe sot e kësaj dite prodhimi shoqëror në përgjithësi nuk rregullohet sipas një plani të studjuar së bashku, por nga ligje të verbëra që shfaqen me forcën e spontanitetit, në fund të fundit — me rrebeshtë e krizave tregëtare periodike.

Pamë se si në një shkallë relativisht të lashtë të zhvillimit të prodhimit fuqia punëtore e njeriut mund të japë shumë më tepër produkte se sa duhen për ekzistencën e prodhuesit dhe se kjo shkallë zhvillimi përgjithësisht është pikërisht ajo shkallë në të cilën lind ndarja e punës dhe këmbimi midis individëve. Dhe tani u desh pak kohë për të zbuluar „të vërtetën”

e madhe se edhe njeriu mund të jetë një mall, se forca e njeriut mund të këmbehet dhe mund të përdoret, po ta bësh njeriun skllav. Sapo njerëzit filluan të këmbenin, u bënë edhe ata vetë objekte këmbimi. Trajta veprare u bë pësore, — me dashjen ose pa dashjen e njerëzve.

Me skllavërinë, që arriti në kohën e qytetërimit kulmin e zhvillimit, u bë ndarja e parë e madhe e shoqërisë në klasa shfrytëzuese dhe në klasa të shfrytëzuara. Kjo ndarje vazhdoi të ekzistonte gjatë gjithë periudhës së qytetërimit. Skllavëria është forma e parë e shfrytëzimit, karakteristike për botën antike; pas saj vijnë: bujkrobëria në kohën e mesme, puna me mëditje në kohën e re. Këto janë tri format e mëdha të skllavërimit, që janë karakteristike për tri epokat e mëdha të qytetërimit; atë e shoqëron gjithnjë skllavëria e hapët, dhe në kohët e fundit skllavëria e maskuar.

Shkalla e prodhimit të mallrave, me të cilën fillon qytetërimi, nga pikëpamja ekonomike karakterizohet: 1) nga përdorimi i parasë metalike, dhe bashkë me të edhe i kapitalit para, i përqindjes dhe i fajdesë; 2) nga dalja e tregëtarëve si një klasë ndërmjetëse midis prodhuesve; 3) nga lindja e pronës private mbi tokën dhe e hipotekës, dhe 4) nga puna e skllavit si formë sunduese e prodhimit. Qytetërimi i përgjigjet dhe bashkë me të vendos përfundimisht sundimin e vet forma e re e familjes — monogamia, sundimi i burrit mbi gruan, dhe familja e veçantë si njësi ekonomike e shoqërisë. Si forcë bashkuuese në shoqërinë e qytetëruar shërben shteti, i cili në të gjitha periudhat tipike është shtet vetëm i klasës sunduese dhe në të gjitha rastet mbetet kryesisht një maqinë për të shtruar të shtypurin, klasën e shfrytëzuar. Për qytetërimin është karakteristike edhe kjo: nga njëra anë, përforcimi i kontrastit midis qytetit dhe fshatit si bazë e gjithë

ndarjes shoqërore të punës; nga ana tjetër, testamentet, me të cilat pronari mund të disponojë mbi pronën e vet edhe pas vdekjes. Ky institucion, i cili është drejt-përdrejt në kundërshtim me rendin e vjetër gjinor, në Athinë nuk njihej deri në kohën e Solonit; në Romë ai hyri shpejt, por kur pikërisht, — nuk e dimë*; te gjermanët atë e futën priftërinjtë, me qëllim që gjermani i ndershëm t'ia linte pa pengesa kishës trashëgimin e vet.

Qytetërimi i mbështetur në këtë rend shoqëror bëri vepra të tilla, nga të cilat shoqëria e vjetër gjinore ishte shumë larg. Por ajo i bëri këto vepra duke vënë në lëvizje instinktët dhe pasionet më të poshtira të njeriut dhe duke i zhvilluar në dëm të të gjitha aftësive të tij. Lakmia e poshtër ka qenë forca lëvizëse e qytetërimit që në ditët e para të tij e deri më sot; pasuria, pasuria dhe përsëri pasuria, pasuria jo e shoqërisë, por e këtij individi të lig, të veçantë, ishte i vetmi qëllim, qëllimi vendimtar. Në qoftë se këtu në gjirin e kësaj shoqërie shkenca zhvillohej gjithnjë më tepër dhe përsëriteshin periudha të lulëzimit më të

* „Sistemi i të drejtave të fituara” i Lasalit në pjesën e dytë vërtitet kryesisht rreth tezës se testamenti romak është aq i vjetër, sa edhe vetë Roma, se në historinë romake kurrë „nuk ka ekzistuar kohë pa teste”, se testamenti ka më tepër të ngjarë të ketë lindur përpara periudhës romake nga kulti i të vdekurve. Lasali, si një hegelian i vjetër ortodoks, nuk i nxjerr normat juridike romake nga marrëdhëniet shoqërore të romakëve, por nga „koncepti spekulativ” i vullnetit, dhe kështu arrin në pohimin krejt antihistorik, që përmendëm më lart. Kjo nuk është për t'u çuditur në një libër, autori i të cilit në bazë të po atij koncepti spekulativ arrin në përfundimin se në trashëgimin romak transferimi i pasurisë ka qenë vetëm një çështje e dorës së dytë. Lasali jo vetëm u beson iluzioneve të juristëve romakë, sidomos të atyre të kohëve të para, por edhe ua kalon atyre.

lartë të artit, kjo bëhej vetëm sepse pa këtë nuk mund të arriheshin të gjitha realizimet e kohës sonë në fuqshën e grumbullimit të pasurisë.

Meqenëse baza e qytetërimit është shfrytëzimi i një klase nga një klasë tjetër, gjithë zhvillimi i tij bëhet në një kontradiktë të përhershme. Çdo hap përpara në prodhim është njëkohësisht një hap prapa në gjendjen e klasës së shtypur, d.m.th. të shumicës së madhe. Çdo e mirë për një palë është medoemos një e keqe për palën tjetër, çdo çlirim i ri i një klase është një shtypje e re për tjetrën. Shembulli më i gjallë i kësaj është futja në përdorim e maqinave, pastaj e së cilës sot njihen nga të gjithë. Dhe në qoftë se te barbarët, siç e pamë, mezi mund të shquajmë të drejtat nga detyrat, qytetërimi edhe një budallai më të humbur ia bën të qartë ndryshimin dhe kundërshtimin midis tyre, duke i dhënë një klase pothuajse të gjitha të drejtat dhe duke ngarkuar një tjetër pothuajse me të gjitha detyrat.

Por nuk duhet të jetë kështu. Ajo që është e mirë për klasën sunduese, duhet të jetë e mirë edhe për gjithë shoqërinë, me të cilën klasa sunduese e identifikon veten e vet. Prandaj, sa më tepër shkon përpara qytetërimi, aq më tepër ai është i shtërnguar t'i mbulojë me vellon e dashurisë të këqiat që ka pjellë ai vetë në mënyrë të pashmangshme, t'i zbukurojë ose t'i mohojë me gënjeshtër, — me një fjalë, të praktikojë hipokrizinë konvencionale, e cila nuk njihej as në format fillestare të shoqërisë as edhe në shkallët e para të qytetërimit dhe e cila, më në fund, arrin kulmin në thënien: shfrytëzimi i klasës së shtypur bëhet nga klasa shfrytëzuese vetëm e vetëm për interesat e vetë klasës së shfrytëzuar; dhe në qoftë se kjo e fundit nuk e kupton këtë dhe madje fillon të ngrihet kundër

kësaj, kjo është mosmirënjohja më e keqe kundrejt mirëbërësve, kundrejt shfrytëzuesve*.

Dhe tani, për të përfunduar, ja një gjykim i Morgani mbi qytetërimin:

„Me qytetërimin pasuria u shtua aq tepër, format e saj u bënë aq të ndryshme, përdorimi i saj u zgjerua aq tepër, dhe administrimi i saj për interesat e pronarëve u bë me aq zotësi, saqë kjo pasuri *u bë një forcë e pamposhtur që është vënë përballë popullit. Mendja e njeriut mbetet e pafuqishme dhe e habitur përpara veprës së saj.* Por megjithkëtë do të vijë një kohë kur arësyeja e njeriut do të forcohet për të sunduar mbi pasurinë, kur ajo do të caktojë si pozitën e shtetit kundrejt pronës që ai mbron, ashtu dhe kufijtë e të drejtave të pronarëve. Patjetër interesat e shoqërisë qëndrojnë më lart se interesat e individëve, dhe midis tyre duhen krijuar raporte të drejta dhe harmonike. Lakmia për pasuri në vetëvete nuk është misioni i fundit i njerëzimit, në qoftë se përparimi do të mbetet ligj për të ardhmen, siç ka qenë për të kaluarën. Koha që ka kaluar që nga lindja e qytetërimit nuk është veçse një pjesë fare e vogël e kohës që ka jetuar njerëzimi, një grimë pa rëndësi e kohës që shoqëria ka përparuar në jetën e vet. Vdekja e shoqërisë po na kanoset si mbarim i një periudhe historike, që ka si qëllim të vetëm e të fundit pasurinë, sepse kjo periudhë përmban në vetëvete elementet e zhdukjes së saj. Demokracia në udhëheqje, vëllazëria brenda shoqërisë, barazia e të drejtave, arësimi i përgjithshëm do të

* Në fillim unë doja të përmendja, krahas me kritikën që i bën Morgani qytetërimit dhe krahas me kritikën time, kritikën e shkëlqyer që i ka bërë qytetërimit në pjesë të ndryshme të veprave të veta Shari Fureja. Për fat të keq, unë nuk kam kohë të merrem me këtë gjë. Vetëm dua të them se edhe te Furjeja monogamia dhe prona mbi tokën janë karakteristikat kryesore të qytetërimit dhe se ai e quan atë një luftë të të pasurve kundër të varfërve. Gjithashtu Furjeja e kupton thellë se në të gjitha shoqëritë e papërsosura, të brejtura nga antagonizmat, familjet e veçanta (les familles incohérentes) janë njësi ekonomike.

inaugurojnë shkallën e ardhshme, shkallën më të lartë të shoqërisë, për të cilën punojnë parreshtur eksperiencia, arësyeja dhe shkenca. Ajo do të jetë një rilindje — por në një formë më të lartë — e lirisë, e barazisë dhe e vëllazërisë së gjinive të vjetra” (Morgan, „Shoqëria e lashtë”, f. 552).²⁷⁰

Shkruar në fund të marsit

— 26 majit 1884

Doli si libër më vete në

Cyrih në vitin 1884

Botohet sipas Veprave të

K. Marksit e F. Engelsit

bot. i 2-të rus., vëll. 21,

f. 28-178.

Nënshkruar:

Fridrih Engels

SHËNIME

¹⁴² „Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit” — një nga veprat themelore të marksizmit. Në këtë vepër bëhet një analizë shkencore e historisë së njerëzimit në: etapat e hershme të zhvillimit të tij, tregohet procesi i shtthurjes së rendit të komunës primitive dhe i formimit të shoqërisë me klasa, të mbështetur në pronën private, tregohen tiparet karakteristike të përgjithshme të kësaj shoqërie. Shpjegohen veçoritë e zhvillimit të marrëdhënieve familjare në formacionet e ndryshme ekonomike-shoqërore, zbulohen origjina dhe thelbi i shtetit dhe provohet se shuarja e tij, pas fitores përfundimtare të shoqërisë komuniste pa klasa, është historikisht e pashmangshme.

Librin „Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit” Engelsi e shkroi mbrenda dy muajve, që nga fundi i marsit e deri në fund të majit të vitit 1884. Duke kaluar nëpër duar dorëshkrimet e Marksit, Engelsi gjeti një koncept të hollësishëm të librit „Shoqëria e lashtë” të shkencëtarit përparimtar amerikan L. H. Morgan, të hartuar nga Marksi në vjetët 1880-1881 me shumë vërejtje kritike dhe teza të formuluar prej tij, si dhe me shumë plotësime nga burime të tjera. Pasi u njohi me këtë konspekt dhe u bind se libri i Morganit vërtetonte kuptimin materialist të historisë të përpunuar prej Marksit dhe prej tij, si dhe pikëpamjet që ishin formuar te ata në lidhje me shoqërinë primitive, Engelsi e pa të nevojshme të shkruante një vepër të posaçme duke shfrytëzuar gjerësisht vërejtjet e Marksit si dhe disa konkluzione e materiale me fakte që përmbante libri i Morganit. Engelsi e quante këtë punë si „një farë

plotësimi të testamentit" të Marksit. Për këtë libër Engelsi përdori materiale të shumta dhe të ndryshme plotësuese nga studimet që kishte bërë ai vetë mbi historinë e Greqisë dhe të Romës, të Irlandës së vjetër, të gjermanëve të lashtë, etj. (Shih veprat e Engelsit „Marka”, „Rreth historisë së gjermanëve të lashtë” dhe „Periudha e frankëve”, vëllimi 19 i botimit të 2-të rusisht të Veprave të K. Marksit e të F. Engelsit, etj.).

Në fillim Engelsi kishte ndër mend ta botonte veprën e vet në revistën teorike legale të socialdemokracisë gjermane „Neue Zeit” („Kohët e reja”), por më vonë hoqi dorë nga ky plan, duke menduar se, për shkak të orientimit politik të saj, kjo vepër nuk mund të shtypej në Gjermani në një kohë kur ishte në fuqi ligji i jashtëzakonshëm kundër socialistëve. Libri doli në dritë në Cyrih në fillim të tetorit 1884. Kohët e para autoritetet gjermane u munduan ta pengonin përhapjen e tij, por më vonë këto vështirësi u kapërcyen dhe dy botimet e mëvonshme të librit (botimi i dytë i vitit 1886 dhe i treti i vitit 1889) djalën në Shtutgart. Në to nuk u bë asnjë ndryshim në krahësim me botimin e parë.

Më 1890, në lidhje me materialet e reja që ishin grumbulluar mbi historinë e shoqërisë primitive, Engelsi iu vu punës për përgatitjen e një botimi të ri të librit të vet. Gjatë punës për përgatitjen e këtij botimi ai studjoi gjithë letërsinë moderne mbi këtë çështje, në mënyrë të veçantë veprat e shkenctarit rus M. M. Kovalevskit, bëri ndryshime, ndreqje dhe plotësime të shumta në tekstin fillestar, sidomos në kapitullin mbi familjen, duke pasur parasysh zbulimet më të reja të arkeologjisë dhe të etnografisë. Porse këto ndryshime dhe përsaktësime nuk i kanë cenuar konkluzionet e Engelsit, të cilat u vërtetuan edhe një herë nga të dhënat e reja të shkencës. Këto konkluzione e ruajtën plotësisht vlerën e vet edhe më vonë; zhvillimi i mëtejshëm i shkencës ka treguar se sa të drejta janë tezatat themelore të veprës së Engelsit, megjithëse disa hollësi, të marra nga libri i Morgani, kanë nevojë, në dritën e të dhënave të reja shkencore, për një farë përsaktësimi (për shembull, periodizimi i historisë primitive i bërë nga Morgani, terminologjia e përdorur prej tij në lidhje me këtë, etj.).

Botimi i katërt, i ndrequr dhe i plotësuar, i librit të Engelsit doli në Shtutgart në fund të vitit 1891 dhe më vonë atij nuk iu bë më asnjë ndryshim.

Me gjallje të Engelsit dualën edhe dy botime të tjera. — i pesti (1892) dhe i gjashti (1894), që nuk ishin veçse një rishtypje e botimit të katërt. — 5

¹⁴³ Është fjala për „Konspektin e librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë” të bërë nga K. Marks; është botuar në librin „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, 1941, f. 1—192. — 6

¹⁴⁴ Është fjala për librin: E. A. Freeman, „Comparative Politics”. London, 1873 (E. A. Friman, „Politika krahasuese”. Londër, 1873). — 8

¹⁴⁵ Kjo është parathënia e shkruar nga Engelsi për botimin e katërt të librit të tij „Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit”. Para se të dilte në dritë libri, parathënia u botua me pëlqimin e autorit në revistën „Neue Zeit” Nr. 41, 1891, me titullin „Rreth historisë së familjes primitive (Bahofen, Mak-Lenan, Morgan)”. — 9

¹⁴⁶ Eskili, „Orestia. Eumenidet” (shih bot. shqip, 1960, f. 225). — 13

¹⁴⁷ Engelsi citon librin e Mak-Lenanit „Studies in Ancient History comprising a Reprint of „Primitive Marriage. An Inquiry into the Origin of the Form of Capture in Marriage Ceremonies”. London and New-York, 1886, p. 124-125 („Studime mbi historinë e lashtë bashkë me një ribotim të librit „Martesa primitive. Një studim mbi origjinën e zakonit të rrëmbimit në ceremonitë e martesës””. Londër dhe Nju-Jork, 1886, f. 124-125). Vepra e Mak-Lenanit „Martesa primitive”, doli për herë të parë si botim më vete në Edinburg më 1865, kurse botimi i parë i „Studimeve mbi historinë e lashtë” (bashkë me një ribotim të veprës „Martesa primitive”) doli në dritë në Londër më 1876. Më poshtë Engelsi përmend edhe këtë botim. — 17

¹⁴⁸ *Magarët*. — fis, sot kombësi që banon në zonat perëndimore të Nepalit. — 17

¹⁴⁹ Në gusht-shtator 1888 Engelsi bëri një udhëtim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Kanada së bashku me Eduard Evelingun, Eleonora Marks-Evelingun dhe K. Shorlemerin. Shih përshtypjet e Engelsit nga ky udhëtim në botimin e 2-të rusisht të Veprave të K. Marksit e të F. Engelsit, vëll. 21, f. 484—486. — 24

¹⁵⁰ Shi L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 19, si dhe „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 4. — 27

¹⁵¹ *Pueblo* — emër i një grupi fisesh indiane të Amerikës Veriore që jetonin në territorin e Meksikës së Re (sot — Jugperëndimi i SHBA-së dhe Meksika Veriore) dhe që i lidhte një histori e një kulturë e përbashkët. Këtë emër, që vjen nga fjala spanjishte pueblo (popull, katund, komunë), ua dhanë pushtuesit spanjollë për shkak të karakterit të veçantë të katundeve të tyre, që ishin shtëpi-kalla të mëdha, të përbashkëta, me 5-6 kate e që nxinin deri në një mijë vetë; ky emër është përdorur edhe për katundet e këtyre fiseve. — 31

¹⁵² *Normanët*, kombësi skandinave që banonte në Evropën e Veriut; ky është emri i përgjithshëm me të cilin thërriteshin norvegjezët, suedezët dhe danezët e lashtë në fillim të mesjetës. — 33

Vikingët, piratë dhe lundëtarë skandinavë, të cilët në fund të shekullit VIII dhe nga mesi i shekullit XI kanë sulmuar disa herë Evropën dhe kanë lundruar në Atlantikun Verior duke shkuar deri në Amerikë.

¹⁵³ Engelsi ka parasysh veprat e Gaj Jul Cezarit „Shënime rreth luftës me galët” dhe të Publi Kornel Tacitit „Gjermania”. — 34

¹⁵⁴ *Fiset dravidiane* përbënin popullsinë kryesore të gadishullit indian në kohërat e lashta; sot banojnë në Indi në e mesme. — 37

Fiset gaura, fise indiane të Bengalit Perëndimor.

¹⁵⁵ Gjatë përgatitjes së botimit të parë të veprës së vet Engelsi ka përdorur këta libra të Mak-Lenanit: „Primitive Marriage. An Inquiry into the Origin of the Form of Capture in Marriage Ceremonies”. Edinburg, 1865 („Martesa primitive. Një studim mbi origjinën e zakonit të rrëmbimit në ceremonitë e martesës”. Edinburg, 1865); „Studies in Ancient History comprising a Reprint of „Primitive Marriage. An Inquiry into the Origin of the Form of Capture in Marriage Ceremonies””. London, 1876 („Studime mbi historinë e lashtë bashkë me një ribotim të librit „Martesa primitive. Një studim mbi origjinën e zakonit të rrëmbimit në ceremonitë e martesës”” Londër, 1876); më vonë, në përgatitjen e botimit të katërt (1891), Engelsi pati parasysh edhe botimin e ri të librit të fundit të Mak-Lenanit, që doli në Londër dhe në Nju-Jork më 1886. — 38

¹⁵⁶ L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 435. — 38

¹⁵⁷ K. Marks. „Konspekt i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” (shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 21). — 39

¹⁵⁸ Është fjala për librin: J. J. Bachofen. „Das Mutterrecht. Eine Untersuchung über die Gynäkokratie der alter Welt nach ihrer religiösen und rechtlichen Natur”. Stuttgart, 1861 (J. J. Bahofen. „E drejta amtare. Një studim mbi gjinekokracinë e botës së lashtë në bazë të natyrës së saj fetare dhe juridike”. Shtuttgart, 1861). — 40

¹⁵⁹ *Karaibët* — popullsia indiane e Amerikës së Jugut; banonin në territorin e Brazilit Verior e Qendror dhe në rajonet kufi me Venezuelën, Guajanën dhe Kolumbinë. — 46

¹⁶⁰ Kjo letër e Marksit nuk na ka rënë në dorë. Engelsi e përmend atë në letrën që i dërgoi Kautskit më 11 prill 1884. — 48

¹⁶¹ Është fjala për tekstin e tetralogjisë operistike të R. Vagnerit „Unaza e Nibelungut”, të shkruar nga vetë kompozitori në bazë të eposit skandinav „Eda” dhe të eposit gjerman „Kënga e Nibelungëve”. Shih R. Wagner. „Der Ring des Nibelungen, erster Tag, die Walküre”, zweiter Aufzug (R. Wagner. „Unaza e Nibelungut, dita e parë, Valkiria”, akti i dytë). — 48

„Kënga e Nibelungëve” — një nga monumentet më të mëdha të eposit heroik popullor gjerman, i krijuar në bazë të miteve të lashta gjermane dhe të legjendave të periudhës së të ashtuquajturës dyndje e madhe e popujve (shek. III-V). Në trajtën që ka arritur deri te ne, kjo poeme epike është thurur rreth vitit 1200.

¹⁶² „Eda” — përmbledhje legjendash dhe këngësh mitologjike dhe heroike të popujve skandinavë: është ruajtur në formën e një dorëshkrimi të shek. XIII që u zbulua më 1643 nga peshkopi islandez Svejnson (e ashtuquajtura „Eda e moçme”), dhe në formën e një traktati mbi poezinë e skaldëve, të hartuar në fillim të shek. XIII nga poeti dhe kronisti Snorri Sturluson („Eda e re”). Këngët e „Edës” kanë pasqyruar gjendjen e shoqërisë skandinave në periudhën e shturjes së rendit gjinor dhe të dyndjes së popujve. Aty gjejmë modele dhe subjekte nga krijimtaria popullore e gjermanëve të lashtë. — 49

„Egisdreka” — një nga këngët e „Edës së moçme” që u përket teksteve më të vona të përmbledhjes. Engelsi citon këtu disa pjesë nga strofat 32 dhe 36 të kësaj kënge.

¹⁶³ Asët dhe vanët — dy grupe perëndimore në mitologjinë skandinave. — 49

„Saga e Inglingëve” — saga e parë e librit mbi mbretërit norvegjezë (prej kohërave më të lashta deri në shek. XII) të poetit dhe kronistit mesjetar islandez Snorri Sturluson „Heimskringla” („Rrethi i dheut”), të shkruar në gjysmën e parë të shek. XIII në bazë të kromikave historike mbi mbretërit norvegjezë dhe të sagave gjinore të Islandës dhe të Norvegjisë. Engelsi citon një pjesë nga kapitulli i 4-të i kësaj sage.

¹⁶⁴ K. Marks. „Konspekt i librit të Luis H. Morganit „Shogëria e lashtë”” shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 187). — 52

¹⁶⁵ Është fjala për martesat me klasa, ose seksionet — grupe të veçanta, në të cilat ndahej shumica e fiseve australiane. Burrat e secilit grup mund të martoheshin vetëm me gra të një grupi tjetër të caktuar; çdo fis kishte 4-8 grupe të tilla. — 53

¹⁶⁶ Rezultatet e studimeve të bëra nga Fajsoni së bashku me Hauitin janë paraqitur në librin: L. Fison and A. W. Howit. „Kamilaroi and Kurnai”. Melbourne, Sydney, Adelaide and Brisbane, 1880 (L. Fajson dhe A. U. Hauit. „Kamilaroitë dhe kurnaitë”. Melburn, Sidnej, Adelaida dhe Brisbejn, 1880). — 56

¹⁶⁷ Shih L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 459; Engelsi e sjell këtë citat ashtu si e ka dhënë Marksii (shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 28). — 60

¹⁶⁸ Engelsi citon letrën e A. Rajtit sipas fragmentit që jepet në librin e Morganit (shih L. H. Morgan. „Ancient Society”, London, 1877, p. 455, si dhe „Arkivin e Marksit dhe të Engelsit”, vëll. IX, f. 26-27). Teksti i plotë i kësaj letre (data e saktë e saj është 19 maj 1874), Morgan jep vitin 1873) u botua në revistën „American Anthropologist”. New Series. Menasha, Wisconsin, USA, 1933, Nr. 1, p. 138-140 („Antropologu amerikan”. Seri e re. Menasha, Uiskonsin, SHBA, 1933, Nr. 1, f. 138-140). — 63

¹⁶⁹ *Saturnalet* — kremtime të përvitshme në Romën e Vjetër për nder të perëndisë Saturn, që bëheshin në kohën e solsticit të dimrit me rastin e përfundimit të punimeve bujqësore. Gjatë këtyre kremteve organizoheshin bankete dhe orgji në masë; në saturnalet merrnin pjesë edhe skelleverët, të cilëve u lejohej të rrinin në një tryezë me

të lirët. Në ditët e saturnaleve mbretëronte liria e marrëdhënieve seksuale. Fjala „saturnale” përdoret në kuptimin e banketeve dhe të orgjive të shthurura.

¹⁷⁰ Është fjala për të ashtuquajturën „Sentencë të Guadalupe” të 21 prillit 1486, vendim arbitrazhi i marrë nga mbreti Ferdinand i V Katoliku nën presionin e kryengritjes fshatare të Katalonjës; mbreti luajti rolin e arbitrit midis fshatarëve kryengritës dhe feudalëve. Në këtë vendim parashikohej heqja e lidhjes së fshatarëve pas tokës dhe zhdukja e një vargu të tërë angarisht feudale që urreheshin më shumë nga fshatarësia, duke u përfshirë këtu edhe e drejta e natës së parë; për këtë fshatarët duhej të paguanin një shpërblesë të madhe. — 67

¹⁷¹ K. Marks. „Konspekti i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” (Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 112). — 73

¹⁷² K. Marks. „Konspekti i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” (Shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 112). — 73

¹⁷³ Shih L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 465-466, si dhe „Arkivin e Marksit dhe të Engelsit”, vëll. IX, f. 29. — 73

¹⁷⁴ Shih L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 470, si dhe „Arkivin e Marksit dhe të Engelsit”, vëll. IX, f. 31. — 74

¹⁷⁵ K. Marks. „Konspekt i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” (shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 31). — 74

¹⁷⁶ Është fjala për veprën e M. M. Kovalevskit „E drejta primitive, fashikulli I, Gjinia”. M. 1886. Në këtë vepër Kovalevski u referohet të dhënave në lidhje me komunitetin familjar në Rusi, të botuara nga Orshanski më 1875 dhe nga A. J. Jefimenkoja më 1878. — 76

¹⁷⁷ „Pravda” e Jerosllavit quhet pjesa e parë e tekstit më të lashtë të „Russkaja Pravda”-s — përmbledhje ligjesh të Rusisë së Vjetër që doli në shekujt XI-XII mbi bazën e së drejtës zakonore të asaj kohe dhe që pasqyronte marrëdhëniet ekonomike dhe sociale të shoqërisë së atëherëshme. — 76

178 *Kanunet e Dalmacisë* — përmbledhje e ligjeve që ishin në fuqi gjatë shekujve XV-XVII në Police (pjesë e Dalmacisë); njihet me emrin Statuti i Polices. — 76

179 *Calpulis* — komuna familjare të indianëve të Meksikës në kohën e pushtimit të saj prej spanjollëve; çdo komunë familjare (calpulli), gjithë anëtarët e së cilës kishin një prejardhje të përbashkët, zotëronte një copë tokë të përbashkët, e cila nuk mund as të jetërsohej as të ndahej si trashëgim. Calpullis janë përshkruar nga Alonso de Surruta në veprën e tij „Raport sur les différentes classes de chefe de la Nouvelle-Espagne, sur les lois, les moeurs des habitants, sur les impôts établis avant et depuis la conquete, etc., etc.” („Raport në lidhje me kategoritë e ndryshme të udhëheqësve në Spanjën e Re, mbi ligjet, zakonet e banorëve, mbi tatimet, të vendosura para dhe pas pushtimit, etj. etj.”) të botuara për herë të parë në librin: „Voyages, relations et mémoires originaux pour servir à l'histoire de la découverte de l'Amérique, publiés pour la première fois en français, par H. Ternaux-Compans”. Vol. 11. Paris, 1840, pp. 50-64 („Udhëtime, raporte e memoare origjinale në lidhje me historinë e zbulimit të Amerikës, të botuara për herë të parë frëngjisht nga A. Terno-Kompani”. Vëll. 11, Paris, 1840, f. 50-64). — 77

180 Është fjala për artikullin e G. Kunovit „Die altperuanischen Dorfund Markgenossenschaften” („Komunar e vjetra peruane të fshatit dhe të markës”), botuar në revistën „Ausland” të 20 dhe 27 tetorit dhe të 3 nëntorit 1890.

„Das Ausland” („Vendet e huaja”) — revistë gjermane për çështjet e gjeografisë, të etnografisë dhe të shkencave të natyrës, në fillim e përditëshme, prej vitit 1853 e përjavshme, dilte në vjetët 1828-1893; prej vitit 1873 botohej në Shtutgart. — 77

181 Është fjala për nenin 230 të Kodit civil (shih shën. 80), që hyri në fuqi në kohën e Napoleonit, më 1804, — 79

182 Shih K. Marks. „Konspekt i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë” („Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX. f. 32). — 79

183 Homeri, „Odisea”, kënga e parë. — 79

184 Eskili „Orestia. Agamenoni”. — 80

185 *Spartiatët* — qytetarë që gëzonin të gjitha të drejtat në Spartën e Vjetër.

Helotët — banorë të Spartës së Vjetër që nuk gëzonin të drejta, që ishin të lidhur pas tokës dhe që ishin të detyruar të kryenin dësa angari në dobi të pronarëve spartiatë të tokës. Gjendja e helotëve në thelb nuk ndryshonte fare nga ajo e skllëvërve. — 81

¹⁸⁶ Aristofani. „Gratë në festën e Thesmoforive”. — 82

¹⁸⁷ Euripidi. „Orestia”. — 82

¹⁸⁸ Engelsi përmend një mendim të formuluar në vepërën e Marksit dhe të Engelsit „Ideologjia gjermane” (shih K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. i 2-të rus., vëll. 3, f. 30). — 83

¹⁸⁹ L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 504 — 84

¹⁹⁰ *Hijerodulet* — skllëvër dhe skllave të tempujve në Greqinë e Vjetër dhe në kolonitë greke. Në shumë vise, sidomos në qytetet e Azisë së mëparme dhe në Korint, gratë hijerodule ushtronin prostitucionin në tempujt. — 85

¹⁹¹ Amain Marcelini. „Historia në 31 libra”, lib. XXXI, kap. 9; Prokopi i Qesarisë. „Lufta kundër gotëve”, lib. II, kap. 14 (Libri VI. i „Historisë së luftërave të Justinianit kundër persëve, vandalëve dhe gotëve”).

Tajfalët, popull gjermanik i afërt me gotët, i cili në shek. III u vendos në rajonet veriore të Detit të Zi, prej nga u dëbuan nga hunët.

Herulët, popull gjermanik, i cili në fillim të erës sonë pushtoi Skandinavinë; në shek. III një pjesë e herulëve emigruan në rajonet veriore të Detit të Zi, por u dëbuan nga hunët. — 89

¹⁹² Është fjala për poezinë e trubadurëve të Francës Jugore të fundit të shek. XI — fillimit të shek. XIII. — 89

¹⁹³ Englesi parafrazon këtu një pjesë nga vepra e Sh. Furjesë. „Théorie de l'unité universelle”, vol. III, 2 — me éd.; Oeuvres complètes, t. IV, Paris, 1841, p. 120 (Sh. Furje. „Teoria e unitetit universal”, vëll. III, bot. i 2-të; Vepra të plota, vëll. IV, Paris, 1841, f. 120); botimi i parë i kësaj vepre doli me titullin: „Traité de l'association domestique-agricole” T. I.—II, Paris-Londres, 1882. — 91

¹⁹⁴ *Dafnis* dhe *Kloe* — heronj të një romani të lashtë grek të shek. II—III; për autorin e tij, Longen, nuk dimë asgjë. — 98

- 195 Shih „Kënga e Nibelungëve”, kënga e dhjetë. — 100
- 196 „Gudrun” (ose „Kudrun”) — poemë mesjetare epike gjermane e shek. XIII. — 100
- 197 Shih K. Marks e F. Engels. „Manifesti i Partisë Komuniste”. bot. shqip, 1968, f. 2—10. — 102
- 198 L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 491—492. — 107
- 199 L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 85—86; Engelsi e jep citatin sipas „Konspektit të librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë” të Marksit (shih. „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 71). — 114
- 200 Është fjala për pushtimin e Meksikës nga konkvistadorët spanjollë më 1519—1521. — 116
- 201 L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 115. — 118
- 202 Këtu dhe më tutje Engelsi ka parasysh veprën e Tacitit „Gjermania”. — 119
- 203 *Meksikanët e rinj* — shih shënimin 151. — 121
- 204 „Kombi asnjans” — kështu quhej në shek. XVII bashkimi ushtarak i disa fiseve indiane të afërta me irokezët e që banonin në brigjet veriore të liqenit Eri. Ky bashkim u quajt kështu prej kolonizatorëve francezë ngaqë ai ruante asnjansinë në luftërat midis fiseve të irokezëve të mirëfilltë dhe të guronëve. — 125
- 205 Është fjala për luftën nacionalçlirimtare të zuluve dhe të nubianëve kundër kolonizatorëve anglezë. Të sulmuar nga anglezët në janar të vitit 1879, zulutë, me udhëheqësin e tyre Ketyvajo në krye, u bënë për gjashtë muaj me radhë një rezistencë jashtëzakonisht të vendosur trupave të kolonizatorëve anglezë. Këta të fundit mundën të korrnin fitoren vetëm pas shumë luftimesh, në saje të epërsisë së madhe që kishin në armatime. Vetëm më vonë, më 1887, anglezët mundën t'i nënshtronin përfundimisht zulutë duke shfrytëzuar luftën vëllavrasëse të provokuar prej tyre, që vazhdoi disa vjet, midis fiseve të ndryshme zulu.
- Kryengritja nacionalçlirimtare e nubianëve, e arabëve dhe e kombësive të tjera të Sudanit, me predikatorin mysliman Muhamed-Ahmetin në krye, që u vetëquajt „mahdi”, d.m.th. „shpëtimtar”, filloi më 1881 dhe korri suksese të veçanta më 1883—1884, kur pothuajse tërë territori i Suda-

nit u çlirua nga trupat e kolonizatorëve anglezë që kishin depërtuar në Sudan në vjetët 1870—1880. Gjatë kryengritjes u formua shteti i centralizuar dhe i pavarur mahtist. Vetëm më 1899 trupat e kolonizatorëve anglezë, duke përfituar nga dobësimi i brendshëm i këtij shteti për shkak të luftërave të vazhdueshme dhe të grindjeve midis fiseve, si dhe duke u mbështetur në epërsinë dërrmuese të armatimeve, e pushtuan Sudanin. — 125

²⁰⁶ Është fjala për fjalimin që mbajti Demosteni në gjyq kundër Eubulidit. Në këtë fjalim përmendet zakoni i lashtë që në varret e gjinisë të varroseshin vetëm njerëz të asaj gjinie. — 129

²⁰⁷ K. Marks. „Konspekt i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” (shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 134). — 130

²⁰⁸ Pjesa që përmend këtu Engelsi nga vepra e filozofit të lashtë grek Dikeark, vepër që nuk ka arritur deri në ditët tona, është dhënë në librin e Vaksmutit „Hellenische Alterthumskunde aus dem Gesichtspunkte des Staates”. Th. I., Abth. I. Halle, 1826. S. 312. — 130

²⁰⁹ K. Marks. „Konspekt i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” („Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 136). — 131

²¹⁰ K. Marks. „Konspekt i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” (shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 132). — 131

²¹¹ G. Grote. „A History of Greece”. A New Ed., vol. III, London, 1869, p. 60. Ky citat është dhënë nga Marksii (me vërejtje në kllapa) në „Konspektin e librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” (Shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit” vëll, IX, f. 138). — 132

²¹² K. Marks. „Konspekt i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” (shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll IX, f. 138—139). — 133

²¹³ Homeri. „Iliada”, kënga e dytë. — 133

²¹⁴ Dionisi nga Halikanrasi. „Historia e Romës së Vjetër”, libri II, kap. 12. — 135

²¹⁵ Eskili. „Shtatë kundër Tebës”. — 135

²¹⁶ K. Marks. „Konspekti i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” (shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 138—139). — 133

sit", vëll. IX, f. 143); citohet një pjesë nga libri: L. H. Morgan. „Ancient society”. London, 1877, p. 248. — 136

²¹⁷ Homeri. „Iliada”, kënga e dytë. — 137

²¹⁸ Shih K. Marks. „Konspekt i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” (Shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 144—145). — 138

²¹⁹ Tukididi. „Historia e luftës së Peloponezit”, lib. I, kap. 13. — 138

²²⁰ Aristoteli. „Politika”, lib. III, kap. 10 — 139

²²¹ Është fjala për të drejtën e ushtrimit të detyrave civile që u dha klasës së katërt të qytetarëve të Athinës — fetëve (njerëzve të lirë por të vobektë), gjë që sipas disa burimeve i vishet Aristidhit (shek. V para erës sonë). — 151

²²² Është fjala për të ashtuquajturit metekë — të huaj që u ngulën për banim të përhershëm në Atikë; ndonëse ishin të lirë, ata nuk gëzonin të drejtat e qytetarëve të Athinës (të drejtën për të ushtruar detyrat shoqërore, për të marrë pjesë në kuvendet e popullit, për të zotëruar pasuri të patundshme, etj.). Ata merreshin kryesisht me zejтари dhe me tregti, ishin të detyruar të paguanin një tatim të posaçëm dhe të kishin „ndorës” ndër qytetarët që gëzonin të drejta të plota, nëpërmjet të cilëve ata mund t'u drejtoheshin organeve të qeverimit. — 152

²²³ Në vjetët 510—507 para erës sonë, Klisteni, përfaqësues i gjinisë së Alkmeonidëve, udhëhoqi luftën e demosit të Athinës kundër sundimit të aristokracisë së vjetër gjinore; si rezultat ajo u përmbys dhe u bënë reforma që kishin për qëllim zhdukjen e mbeturinave të rendit gjinor — 152

²²⁴ Shih L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 271. — 152

²²⁵ Në vitin 560 para erës sonë pushtetin në Athinë e rrëmbeu përfaqësuesi i një gjinie aristokratike të rrënuar, Pisistrati, i cili vendosi një regjim qeverisjeje personale — tiraninë. Ky regjim qëndroi më këmbë me ndërprerje (Pisistrati u dëbua dy herë nga Athina dhe u kthye përsëri) deri në vdekjen e Pisistratit më 527, dhe pas saj deri në 510, kur i biri, Hipi, u dëbua dhe fill pas dëbimit të tij në Athinë u vendos sundimi i demokracisë skllavopronare me Klistenin në krye. Veprimtaria e Pisistratit, që synonte të mbronte interesat e pronarëve të vegjël dhe të mesëm të

tokës kundër aristokracisë gjinore, nuk pruri ndonjë ndryshim të rëndësishëm në strukturën politike të shtetit të Athinës. — 155

²²⁶ *Ligjet e Dymbëdhjetë tabelave* — monumenti më i lashtë i së drejtës romake. U përpiluan aty nga mesi i shekullit V para erës sonë si rezultat i luftës së plebejve kundër patricëve dhe zunë vendin e së drejtës zakonore, që kishte qenë deri në atë kohë në fuqi në Romë; këto ligje pasqyruan proceset e diferencimit pasuror të shoqërisë romake, të zhvillimit të skllavërisë dhe të formimit të shtetit skllavopronar; këto ligje qenë shkruar në dymbëdhjetë dërrasa (tabela). — 157

²²⁷ Është fjala për betejën në *Pyllin e Teutoburgut* (viti 9 i erës sonë) midis fiseve gjermane që kishin ngritur krye kundër pushtuesve romakë dhe trupave romake, të komanduara nga Vari. Kjo betejë përfundoi me disfatën e romakëve dhe me vdekjen e prijësit të tyre. — 157

²²⁸ *Api Klaudi* u zgjodh për vitin 451 dhe 450 para erës sonë në komisionin e të dhjetëve (decemvirëve), të ngarkuar me hartimin e ligjeve që u bënë të njohura si ligje të Dymbëdhjetë tabelave; gjatë kësaj kohe komisioni ishte veshur me të gjitha fuqitë; me kalimin e këtij afati Api Klaudi, së bashku me decemvirët e tjerë, u mundua me anë të uzurpimit ta zgjaste pushtetin e komisionit edhe për vitin 449; por dhuna dhe arbitrariteti i decemvirëve, sidomos i Api Klaudit, shkaktuan kryengritjen e plebejve që çoi në përmbyshjen e decemvirëve; Api Klaudi u burgos dhe pas pak kohe vdiq.

Lufta e dytë punike (218—201 para erës sonë) — një nga luftërat që kanë bërë midis tyre dy nga shtetet skllavopronare më të mëdha të lashtësisë — Roma dhe Kartagjena — për vendosjen e sundimit në Mesdheun Perëndimor, për pushtimin e territoreve të reja dhe për sigurimin e skllavëve. Lufta përfundoi me disfatën e Kartagjenës. — 159

²²⁹ Këtu Engelsi përmend përsëri vërejtjen e bërë nga Marksi në lidhje me gjininë e grekëve (shih „Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 134). — 159

²³⁰ Tit Livi. „Historia e Romës që nga themelimi i qytetit”. — 160

²³¹ B. G. Niebuhr. „Römische Geschichte”. Th. I—III (B. G. Niebur, „Historia e Romës”. Fj. I—III); Engelsi jep një citat nga pjesa e parë, botimi i parë i së cilës doli në Berlin më 1811. — 165

²³² Th. Mommsen. „Römische Geschichte“. Bd. i Buch I, Kap. 6 (T. Momzen. „Historia e Romës“, vëll. I, lib. I, kap. 6); botimi i parë i vëllimit të parë të kësaj vepre doli në Lajpoig më 1854. — 166

²³³ Dureau de la Malle. „Economie politique des Romains“. T. I—II, Paris, 1840 (Duro de la Mal. „Ekonomia politike e romakëve“. Vëllimet I—II, Paris, 1840), Është fjala për tabelat krahasuese të masave të lashta dhe të reja, si dhe të njësive monetare që gjenden në fund të vëllimit të parë. — 168

²³⁴ J. F. M'Lennan. „Primitive Marriage“. Edinburgh, 1865. — 170

²³⁵ M. Kovalevsky. „Tableau des origines et de l'évolution de la famille et de la propriété“. Stockholm, 1890. — 170

²³⁶ Pushtimi i Uelsit nga anglezët përfundoi më 1283, porse edhe pas kësaj Uelsi vazhdoi ta ruante autonominë e vet; ai u bashkua plotësisht me Anglinë nga mesi i shek. XVI. — 171

²³⁷ Në vjetët 1869—1870 Engelsi u muar me një vepër të madhe kushtuar historisë së Irlandës, vepër që mbeti e papërfunduar (sish një pjesë të kësaj vepre të shkruar nga Engelsi në bot. e 2-të rusisht të Veprave të K. Marksit e të F. Engelsit, vëll. 16, f. 479—524; një pjesë e materialeve të përgatitura për të gjendet në „Arkivin e Marksit dhe të Engelsit“, vëll. X. 1948, f. 100—263), dhe në lidhje me studimin e historisë së keltëve ai studjoi edhe ligjet e Uelsit të Vjetër. — 171

²³⁸ Engelsi citon librin: „Ancient Laws and Institutes Wales“, Vol. I, 1841, f. 93 („Ligjet dhe dispozitat e lashta të Uelsit“, vëll. I, 1841, f. 93). — 172

²³⁹ Në shtator të vitit 1891 Engelsi bëri një udhëtim nëpër Skoci dhe Irlandë. — 174

²⁴⁰ Në vjetët 1745—1746 në Skoci shpërtheu kryengritja e klaneve të malësorëve kundër padrejtësive dhe zaptimit të tokave të tyre në interes të aristokracisë anglo-skoceze të tokës dhe të borgjezisë; malësorët luftonin për ruajtjen e organizimit të vjetër gjinor. Pakënaqësinë e malësorëve e shfrytëzoi një pjesë e aristokracisë së Skocisë malore, që kishte interes të ruhej sistemi patriarkal feudal i klaneve dhe që i vuri si qëllim kryengritjes rivendosjen e dinastisë së Stjuartëve në fronin e Anglisë. Pas sukseseve të përkoh-

shme që korri në fillim, ushtria e kryengritësve u thye. Si rezultat i shtypjes së kryengritjes sistemi i klaneve në Skocinë malore u prish, mbeturinat e zotërimit gjinor të tokës u likuiduan, u intensifikua procesi i dëbimit të fshatarëve skocezë nga toka u hoqën gjyqet gjinore dhe u ndaluan disa zakone gjinore. — 175

²⁴¹ L. H. Morgan. „Ancient Society”. London, 1877, p. 357, 358. — 175

²⁴² Beda Venerabilis. „Historia ecclesiastica gentis Anglorum”. — 175

²⁴³ Cezari. „Shënime rreth luftës me galët”, lib. VI, kap. 22. — 176

²⁴⁴ „E drejta alemane” — kod i së drejtës zakonore të bashkimit të fiseve gjermane të alemanëve (alamanëve), që zinte prej shek. V territorin e Alsasës së sotme, të Zvicrës Lindore të sotme dhe të Gjermanisë Jugperëndimore; i përket fundit të shek. VI. — fillimit të shek. VII dhe shek. VIII. Engelsi i referohet këtui ligjit LXXXI (LXXXIV) të „Së drejtës alemane”. — 176

²⁴⁵ Është fjala për veprat e M. M. Kovalevskit „E drejta primitive. Fash. 1. Gjinia”. M., 1886 dhe „Tableau des origines et de l'évolution de la famille et de la propriété”. Stockholm, 1890 — 176

²⁴⁶ „Kënga e Hildebrandit” — poemë heroike, monument i poezisë epike të lashtë gjermane të shek. VIII, nga i cili janë ruajtur vetëm disa fragmente. — 177

²⁴⁷ Taciti. „Gjermania”, kap. 7. — 178

²⁴⁸ Diodori nga Sicilia. „Biblioteka historike”, lib. IV, kap. 34, 43—44. — 178

²⁴⁹ „Völuspá” („Vegimi i profeteshës”) — njëra prej këngëve të „Edës së moçme” (shih shënimin 162) — 179

²⁵⁰ Është fjala për këto vepra: A. Ch. Bang. „Vluspá og de sibyllinske orakler”. 1879 (A. K. Bang. „Vegimi i profeteshës dhe orakujt e sibilës”, 1879) dhe S. Bugge. „Studier over de nordiske Gude — og Heltesagns Oprindelse”. Kristiania, 1881—1889 (S. Bugge. „Studime mbi prejardhjen e sagave skandinave, mbi perënditë dhe mbi heronjtë”. Kristiania, 1881—1889). — 179

²⁵¹ Kryengritja e fiseve gjermane dhe gale nën udhëheqjen e Civilisit kundër sundimit romak, e shkakuar nga

shtimi i taksave, i rekrutimeve në ushtri dhe nga shpërdorimet e funksionarëve romakë, u zhvillua në vjetët 69—70 (sipas disa burimeve të vjetëve 69—71) në një pjesë të madhe të Galisë dhe të krahinave gjermane që ishin nën sundimin e Romës, duke krijuar rrezikun që Roma t'i humbiste këto territore. Pas sukseseve që korrën në fillim, kryengritësit pësuan disa disfata dhe qenë të detyruar të përfundonin një paqe me Romën. — 180

²⁵² Cezari. „Shënime rreth luftës me Galët”, lib. IV, kap. I. — 179—182

²⁵³ Taciti. „Gjermania”, kap 26. — 183

²⁵⁴ „Codex Laureshamensis” — përmbledhje kopjesh të akt dhurimeve dhe të privilegjeve të manastirit të Lorchit, të themeluar në gjysmën e dytë të shek. VIII në Shtetin e frankëve afër qytetit Vormes. Ky manastir ishte një pronë e madhe feudale në Gjermaninë Jugperëndimore; përmbledhja, e bërë në shek. XII, është një nga burimet më të rëndësishme përsa i përket historisë së pronës fshatare dhe feudale të tokës në shekuj VIII-IX. — 184

²⁵⁵ Plini. „Historia e natyrës në 37 libra”, lib. XVIII, kap. XVII. 185

²⁵⁶ Plini. „Historia e natyrës në 37 libra”, lib. IV, kap XIV. — 191

²⁵⁷ *Ibëret*, popull i kohës së lashtë që ka banuar në një pjesë të Gadishullit Iberik, në ishujt e brigjeve të Mesdheut dhe në juglindje të Francës së sotme.

Ligurët, popull që ka banuar qysh në kohë të lashta në pjesën më të madhe të Gadishullit Italik; në shekullin VI para erës sonë ligurët u dëbuan nga popullsitë italike në drejtim të veriperëndimit të gadishullit dhe në brigjet jugore të Galisë.

Norikët, popuj iliro-keltë që banonin në Norikën e lashtë, provincë e Perandorisë Romake, sot territor i Stirisë dhe pjesërisht i Karintisë (Austri). — 192

²⁵⁸ Liutprandi nga Kremona. „Shpërblimi”, lib. VI, kap. 6. — 196

²⁵⁹ Salviani nga Marseja. „De gubernatione dei” („Mbi qeverisjen hyjnore”), lib. V, kap. 8. — 197

²⁶⁰ *Benefici* (beneficium, fjalë për fjalë mirëbërje, dhuratë) — një formë e dhurimit të tokës, shumë e përhapur në Shtetin e frankëve në gjysmën e parë të shek. VIII. To-

ka që jepej në formë benefioi, bashkë me fshatarët e varur që jetonin aty, kalonte në përdorim të përdorshëm të abij që e merrte (të beneficiarit), me kusht që ai të kryente disa shërbime të caktuara, më të shumtën e herës me karakter ushtarak. Në rast vdekjeje të dhuruesit ose të beneficiarit, si dhe në rast se ky i fundit nuk i plotësonte detyrimet e veta dhe e linte pas dore pronën, benefici duhej t'i kthehej pronarit ose trashëgimtarëve të tij, dhe për rivendosjen e marrëdhënieve benefciale duhej një akt i ri dhurimi. Ndarjen e beneficeve nuk e përdorte vetëm pushteti mbretëror, por edhe kisha dhe manjatët e mëdhenj. Sistemi i beneficeve ka kontribuar në formimin e klasës së feudalëve, sidomos të fisnikërisë së vogël dhe të mesme, në skllavërimin e masave fshatare, në zhvillimin e marrëdhënieve vasalore dhe të hierarkisë feudale. Më vonë beneficet u shndërruan në feude të trashëgueshme. Rrollin e sistemit të beneficeve në historinë e formimit të feudalizmit Engelsi e ka treguar në veprën e vet „Periudha e frankëve” (K. Marks e F. Engels, Veprat, bot. i 2-të, rus., vëll. 19, f. 495—546). — 199

²⁶¹ *Kontët e distrikteve* (Gaugrafen) — funksionarë të mbretit në Shtetin e frankëve, të vënë në krye të distrikteve ose të konteve. Çdo kont ishte i veshur me pushtetin gjyqësor në distriktin e vet, vilte në të tatimet dhe komandonte ushtrinë në kohë fushatash. Për shërbimet e veta ai gëzonte të drejtën e një të tretës së të ardhurave mbretërore në distriktin e vet dhe, si shpërblim, mbreti i dhuronte toka. Më vonë kontët u shndërruan dalngadalë nga ofiqarë që emëronte mbreti në senjorë të mëdhenj feudale të veshur me pushtet sovran, sidomos pas vitit 877, kur u vendos zyrtarisht që ofiqi i kontit të bëhej i trashëgueshëm. — 200

²⁶² Është fjala për poliptikun (listë e zotërimeve të tokës, e popullsisë dhe e të ardhurave) e manastirit të Sen-Zhermen-dë-Prisë, i hartuar në shek. IX dhe i njohur me emrin „Poliptiku i abatit Irminon”. Me sa duket, të dhënat nga poliptiku Engelsi i sjell sipas librit: P. Roth. „Geschichte des Beneficialwesens von den ältesten Zeiten bis ins zehnte Jahrhundert”. Erlangen, 1850, S. 378 (P. Roth. „Historia e sistemit të beneficeve qysh prej kohërave më të lashta e deri më shekullin e dhjetë”. Erlangen, 1850, f. 378). — 201

²⁶³ *Angarilë* — detyrime me të cilat ngarkoheshin banorët në Perandorinë Romake. Në bazë të tyre ata duhej

të jepnin kuaj dhe njerëz për të siguruar transportimet shtetërore; më vonë muarën karakter më të gjerë dhe u bënë një barrë e rëndë për popullin. — 201

²⁶⁴ *Komenda* — një nga format e rënies së fshatarëve „ndore” feudalëve, ose e rënies së feudalëve të vegjël „ndore” feudalëve të mëdhenj me kushte të caktuara (shërbimi ushtarak dhe shërbime të tjera në dobi të „ndorësit”, kalimi i tokës në duart e tij për ta rimarrë prej tij me kusht), e përhapur në Evropë qysh prej shekujve VIII—IX. Për fshatarët, të cilëve shpeshherë ky akt u imponohej me forcë, kjo shënonte humbjen e lirisë personale, kurse për feudalët e vegjël rënien e tyre në marrëdhënie vasaliteti me feudalët më të mëdhenj. Komenda ka kontribuar, nga njëra anë, në skllavërimin e fshatarësisë, e, nga ana tjetër — në konsolidimin e hierarkisë feudale. — 203

²⁶⁵ Ch. Fourier. „Théorie des quatre mouvements et des destinées générales”, 3-me éd.; Oeuvres complètes, t. I, Paris, 1846, p. 220 (Sh. Furje. „Teoria e katër lëvizjeve dhe e fateve të përgjithshme”. bot. i 3-të; Vepra të plota, vëll. I, Paris, 1846, f. 220); botimi i parë i librit doli në Lion më 1808 pa emrin e autorit. — 204

²⁶⁶ „Kënga e Hildebrandit” — shih shënimin 246.

Në *Histings* më 1066 trupat e dukës së Normandisë, Vilhelmit, që kishin invaduar Anglinë, u ndeshën me anglosaksonët. Trupat anglosaksonë, që kishin ruajtur në organizimin e vet ushtarak mbeturina të rendit të komunës dhe përdornin armatime primitive, u thyen, mbreti i anglosaksonëve Harold u vra në luftë, kurse Vilhelmi u bë mbret i Anglisë me emrin Vilhelmi I Pushtuesi. — 213


²⁶⁷ K. Marks. „Konspekt i librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lashtë”” („Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 153—154). — 215

²⁶⁸ *Ditmarsheni* — krahinë në pjesën jugperëndimore të Shlezvig-Holshtajnit të sotëm. Në kohërat e lashta banohej nga saksët, në shek. VIII u pushtua nga Karli i Madh, pastaj u bë pronë feudalësh të ndryshëm kishtarë e shekullarë. Qysh prej mesit të shek. XII popullsia e Ditmarshenit, në të cilën mbizotëronin fshatarët e lirë, dalngadalë fitoi mëvetësinë, dhe prej fillimit të shek. XIII deri nga mesi i shek. XVI në fakt ka gëzuar pavarësinë, duke përballuar me sukses orvatjet e shumta të mbretërve danezë dhe të dukëve të Holshtajnit për ta pushtuar këtë krahinë. Zhvillimi shoqëror i Ditmarshenit

ka ndjekur një rrugë mjaft origjinale: fisnikëria e vjetër vendase aty nga shek. XIII në fakt që zhdukur, gjatë periudhës së pavarësisë Ditmarsheni ishte një tërësi komunash fshatare që vetëqeveriseshin e që në shumë raste kishin si bazë gjinitë e vjetra fshatare. Deri në shek. XIV pushteti suprem në Ditmarshen i takonte kuvendit të të gjithë pronarëve të lirë të tokës, pastaj ai kaloi në duart e tri kolegjiëve të zgjedhura. Në vitin 1559 trupat e mbretit danez, Frederikut II, dhe të dukëve të Holishtajnit, Johan dhe Adolf, e thyen rezistencën e popullsisë së Ditmarshenit dhe kjo krahinë u nda midis fituesve. Porse organizimi në komuna dhe një vetëqeverisje e pjesshme u ruajtën në Ditmarshen deri në gjysmën e dytë të shek. XIX. — 222

²⁶⁹ G. W. F. Hegel. „Grundlinien der Philosophie des Rechts”, §§ 257 dhe 360 (G. V. F. Hegel. „Bazat e filozofisë së të drejtës”, §§ 257 dhe 360); botimi i parë i kësaj vepre doli në Berlin më 1821. — 222

²⁷⁰ Një pjesë të copës së cituar Marksi e ka dhënë në „Konspektin e librit të Luis H. Morganit „Shoqëria e lash-të”” („Arkivi i Marksit dhe i Engelsit”, vëll. IX, f. 56—57). — 234



PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----|
| Parathënie për botimin e parë | 5 |
| Parathënie për botimin e katërt gjermanisht | 9 |
| I. Shkallët parahistorike të kulturës | 27 |
| 1. Egërsia | 28 |
| 2. Barbaria | 30 |
| II. Familja | 36 |
| III. Gjinia e irokezëve | 108 |
| IV. Gjinia greke | 128 |
| V. Lindja e shtetit të Athinës | 141 |
| VI. Gjinia dhe shteti në Romë | 156 |
| VII. Gjinia e keltëve dhe e gjermanëve | 170 |
| VIII. Formimi i shtetit të gjermanëve | 190 |
| IX. Barbaria dhe qytetërimi | 206 |
| Shënime | 235 |

FRIDRIH ENGELS

ORIGJINA E FAMILJES,
E PRONËS PRIVATE DHE E SHTETIT

Kopertinën dhe redakturën teknike

Shyqri Kushevcica

Korrektor

Kujtim Spahiu

Tirazhi 4.000 copë

U shtyp në prill të vitit 1976
në Shtypshkronjën e Ndërmarrjes
gazetare, botuese e grafike
„Rilindja” — Prishtinë